


# TIRANA

## Sfida e Zhvillimit Urban

BESNIK ALIAJ KEIDA LULO GENC MYFTIU









TIRANA  
Sfida e Zhvillimit Urban



# TIRANA

## Sfida e Zhvillimit Urban

Besnik Aliaj  
Keida Lulo  
Genc Myftiu





## Mirënjohje

Ky libër është përgatitur mbi bazën e një pune kërkimore shkencore dhe të kontakteve dhe bashkëpunimeve me një numër institucionesh shkencore apo individësh që në fillim të viteve 90 dhe deri në ditët tona.

### Falenderojmë në mënyrë të veçantë:

Të gjithë stafin e Co-PLAN, dhe në veçanti partnerët strategjikë të Co-PLAN, të cilët bënë të mundur punën e tij: CORDAID dhe NOVIB, Hollandën, dhe Ambasadën e Mbretërisë së Hollandës në Tiranë.

Z. Flamur Kuci, Z. Zhani Canco, Z. Artan Basha,  
Z. Agim Mero, Z. Koco Miho, Z. Agron Lufi (Tiranë);  
Z. Ferdinando Semboloni, Z. Carlo Canepari (Faculty of  
Architecture, University of Florence, Italy);  
Z. Giovanni Sergi (University of Ancona, Italy). Ms. Silvia  
Russo (University of Turin, Italy)

Drejtorinë e Përgjithëshme të Arkivave të Shtetit; Arkivën  
Qendrore Teknike të Ndërtimit, Projektin e Manaxhimit të  
Tokës Urbane, Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe  
Turizmit; Fakultetin e Ndërtimit, Universitetin Politeknik të  
Tiranës; Projektin "Tempus" të EU, etc.

### Shënim

Autorët janë të interesuar të marrin komente në adresat  
[seda@albnet.net](mailto:seda@albnet.net) dhe [co-plan@co-plan.org](mailto:co-plan@co-plan.org)

Kjo guidë është publikuar edhe në Internet në adresat:  
[www.co-plan.org](http://www.co-plan.org) dhe [www.seda.org.al](http://www.seda.org.al)

### Autorët:

Besnik Aliaj      Kejda Lulo      Genc Myftiu

### së bashku me:

Prof. Kristo Frashëri, Prof. Muzafer Korkuti, Prof. Dr. Josif Papagjoni,  
Prof. Ferid Hudhri, Prof. Andromaqi Gjergji

### Botues dhe Editor:

Genc Myftiu, Kryetar OJF SEDA

### Fotot janë mbledhur nga:

Ark/Urb. Besnik Aliaj, Ark. Keida Lulo, Prof. Muzafer Korkuti, Prof. Dr.  
Josif Papagjoni, Prof. Ferid Hudhri, Genc Myftiu, Prof. Andromaqi Gjergji,  
Co-PLAN

### Foto të reja janë realizuar nga:

Petrit Kenuti, Besnik Aliaj, Genc Myftiu

### Pregatitja digitale për botim:

Enkeleida Myfiu, Spartak Ludi, Flamur Kuci

### Ky botim është nismë e:

Co-PLAN, Institute for Habitat Development  
dhe OJF SEDA

### Ky botim është financuar nga:

Co-PLAN, Institute for Habitat Development

### ISBN

### Të gjitha të drejtat i rezervohen:

SEDA dhe Co-PLAN

Shtypur dhe lidhur në Shtypshkronjën: GVG



Rr. VAso Pasha Pall13/1 KAti 6 Ap 3  
Mobile: ++355692020319  
Fax: ++355 4 257623  
e-mail: [seda@albnet.net](mailto:seda@albnet.net)  
[www.seda.org.al](http://www.seda.org.al)



Institute for Habitat Development  
**Instituti per Zhvillimin e Habitatit**  
Str. Dervish Hima, Ada Tower, Ap.4, KP 2995, Tirana Albania  
Tel: +355.(0)4.257808/9; Fax: +355.(0)4.257807  
Mobile: +355 (0)69.20.34126/32957  
E-mail: [co-plan@co-plan.org](mailto:co-plan@co-plan.org)  
Internet: <http://www.co-plan.org>



## *Një ëndërr që kërkon akoma shumë punë për t'u bërë realitet*

*“Mez’ i Shqipërisë, do-me-thënë kryeqytet’ i përgjithçim, do te jetë një nga qytetet, që ndodhenë në mest të Shqipërisë, e në të cilët te flitetë gjuha shqip. Po më mirë do të qe të bëhesh një qytet i ri në mest të Shqipërisë më një vend të shëndëçim e të bukurë. Ky qytet të cilën mundimë ta quajmë Skënderbegas, do të goditetë më një mëndyrë fort të bukurë, me udhë të gjëra e të drejta, me shtëpi të mira, me sheshe e me gjithë ç’duhetë; edhe ne pakë kohë mund të rritet’ e të madhohetë shumë, se gjithë parësi e Shqipërisë e Shqipëtarët’ e xgjuarë do të kenë nevojë të mblidhenë e të bëjnë shtëpi atje.*

*Kështu ky qytet i ri do të jet’ i çpënguarë nga gjithë zakonet’ e keq, që kanë qytetet e vjetërë; edhe me qënë që ndënjësit’ e ti do të jenë të mbledhurë nga gjithë anët e Shqipërisë, edhe gjuha që të flitetë atje, do të jet’ e përzjerë, që të muntnjë të quhetë gjuh’ e përgjithçme e gjuhë letrarishte e gjithë Shqipërisë.*

*Ky qytet me pak vënde rrotull do të qeverisetë si një nënëgastr’ e veçantë.”*

*Sami Frashëri*

*Marrë nga “SHQIPËRIA Ç’KA QËNË, Ç’ËSHTË DHE Ç’DO TË JETË”  
botuar më 1899, duke parashikuar të ardhmen e kryeqytetit që është bërë realitet në shumë aspekte.*

## *Parathënie*

Qyteti i Tiranës dhe zona metropolitane përreth është një shembull tipik dhe kompleks i një qyteti në tranzicion, i një tranzicioni të vazhdueshëm dhe që përfshin struktura mikse e ndodhi historike. Tirana është një simbol i kulturës urbane në Shqipëri, kulturë e zhvilluar fare pranë detit dhe malit duke ruajtur kulturat Ilire, Romake dhe Bizantine në një atmosferë orientale ku elementet Europiane dhe ato tipike Mesdhetare dhe Ballkanase, kanë mbijetuar si në sistemet më autoritare të planifikimit urban (fashist dhe komunist) ashtu edhe në kaosin më anarkist të mesjetës dhe të kohërave moderne të kapërcimit të mijëvjeçarit të dytë...

*Shkurt, Tirana është një nga qytetet më dinamike të Evropës dhe përfaqëson në vetvete një qytet me një tranzicion tipik dhe të tejzgjatur që përbën akoma sfidën më kryesore dhe më dramatike të ditëve tona.*

Që prej vitit 1920, qyteti i Tiranës ka qënë objekt i studimeve dhe i punimeve për të përmirësuar arkitekturën dhe zhvillimin urban. Disa studime të rëndësishme janë bërë veçanërisht prej 1994 deri në ditët tona ku dallohen “Plani Strategjik për Tiranën e Madhe dhe Bashkinë Kamëz”, studim i cili përmbledh në vetëvete zgjidhjen e mjaft çështjeve të ndërlikuara sociale dhe ekonomike, koncepte të përdorimit të tokës si edhe aktivitetet e mundshme ekonomike, infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim normal duke përfaqësuar deri tani një studim urban shkencor me vlera të mëdha për Tiranën dhe Shqipërinë.

Në vigjilje të mijëvjeçarit Bashkia e Tiranës filloi punime urbane të rëndësishme të cilat po i ndryshojnë imazhin kryeqytetit të vendit. Synimi i bashkisë është të përgatisë një vizion zhvillimi fleksibël dhe të përshtatshëm për ndryshimet e vrullshme të qytetit. Ky vizion i ri kërkon një reformë totale të legjislacionit të planifikimit të zonave urbane si një proces që duhet të ecë me ritme të njëjta me zhvillimin e qytetit. Rregulloret e reja të urbanistikës për Tiranën mund të shërbejnë si një pikë fillimi për hartimin e Ligjit të Planifikimit Urban për të cilin ka nevojë të ngutëshme i gjithë vendi. Hartimi i një Plani Rregullues të ri si një proces në partneritet me shumë institucione të specializuara dhe të gjithë grupet e interesuara dhe komunitetet, pavarësisht diferencave që mund të ekzistojnë ndërmjet tyre, ka të ngjarë që të jetë e vetmja mënyrë për të parandaluar kaosin urban që kemi përjetuar deri tani në këtë periudhë tranzicioni. Le të shpresojmë për një ndryshim pozitiv në të ardhmen. Në rast të kundërt çdo iniciativë e izoluar individuale ka treguar se është e destinuar të deshtojë.

Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se autoritetet e Bashkisë së Tiranës duken tashmë të ndërgjegjshëm se hartimi i një plani të ri rregullues nuk duhet mbivlerësuar. Ky plan nuk i zgjidh automatikisht të gjitha problemet e komplikuara të Tiranës, por ky plan mund të rrisë transparencën dhe mund të udhëzojë më mirë administratën e bashkisë në



mund të rrisë transparencën dhe mund të udhëzojë më mirë administratën e bashkisë në procesin e përvijimit të një vizioni më të qartë për zhvillimin e qytetit duke përmirësuar llogjikën e zhvillimit me shpresën që të mos ndodhin përsëri ngjarje urbane të padëshëruara, dëshmitarë të të cilave kemi qënë gjatë gjithë dekadës së fundit.

Në se do te punohet për qytetin dhe qytetarët, e jo për lobet e caktuara ekonomike, Tirana ka shans te rikuperohet nga gabimet. Ky është edhe kriteri më i mirë për të vlerësuar performancën dhe suksesin apo dështimin e çdo administrate bashkiake dje, sot dhe në të ardhmen.

Mbi bazën e mësimëve të nxjerra nga planifikimi urban i së shkuarës, duke marrë në konsideratë zhvillimet urbane të kohës sonë, si edhe në këndvështrimin e planeve të reja urbane për rajonin e Tiranës (të cilat përshkruhen gjerësisht në këtë libër), *e ardhmja e Tiranës është një sfidë zgjidhja e së cilës varet nga kontributet e qytetarëve, roli i komuniteteve dhe biznesit si edhe nga udhëheqesit e administratës publike*. Tirana e ka një shans të mirë për t'u bërë qytet konkures në Ballkan, duke krijuar mundësira për biznesin vendas dhe të huaj si edhe për të krijuar shërbime më të mira për banorët dhe vizitorët. Ky shans nuk duhet të humbasë. Brezat e ardhshëm nuk do të na e falin "ngathtësinë" e sotme në se nuk bëjmë ç'duhet bërë për të ndrequr gabimet në fushën urbane dekadën e fundit dhe për të ndërtuar dhe zbatuar një sistem të ri të zhvillimit urban.

Ky libër i ka fillimet e tij në vitet para të 90-s, në përsiatjet dhe punën shkencore individuale të autorëve të këtij botimi. Me kalimin e kohës ideja për të prezantuar sfidën e zhvillimit urban të Tiranës, bashkë me historinë e këtij zhvillimi, u bë më tunduese për autorët dhe më e nevojshme për kohën. Këto rrethana sollën që autorët të gjejnë njëri-tjetrin gjatë kërkimit shkencor.

Autorët e këtij botimi i përkasin një gjenerate arkitektesh dhe ekspertësh të formuar në kushtet e një mungese totale të literaturës kombëtare dhe ndërkombëtare për arkitekturën dhe zhvillimin urban. Nuk do ishte e udhës që brezat e ardhshëm të kenë të njëjtin fat. Edhe ky fakt ishte një shtysë tjetër për botimin e këtij libri. Ndryshimet dramatike të viteve 90 në Tiranë dhe Shqipëri, veçanërisht në fushën urbane, shërbyen pa dyshim si një motiv tjetër më frymëzues se të parat. Ky libër mund të pasohet në të ardhmen edhe nga libra të tjerë. Për momentin kjo nismë duhet inkurajuar, me gjithë mangesitë që mund të ketë.

Objektivi kryesor i publikimit të "Tirana, sfida e zhvillimit urban" është të nxisë qytetarët, vendim-marrësit dhe shoqërinë civile të shfrytëzojnë momentin e shpresës që ka lindur në Tiranë dhe në Shqipëri se "ky vend mund të bëhet" pavarësisht nga dështimet e shumta të së shkuarës dhe sfidat e vështira të së sotmes.

Në Pjesën e Dytë të këtij botimi përfshihen disa kapituj interesantë për historinë, dëshmitë arkeologjike, traditat, kulturën, artin dhe turizmin në Tiranë që prej krijimit të saj deri në ditët tona për të plotësuar panoramën e rajonit ku ka ndodhur dhe po ndodh ky zhvillim urban kaq original, i vrullshëm dhe sfidant për metropolin e ardhshëm Shqiptar. Autorët e tyre janë personalitete në fushat përkatëse.

Ky botim në Shqip bëhet pas botimit në versionin Anglisht, paraqitur në konferencën e ENHR, Rrjeti European për Studimet e Strehimit, në 26-29 Maj 2003 "Qytetet motore të zhvillimit"! Pjesmarrja e madhe prej mëse 70 vendeve të botës bëri të mundur që ky libër të entuziazmojë shumë shpejt rrethet e shkencës urbane, dhe autorët së bashku me Bashkinë e Tiranës të marrin përshëndetjet e para të ngrohta nga dashamirësit e miqtë e huaj dhe vendas.

Nëse botimi në Anglisht u bë për të kontribuar sa më shpejt në ndërtimin e imazhit të një Shqipërie që mund të bëhet, botimin në Shqip autorët e vlerësojnë si një detyrim moral dhe kulm të punës së tyre shumëvjeçare për të bashkëbiseduar me kolegët, mësuesit dhe nxënësit e gjithë brezave që mund të lexojnë sot dhe atyre që do të lexojnë nesër.

Si përfundim, autorët e këtij botimi besojnë se Tirana do t'ia dalë mbanë "të bëhet" në se shumë duar, zemra dhe mendje do të punojnë së bashku "për ta bërë atë". Po në këtë kuadër autorët i presin me kënaqesi çdo koment dhe ide për t'a diskutuar atë në forumet qytetare për të mirën e qytetit tonë të dashur, Tiranës.

Tiranë, dhjetor 2003

Ark.Urb. **BESNIK ALIAJ**  
MA in Urban Management

Ark. **KEIDA LULO**

Ing. **Genc Myftiu**



# TIRANA

## Sfida e Zhvillimit Urban

### PËRMBAJTJA

	<i>Faqe</i>
<b>PJESA E PARË</b>	
Historia e Arkitekturës dhe Zhvillimit Urban në Tiranë	
1.Hyrje. Nga themelimi deri në1920	13
2.Nga Pavarësia deri në Luftën e II Botërore	29
3.Pushtimi Italian dhe Lufta e II Botërore	44
4.Zhvillimet gjatë ekonomisë së centralizuar	54
5.Zhvillimet në epokën post komuniste	68
6.Skenarë të Mundshëm të zhvillimit urban të Tiranës	102
7.Konkursi ndërkombëtar për qendrën e Tiranës	129
<b>PJESA E DYTË</b>	
1.Dëshmi të Vlerave Arkeologjike të Tiranës dhe përreth saj	141
2.Tirana, Një Vështrim i shkurtër Historik	151
3.Aspekte nga Jeta Tradicionale e Tiranës	191
4.Jeta Kulturore në Tiranë	201
5.Tirana Qendër e Artit Figurativ	213
6.Turizmi në Tiranë dhe rreth saj	221
<i>Bibliografi</i>	233



# PJESA E PARË

## Historia e Arkitekturës dhe Zhvillimit Urban në Qytetin e Tiranës



# QYTETI I TIRANES

## HISTORIA E ARKITEKTURES DHE E ZHVILLIMIT URBAN

### 1. NGA KRIJIMI DERI NE 1920

#### Hyrje


Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë dhe qyteti më i madh i vendit. Bashkia Tiranë zyrtarisht ka sot rreth gjashtëqindmijë banorë. Ndërsa rajoni i

Tiranës së Madhe numëron 700-800 mijë banorë. Hapësira metropolitane Tiranë - Durrës - Fushë Krujë përfshin gati 1/3 e popullsisë së vendit. Tirana ndodhet



*Pamje ajrore panoramike e qytetit të Tiranës, viti 1999*





Harta e Rajonit të Tiranës (Bashkia dhe Komunat)

thuaje në qendër të vendit dhe sot është e shtrirë të paktën në 3000 hektarë.

Qyteti i Tiranës ka një histori modeste në krahasim me shumë kryeqendra europiane. Ndërkohë që si kryeqendër e shqiptarëve por edhe për faktin se përbën një nga modelet e veçanta të zhvillimit urban në Europë, ajo meriton një vëmendje të veçantë.

Tirana është shembull tipik i një strukture të përzier midis detit dhe malit, midis trashëgimive kulturore ilire, romake, bizantine dhe atmosferës orientale; midis elementeve europiane

dhe atyre tipike mesdhetare e ballkanike; midis modeleve urbane të zhvilluara dhe atyre në zhvillim; midis disiplinës urabanistike më autoritare të kohës së komunizmit dhe kaosit më anarhist të kohëve moderne... Me pak fjalë, Tirana është një nga qytetet më dinamike në Europë dhe përfaqëson pa diskutim një qytet në tranzicion tipik të tejzgjatur deri në ditët tona.

Tranzicioni si dukuri është i pranishëm në çdo qendër të banuar, si shprehje e një procesi historik të vazhdueshëm dhe të pandërprerë të transformimit urban përgjatë kohërave.


Tirana si qytet në tranzicion përfaqëson një periudhë kalimtare të zhvillimit strukturor dhe urban në disa faza historike, produkte të shumë faktorëve, përfshi këtu ndryshimet politike, ekonomike, sociale, që kanë ndodhur pas vitit 1990 dhe në vazhdim.

Transformimi urban i vazhdueshëm ka patur ndikim të qartë mbi trashëgiminë modeste historike të qytetit, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit politik dhe ekonomik të viteve 90-të. Por për të pasur një ide më të qartë për zhvillimin e qytetit të Tiranës është shumë e rëndësishme të analizojmë zhvillimin historik të tij në këndvështrimin arkitektoniko urbanistik.

### Parahistoria dhe fillimet para shekullit të 14-të

Megjithëse origjina e Tiranës nuk është aq e lashtë sa qytetet e tjera historike të Shqipërisë si: Durrësi, Berati, Gjirokastra, Kruja, Shkodra, Elbasani, Korça, etj. Gjetjet arkeologjike në shpella të lashta tregojnë se territori ku shtrihet sot Tirana ka qenë i banuar para periudhës neolitike dhe bëhet fjalë për vendbanime prehistorike, njëri prej të cilëve ka qenë Shpella e Pëllumbasit. Fusha dhe kodrinat e Tiranës kishin mikroklimë të veçante për shkak të pozitës gjeografike dhe ndikimit zbutës të detit Adriatik, rreth 30 kilometra larg në perëndim.


Kushtet klimaterike, pasuritë e bollshme ujore me lumenj dhe përrenj, relievi i larmishëm fushor - kodrinor, prania e Malit të Dajtit si mur mbrojtës



Pamje e kullës së kalasë së Prezës



Pamje e kalasë së Petrelës, mes kodrave të Tiranës



Profili i zakonshëm panoramik i Tiranës: pamje e malit të Dajtit, parë nga qendra e Tiranës



nga erërat e ftohta të veri-lindjes, përcaktuan që rajoni i Tiranës të jetë që nga lashtësia deri më sot, një fushë pjellore bujqësore e pasur dhe terësisht e përshtatshme për të jetuar.

Gjate shekujve 3 dhe 4(e.s.), fusha e Tiranës shfrytëzohej nga popullsia lokale e fshatrave pranë kësaj fushe, e cila për arsye mbrojtje kishte ndërtuar banesa dhe fortesa kryesisht në pikat strategjike të kodrave përreth. Kjo vërtetohet nga gjetjet arkeologjike në fortifikimet dhe kështjellat përreth Tiranës si në atë të Zgërdheshit, Lalmit, Shkallës së Tujanit, Dorëzit, Kucit, Persqopit, Farkës, Bërzhitës, Bastarit, Dorakut, Ndroqit, Petrelës, Brrarit, etj.

### Pushtimi Otoman midis shekujve të 14-të dhe 20-të

Okupimi otoman i Shqipërisë, në shekullin e 14-të, e gjeti Tiranën si një kryqëzim të rëndësishëm në akset kryesore të transportit të rajonit Ballkanik dhe të vendit duke u konsideruar si një vend tranzit strategjik ndërmjet Europës kristiane dhe Turqisë orientale.

Ky pozicion gjeografik nuk mund të influenconte pozitivisht në zhvillimin arkitekturor dhe urban të qytetit për vetë natyrën kalimtare të qëllimeve të zhvillimit. Bënë përjashtim vetëm objektet e kultit, të cilat u zhvilluan sepse ishin pjesë e politikës së konvertimit të popullsisë vendase nga kristiane në muslimane.

Gjatë shekujve 16-18, xhamitë bëhen objekte përcaktuese në ndërtimin e


qendrave të qyteteve. Ato ndërtoheshin në pjesët më aktive të tyre, pranë tregut dhe ndërtimeve të tjera publike, ose në komplekse arkitekturale me objektet e mësipërme.

Edhe për Tiranën, xhamitë luajtën rol pozitiv nga pikpamja urbanistike, sepse nxitën krijimin e 5-6 "ishujve" urbanë (mbi bazë familjesh ose fisesh), të cilat me tendencën e tyre për rritje u bashkuan dhe në kombinim me traditat lokale, krijuan një skenografi, siluet dhe identitet të ri urban: Tiranën.

### Bërthamat e para urbane të qytetit të Tiranës

Bërthama e parë historike e qytetit lindi dhe hodhi shtat së bashku me xhaminë e vjetër të Sulejman Pashës në qendër të strukturës së sotme të Tiranës, pikërisht në kryqëzimin e arterieve kryesore të tranzitit tregtar ndërkrahinor. Bashkë me xhaminë në fjalë u ndërtuan edhe banesa të tjera, midis tyre edhe ato të feudalëve dhe të të afërmeve të tyre, në bregun e djathtë të përroit të Lanës.

Më tej në distancë 50-60 metra në perëndim të xhamisë u ndërtuan një furrë, një banjë publike dhe një han, tre objekte shërbimesh që ndikuan në zgjerimin e pazarit. Këto ndërtesa së bashku me banesat, ahuret, oborret, pusët, gjelbërimet rrugicat, sheshet dhe varrezat, të gjitha të përqëndruara rreth ndërtesës së xhamisë, formonin një njësi sociologjike, pronësie, gjinie dhe lidhje familjare jo vetëm në krijimin e saj por edhe shumë kohë më pas.



Dinamika e zhvillimit të qytetit të Tiranës. Emrat e xhamive më të vjetra (sipas K. Miho) që shërbyen si bërthamëza zhvillimi





Bërthama e dyte urbanistike u krijua në fillim të shekullit të 18 rreth xhamisë së Fires, e zhvendur rreth 600 m. në veriperëndim të bërthamës së parë, pikërisht aty ku takohen sot rruga e Barikadave dhe rruga Fortuzi. Kjo ndërtesë e amortizuar u rindërtua mbi themelet e saj në vitet 1859 duke u quajtur kësaj rradhe xhamia e Beshirit sipas emrit të tregëtarit që e ndërtoi.

Bërthama e tretë ndërtohet në verilindje të bërthamës së parë duke filluar me ndërtimin e xhamisë së Zajmit në 1775 dhe shembur për nevoja urbanistike në takimin e rrugës së Dibrës me rrugën Thanas Ziko.

Bërthama e katërt nis me kohën e themelimit të xhamisë së Haxhi Ethemit e cila u vendos rreth 200 m. në perëndim të xhamisë së vjetër dhe rrethuar me banesa kopshte varre etj.

Në këtë llogjikë, në pika të ndryshme, gjithnjë në një distancë të afërt me bërthamën e parë, formohen me kohë edhe bërthama të tjera me qendër një xhami si ajo e Stërmasit ndërtuar më 1840, e Kokonozit dhe e Bërxollit në shekullin e 19, e Karapicit në 1858, e Mujos, e Reçit etj duke lëvizur në mënyrë centrifugale nga qendra në periferi e përsëri në qendër me anë të ishujve të pavarur vendosur larg nga njeri tjetri e që më pas, pa asnjë lloj organizimi dhe disipline vijne dhe zmadhohen gradualisht derisa takohen me njëri tjetrin duke krijuar një sfond urbanistik me thurje të çrregullt dhe me dendësi të pakët, që kushtëzohet nga ekzistenca e

pronës private mbi tokën.

Coptimi feudal i tokës, mungesa e një administrate qendrore e aftë për të diktuar ligje kanë kushtëzuar ndërtime të çrregullta dhe shumë të rralla pa ndonjë parapërgatitje teknike.


Ndërtimi xhamisë së Sulejman Pashës (1614) së bashku me banjat publike (hamam), hanin (hotel), furrën e bukës simbolizon nga pikëpamja historiko arkitektonike lindjen e qytetit të Tiranës.

Sot nuk ekziston asnjë prej tyre, pasi xhamia e vjetër u prish gjatë bombardimeve të Luftës së dytë botërore, kurse objektet e tjera gjatë rregullimeve të pasluftës


Në këtë kompleks objektësh bënte pjesë edhe Tyrbja e Sulejman Pashës (që ekziston sot) ndërtuar nga i biri, Kapllan Pasha 19 vjet më vonë, si një varr monumental përkujtimor për të atin.

### Arkitektura

Xhamia e Sulejman Pashës së bashku me minaren e ndërtuar prej të birit 19 vjet më pas, u njoh fillimisht nga gravura e piktorit anglez E. Lear, pas meremetimit që i bënë feudalët Toptanas. Mbi këtë bazë dhe sipas shënimeve të kohës, u bë rikonstrukcioni hipotetik i saj. Nga pikpamja arkitektonike, xhamia e vjetër kishte plan drejtkëndor me brinjë 16x13m. Pjesën më të madhe të sipërfaqes e zë salla e lutjes dhe pjesën që mbetet e zë portiku, që përfaqësonte fasadat lindore dhe veriore të qytetit.



Pamje e xhamisë së Sulejman Pashës




Planimetria e xhamisë së Sulejman Pashës



Pamje e "Tyrbes", memorial i realizuar nga Kapllan Pasha





*Pamje e Tiranës, pikturuar nga Eduard Lear më 1848*

Volumi i xhamisë ishte një paralelipiped me shumë i shtrirë se sa i lartë me një lartësi afër 9 m. E gjithë fasada e xhamisë ishte e zbukuruar me afreske shumëngjyrëshe me motive lulësh dhe frutash si edhe me pamje nga Stambolli.

Tyrbja e Sulejman Pashës, një objekt shumë interesant, është ndërtuar me gurë të gdhendur, ka një planimetri 8 këndëshe dhe përbëhet nga një arkad me kollona që mbështetet mbi një bazament të ulët.

Kollonat janë prej guri dhe me kapitele me dekor bimor në sipërfaqe. Edhe pse e

vogël, tyrbja shquhet për elegancën e arkadës dhe punimin e detajeve.

Ndërsa xhamia e vjetër e Sulejman Pashës simbolizon lindjen e Tiranës, xhamia e Ethem Beut simbolizon memorien vizuale historike të qytetit të sotëm sepse është e vetmja xhami e vendosur në qendrën historike të qytetit që i ka shpëtuar shkatërrimeve të luftës dhe kohës.

*Xhamia e Ethem Beut dhe Kulla e Sahatit* u ndërtuan gjatë viteve 1794-1822, duke nxitur karakterin vertikal të qendrës së qytetit. Edhe pse në vetvete nuk përfaqësojnë një stil autokton shqiptar, ato janë të ndërtuara sipas një stili të

përzier ku ndihet qartë ndikimi i arkitekturës tradicionale.


Kjo xhami nga pikpamja arkitektonike, përbëhet nga salla e faljeve në formë kubike dhe hajati. Vëllimi kubik i sallës së faljeve qarkohet nga lindja dhe veriu me portikun me arkada mbi kollona. Ambjenti qendror mbulohet me kupolë që mbështetet mbi trompa parabolike në qoshet; kjo sallë është e ndërtuar me gurë lumi të suvatuara ndërsa brendësia e saj është e pikturuar me ornamente bimore, vizatimi i të cilave i përmbahet rregullave të simetrisë.

Pjesa e jashtme e sallës së faljeve që përfshihet brenda portikut, është e zbukuruar me dekor bimor dhe një sërë tabllosh me pamje nga Stambolli.


Në këtë xhami zhvillohet më tej prirja për një afrim të arkitekturës së kultit me atë popullore, si rezultat i shkëputjes nga tipat e vjetër të kopjuar nga arkitektura e kultit islam. Portiku i zhvilluar tërësisht me arkadën gjysëm rrethore, me linjën e tij të lehtë, kalon në një plan të dytë volumin kubik dhe i jep një vend më bindës minares.

Minarja e larte dhe e hollë, është ndërtuar prej guri të gdhendur. Pjesa e poshtme ka seksion katror, ndërsa pjesa tjetër që vjen duke u zvogëluar lehtësisht, ka të gdhendura kanelura vertikale të proporcionuara.


Në organizimin urbanistik të qendrës së Tiranës, një vend të veçantë zë Kulla e Sahatit. Ajo ka mbaruar së ndërtuari në 1830. Kulla e sahatit si pozicion është e



*Pamje e xhamisë së Ethem Beut*




*Planimetri dhe prerje e xhamisë së Ethem Beut*



Planimetri dhe prerje e kullës së Sahatit



Kulla e Sahatit para rikonstruksionit të 1928



Pamje e Kullës së Sahatit

vendosur në krahun lindor të xhamisë rreth 20 m. pranë saj me faqet e mureve të drejtuara përafërsisht nga pikat e horizontit. Ajo paraqet një vëllim prizmor paraleliped që në pjesën e sipërme përfundon me një çati piramidale.

E ndërtuar në aksin vertikal me lartësi të madhe, ajo është me bazë kuadratike dhe përbëhet prej pjesës së poshtme që zë lartësinë më të madhe, ku lëvizin peshat, prej ambjenteve të mekanizmit mbi të dhe kambanës në pjesën më të lartë.

Pjesa e jashtme e kullës nga niveli i trotuarit deri tek ballkoni është ndërtuar me gurë të bardhë të gdhendur dhe në forma drejtkëndore. Në krahun verior ndodhet porta e hyrjes në kullë mbuluar nga një hark i plotë guri. Prej saj me anë shkallësh të vogla që ndjekin perimetrin e mureve anësore të ndriçuara nga frëngji të vogla hipet lart dhe dilet në ballkon me anë të katër dyerve me hark.

Ndërtimi i kullës së sahatit përbënte një arritje në fushën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror dhe një objekt të ri në fondin e arkitekturës bashkëkohore. Kulla e Sahatit ka karakter të theksuar arkitektonik, duke u bërë me kalimin e kohës me siluetën e saj, pjesë përbërëse e fizionomisë së qytetit, simbolika e tij.

Në shekullin e 18-të, u themelua në përëndim të Tiranës Panairi i Tregtisë së Shën Lleshit, i cili u bë një pikë takimi dhe pol tërheqës interesash blegtorale dhe tregtare, duke shërbyer si mjet ndërlidhës i qytetit me fshatin dhe me qytete të tjera

si me Shkodrën, Beratin Elbasanin si edhe me krahinat më të largëta si Dibra dhe Kosova. Më 1871 ky panair filloi sërish të rimëkëmbej duke u zhvilluar pothuajse një herë në vit.

## STRUKTURA E QYTETIT TË TIRANËS

(Shek 18- fillim Shek 20)

Shumë shpejt qyteti i vogël dhe modest mori pamjen e një qyteti tregtar nga nevojat ekonomike të zonës, duke paraqitur shembullin e kalimit gradual nga një qendër e vogël e banuar në një qytet të mirëfilltë. Për këtë kontribuan veçanërisht familjet e pasura dhe aristokracia e qytetit.

Deri në çerekun e parë të shekullit të XX, qyteti shtrihej rreth qendres së tij, ku qe ndërtuar pazari dhe dy xhamite më të shquara. Arteriet kryesore në formë radiale, lidhnin qendrën e qytetit me lagjet e banuara rrallë, ku banesa rrethohej me troje shumë të gjerë. Lidhja e një pjesë të popullsisë, përveç zejtarisë, me blegtorin dhe bujqësi, ka kushtëzuar karakterin urbanistik të kësaj qendre, veçanërisht në lagjet e saj periferike.

E krahasuar me disa qytete të ngritura sipas një plani paraprak urbanistik të cilat dallohen për struktura kompakte, struktura planimetrike e qytetit të Tiranës është kryesisht produkt i anarkizmit feudal, i prapambetjes së madhe ekonomike dhe kulturore dhe si rrjedhojë paraqitet e çrregullt, e shtrirë dhe e coptuar.

Në të bëjnë pjesë dy zona, ajo e banimit dhe ajo ekonomike dhe si



ndërlidhëse ishin rrugët dhe rrugicat.


Gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të qytetit këto pjesë kanë qënë në lidhje dhe varësi të ndërsjelltë, në shkallë e përmasa të ndryshme në kohë, por duke ruajtur karakteristikat themelore, fakt që ka gjetur pasqyrim në strukturën planimetrike të qytetit.

Dhe me të vërtete, megjithë evolucionin e pësuar në rrjedhën historike, prej fillimeve e deri në prag të shekullit 20 siç ka vënë në dukje më 1905 Degrand; "...qyteti ruajti gati atë fizionomi që kishte para 3-4 shekujsh..."

Mbështetur mbi këtë bazë struktura e qytetit zhvillohej në këtë mënyrë:

*-Zona e banimit* tërhequr më tepër nga interesa të ngushta të pronësisë dhe për mungesë kontrolli të centralizuar, shtrihej dhe shpërndahej kudo pa kufi dhe ndonjë zonë të caktuar.

Vetëm banesat e aristokracisë feudale zotëruese të qytetit ishin të grumbulluara thuajse në qendër, brenda mureve të larta të cilat formonin kalanë e qytetit. Por më pas me shtimin e tyre, shtëpitë e tyre u ndërtuan edhe jashtë këtyre



Banesa në veri-lindje të qytetit të Tiranës

mureve, ndersa feudalët e tjerë zejtarë dhe tregëtare ishin shpërndarë në të katër anët e qytetit pa lidhje dhe përkujdesje për njëri tjetrin, ndarë mes tyre edhe nga hapsira të mëdha boshe, gjë që ka ndikuar edhe në shtrirjen e pajustificuar të qytetit.

Banesa tipike e Tiranës së asaj kohe ishte një ose dy katëshe e ndërtuar me qerpiç dhe të distancuara nga njëra tjetra me kopshte të rrethara me mure relativisht të ulëta të cilat zgjateshin rrugëve. Ndonëse numerikisht përbënte objektin kryesor të qytetit, në aspektin urbanistik, banesa qëndronte tërësisht pasive, për shkak të tërheqjes së saj nga rrugët kryesore.

Por me kalimin e kohës këto raporte marrin vlera të tjera. Nga mesi i shekullit të 18 filluan të ndërtohen banesa që dalin në ballë të rrugës dhe me pamjet e tyre kryesore të drejtuara ndaj saj dhe dyqanet të shkëputen nga qendra e qytetit dhe të dalin në buze të rrugëve.

*-Zona tregëtare dhe ekonomike* përfaqësohej nga pazari i vendosur tërësisht në pjesën qendrore të qytetit. Pazari i vjetër është i përbërë nga dyqane me galeri e strehë druri që sipas Degrand u rindërtuan në 1905 mbi bazën e pazarit të mëparshëm. Siç dihet edhe pazari i rindërtuar u shemb në vitet 60 për ndërtimin e Pallatit të Madh të Kulturës.

Pazari i Tiranës ishte i shtrirë brenda hapsirës së kufizuar nga Rruga e Barikadave, Rruga e Dibrës, rruga e sotme Luigj Gurakuqi dhe prej një pjese të

sheshit të Qendrës së Tiranës, duke zënë një sipërfaqe prej 2-3 ha.

#### *-Sistemi i rrugëve*

Të dy zonat e sipërpërmendura lidheshin ndërmejt tyre me një mori rrugësh e rrugicash të cilat përbëjnë dukurinë më karakteristike të qytetit. Pavarësisht se ajo shtrihej në një terren të pastër fushor që favorizon sistemin rrugor drejtkëndor, Tirana pati një sistem rrugor ku të gjitha rrugët kryesore priren të shkojnë drejt qendrës.

Rrugë për qerre, për karvanë, për këmbësorë, për bagëti dhe me vonë për automjete. Të gjera e të ngushta, diku të drejta por më shumë të thyera dhe sidomos të lakuara, të ndërprera dhe jo rrallë pa krye, që me ndarjet e shtesat familjare e interesat e pronësisë degëzoheshin në të tjera, formonin me qindra fije që e bënë strukturën rrugore të qytetit gjithshka të ngjashme me damarët e një gjetheje plepi. Në përgjithësi ato ishin nga 2-12 metra të gjera dhe të tëra të pashtruara.

#### *-Sheshet publike.*

Prej tyre mund të përmendim sheshin para xhamisë së vjetër dhe xhamisë së Ethem-Beut, sheshi i Lutjeve (Namazgjaja) në lagjen e Tabakëve (sot Ali Demi), sheshi i Paradave ushtarake që përkon me zonën e Shallvareve, dhe sheshi i Shqiptarëve para Kinema Republikës.


Më tepër se sheshe klasike si hapsira gjeometrike të organizuara me ndërtesa përreth, ato ishin ngastra të vogla të




Pamje e Pazarit të vjetër



Pamje e Pazarit, pas rikonstruksionit të 1905



Pamje ajrore e Pazarit dhe pjesës jug-perëndimore të Tiranës



Pamje e një rrugice në Tiranë

krijuara si zgjerime pjesore rrugësh me forma të çrregullta dhe të lira nga ndërtimet.

#### -Gjelbërimi

Vetë Tirana ka lindur mes gjelbërimit. Ajo ka qenë pjesë e çdo shtëpie madje edhe atyre më të varfërave. Gjelberimi gjendej në një shkallë më të kufizuar në shërbimin publik, si për shëmbull përpara çdo xhamije dhe sheshi si pikë referimi dhe anash ndonjë pjese të rrugës si në rastin e rrugës së Kavajës.

Nga analiza sintetike që iu bë strukturës urbanistike të qytetit prej lindjes së tij deri në fillim të shekullit XX, del se qytetit ka pasur një nisje ndërtimore spontane, një ecuri të ngadaltë por të vazhdueshme, karakterizuar nga një strukturë e çrregullt dhe një shtrirje irracionale.

Nëntori i vitit 1912, është viti i pavarësise politike të Shqipërisë nga pushtimi 5-shekullor otoman. Kjo datë shënon fundin e periudhës së parë të rëndësishme të tranzicionit për

strukturën urbane të qytetit - ku qyteti u themelua si një qender urbane me influenca të qarta dhe karakter oriental otoman. Gjatë kësaj periudhe logjika e zhvillimit urban mbi traditën lokale shqiptare u përqëndrua më shumë në arkitekturë se sa në urbanistikë. Kjo ishte shprehje e një forme të veçantë të rezistencës kundër pushtimit.

Produkt i kësaj periudhe është Shtëpia Tradicionale Tiranase, e ndërtuar me materiale lokale të buta ndërtimi (qerpiç) të shoqëruara nga punime artizanale në dru dhe hekur. Banesa tiranase është tipi më i hershëm i banesës tradicionale shqiptare dhe kjo duket qarte në zhvillimin kompozicional të saj.

#### Arkitektura e Banesës tiranase.

Banesa tiranase ngrihet mbi një truall mjaft të gjerë, rrethuar me mure të lartë që përgjithësisht nuk kufizohet me rrugën. Porta e hyrjes dy katëshe është me përmasa të mëdha dhe disa herë në një rën flegër të derës ndërtohet një portëz më e vogël e cila është më e përdorshme. Në oborrin e gjerë me pemë ndërtohet pusi dhe një rruginë e shtruar me kalldrem lidh shtëpinë me portën.

Në planin kompozicional, banesa karakterizohet nga një zgjidhje origjinale, që nuk ngjan me asnjë tip banese tjetër në Shqipëri. Në këtë zgjidhje vendin kryesor si bërthama kompozicionale, e zë shtëpia e zjarrit. Ky ambient ku zhvillohet gjithë jeta e përditshme madje në variantet e thjeshta dhe flihet, dallon nga ambientet e tjera jo vetëm nga vendi në

kompozim, por dhe nga sipërfaqja dhe volumi që zë.

Lartësia relativisht e madhe e shtëpisë së zjarrit, që arrin deri në 5 m, ka mundësuar që ambientet përreth saj të zhvillohen në dy kate. Sipërfaqja e dhomës së zjarrit varion nga 30-35 m<sup>2</sup> dhe në plan ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë.


Në këtë ambient gjejmë gjithmonë vatrën e cila ndërtohet në drejtim të boshtit gjatësor. Lidhja e dhomës së zjarrit me katet e sipërme që e rrethojnë, bëhet nëpërmjet një ballkoni të brendshëm që quhet "Mafil" tek i cili shkon nëpërmjet shkallëve të lehta të drurit.

Përpara shtëpisë së zjarrit ndërtohet hajati, që mbulohej me të njëjtën çati të shtëpisë së zjarrit. Balli i tij formohej nga shtylla druri dhe krijonte një sipërfaqe të mbrojtur para hyrjes, e cila shërbente për përpunimin e produkteve bujqësore, punimin në avlement etj.


Varianti më i zhvilluar dhe më karakteristik i shtëpisë tiranase është ai i mbylljes së plotë të shtëpisë së zjarrit nga të katër anët nga Anekset me kat.

Banesa tiranase, si në pamjen e jashtme, ashtu dhe në brendësi të saj, karakterizohet nga një trajtim i thjeshtë i elementeve arkitektonikë.

Së jashtmi të bie në sy volumi i saj i madh, format e thjeshta volumore, që thyhen deri diku vetëm nga sipërfaqet e



"Shtëpia e zjarrit", nukli i shtëpisë tiranase



Planimetri dhe pamje e një prej formave më të zhvilluara të shtëpisë tiranase



hapura të hajatit.

Kjo banesë ndërtohet me qerpiç dhe përforcohet me breza druri, ndërsa si lidhës përdoret balta e punuar. Lënda e drurit përdoret për konstruksionin e çatisë, dyshemesë, dyert dhe dritaret.

Ndërsa çatia mbulohet me tjegulla të lugëta të kuqe dhe kjo është arsyeja që Tirana e vjetër shpesh është quajtur Tirana e Kuqe, në ndryshim nga çka predikohej pas Luftës së Dytë Botërore nga ideologjia komuniste.



Pamje e Urës së "Tabakëve", në vitet 1920-1930


## 2. NGA PAVARËSIA TEK LUFTËRAT BOTËRORE (1920-1938)

Më 20 Janar 1920, Tirana shpallet kryeqytet i vendit nga Kongresi i Lushnjës. Ky akt përbente një ngjarje të shënuar historike, politike dhe administrative. Ja si shkruante Sami Frashëri për kryeqytetin e ardhshëm të Shqipërisë:



"Kryeqyteti i përgjithshëm do të jetë një nga qytetet që ndodhen në mes të Shqipërisë

në të cilin të flitet gjuha shqipe. Po më mirë do të jetë të bëhet një qytet i ri, në mes të Shqipërisë, në një vend të shëndetshëm dhe të bukur.

Ky qytet, të cilin mund t'a quajmë Skënderbegas, do të goditet në një mënyrë fort të bukur, me udhë të gjera dhe të drejta, me shtëpi të mira, me sheshe dhe gjithshka duhet".



Situacion i Tiranës së vitit 1916, hartuar nga studiues austriakë, shk 1 :5000



Planimetria e strukturës rrugore, hartuar nga studiues Austriakë më 1917

Duket që koha e kënaqi plotësisht këtë dëshirë të rilindasit të madh me caktimin e Tiranës si kryeqytet, si për kushtet e favorshme klimatike, largësinë e lakmuar nga mali dhe deti etj. me fusha pjellore, me klimë të butë, ashtu edhe me mundësitë për zhvillimin ekonomik, komunikacionit, tregëtisë etj. Por, Tirana duhej të përgatitej për rolin që do të merrte dhe për këtë duhet të

ndërmerreshin masa për shndrimin e saj gradual në një qendër politiko-administrative. Kjo përbën aktin dhe momentin kyç të transformimit të qytetit nga një strukturë urbane spontane dhe kaotike në atë të një zhvillimi modern urban, bazuar mbi studime dhe plane rregulluese.

Viti 1920 e gjen Tiranën një qytet me sipërfaqe 305 ha, ku zona e banimit zë 98,2% të sipërfaqes së qytetit, popullsia numëron 15000 banorë dhe dendësia e popullsisë është afërsisht 50 banorë për ha. Qyteti zhvillohet rreth celulës së pazarit dhe zona e banimit shtrihet kryesisht në veri dhe lindje të qytetit.


Zona e banimit dhe ajo ekonomike lidhen me një sërë rrugësh dhe rrugicash, që përbënin dukurinë më karakteristike të qytetit. Ato ishin shumë të ngushta, të shtrembëra dhe herë herë dhe pa krye. Nga kjo mori rrugët ndërkrahinore si ajo e Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Dibrës, Kavajës, Shëngjergjit etj, të cilat kryqëzoheshin të gjitha në qendër (Pazari). Pra qendra e qytetit është pazari, ku zhvillohej njëkohësisht si aktiviteti prodhues dhe ai tregtar.

Pas një viti, më 1921, qyteti rritet me 15%, pra zgjerohet në 350 ha, dhe ka tendencë të zhvillohet në drejtimin VL-JP.


Në vitin 1923, hartohet *plani i parë rregullues* i qytetit, nga arkitektë dhe inxhinjerë austriake. Plani rregullues i vitit 1923 kërkon të arrijë një zgjidhje kompromisi midis ndërtimit të një rrjeti rrugor të rregullt drejtkëndor dhe

rregullimit dhe përshtatjes së atij ekzistues, pra kërkon të krijojë një rrjet rrugor kuadratik të pastër në jug dhe perëndim të pazarit, zonë e cila ishte pothuaj e lirë, dhe në pjesën tjetër të qytetit në veri dhe lindje të pazarit, ky rrjet rrugor merr parasysh drejtimin e rrugëve dhe rrugicave kryesore, veçanërisht të rrugëve radiale, duke i drejtuar dhe zgjeruar ato. Qendra e qytetit mbetet përsëri pazari. Megjithatë nuk ishte një studim shumë i suksesshëm për sa i përket realizimit, plani udhëhoqi hapjen (zgjerimin) e akseseve kryesore të qytetit si: Rruga e Durrësit, Rruga e Kavajës, Rruga e Barrikadave, etj.

Pas një periudhe politike të rrëmujshme dhe me ardhjen në pushtet të qeverisë së udhëhequr nga Ahmet Zogu, autoritetet e asaj kohe e orientuan politikën e vendit nga Italia, që ishte në atë kohë vendi fqinj më i fuqishëm dhe më i zhvilluar. Në mungesë të mjeteve financiare, qeveria kërkoi një ndihmë ekonomike nga Italia për rilevimin gjeodezik të qyteteve shqiptare si dhe për hartimin e planeve të tyre rregulluese. Me ndihmën ekonomike të dhënë nga Italia, me anën e Bankës Kombëtare, Italia krijoi "Shoqërinë për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë". Italia e Musolinit e pa këtë afim si një shans ideal për të finalizuar aspiratat e saj për një ekspansion të mundshëm drejt Ballkanit. Kështu që pas pushtimit otoman, Shqipëria u konsiderua për të dytën herë si një "urë" apo vendkalim për interesa të caktuara gjeopolitike të kohës, por tashmë në një sens tjetër: nga perëndimi drejt lindjes.



Pjesë e Planit Urbanistik të 1923 (Zona ndërmjet Rruga e Durrësit dhe lumit të Lanës)



Pjesë e Planit Urbanistik të 1923, (Zona e qendrës dhe Pazarit)



Rruga "Nëna Mbretëreshë" (Rr. e Durrësit), rikonstruktuar në 1922-1923





Rruga "28 Nëntori", rikonstruktuar më 1923

Kjo kohë shënon fillimin e periudhës së dytë të rëndësishme të transformimit të strukturës urbane dhe arkitektonike të Tiranës. Përpyekja e parë nga autoritetet e kohës, që ftesa që ju bë profesionistëve me emër të asaj periudhe si arkitekti Italian *Brasini* në vitin 1925.


Ky i fundit e pranoi ftesën dhe hartoi projektidenë e parë rreth riorganizimit të qendrës së re të kryeqytetit shqiptar që konsistonte në një grup prej 6 ndërtesash monumentale dhe të një bulevardi qendror eklektik, i cili u realizua më vonë me ndryshime, dhe do të materializohej

në forma më pragmatike nga arkitekti italian Florestano Di Fausto që punoi për Tiranën më pas.


*Ideja e Arkitekt Brasinit* ishte që të krijonte një ishull roman në qytet, pa u ndërthurur me pjesën tjetër të qytetit me karakter të theksuar oriental, por që do të shërbente si një çernierë lidhëse ndërmjet qytetit të vjetër dhe qytetit modern që do të ngrihej në të ardhmen. Projekti konsistonte në krijimin e një bulevardi të gjerë me orientim të pastër V-J, që ndan qytetin ekzistues nga periferia e tij, dhe që propozohet si qendër monumentale dhe qeveritare e një qyteti të ri autonom që do të zhvillohet duke injoruar trashëgimime orientale të qytetit të vjetër.

Tirana e re nuk do të ishte tjetër veçse realizimi i projektit të asaj kulture perëndimore të kohës që të impononte vizibilitet dhe aparençë madhështore. Sheshi i Ministrive dhe aksi madhështor i bulevardit ishin qartësisht nyja qendrore e një qyteti të inspiruar nga "varësia ireale" ndaj rilindjes italiane, që lidhej vetëm me dëshirën e autoriteteve të asaj kohe për të ndërtuar një qytet modern sipas arkitekturës më bashkëkohore dhe të një hapësire të pamatë (pjesa jugore dhe perëndimore e Tiranës ishin pothuajse bosh), e cila të lejonte të realizohej çdo ide sado madhështore të ishte ajo.


Në vitin 1926 hartohet *plani i dytë rregullues* i Tiranës që është jo vetëm një rishikim i planit rregullues të vitit 1923, i cili pati shumë mangësi, por materializohet për herë të parë ideja e




Projekt-idea e parë e aksit veri-jug, hartuar nga Ark. Brasini




Projekt-idea e Pallatit Mbretëror në fundin jugor të Bulevardit (sot vendndodhja e Universitetit)




Projekt-idea e "Portës së hyrjes në bllokun e Ministrive", dizenuar nga Ark. Brasini



Projekt-idea e zyrave të Prefekturës, të para nga sheshi "Skënderbej", dizenuar nga Ark. Brasini



Pjesë e Planit Rregullues të vitit 1926




Pjesë e Planit Rregullues të vitit 1926

arkitekt Brasinit, për ndërtimin e një bulevardi të gjerë sipas një aksi veri-jug që përkonte përpëndikularisht me përroin e Lanës dhe përshkonte mes për mes qytetin.

Në këtë plan rregullues kontribojnë tre autorë të tjerë Inxhinjeri shqiptar z. Eshref Frashëri, Ing. Castellani (italian) dhe austriaku Weiss. Qendra administrative do të ndërtohet në J-P të Pazarit, hidhet njolla e parë e sheshit "Skendërbej", forma e së cilës erdhi si rezultat i përpunimit të vizatimeve të arkitekt Brasinit që sheshin e ideoi në formë rrethore dhe që në këtë plan rregullues merr një formë gjatësore, formë të cilën pak a shumë e ruan edhe sot. Në këtë plan rregullues parashikohet për herë të parë sistemimi i Lanës, por nuk bëhet fjalë për një sistemim të mirëfilltë të saj. Interesant është fakti se në këtë plan projektohet një shesh rrethor nga i cili dalin shumë radiale, ku njëra prej të cilave është një rrugë që nis nga sheshi "Sulejman Pasha" që në atë kohë quhej "rruga e pishës", dhe që përputhet plotësisht me sheshin e sotëm "Avni Rustemi".

Plani i tretë rregullues si kronologji, por i pari i periudhës kur Shqipëria u bë Mbretëri, është ai i vitit 1928 i hartuar nga arkitekti austriak KOHLER. Në të vërtetë ky është dhe plani i parë i mirëfilltë urbanistik, pasi ky plan rishikon në mënyrë të hollësishme të gjithë shtrirjen e qytetit dhe ndërhyr mbi të. Në këtë plan rregullues hartuar në shkallën 1:5000, duket qartë sistemi kuadratik i rrjetit rrugor, sidomos në zonën e Tiranës së re e cila qe pothuaj e pabanuar. Në




Plani Urbanistik i vitit 1928

ndryshim nga planet e mëparshme rregulluese të cilat respektonin morinë e rrugëve dhe rrugicave të shtrembëra dhe vetëm sa i drejtonin dhe zgjeronin ato, në këtë plan rregullues sistemi kuadratik i rrugëve shtrihet në të gjithë qytetin, duke përfshirë edhe pjesën e vjetër të tij, pra pjesën veriore dhe lindore të tij.

Në këtë sistem kuadratik rrugësh, rrugët radiale përsëri kanë një rol kryesor, sidomos rruga e Durrësit, rruga e Kavajës, rruga e Dibrës dhe ajo e Elbasanit, të cilat paraqiten si akse mjaft të gjera.

Në këtë plan rregullues konturohet me saktësi aksi V-J i bulevardit me sheshin Skendërbej në pjesën veriore të tij, ku vendoset qendra administrative, dhe që fillon nga pjesa perëndimore e pazarit, deri në rrezë të kodrave në Jug, tek pallati Mbretëror. Në të dy krahët e këtij aksi projektohen breza të gjerë gjelbërimi. Në këtë plan rregullues është bërë sistemimi i mirëfilltë i Lanës përpëndikular me



Pjesë e Planit Rregullues të vitit 1928, Zona e Tiranës së re


aksin e bulevardit, me dy rrugët paralele që e kufizonin atë në të dy krahët e saj.

Zona e Tiranës së re konceptohet si zonë me zhvillim ekstensiv, pra zonë vilash, të cilat vendosen në parcela drejtëkëndëshe dhe që formojnë kuartalle kuadratikë sipas rrjetit rrugor, ose





Vila Goldi



Shtëpia e Omer Fortuzit



Vila e familjes Petrela



Zyrat e Ambasadës Italiane më 1930



Vilë e ndërtuar më 1930, në rrugën e Durrësit



Ish-Ambasada Turke (sot Jugosllave), pronë e Qemal Jusufatit, më 1931


vendosen sipas disa rrateve bashkëqendrore.

Në planin rregullues të Tiranës së re të gjitha parcelat kanë të shënuar emrat e pronareve të rinj, dhe pavarësisht nga ndryshimet që pësoi më vonë ky plan rregullues, u respektua zona e parcelave private. Këto parcela varionin nga 1000-1500 m<sup>2</sup> duke krijuar hapësira të bollshme për kopshte dhe që më vonë do të quhej nga arkitektët italianë që e rishikuan këtë plan rregullues si "Citta giardino", pra "qyteti-kopesht".


Në bazë të këtij plani rregullues, në Tiranë u ndërtuan vila të mrekullueshme dhe me arkitekturë bashkëkohore, që anonte nga shfaqje të neoklasicizmit deri tek shfaqjet e fundit të modernizmit.

*Plani i katërt rregullues* i periudhës së mbretit Zog është ai i vitit 1929. Në këtë plan rregullues aksi i bulevardit zgjatet, dhe nuk fillon më nga pazari, por nga stadiumi i ardhshëm i qytetit që përkon me Stacionin e trenit të sotëm në veri, deri tek pallati Mbretëror në Jug.

Në këtë plan rregullues janë përcaktuar *kufijtë e qytetit*, që brendashkruajnë një sipërfaqe 4,5 km<sup>2</sup>, dhe njëkohësisht konturohet zona e qendrës së qytetit që përfshin bulevardin V-J dhe rrugët kryesore si Rruga e Durrësit, e Kavajës, Elbasanit etj që do t'i nënshtroheshin një rikonstruksioni të plotë sipas arkitekturës dhe urbanistikës bashkëkohore me akse të gjera rrugësh të asfaltuara dhe përbri tyre godina me arkitekturë bashkëkohore sipas ligjit nr 2241 dt 21/9/1929 të Mbretërisë, datë e cila ligjëroi fillimin e punimeve për



Plani Rregullues i vitit 1929




Pamje e bulevardit "Zogu i parë", mbas inagurimit

ndërtimin e bulevardit "Zogu i parë", që përfaqësonte gjysmën veriore të këtij aksi.

Në fillim të vitit 1930 nisnin punimet për ndërtimin e dy akseve kryesore që do t'i jepnin frymëmarrje qytetit dhe që të dyja

historike si xhamia dhe kulla e sahatit në të dy variantet.

*Varianti i tretë*, i cili u mbështet në zgjidhjen kompozicionale të variantit të dytë, u projektua si një shesh me sipërfaqe




*Varianti i dytë i planit të qendrës së Tiranës*


rreth 2 ha me formë gjatësore në drejtim të bulevardit, ku anët e ngushta mbylleshin në formë gjysëm rrethi. Sheshi rrethohet nga të gjitha anët me 8 objekte, të vendosura në mënyrë simetrike.

Ky variant u miratua jo vetëm se përbënte një zgjidhje kompozicionale me të thjeshtë dhe harmonike, por edhe se përfshinte në të dhe xhaminë e Ethem Beut dhe kullën e sahatit.

*Varianti i katërt* Në vitin 1931, arkitekti fjorentin **Florestano De Fausto** realizoi tentativën e fundit për sistemimin



*Varianti i tretë i planit të qendrës së Tiranës*




*Varianti i parë i projekt-idesë për qendrën e Tiranës*

sheshin e "San Pietros" në Romë, ku godinat e ministrive do të vendoseshin sipas perimetrit të këtij rrethi. Godina të tjera me karakter administrativ dhe social do të ndërtoheshin përgjatë bulevardit, me fasada paralele me rrugën dhe në mbyllje të bulevardit në jug do të ndërtohej pallati presidencial.


Si varianti i parë dhe ai i dytë nuk u miratuan, për shkak të një skeme kompozicionale të papërshtatëshme të variantit të parë dhe për shkak të mospërfshirjes në to, të objekteve



*Shtëpia e A. Libohovës, më 1930*



*Shtëpitë e nëpunësve në zonën e Tiranës së re, ndërtuar nga 1930-1937*



*Vila e Princeshës Sanie, më 1930*


përfundonin në sheshin "Skëndërbej", si bulevardi qendror "Zogu i parë", hapja dhe zgjerimi i Rrugës së Durrësit si dhe godinat e ministrive të sheshit qendror. Përgjatë këtyre arterieve kryesore, nisin të ndërtohen konstruksione moderne me arkitekturë perëndimore të kohës dhe me fasada të zbukuruar me dekor në relief me një elegancë të admirueshme.

Tirana jetonte në këtë moment një periudhë lavdie dhe prosperiteti urban që shprehej sidomos me hapjen e aksit të bulevardit të ri të qytetit. Një arkitekt francez i kohës që vizitonte Tiranën në atë moment do të shprehej i befusuar por jo pa ironi: *pushë një bulevard pa qytet!* duke vërtetuar se zhvillimet e reja perëndimore ishim mjaft të avancuara krahasuar me stadin e atëhershëm oriental të zhvillimit të qytetit.


Aksi V-J i bulevardit kapte një gjatësi prej 2 km dhe një gjerësi minimale prej 35m. Zgjidhja e tij planimetrike ishte vijëdrejtë, me prerje tërthore të përbërë nga dy rrugë të gjera për makina prej katër korsish të kalimit të automjeteve secila, shtruar me pllaka bitumi dhe nga trutuar të gjera të shtruara me gurë të vegjël shtufi në formë mozaiku dhe të mbjella me 4 rradhë drurësh e ligustrash.

Gjatë viteve '30 vlen për t'u përmendur fillimi i punimeve për ndërtimin e godinës së "Bankës Kombëtare të Shqipërisë" disa vjet më vonë, inaugurimi i së cilës u bë më 1938. Kjo ndërtesë e madhe dhe me linja arkitektonike që tregonin potencë dhe soliditet, ishte vepër e arkitektit italian Vittorio Morpurgo. Godina u ndërtua në hyrje të rrugës "Mussolini" në atë kohë, sot rruga e Kavajës. Kjo ndërtesë mjaft moderne






Asfaltimi i sheshit "Skënderbej", përballë ish-Ministria e Punëve të Brendëshme




Pamje e ish-Ministrisë së Drejtësisë



Pamje e Bashkisë së Tiranës, ndërtuar nga 1929-1931



Pamje e lulishteve në sheshin "Skënderbej", përfunduar në 1936




Pamje e Ministrisë së Punëve Publike

e qendrës së qytetit, tentative e cila rezultoi këtë rradhë e suksesshme dhe u realizua pothuajse tërësisht në saj të ambicieve të Mbretit Zog për t'a bërë Tiranën një qytet modern europian.

Sipas këtij plani, u ndërtua kompleksi i 6-të ministrive, Bashkia e Tiranës, Banka Kombëtare, lulishtja e këtij kompleksi qëndror, sheshi qëndror me shatërvanin si dhe ajo që sot njihet si "Parku Rinia".

### Struktura dhe stili arkitektonik i sheshit të ministrive

Arkitekti De Fausto e përpunoi dhe plotësoi variantin e tretë me një lulishte në mes të katër godinave të ministrive në pjesën jugore të sheshit dhe me një shatërvan në formë rrethore të vendosur simetrikisht ndërmjet dy godinave të ndërtuara në pjesën veriore të tij. (Në variantin e tretë pjesa veriore kishte 4 objekte). Për shkak se sheshi kishte përmasa lineare shumë të mëdha dhe godinat rreth tyre nuk ishin shumë të



Varianti i katërt i planit të qendrës së Tiranës

larta, ato u shtuan me një ose dy kat dhe lulishtja në mes u thellua 1,5 m për të rritur me anë të një efekti joreal lartësinë e tyre.

Projekti arkitektoniko-urbanistik i qendrës së qytetit u mundua të evidentojë imazhin e ri të Tiranës duke shmangur në maksimum shkatërrimin e ndërtimeve ekzistuese si: pazari i vjetër, dyqanet, xhamitë, kullën e sahatit etj. Objektet e ndërtuara kishin një cilësi të lartë arkitektonike dhe një tendencë të fuqishme për t'u imponuar, gjë që tregonte potencën e shtetit të Mbretit Zog.

Konstruksioni i godinave të ministrive është realizuar si me beton të armuar, ashtu edhe me konstruksion tulle.

Kompleksi i Ministrive është realizuar nga pikëpamja arkitektonike sipas një stili të pastër të rilindjes italiane. Përdorimi në fasadë i kornizave të rënda në ndarjet e kateve, i kornizave zbukuruese të dritareve, i ornamenteve dhe skulpturave të vogla, si dhe i portave hyrëse madhështore tregojnë dhe një herë pompozitetin e stilit neo-klasik në funksion të fuqisë së një shteti të ri shqiptar që po konsolidohej çdo ditë e më shumë.

Të ngritura mjaft nga toka, me veshje tulle dhe suva granili, realizuar sipas raporteve mjaft të arrira dhe harmonike të formës së jashtme, dhe të zbukuruara me elemente arkitektonike sipas stilit neoklasik, padyshim ato përbënin kompleksin më bashkëkohor dhe imponues të kryeqytetit të ri.

Në vitin 1937 Tirana kishte 35 000 banorë; kur filloi puna për planin rregullues në 1939-ën, popullsia kishte arritur në 40 000 banorë, e në mbarim të planit rregullues, popullsia arriti në 75 000 banorë. Qyteti u zgjerua nga 500 ha në 800 ha.


*Masterplani* studion një zonë të shtrirë në 2 800 ha, duke përfshirë këtu edhe zonat ushtarake, aeroportin, zonat lidhëse dhe industriale, të cilat në vetvete bëjnë 1 700 ha.

E rëndësishme në këtë masterplan është përcaktimi i kufirit të Tiranës si bashki, e kufizuar nga komunat përreth. Ky kufi përfshin një sipërfaqe 7 300 ha.


#### ZONIMI

**Zona e banimit** Plani rregullues parashikoi zhvillimin e qytetit për një periudhë 60 vjeçare, e mendohej se popullsia mund të arrinte në 130 000 banorë dhe sipërfaqja e qytetit në 1 100 ha. Pra, dendësia mesatare 130 banorë/ha, një shifër kjo mesatare për një qytet ekstensiv. Vetëm zona e banimit shtrihet në një sipërfaqe prej 660 ha.

Në këtë plan rregullues Tirana projektohet si një *qytet-park* shumë i gjelbëruar, me ndërtime të ulta dhe në qendër një zonë intensive, realizimi i së cilës ka qenë shumë i vështirë për shkak të ndjenjës së fortë të pronës private tek banorët. Plani rregullues ka bërë të pamundurën për të bërë sa më pak shpronësime, për të ruajtur godinat ekzistuese dhe për t'i vlerësuar në maksimum ato, kjo me qëllimin e mirë që qytetit të mos i humbasin gjurmët e influences turke.



*Master-plani, pjesë e Planit Rregullues të 1942*



*Plani i sistemit rrugor të propozuar nga Plani Rregullues i vitit 1942*

### 3. PUSHTIMI ITALIAN DHE LUFTA E II-TË BOTËRORE (1939-1944)

Në 7 Prill 1939, Italia pushtoi zyrtarisht Shqipërinë, dhe e shpalli atë pjesë të Mbretërisë Italiane duke hartuar një politike të veçantë edhe në fushën e zhvillimit urbanistik. Rrjedhojë e këtij ndryshimi politik ishte hartimi *planit të rregullues të Tiranës*, që u hartua dhe filloi


të zbatohet gjatë viteve 1939-1942. Ky plan parashihte krijimin e një qendre të zhvilluar urbane që do të popullohej me kolonë italiane. Ai u përgatit nga një grup pune miks me specialiste italianë dhe shqiptarë, të udhëhequr nga arkitekti fiorentin *Gherardo Bossio* dhe inxhinieri *Ferdinando Poggi*.

#### Plani Rregullues i vitit 1940


Arkitektët italianë e parashikuan Tiranën si një qytet në rritje dhe zhvillim, sidomos pas ardhjes së shumë administratorëve dhe qytetarëve italianë për të banuar përfundimisht në Shqipëri...



*Harta e situacionit të sistemit të rrugëve, më 1939*



*Situacioni i trafikut rrugor të Tiranës i vitit 1939  
(Skema e transportit)*



*Foto ajrore e Tiranës, më 1939*





jashtë e qytetit, nga rruga e Durrësit dhe rruga e Kavajës.

**Sistemi i rrugëve** është Radial-unazor. Të gjitha kuartallet që formohen ndërmjet unazave dhe radialeve, përshkohen në vetvete nga rrugë paralele dhe pingule ndërmjet tyre sipas një sistemi kuadratik. Në pjesën jugore të qytetit ku mungojnë radialet, kemi sistem kuadratik të pastër.


Lana e sistemuar ka orientim L-P. Përpindikular me të është aksi V-J i bulevardit. Qyteti përshkohet nga shumë unaza: unaza e madhe që kalon në skajin verior dhe jugor të bulevardit, unaza e

mesme, unaza e vogël dhe disa unaza pjesore. Unaza e madhe është e gjatë 8,11km. dhe me gjërësi në VL dhe VP të saj prej 33m, ndërsa në pjesën J dhe JP, prej 42m. Një linjë kryesore është dhe arteria që shkon paralel me pjesën perendimore të Unazës së madhe e cila përfundon në stacionin e trenit.


**Kushtet urbanistike** paraqiten në mënyrë të detajuar në një hartë të planit rregullues që përfshin gjithë qytetin. Ato janë paraqitur në 9 harta përbërëse të planit të përgjithshëm, të cilat, të hartuara në shkallë më të vogël tregojnë çdo hollësi



Detaje të Kondicioneve Urbanistike të dy Unazave kryesore të Tiranës, 1942



Planimetria e Kondicioneve Urbanistike të Tiranës,  
1942



Planimetria e Qarkullimit të Trafikut, 1942

Zona intensive përfshin bulevardin me godinat qeveritare, rrugën e Durrësit, rrugën e Kavajës, rrugën e Pazarit të vjetër dhe zonat përreth me ndërtime të larta deri në 5 kate, në të cilat do të vendoseshin zyra, dyqane, banka etj në shërbim të qytetarëve.

Në hartën e zonimit, zona intensive zë 110 ha dhe mban një popullsi prej 33 000 banorë, me një dendësi rreth 300 b/ha. Zona gjysëm intensive zë 280 ha me popullsi 56 000 banorë dhe dendësi 200b/ha përfshin pothuajse pjesën më të madhe të qytetit dhe shtrihet veçanërisht në perëndim dhe veri-lindje, ndërsa zona ekstensive shtrihet në pjesën J dhe L të qytetit. Ajo zë një sipërfaqe prej 550 ha, me popullsi 44 000 banorë dhe dendësi 80b/ha.

Qyteti do të zgjerohej në veri, përtej lumit të Tiranës. Pra do të krijohet një zonë satelit që do të lidhej me qytetin me rrugë-ura. Kjo qytezë me vila do të kishte shumë gjelbërim dhe do të quhej "CITTA GIARDINO" (qyteti-kopësht).


**Zonat e gjelbëra** do të ishin 132 ha, kryesisht në lindje dhe në jug të qytetit. Zona sportive 33 ha, në zonën lindore të tij dhe parku mbas shtëpisë së Fashios (Universitetit) në zonën kodrinore do të ishte rreth 22 ha.

**Zona industriale** do të zhvillohej në VP dhe JP të qytetit, dhe ndërmjet këtyre dy zonave do të ndërtohej një qytezë punëtorësh.


Stacioni Hekurudhor do të ishte në JP të qytetit dhe do të lidhte Tiranën me Durrësin dhe Lindjen e Shqipërisë dhe një degëzim i saj do të lidhte zonën industriale me qytetin.

**Zona e shërbimeve** - Zona spitalore dhe varrezat do të ishin në VL të qytetit; në VP të tij do të zhvillohej zona e panairëve. Aeroporti do të ndërtohej në P të tij dhe do të kufizohej nga unaza e

rregullues të qendrës. Këtu u parashikua të prishej godina e pjesës veriore të sheshit (ish komiteti ekzekutiv) dhe të ndërtohej godina e bashkisë së re me një formë kuadratike në plan dhe me oborr të brendshëm. Ndërtimi i saj do të korigjonte përfundimisht gabimin e planit paraardhës që sillte konfuzion në lëvizjen e automjeteve, për shkak të përplasjeve që vinin nga të gjitha rrugët radiale në shesh. Ndërtimi i Bashkisë së re do të sillte rrjedhshmërinë e kalimit nga rruga e Durrësit për në rrugën e Dibrës në anën veriore të objektit dhe rrjedhshmërinë e kalimit nga rruga e Kavajës në rrugën "28 Nëntori" në jug të objektit, pa u konfunduar ndërmjet tyre. Gjithashtu rreth qendrës do të ndërtoheshin objekte shërbimesh dhe social-kulturore si teatri, posta, zyra etj.



Pamje nga maketi i qendrës së Tiranës, 1942



Pamje e përgjithshme e Maketit të qendrës së Tiranës

### Bulevardi "IMPERO"


Vazhdimi i rrugës "Vittorio Emanuele", ish rruga "Zogu i parë", sipas aksit brazilian në jug të sheshit "Skëndërbej", që pa dyshim ndërmarja më domethënëse për urbanistikën e qytetit. Kjo u parapri nga një plan rregullues shumë i detajuar i qendrës dhe Bulevardit "Impero", ku përcaktoheshin të gjitha kushtet urbanistike të bulevardit, trotuareve dhe godinave që do të ndërtoheshin përgjatë tij.

Për të justifikuar madhësinë e këtij bulevardi, duhej që ky aks të plotësohej nga të dyja krahët me godina të destinuar për zyra, banka, aktivitete shoqërore dhe tregtare. Ndërtesat duhet të ishin nga pikëpamja e volumit të njëjta dhe në një largësi të studiuar mirë nga njëra tjetra, për të realizuar një dendësi


të përshtatshme dhe të denja nga pikëpamja arkitektonike për të justifikuar gjerësinë, madhësinë dhe rëndësinë e kësaj rruge. Kjo rrugë është më e rëndësishmja e qytetit dhe e përshkonte atë mes për mes.

### Kompleksi politiko-sportiv


Bulevardi "Viale del Impero" do të shërbente si çernierë lidhëse ndërmjet qendrës ekzistuese të qytetit që zhvillohet rreth sheshit "Skëndërbej" dhe qendrës së re politiko-sportive që do të zhvillohej në skajin jugor të këtij aksi. Arkitekt



Planimetria e Zonimit, sipas Planit rregullues të 1942



Plani Rregullues i Qendrës së Tiranës



Rikonstrukcion Hipotetik i Qendrës së Tiranës, 1942

dhe nuk lënë vend për keq-interpretime. Po kështu jepen prerjet tërthore të të gjitha rrugëve dhe shesheve kryesore, duke përfshirë dimensionet e rrugëve, trotuareve, vendosjen e gjelbërimit, të ndriçimit, largësinë e godinave nga rruga, lartësinë e tyre, deri në lartësitë e çdo kati, veçanërisht për godinat në buzë të rrugëve kryesore etj.

### Stili racional i Arkitekturës dhe Urbanistikës fashiste

Ky operacion urbanistik solli në Shqipëri dhe sidomos në Tiranë, influencën e arkitekturës dhe planifikimit Italian, sidomos të periudhës së fashizmit e cila shquhet për karakterin racional të saj.

Tirana pati një hop cilësor zhvillimi nga pikëpamja urbanistike dhe arkitektonike gjatë viteve 1929-1938, nëpërmjet hapjes së disa akseve të reja rrugore dhe veçanërisht të bulevardit "Zogu i parë", si dhe të ndërtimit të kompleksit të ministrive bashkë me objektet e tjera me karakter administrativ, shoqëror dhe kulturi. Bumin e saj të vërtetë Tirana e pati gjatë periudhës së fashizmit. Gjatë periudhës 1939-1944, Tirana mori pamjen e një qyteti modern dhe me potencial të fuqishëm ekonomik. Fillimi i zbatimit të planit të ri rregullues dhe hapja e fronteve të punës, si dhe financimet e bollshme për të ndërtuar kompleksin e ri të Fashios, bëri që Tirana të njohë një prosperitet ekonomik dhe veçanërisht urbanistik.

### Qendra

Konfiguracioni i sheshit qendror "Skëndërbej" ndryshoi në planin e ri




shqiptare e trajtuar me modernizëm. Stili i të projektuarit të arkitekt Bosios në këtë kompleks luhet ndërmjet ndikimeve të së kaluarës antike dhe të lavdishme Romane me harqe dhe kollona, si dhe stilit të ri racional, realizimi i të cilit favorizohet nga avantazhet që sillte përdorimi i betonarmesë.

Kompleksi përfshin dhe stadiumin olimpik me diametrin e madh 274m dhe diametrin e vogël 142m, me kapacitet prej 15000 vete, me hyrje madhështore dhe zbukuruar me skulptura në fasadën ballore.


Kështu u materializua arkitektura neo-fashiste e viteve 30 dhe e fillimit të viteve 40, me rrugë dhe sheshe të gjera ceremoniale për të organizuar parada madhështore, portikë, mure të veshura me gurë natyrore, kolonada të larta, shkallë të gjera monumentale, stilobate të larta, relieve dhe diçitura në gjuhën latine. Për t'a dalluar këtë stil të ri arkitektonik nga modelet e rilindjes, u përdorën stilizime, skematizime apo thjeshtime të zbukurimeve antike si heqja e kapiteleve, frontoneve dhe zëvendësimin e çatave me terraca.

Edhe pse i kritikuar ashpër pas luftës së dytë botërore nga komunistët shqiptarë, idete kryesore të këtij plani rregullues luajtën rol pozitiv për të parashikuar dhe orientuar zgjerimin e qytetit.

Megjithatë i kufizuar në kohë, në një periudhë mjaft të shkurtër për shkak të kapitullimit të Italisë fashiste, plani pati një influencë shumë të fortë sidomos mbi sistemin e rrugor. Ai nxiti krijimin e një sistemi rrugor radial-unazor përmes



Skica e parë e kompleksit "Politiko-Sportiv", projektuar nga ark. Gherardo Bosio




Projekti i zbatimit të kompleksit "Politiko-Sportiv"



Pamje nga puna për ndërtimin e Stadiumit Olimpik




Pamje e aksit Brazinian të bulevardit "Via del Impero", sot "Dëshmorët e Kombit"



Plani rregullues i bulevardit "Via del Impero", me godinat në të dy krahët e tij, 1942

Gherardo Bosio është autori i këtij kompleksi të madh arkitektonik me arkitekturë tipike racionale fashiste, në të cilën bëjnë pjesë Zyrat e oficerëve madhore (Kryeministria e sotme), Komanda militare dhe Hoteli, Hotel "Dajti" të vendosura në krahët e rrugës. Në ballin e rrugës do të ndërtohej shtëpia e Fashios (Universiteti), "Dopolavoro"; një qendër rekreacioni në të cilën ka sallë teatri, një bibliotekë të pasur dhe salla pritjeje, sot Fakulteti i Arteve dhe "Gioventu Litorio



Pamje e aksit Veri - Jug, e bulevardit "Dëshmorët e Kombit" dhe "Zogu I"

Albaneze" që sot është kollonada me bibliotekën e Universitetit.

Përpara se të prezantonte projektin final për kompleksin e Universitetit dhe veçanërisht universitetin e sotëm (Casa di Fascio), arkitekt Bosio analizoi disa variante të cilat pavarësisht nga ndryshimet, kishin diçka të përbashkët; atë që Bosio e quante procesi i "Riduzionizmo formale" që do të thotë "Përshtatje e formës" dhe që ai e kontrollonte mirë si në shkallë arkitektonike ashtu dhe urbane. Godina e Universitetit, e cila ka një formë të karakterizuar nga paralelopiped komakte të bashkuar me njëri tjetrin dhe të le mbresën e një fortëse, ka bërë një rikthim në memorie të kullës tradicionale




duke përfunduar me luftimet finale gjatë periudhës tetor-nëntor 1944, që shkaktuan dëme të konsiderueshme materiale.

Data 17 Nëntor 1944, shënon ditën e çlirimit të Tiranës nga forcat gjermane dhe hyrjen e forcave partizane, të cilat vendosën menjëherë kontrollin e qeverisë së krijuar nga Partia Komuniste.

Periudha e pushtimit gjerman jo vetëm nuk solli zhvillime të reja por në të kundërt la pas shkatërrimet e luftës, të cilat simbolizohen veçanërisht nga fotot e atyre diteve që tregojnë fitimtarët që hyjnë në një qytet të zbrazet ku spikat në sfond pjesa e sipërme e minares së xhamisë së Ethem Beut e cila ishte shkatërruar nga luftimet.

Sidoqoftë, e rëndësishme është se kjo datë do të shënojë fundin e një periudhe ku qyteti i Tiranës zhvillohej mbi llogjikën


e balancës mes pronës private dhe interesit publik, të një ekonomie që edhe pse modeste kishte përsëri në thelb logjikën e tregut të lirë. Pas kësaj date do të fillonte një periudhë 45 vjeçare e zhvillimit urban bazuar mbi llogjikën e ekonomisë së centralizuar dhe eliminimin gradual të pronës private si faktor kyç për zhvillimin urban.




*Pamje të shkatërrimeve nga lufta për çlirimin e Tiranës*



*Pamje e sotme e Universitetit të Tiranës, pjesë e kompleksit Politiko-Sportiv*



*Pamje panoramike e kompleksit Politiko-Sportiv*



*Pamje sotme e sheshit "Nënë Tereza", në qendër të kompleksit "Politiko-Sportiv"*

hapjes së akseve të reja dhe zgjerimit të katër rrugëve kryesore ekzistuese, që lidhnin Tiranën me pjesët e tjera të vendit. Këto u lidhën me një unazë të re të gjatë 8,11km. Transformimi urbanistik dhe arkitektonik i Tiranës në këtë periudhë ishte evident.

Në këtë periudhë për Tiranën punuan dhe treguan interes arkitektët më me emër në Itali e më gjerë, përfshi edhe babain e arkitekturës moderne, francezin Le Corbusier, i cili realizoi disa skice ide paraprake për planin urbanistik të Tiranës. Por, duke qënë paralelisht i ngarkuar edhe me hartimin e planit urbanistik për qytetin e Algjerit (Algjeri) u tërhoq nga interesi për kryeqytetin shqiptar.

#### **Pushtimi Gjerman**

Zhvillimet interesante të Tiranës nga pikpamja arkitektoniko-urbanistike gjatë influences italiane, u ndërpre në bashkë me kapitullimin e Italisë fashiste në shtator 1943. Territorët e kontrolluara më parë nga ushtria italiane u vunë menjëherë nën kontrollin e ushtrisë dhe autoritetit gjerman deri në nëntor 1944. Gjatë kësaj periudhe afërsisht 1 vjeçare, autoritetet gjermane paraqitën edhe krijimin e një qeverie kuislinge e cila kishte jo vetëm një autoritet të kufizuar por kishte prioritete politike, larg çështjeve si zhvillimi urban. Në këtë kohë nuk mund të nënvizohet ndonjë zhvillim i rëndësishëm arkitektoniko-urbanistik për qytetin.

Në të kundërt veprimtaria e guerrilieve komuniste dhe kundërveprimi i ushtrisë gjermane u bënë gjithnjë e më agresiv,



direktivat e planit të ri rregullues të vitit 1957 mund të përmbliken në:

1-Rritja e dendësisë së banimit në Tiranën ekzistuese për eliminimin e pronës private;

2-Ndryshimi i planit të zonimit, rishpërndarje e zonës industriale dhe e banimit;

3-Përmirësimi dhe shtimi i rrjetit rrugor;


4-Ruajtja e disa zonave si monumente kulture;

5-Shfrytëzim racional i truallit.

### Sistemi rrugor

Plani rregullues i vitit 1957 u hartua mbi bazën e gjendjes ekzistuese të rrjetit rrugor. Më 1957 Tirana kishte vetëm 14,1 km rrugë. Ky plan i jepte qytetit shtrirje deri në kufijtë e unazës së sotme dhe parashikonte realizimin e 73,5 km rrugë, me dy unaza, një të jashtme dhe një të brendëshme.

Plani i ri i 1957 parashikonte një zgjerim dhe shtrirje të qytetit në drejtim të Lindjes (Dajtit) edhe për shkak të karakteristikave të mira gjeologjike të tokës. Sistemi rrugor i qytetit parashikohej



Plani Rregullues i vitit 1957

## 4. ZHVILLIMET GJATË EKONOMISË SË CENTRALIZUAR (1945-1990)

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, për Shqipërinë solli në pushtet një qeveri komuniste. Këtu përfundon periudha e influencës italo-fashiste në urbanistikën e Tiranës. Sistemi diktatorial komunist ishte tepër i centralizuar dhe i prirur drejt operacioneve urbanistike ku nuk merren në konsideratë prona private dhe ku arkitektët dhe urbanistët gëzojnë "lirinë" që me një të rënë të lapsit të "revolucionarizojnë dhe transformojnë", gjithnjë brenda kornizave dhe udhëzimeve politike format e zhvillimit urban.

Pas vitit 1945 *prona private* filloi të eliminohej nëpërmjet shtetëzimeve pa kompensim, gradualisht dhe totalisht. *Kolektivizimi*, u bë parimi bazë i organizimit të jetës. Ndërkohë profesionistët shqiptarë filluan të arsimoheshin dhe orientoheshin me koncepte të shkollës ruse. Ekonomia shkoi gjithnjë e më shumë drejt një centralizimi, duke u shoqëruar me shkurtime drastike të burimeve dhe mjeteve financiare, sipas principeve të "*kursimit ekonomik*" dhe "*mbështetjes tërësisht në forcat e tona*". Këto parime u theksuan edhe më shumë pas prishjeve të marëdhënieve me BS dhe Kinën, sidomos pas vitit 1978 kur Shqipëria mbeti e vetmja qendër e komunizimit të vërtetë në Botë! (citohet sipas prononcimeve të zytratëve të kohës). Mbi këtë sfond të përgjithshëm politik dhe ideologjik u nisën hapat e para për rindërtimin e shkatërrimeve të luftës dhe u vazhdua me

krijimin e strukturave të reja urbane për pothuajse gjysëm shekulli.

### 4.1. PLANI RREGULLUES I 1957

Më 1957, u përpilua plani i ri rregullues për Tiranën. Ai u bazua në rihvillimin e zonave ekzistuese dhe krijimin e zonave të reja periferike, në formën e *qyteteve satelite*, me qëllim që të sigurohej fuqia punëtore për industrinë e re lokale (mekanike dhe tekstile), ndërmarrjet bujqësore dhe minierat e qymyrgurit kryesisht përgjatë akseve kryesore të transportit dhe drejt periferisë së qytetit.

Megjithëse krijimi i zonave të reja periferike ishte një nga dilemat kryesore për arkitektët dhe urbanistët shqiptarë, praktikisht rihvillimi i Tiranës ekzistuese me synim eliminimin e pronës private, u shndërrua në një "mani" të vërtetë. Kështu që përveç transformimit dhe përmirësimit të dukshëm të disa situatave urbanistike, operacionet urbanistike shpesh shkatërruan ansamble të tëra ndërtesash tradicionale me vlera historike dhe ambjentale. Si anë pozitive duhet pranuar se për herë të parë pas luftës, me anë të këtij plani, iu vu fre ndërtimeve pa planifikim.

Bazuar në të dhënat demografike se: në vitin 1945 Tirana numëronte 59.900 banorë; në vitin 1955 popullsia numëronte 108.200 banorë, në vitin 1960 ajo rritet në 136.300 banorë.



*Planimetria e Situacionit Urbanistik të Tiranës, më 1965*



*Foto ajrore e Tiranës më 1959*





Bloqe banimi në të dy krahët e rrugës së Kavajës

e banimit jashtë unazës së parë do të kishte ndërtesa nga 1-3 kat.

Gjatë kësaj periudhe u hapën zona të reja banimi, të cilat paraqesin tentativa interesante nga këndvështrimi urbanistik, por me një cilësi tmerrësisht të keqe arkitektonike dhe zbatimi. Skenografia urbane dhe siluetet panoramike të këtyre lagjeve të banimit si në *Laparakë*, *Allias*, blloku *Partizani*, blloku *"Vasil Shanto"*, *"Ali Demi"*, *"Profarma"*, *"Dinamo"* etj., nënvleftësoheshin plotësisht në emër të reduktimit të kostos. Kjo reflektonte më tepër reduktimin e burimeve financiare, se sa mungesën e aftësisë së specialisteve,



Pamje nga Kombinati i tekstileve "Stalin"

të cilët vuanin izolimin ekstrem nga eksperiencat dhe literatura e huaj bashkëkohore, si edhe pamundësinë për t'u kthyer në traditë.

Për pasojë, nuk u arrit të shmangej përsëritja monotone dhe varfëria arkitektonike e këtyre blloqeve dhe veçanërisht parafabrikateve.

Me gjithë investimet e konsiderushme dhe abuzimin me punën e papaguar në emër të punës vullnetare, strehimi në Tiranë u transformua në një makth social, e acaruar kjo edhe nga rritja intensive e popullsisë.

Plani rregullues 1957-ës vërtetoi një shmangje të madhe nga parashikimet, duke filluar që me prishjen e pazarit të vjetër (nuk paraqitet në planin rregullues ndërtimi i pallatit të kulturës), e deri tek shtrirja e zonës industriale e cila nga 86 ha që do të zgjerohej pas 20 vjetësh, arriti të zerë një sipërfaqe prej 390 ha.

#### QENDRA E QYTETIT

Ideja për riorganizimin e qendrës së Tiranës u inspirua nga tendencat e autoriteteve komuniste për të mohuar ose anashkaluar të kaluarën, sidomos monarkinë dhe fashizmin. Historia e Tiranës do të duhej të fillonte vetëm pas vitit 1945!

Tipike ishin operacionet që filluan në Tiranë pas studimeve urbanistike të viteve 1963 dhe 1974, të cilat e përqëndruan vëmendjen e autoriteteve në qendrën e qytetit. Ky ishte një moment delikat për identitetin e Tiranës.

të ishte përsëri radial-unazor, duke i dhënë një rëndësi sinjifikative aksit veri-jug të bulevardit.

*Pavarësisht nga trysnia e fortë ideologjike, në këtë plan rregullues shihet qartë që traseja e unazës së jashtme kalon në mënyrë identike sipas unazës së jashtme të projektuar në planin rregullues të vitit 1942.*

Unaza e jashtme prej 7,5 km, se bashku me dy rrugët paralele përgjatë Lanës përfunduan së ndërtuari më 1965. Një pjesë e unazës së jashtme nuk u realizua dhe pikërisht ajo nga rrugës "Labinoti" deri tek bulevardi i madh e cila që studiuar me nënkalime. Ndërsa traseja e saj nga ura e fundit e Lanës (afër Ministrisë së Jashtme) deri tek rruga Labinoti u ruajt për ndërtim në një kohë të mëvonshme për shkak të vështirësive financiare .

Shtrirja e qytetit në drejtim L-P diktoi zgjatjen e rrugëve radiale, si dhe përmirësimin e tyre si psh.përmirësimi i rrugës së Durrësit dhe rrugës së Kavajës.



Pamje nga puna për ndërtimin e shtratit të Lanës

#### ZONIMI

Edhe zonimi, ashtu sikurse sistemi rrugor, pavarësisht nga trysnia e fortë ideologjike, i është përmbajtur heshturazi në të shumtën e rasteve planit rregullues të vitit 1942, si për zonën industriale, zonën e gjelbër, ashtu edhe për shtrirjen e zonës së banimit. Pra urbanistët shqiptarë e përdorën planin e 1942 si plan referimi, duke krijuar në një farë mënyre idenë e vazhdimësisë, pavarësisht ndryshimeve të mëdha sidomos në konceptimin e zhvillimit të zonës së banimit dhe të asaj industriale.

#### Zona historike

Pavarësisht deklarimeve për ruajtjen e zonës historike, qëllimi ishte largimi nga gjurmët e qytetit të vjetër me influence orientale, duke motivuar shkatërrimin e Pazarit të vjetër dhe urbanizimin e zonës ku dallohet ndërtimi i Pallatit të Kulturës më 1960.

*Zona industriale* do të zhvillohej në Veri dhe Perëndim të qytetit, ku dallojmë ngritjen e kombinatit të tekstileve "Stalin" dhe ndërtimin e qytezës së punëtorëve prej 4000 familjesh.


#### Gjelbërimi

Përsa i përket gjelbërimit, u vendos objektiv të arrihej standarti prej 8m<sup>2</sup>/banore dhe zona-park(Liqeni) në jug të qytetit prej 190 ha.

#### Zona e banimit

Zona e banimit brenda unazës së parë parashikonte ngritjen e ndërtesave 3-4 kat me densitet 350 banore/ha, ndërsa zona





Pamje nga pazari i vjetër, vendi ku do të ndërtohej  
"Pallati i Kulturës"


psikologjinë e shumicës. Ato ndërprejnë zinxhirin historik të traditës, të së sotmes dhe të ardhmes gjë që siguron pikërisht vazhdimësinë e zhvillimit.

Kjo ndodhi sepse zgjidhjet teknike u kushtëzuan nga interpretimet e forta ideologjike. Me ndërtimin e Muzeut Historik Kombëtar, mori trajtë përfundimtare Sheshi Skënderbej, i destinuar për mitingje politike, manifestime publike dhe evenimente ideologjike. Ndërhyrje të kësaj natyre, reflektojnë orientimin ndaj modeleve të arkitekturës dhe urbanistikës staliniste të vendeve të Europës Lindore.


Ndërtimi i Muzeut Historik Kombëtar sollti ndryshime të rëndësishme në sheshin "Skënderbej". Rruga e re mbas muzeut "Ded Gjon Luli" e zgjeruar deri në 21m gjerësi dhe me trotuare 6-10m së bashku me rrugën e "Barrkadave" të zgjeruar, u bënë pjesë e një unaze të ardhshme, më e vogla e qytetit rreth qendrës që lehtësoi mjaft qarkullimin në qendër.

#### Gjendja ekzistuese e qytetit

Ndërsa në qendër dendësia e rrugëve ishte 5-5,3km/km<sup>2</sup>, më e madhe se norma



Pamje e re e qendrës së Tiranës, më 1960,  
Pallati i Kulturës




Pamje nga qendra e Tiranës në 1980

(2.5-4), në periferi dendësia ishte 1.7-1.8km/km<sup>2</sup>, më e vogël se norma për arsye të mos zbatimit të planit rregullues.


Skenografia e re e qendrës së Tiranës ndryshoi kryekëput nga pjesët e tjera të

Këto ndryshime patën koston e lartë të humbjes së një pjese të memories historike të qytetit. Edhe pse vlerat arkitektonike të objekteve të shembura ishin shpesh modeste, kjo edhe për shkak të përkeqësimit të situatës së objekteve private nga mungesa e mirëmbajtjes dhe eliminimi i sektorit privat, në fakt në këtë mënyrë bashkë me "modernizimin", u zhdukën edhe provat e pakta të origjinës së qytetit.

Qendra e Tiranës u konceptua si një "hapësirë monumentale" që do të përfaqësonte "forcën dhe rilindjen" e Shqipërisë, të kombit dhe shtetit shqiptar.



Pamje të ndërtesave të banimit në rrugën e Durrësit  
dhe "Mine Peza"



Pamje e maketit të qendrës, realizuar më 1970

Për të arritur këtë qëllim u shkatërrua pazari i vjetër i Tiranës, bashkia, katedralja ortodokse, një asambël i vjetër dyqanesh, hotelesh, baresh dhe një grup shtëpish karakteristike, duke i konsideruar si objekte të "degraduara dhe pa vlerë". Në këtë mënyrë dëshmitë e pakta të origjinës tiranase u zëvendësuan nga objekte të rëndësishme si: Pallati i Kulturës, hotel Tirana, Muzeu Historik Kombëtar, Sheshi "Skënderbej" dhe një grup apartamentesh banimi të reja, etj. Ndërtesat e vetme historike të cilat u morën nën mbrojtje ishin Xhamia e Et'hem Beut dhe Kulla e Sahatit, kompleksi i ministrive (përjashto Bashkinë e vjetër), si dhe disa shtëpi tipike tiranase, të cilat megjithëse kishin huazuar mjaft elemente të importuar, në vetvete ishin interpretime të mirëfillta të arkitekturës lokale.

Në fund të viteve 80-të, qendra e qytetit mori karakter zyrtar, përmasa monumentale dhe raporte johumane, duke u konsideruar edhe sot një hapësirë e ftohtë dhe tranzit për shumicën e qytetarëve. Kjo u theksua për shkak të mungesës së shërbimeve dhe të faktit se mjaft objekte kishin natyrë dhe funksione zyrtare.

Kështu që, nga një pikë takimi për qytetarët e saj, qendra e Tiranës u transformua thjesht në një dekor butaforik për regjimin, një udhëkryq për rregullimin e trafikut të përditshëm këmbësor e të makinave. Stili disi i huaj arkitektonik nuk ishte më tërheqës për banorët dhe operacionet e kryera urbanistike patën një ndikim negativ për



ekzistuese urbane u shembën dhe u zëvendësuan me komplekse apartamentesh banimi (shpesh të parafabrikuara) me cilësi mjaft modeste.

Zakonisht nuk preferohej aplikimi i projekteve të rehabilitimit dhe përdorej më shumë rizhvillimi i zonave ekzistuese, se sa hapja e zonave të reja për zhvillim. Strukturat e reja urbane, shpesh nuk prodhonin asnjëherë situata më të mira. Kostoja e rizhvillimit mbetej mjaft e lartë.

### PLANI RREGULLUES I 1989

Në vitin 1985, Instituti Kombëtar i Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike ndërmori hartimin e një plani të rregullues që u miratua nga qeveria në vitin 1989.

Ky plan i ri rregullues që bëri më i domosdoshëm se kurrë për shkak të humbjes së aktualitetit të planit të 1957, të rritjes së kërkesës për banim dhe daljes së saj jashtë kufijve të parashikuar në kurriz të shërbimeve sociale dhe publike, si dhe të zgjerimit të paparashikueshëm të zonës industriale dhe të përzierjes së saj me zonën e banimit.

### Objektivat

*Objektivi I* këtij plani ishte të kënaqte kërkesat për banim deri në vitin 2005, të përcaktonte hapësira të reja për zhvillimin industrial duke parashikuar zgjidhjen e problemit të ndotjes dhe të shtonte e të përmirësonte rrjetin rrugor.

*Objektivi II* i planit rregullues ishte rishikimi dhe rivlerësimi i një pjese të

1




2



1- Apartamente banimi të ndërtuara me elemente beton / arme të parafabrikuara

2 - Pamje nga një fasade pallati, modern për kohën, projektuar nga ark. Maks Velo në vitet '70



3 - Apartamente të ndërtuara mbas Muzeut Historik Kombëtar, në krah të Unazës më të vogël të Tiranës


4 - Pamje panoramike e Tiranës së viteve '80

4


madhe të zonës së banimit që ishte përcaktuar si zonë me zgjidhje të pa përshtatëshme. Nga 960 ha zonë e banuar, vetëm 460 ha ishin konsideruar si të zgjidhura drejt, ndërsa 500 ha të tjerë do të ishin objekt të planeve më të detajuara të rivlerësimit, në mes të së cilës duhej gjetur hapësira e nevojshme për rritjen e shërbimeve edhe sikur kjo hapësirë të fitohej nëpërmjet prishjeve të nevojshme ekzistuese.




Pamje nga veriu i qendrës së Tiranës



Pamje nga paradat dhe manifestimet me rastin e "1 Majit"



Pamje ajrore e Muzeut të diktatorit Enver Hoxha, sot Qendra Ndërkombëtare e Kulturës



Pamje panoramike e pjesës jugore të Tiranës



Pamje e qendrës së Tiranës, më 1980



Proçesi i zgjerimit të Tiranës nga 1917-1987.

kryesisht për trafikun e rëndë dhe për më tepër do të konsiderohej si kufi për zhvillimet e ardhshme. Nga ky korridor sot është ndërtuar vetëm një segment i vogël në zonën perëndimore të Tiranës që lidh Rrugën e Durrësit me Rrugën e Kavajës.

3 - Detyra të tjera të këtij plani ishin zgjatimi i të gjitha rrugëve radiale deri në ndërprerjen e tyre me unazën e re.

4 - Krijimi i dy rrugëve radiale të reja si Rruga « Don Bosko » dhe një rrugë e re në krah të Fakultetit të Ndërtimit.

5 - Zgjatja e rrugëve paralel me Lanën në P dhe L, nga Lindja deri në Shkozë ndërsa nga perëndimi deri ku kryqëzohet me Rrugën e Kavajës.

6 - Krijimi i një gjysmë unaze të re midis unazës ekzistuese dhe asaj të re.

#### 4.2.3. ZONIMI


Tirana deri në 1985 shtrihej në 1540 ha. Plani i vitit 1989 parashikonte një zgjerim të qytetit deri në 32 km<sup>2</sup>(3238 ha) të ndarë në:

- Zonë banimi 1902 ha
- Zonë industriale 524 ha
- Shërbime 293 ha
- Gjelbërimi 439 ha
- Zonë bujqësore(sera ,fidanishte) 80 ha.

Tirana Plan




Tirana 1957 Existing Situation



Regulatory plan - Tirana 1963



Regulatory plan - Tirana 1972



Tirana 1977 Existing Situation



Regulatory plan - Tirana 1987

**Objektivi III** Një problem shqetësues që duhet të zgjidhete plani i ri rregullues ishte dhe ai i imigracionit, i cili do të ishte i vështirë për t'u kontrolluar pas vitit 1990.

Nga 60000 banorë që numëronte Tirana më 1945, në vitin 1992 popullsia arriti shifrën 300000 banorë. Plani i ri parashikonte ritjen e popullsisë deri në vitin 2005 në 317000 banorë.

Pavarësisht nga zhvillimi dinamik demografik, falë rritjes së sipërfaqes së zonës së banimit, plani parashikon një ulje të dendësisë së banimit nga 224 banorë / ha në 1988, në 170 banorë/ha në 2005.


#### Rrjeti rrugor

Ky plan rregullues pati si qëllim të shfrytëzojë rrjetin ekzistues të rrugëve dhe t'ja përshtasë nevojave në rritje të qytetit. Sistemi rrugor do të mbetej përsëri *radial-unazor*, i cili jo rrallë krijon probleme në qytetet e mëdha për shkak të bllokimit të trafikut në kryqëzime.


1 - Si bosht bazë në këtë plan rregullues u konsiderua zgjatimi në veri i bulevardit "Dësh-morët e Kombit", i cili me një

kthesë në perë-ndim takohet me rrugën e fushë Krujës dhe aty bëhet shkë-putja, ku një krah lidhet me autostra-dën, kurse degëzimi tjetër përfundon në Rinas. Kjo do të ishte dhe hyrja kryesore për në qytet.

2 - Detyrë tjetër kryesore e këtij plani rregullues qe krijimi i një unaze të jashtme që do të shfrytëzohej




Plani Rregullues i vitit 1989, Varianti i I i skemës së zonimit



Plani rregullues i 1989, Varianti i parë i sistemit të rrugëve

u konsiderua zgjatimi në veri i bulevardit "Dësh-morët e Kombit", i cili me një kthesë në perë-ndim takohet me rrugën e fushë Krujës dhe aty bëhet shkë-putja, ku një krah lidhet me autostra-dën, kurse degëzimi tjetër përfundon në Rinas. Kjo do të ishte dhe hyrja kryesore për në qytet.

Plani rregullues i 1989, Varianti i II i sistemit të rrugëve hartuar nga Instituti Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike (ISPU)





planeve dhe politikave të zhvillimit. Modeli i zhvillimit kaotik të Tiranës gjatë kësaj periudhë, reflekton më së miri tranzicionin e vështirë politik, ekonomik dhe social nga ekonomia e centralizuar drejt shoqërisë së tregut të lirë. Gjendja e arkitekturës dhe urbanistikës në këtë periudhë është shprehja më e mirë vizuale e tranzicionit të vështirë të qytetit.

Liria e fituar, u keqpërdor në atë masë sa që interesi publik u përbuz, u injorua dhe e dhunua në një masë të konsiderueshme. Të paktën 70% e ndërtimeve të bëra pas vitit 1990 në Tiranë

janë pa leje ndërtimi. Situata përkeqësohej më tej për shkak të bllokimit të procesit të kthimit të pronave.

Gjatë periudhës 1990-2003 u ndërtuan në shkallë kombëtare 200 000 objekte pa leje me vlerë minimalisht 3 miliard dollarë USA. Nëse këto investime do të ishin legalizuar dhe bazuar në kritere urbane dhe ekonomike me siguri do të kishim një rezultat shumë më të mirë dhe një panoramë më të bukur.

Gjatë kësaj periudhe Tirana, dallohet për degradimin ekstrem të cilësisë së



Foto ajrore e Tiranës, viti 1994

## 5. ZHVILLIMET NË PERIUdhËN POST-KOMUNISTE

Si pasojë e kolapsit të sistemit të ekonomisë së centralizuar dhe atmosferës së ndryshimeve politike dhe ekonomike në gjithë vendet ish-socialiste të Evropës Lindore, pas vitit 1990-të, edhe në Shqipëri fillon një erë e fortë ndryshimesh. Edhe kjo periudhë natyrisht që do ketë influencën e saj për arkitekturën dhe urbanistikën e Tiranës. Madje influencat do të jenë tepër të forta. Kjo përbën fundin e periudhës së realizmit socialist

dhe ekonomisë së centralizuar në arkitekturë dhe urbanistikë.

### Ndërtimet ilegale

Eksperiencia e re e zhvillimit urban gjatë viteve 90-të në Tiranë krijoi një nga rastet më unike të zhvillimit arkitektonik dhe urbanistik në Europë, goftë për dinamizmin dhe energjinë e saj, apo për parregullsinë dhe kaosin total të krijuar, si dhe për mungesën e plotë të



Rënia e bustit të diktatorit në qendër të Tiranës, më 20 Shkurt 1991



Pamje e qendrës së Tiranës në vitet 1993-1999

ambienteve urbane, për pushtimin e hapësirave publike nga ndërtimet e paligjshme, shoqëruar me një dëmtim serioz të mjedisit. Mungesat e ligjit, dhe veçanërisht e ligjeve të specializuara indirekt nxiti më shumë kaos. Kjo favorizohej edhe nga niveli i lartë i papunësisë dhe varfërisë, nga me problematikët në Europë. Për më tepër u ndje mungesa e kulturës së bashkë-ekzistencës në një shoqëri të lirë. Kjo favorizoi çrregullime urbanistike që u shprehën përmes dy formave kryesore:

- ndërtime të paligjshme për qëllime strehimi, kryesisht në periferi të qytetit, si në rastin e Bathores;
- ndërtime pa leje për qëllime biznesi, kryesisht në qendër të qytetit, si në rastin e Lumit Lana.

Më tej shkalla e thyerjes së ligjit varion nga informaliteti (ku respektohet pronësia mbi tokën por thyhen normat dhe standartet urbanistike), tek ilegaliteti (ku si pronësia mbi tokën dhe rregullat urbanistike nuk respektohen).

Burime jo zyrtare referojnë shifrën e të paktën 20,000 objekteve informale dhe ilegale në Tiranë. Burime joqeveritare flasin për 80.000 të tilla. Në mes të viteve 90-të Tirana numëronte të paktën 2,000 kioska nga të cilat vetëm rreth 500 kishin leje provizore. Shumica u ndërtuan pa projekt, në mënyrë amatore dhe shpesh banale, për shkak të kufizimeve financiare.


Në periferi të Tiranës u krijuan lagje të vërteta me ndërtime të paligjshme si pasojë e lëvizjes së lirë të popullsisë kryesisht nga zonat verilindore të vendit, ku problemet ekonomike ishin edhe më



Kioska pa leje afër kullës së Sahatit




Kioska pa leje në rrugën e Elbasanit



Pamje nga ndërtimet pa leje mbi lumin Lana



Kioska në lulishten e Muzeut Kombëtar



Ndërtime pa leje në pjesën veri-lindore të Tiranës



Pamje nga ndërtimi i godinave ilegale mbi Lanë



Por prishjet, mendohet sot të realizohen edhe kundrejt ndërtimeve të reja shumëkatëshe pa leje të cilat prishin urbanistikën e territorit ku ngrihen, dëmtojnë infrastrukturën ekzistuese, duke zhdukur përfundimisht mendimin se ndërtimet e larta mund të mbijetojnë për shkak të vlerës së lartë financiare, por dhe shtesave të katit, anësore, garazheve dhe rrethimeve e gardheve të çdo lloji të cilat janë kthyer në një fenomen gangrenë për kryeqytetin. Shtesat e kateve dhe sidomos ato anësore kanë shpërfytyruar fasadat e pjesës dërmuese të ndërtimeve të periudhës së socializmit, duke lënë një impresion negativ sidomos buzë rrugëve kryesore të qytetit.

Prishja e çdo ndërtimi ilegal, i madh apo i vogël qoftë ai, i ka dhënë një goditje përfundimtare të gjithë tendencave për të përfituar në kurriz të pronës publike ose në kurriz të prishjes së imazhit të rregullit urbanistik në qytet.

Sot prishjet nuk bëhen si qëllim në vetvete, por ato realizohen në përputhje të plotë me projektet për ndërtimin dhe reabilitimin e një zone apo rruge të caktuar.

Por nuk qe e pakët humbja ekonomike gjatë këtyre prishjeve, e cila mund të evitohet nëqoftëse këto ndërtime ilegale do të ishin bërë në mënyrë të ligjshme. Rasti më tipik është ai i ndërtimeve mbi Lanë, ku u prishën një vëllim investimesh fizike prej 10 milion \$, pa llogaritur efektin ekonomik shumëfishues për shkak të aktivitetit ekonomik, punësimit dhe pagimit të taksave.

Këta shembuj treguan qartë paaftësinë dhe mungesën e vizioneve të zhvillimit të administratave të para lokale, për të orientuar drejt mjetet financiare të komunitetit.

Në rastin e Bathores, dhe të zonave të tjera në periferi të Tiranës, ku objektet kanë karakter kryesisht strehimi, autoritetet vendore nguruan të ndërmerrnin aksione prishjeje. Në të vërtetë, tentativa të ngjashme në 1995 dhe 1998 dështuan dhe degjeneruan në konflikte sociale me banorët e këtyre zonave. Kështu që autoritetet kanë parapëlqyer të ndjekin një politikë më të butë, atë të përmirësimit dhe integritit të këtyre zonave, madje në vitet 2000-01 u fol për herë të parë për legalizimin e tyre, që deri atëherë ishte konsideruar si tabu. Bashkia e Tiranës ka ngritur një njësi të posaçme për të studiuar rast pas rasti mundësinë e legalizimit. Ndërsa aktualisht qeveria po diskuton një draft-ligj për legalizimin e ndërtimeve informale.

#### Infrastruktura ekzistuese

Rritja e shpejtë e popullsisë dhe për rrjedhojë shtrirja e madhe e strehimit dhe ndërtimeve, ka tejkaluar aftësinë mbajtëse të rritjes të infrastrukturës. Densifikimi i zonave ekzistuese, i kombinuar dhe me efektet negative të akumuluar nga investimet e kufizuara ndër vite për mirëmbajtjen e infrastrukturës, rezulton në një spirale në zbritje të cilësisë së saj dhe shërbimeve komunitare.

Mungesa e infrastrukturës në zonat me zhvillime të reja, veçanërisht lagjet me

të komplikuar dhe shteti nuk ofronte alternativa të ligjshme.

Ndërtimet e paligjshme nuk janë thjesht shprehje e shkallës së ulët të zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe as çështje kulture.

Para së gjithash ato janë shprehja më e qartë e dobësisë së administratës publike e veçanërisht e asaj vendore për të kërkuar zbatimin e ligjit, si dhe i mungesës së vizionit dhe i politikave të zhvillimit nga ana e autoriteteve qendrore të viteve të para të tranzicionit, sidomos në fushën e zhvillimit urban dhe strehimit. Ato dëshmojnë për lidhje të pakta të komunitetit me qeverisjen vendore, dhe ndikimet negative të politikave centralizuese që hartohen në nivel ministrish.

Koncepti i ndërtimeve të paligjshme nuk duhet kufizuar vetëm në ndërtimet pa leje. Ekzistojnë gjithashtu një numër i madh ndërtimesh me leje, por të paligjshme nga pikëpamja urbanistike, pa respektuar as rregullat më elementare të zhvillimit urban, duke pushtuar sipërfaqet e gjelbërta midis ndërtesave ekzistuese dhe duke u përkujdesur vetëm për të garantuar sipërfaqen e banimit, pa marrë parasysh funksione të tjera të rëndësishme që lidhen me jetesën normale. Planet që hartoheshin nga arkitektet dhe shqyrtoheshin në K.R.R.T., shiheshin më tepër si një instrument që për ligj marrjen e lejës së ndërtimit dhe ka si kriter themelor efektivitetin e sipërmarrjes nga pikëpamja e ndërtuesit. Në shumë raste ato nuk ishin

fryt i studimeve komplekse në të gjithë faktorët e domosdoshëm, që garantojnë jo vetëm funksionin e strehimit si hapësirë banimi, por dhe atë të të gjithë komponentëve të tjerë të jetesës së njerzve në kushte normale.

#### Fillimi i procesit të prishjeve të ndërtimeve ilegale

Problemi i prishjes të ndërtimeve pa leje u shfaq për herë të parë vetëm në 1998, kur autoritetet shqiptare vendosën kontrollin mbas trazirave të 1997-ës. Më parë vetëm ndërtohej pa leje dhe as që mendohej se do të vinte një ditë që do të fillonin prishjet.

Prishjet filluan më shumë si një përpjekje për të vendosur autoritetin e shtetit. Ky akt u mirëprit dhe u përshëndet nga popullsia. Besueshmëria e publikut dhe vendosmëria e serioziteti për vendosjen e rregullit territorial, u pa me prishjet tek Parku RINIA, ku sipërfaqe të mëdha të gjelbëra ishin shëndruar në biznese solide informale.

Në rastin kur ndërtimet e paligjshme kishin karakter ekonomik, autoritetet u treguan tepër të ashpra, prishjet u bënë në një periudhë tepër të shkurtër dhe kundërshtimi qe i pakët.

Sot prishjet kanë hyrë në një fazë të re. Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me policinë ndërtimore bënë prishjen më të madhe dhe më të rëndësishme të ndërtimeve të paligjshme mbi lumin e Lanës. Brenda një kohe record u prishën rreth 550 objekte ilegale në një gjatësi prej 4km të lumit të Lanës .

ndërtime të paligjshme në periferi, ka patur pasoja serioze për shëndetin e banorëve dhe pritet që gjendja të përkeqësohet nëse nuk merren masa parandaluese.


Mungesa e rrugëve pengon zhvillimin e transportit publik, redukton mobilizimin e punësimit, ndalon mbledhjen e plehrave dhe në përgjithësi kontribon në mungesën e efikasitetit në të gjitha aktivitetet urbane. Si rrjedhojë pengohet përfitimi ekonomik që zakonisht duhet të derivojë nga procesi i urbanizimit.

Impakti negativ në ambient i zhvillimit informal të tokës është serioz dhe mund të bëhet i pakthyeshem. Rrugë të pashtruara dhe të padrenazuara në këto zona rrisin erozionin, bllokojnë sistemin e kullimit dhe rrisin ndotjen. Vendderdhjet informale të ujërave të zeza në zona të tëra banimi, po ndotin burimet e ujit të pishëm si pusët të cilat përdoren shpesh si ujë të pishëm nga banorët e ardhur.


Mungesa e aksesit nga makina, pengon mbledhjen e plehrave të cilat zakonisht përfundojnë në lumenj ose mblidhen në pirgje të mëdha të cilat dergjen pa mëshirë ose digjen. Në mjaft nga këto lagje të krijuara rishtas, mungojnë shkollat dhe objektet e nevojshme sociale, kurse analfabetizmi po bëhet problem shqetësues. Të gjitha këto bëjnë që fenomeni i urbanizimit të shpejtë të shikohet si një proces i dëmshëm dhe me kosto të lartë ekonomike dhe sociale.

#### Lagja e BATHORES


Në prag të viteve 90, Kamza ishte një zonë fshatare me rreth 7000 banore.




Degradimi i tokës mbas Pallatit të Kulturës




Degradimi i shtratit të Lanës nga ndërtimet pa leje




Pamje të Kioskave mbas Pallatit të Kulturës



Pamje të Kioskave nga "Ushtari i panjohur" deri tek Sahati



Prishja e kioskave në parkun "Rinia"



Kioska të ndërtuara në parkun "Rinia"



Prishja e ndërtimeve mbi lumin Lana



Realiteti urban specifik në Bashkinë e Kamzës, është sa informal aq dhe dinamik, dhe po kështu janë parametrat social-ekonomik, sfidat dhe vështirësitë e çdo lloji, me të cilat duhet të përballesh çdo ditë. Autoritetet lokale janë duke bashkëpunuar intensivisht në disa projekte zhvillimi me Bankën Botërore dhe organizata të tjera joqeveritare, me qëllim që të lehtësojnë situatën.

Partneri strategjik i kësaj Bashkie në këto vite ka qënë Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, një organizatë profesionale jo-qeveritare që vepron në fushën e manaxhimit urban, të bashkëpunimit me komunitetin, të projektimit dhe implementimit të projekteve të ndryshme, dhe të hartimit të politikave zhvilluese në këtë fushë.


Co-Plani e ka nisur aktivitetin e tij në fushën e zhvillimit urban, përfshi problemin e ndërtimeve ilegale që në 1995, dhe në Kamzë më 1997.

Si rezultat i bashkëpunimit me Bashkinë e Kamzës, u realizua një projekt 3-vjeçar i rëndësishëm "*Forcimi i Qeverisjes Lokale dhe Iniciativave Komunitare në Bashkinë e Kamzës*".

Bazuar në prioritetet e identifikuar paraprakisht, nga Bashkia e Kamzës, u përcaktuan tre objektiva bazë:

1-Hartimi i Planit Strategjik të Zhvillimit Urban të Bashkisë Kamzë.(SUDP)

2-Trajnimi i Stafit të Bashkisë.



Pamje ajrore e Kamzës më 1995

3-Investimet pilot në infrastrukturën fizike dhe sociale, përfshi planin e zhvillimit ekonomik lokal.

Hartimi i SUDP, si objektivi bazë i projektit i cili sintetizonte interesat afatgjata dhe vizionin e Bashkisë së Kamzës në të ardhmen, është udhëhequr dhe shoqëruar nga një strategji dhe komunikim i veçantë.

Ai kishte si qëllim transparencën, publikimin e procesit, bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve dhe grupeve të interesuara si edhe përfshirjen e komunitetit si një partner dhe bashkëzotërues i këtij plani. Kjo u realizua nëpërmjet publikimeve me anë të broshurave, posterave, mediave dhe mbledhjeve të hapura dhe direkte me banorët.

Elementet struktural të këtij plani janë:

a-Mbledhja e të dhënave dhe analizimi i situatës së Bashkisë.

b-Parashikimi i rritjes së popullsisë.

Menjëherë pas lejimit të lëvizjes së lirë të popullsisë dhe fillimit të reformës së privatizimit të tokës, aty nga fillimi i vitit 1991, u vu re një proces i egër urbanizimi dhe ndërtimesh të paligjshme. Pothuajse gjithë të ardhurit janë nga zona verilindore e Shqipërisë (Tropojë, Dibër, Kukës, Mat, Mirditë, Pukë etj), zonë e cila është tepër e varfër, dhe e prapambetur ekonomikisht për shkak të izolimit të saj nga terreni malor dhe mungesës së infrastrukturës së nevojshme rrugore dhe e telekomunikacionit.

Të inkurajuar nga kaosi i ndryshimeve politike, dhe nga mungesa totale e vizionit të autoriteteve të kohës për disiplinimin e këtij imigrimi, njerëzit e këtyre zonave morrën iniciativën të vendoseshin afër qyteteve të mëdha dhe veçanërisht afër Tiranës, për një jetë më të mirë.

Në ditët e sotme, popullsia e Bashkisë së Kamzës, ku përfshihet dhe lagjja e Bathores, është 10 herë më e lartë se ajo e




Pamje ajrore e zonës së Bathores, më 1994

vitit 1990, dhe përfaqëson ritmin më të lartë të rritjes urbane në vend.

Në zonën e Bathores e shtrirë në një sipërfaqe prej 400 ha, të ardhurit janë të gjithë me status jo zyrtar ose të paligjshëm.

Ndërsa numri i banorëve të ardhur rritet çdo ditë, bashkia e Kamzës ka mundur të regjistrojë vetëm 60% të tyre.



Autoritetet lokale kanë qënë pothuajse të pa afta të përballojnë ritme të tilla rritjeje. Ato kanë pasur në dispozicion buxhete tepër të varfra, kompetenca mjaft të kufizuara dhe përvojë të pamjaftueshme. Megjithë vështirësitë e krijuara, Bashkia e Kamzës mund të përmendet si një shembull interesant dhe pozitiv, se si mund të mobilizosh energji pozitive për realizimin në praktike të një qeverisjeje modeste por premtuese.




Pamje ajrore e zonës së Bathores, më 1999



*Pjesëmarrja e komunitetit në projektimin e Planit Rregullues të zonës dhe ekspozimi i tij në një vend të dukshëm, si pjesë e një procesi transparent dhe konsensual*




*Vendosja e gurrëve kufizues për hapësirat e ardhshme publike*




*Prishje me konsensus e mureve rrethuese për t'i lënë vend hapësirave publike*




*Pamje nga puna për ndërtimin e një rruge në Bathore, bazuar në bashkëpunimin e Co-Plan me Bankën Botërore dhe me pjesëmarrjen e komunitetit dhe pushtetit vendor*



*Hapi i parë Ardhsja e gurrëve të themeleve*



*Hapi i tretë Ndërtimi i katit të parë të shtëpisë*



*Hapi i dytë Ndërtimi i një barrake*



*Hapi i katërt Ndërtimi përfundimtar i shtëpisë*

*Shembull i etapave të ndërtimit të një shtëpie në Bathore*



*Bathore-Kamëz 2002*





*Shoqata e komunitetit të Bathores, duke nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimi me Këshillin e Rrethit, në 2000*

c-Hartimi i Planit të Përdorimit të Tokës.

d-Hartimi i Planit të Infrastrukturës.

e-Hartimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane.


f-Hartimi i Planit të Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Parashikimi i rritjes së popullsisë për 20 vjetët e ardhshme u analizua nga dy pika vështrimi, bazuar në dy skenare të mundshme :

I.Nëqoftëse qeveria nuk merr masa për përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve, atëherë mundësia për zhvillime kaotike, të pakontrolluara dhe zhvillimeve të paorientuara, do të vazhdojë.

Në këtë rast, llogaritjet tregojnë se popullsia e Kamzës në 2022 mund të jetë rreth 105 000 banore, dhe dendësia e banimit 45b/ha.

II.Mundësia e dytë është që qeveria do të sigurojë përmirësimin e shërbimeve dhe të infrastrukturës, dhe kështu të nisë



*Vizita në terren e Presidentit të Bankës Botërore, Wolfhenson dhe Kryeministrit Pandeli Majko në Bathore, në 2000.*

menaxhimin e realitetit urban. Në këtë mënyrë, do të vihet rregull në procesin e urbanizimit.


Sipas këtij skenari, popullsia e Kamzës do të jetë me 2022, rreth, 154 000 banorë dhe dendësia rreth 66 b/ha.

Bashkia e Kamzës mund t'a ndajë territorin në tre pjesë sipas karakteristikave të ndryshme urbane dhe pikërisht: në zonën jugore, në zonën veriore dhe në atë të ndërmjetme.

Sygerimi kryesor i "Planit të Përdorimit të Tokës", është që të densifikojë zonat tashmë të urbanizuara, duke ndaluar kështu procesin e urbanizimit në tokat e lira, dhe në këtë mënyrë të ndalojë harxhimin e tokës bujqësore.

Kështu, përqëndrimi i infrastrukturës do të bëjë që ajo të jetë më pak e kushtueshme dhe më atraktive, nëqoftëse zona do të jetë më kompakte.


Hapat konkretë që duhet të ndërmerren sipas "Planit të infrastrukturës" përfshijnë:




*Pamje nga një rrugë në rikonstrukcion në Bathore, bazuar në principet implementuese të Co-Plan-it dhe Bankës Botërore*







*Park në qendër të Kamzës para dhe pas rehabilitimit*




*Qendra e re e Komunitetit në Bathore*



*Mirëmbajtja e këndit të lojrave për fëmijë*



Plani Rregullues Strategjik i Bashkisë së Kamzës, i mbivendosur në situacionin real në terren



Plan Urbanistik pjesor i Bathores, realizuar nga Co-Plani dhe Projekti i manaxhimit të tokës urbane (Banka Botërore), në bashkëpunim me komunitetin. Plani urbanistik është pranuar nga komuniteti, aprovuar nga Këshilli i Rrethit dhe është në procesin e zbatimit të tij. Përveç rrugës prej 6 km, janë kryer gjithashtu sistemi pilot i ujësjes dhe kanalizimeve. 95% e banorëve kanë paguar kontributin financiar.

1. Hapjen e hapësirave publike (rrugë dhe sheshe për objekte ekonomike dhe sociale) në zonën Jugore të Bashkisë.

2. Ndërtimin e infrastrukturës në zonën Jugore të Bashkisë.

3. Fillimin e procesit të identifikimit të pronave në zonën e Jugut dhe në atë të Ndërmjetme, dhe në perspektivë, zhvillimin e zonës së veriut të Bashkisë.

4. Projektimin dhe sigurimin e hapësirës publike në zonën e Ndërmjetme

5. Vendosjen e një sistemi taksash, të bazuar në GIS (Sistemin Gjeografik të Informacionit), të pronave të paluajtëshme

6. Nisjen e procesit të sigurimit të infrastrukturës dhe legalizimit në zonën Jugore të Bashkisë.

7. Fillimin e projektimit të Planeve Pjesore urbane në zonën Jugore dhe në atë të Ndërmjetme.

8. Kordinimin e punës me Qeverinë qendrore për ndërtimin e infrastrukturës së rëndë dhe pikërisht realizimin e lidhjes së pjesës veriore të hyrjes së Tiranës me Aeroportin "Nënë Tereza".

Plani i Zhvillimit Ekonomik ka marrë në konsideratë kërkesat hapsinore të Bashkisë (kryqëzimet, korridoret dhe hapësirat me zhvillim specifik).

Plani i Manaxhimit të Mbetjeve Urbane, tregon skemën e re të mbledhjes së mbeturinave të ngurta dhe trajtimin e tyre.

Objektivi i investimeve pilot, ka për qëllim të nxisë Administratën Lokale të sigurojë bashkëpunimin me komunitetin, dhe prej saj të gjenerojë një punësim provizor i banorëve të zonës.

Këto investime kryhen në bashkëpunim në komunitetin, ose kontributet financiare të Bashkisë, dhe kanë shërbyer shumë mirë në forcimin e idesë së bashkë-financimit dhe të parimeve të "Zhvillimit me Pjesëmarrjen e Komunitetit". Midis shumë investimeve të realizuara në këtë mënyrë mund të përmendim :

-Pastrimin dhe rehabilitimin e hapësirës së gjelbër në qendër të Kamzës, në bashkëfinancim me Bashkinë.

-Ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në "Lagjen e Re" në Laknas, në bashkëpunim me komunitetin.

-Rehabilitimin e Stadiumit të futbollit në bashkëfinancim me Bashkinë.

-Ndërtimin e një ndërtese 3-katëshe multifunksionale në Bathore (kopësht, qendra e komunitetit, zyra, etj).

### Popullsia

Në verën e vitit 1990 u dekretua lejimi i lëvizjes së lirë dhe njohja e sektorit privat në ndërtim. Ky akt mund të krahasohet në mënyrë figurative me heqjen e digës së një liqeni gjigand, pa projektuar dhe zbatuar më parë masat për ta orientuar vëllimin e madh të ujit të grumbulluar për të shkuar atje ku duhet përmes kanaleve shkarkuese, që do të shmangnin pasojat e një përmbytje masive.




Barriera e masave të rrepta dhe e politikave frenuese ndaj urbanizimit dhe lëvizjes së lirë së popullsisë për disa dekada gjatë regjimit komunist, u hoq pa menduar gjatë se çdo të bëhej me atë kërkesë të jashtëzakonshme për strehim e punësim dhe me aspiratën për një jetë më të mirë të popullsisë.

Dështimi i ekonomisë të centralizuar dhe i modelit të të subvencionimit të rajoneve joproduktive të vendit, kishte krijuar një gjendje të pa shprese për popullsinë lokale. Të papunë, të izoluar dhe larg çdo vëmendje të autoriteteve qendrore, njerzve nuk u mbetej gjë tjetër veçse të vërshonin për një jetë më të mirë drejt rajoneve më të zhvilluara të vendit, ultësirës perëndimore (rajoni fushor midis Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës) dhe sidomos rajonit të kryeqytetit (hapësira midis Tiranës, Durrësit dhe Fushë Krujës) të cilat krijojnë mundësi më të mira të paktën për punësim dhe jetë më normale, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë.


Lëvizjet demografike nuk u panë si përparësi nga ana e autoriteteve qendrore dhe lokale. Nga ana tjetër ndarja administrative nuk merr parasysh këto ndryshime të popullsisë së kryeqytetit ;

Rritja e menjëhershme e popullsisë së qyteteve, shndëroi në qytetarë një pjesë të rëndësishme të popullsisë rurale, pa i dhënë asaj kohë për një proces të natyrshëm përshtatjeje dhe ndryshimi;

Qeverisja vendore e Kryeqytetit u përball me një përzierje të pazakontë të popullsisë së ardhur nga treva të



Viti	Urbanizimi	Ritmi
1945	= 20%	
	45 vjet =	15%
1990	= 35%	0.33/vit
	11 vjet =	17%
2001	= 52%	0.64/vit



Harta komplekse dhe diagrama e rritjes dinamike të popullsisë, asaj ekzistuese dhe asaj të parashikuar, në Tiranë nga 1994-2014.



Plani Rregullues i propozuar i përdorimit të tokës dhe infrastrukturës për zonën jugore të Kamzës.

suksesshme në periudhën e tranzicionit. Lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale drejt qyteteve kryesore, nevojat e mëdha për strehim dhe krijimi i shtresës së pasur që preferon më shumë se një shtëpi çuan në zhvillimin e paparë të tregut të banesave, ndërtimi i banesave zuri rreth 60% të totalit të ndërtimeve. Por ndërkohe ndërtohen dhe objekte të tjera si shkolla e kopshte private, qendra shëndetësore, objekte kulti dhe sidomos fabrika, punishte industriale dhe objekte tregtare.

Në të gjithë vendin veprojnë mbi 3000 firma ndërtimi, dhe liçensimi i tyre vjen në rritje. Ndërtimi është aktualisht një nga sektorët prioritarë të ekonomisë, që jep 15-20% të prodhimit të brendshëm bruto.

Gjithashtu një numër të konsiderueshëm zënë dhe firmat e huaja, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre privat kryesisht në infrastrukturë, ndërtim banesash dhe prodhim të materialeve inerte.

Fitimet e mëdha të këtij biznesi kanë qënë faktorët kryesorë të rritjes së kërkesave për liçensim në këtë sektor;

Në fillimet e tranzicionit, ndërtimi realizonte objekte me cilësi jo të mirë përse i përket fasadave dhe rifiniturave të brendëshme, por me kalimin e kohës edhe për shkak të hyrjes së materialeve të reja në ndërtim, të teknikave të reja të ndërtimit, të rritjes së kërkesës për cilësi dhe mbi të gjitha të forcimit të konkurrencës, cilësia dhe teknologjia e ndërtimit kanë ardhur duke u përsosur dhe ky është një proces që vazhdon.

Mbetet i diskutueshëm kontrolli i kualitetit të ndërtimit, problemet e sigurisë, qëndrueshmëria sizmike për të cilat duhet pohuar se ka munguar monitorimi i autoriteteve.


### Arkitektura Post-Komuniste (pas vitit 1990).

#### Retrospektivë


Arkitektura ka qënë një nga sferat më të komplikuar gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Ajo i duhej regjimit të kohës për zgjidhjen pragmatike të çështjeve me karakter teknik të shoqërisë, si strehimi, ndërtimi i godinave dhe ambienteve publike, etj. Por ajo i duhej këtij regjimi sidomos për të ndërtuar imazhin "e shtetit socialist të fortë e të pavarur".

Për këtë arsye arkitektet u mbajtën larg eksperiencave botërore, larg teknikave bashkëkohore dhe mjeteve e materialeve të reja ndërsa u injektuan me ideologjinë e arkitekturës socialiste. Ata u shndërruan në teknikientë të mirëfilltë, dhe u edukuan me frymën e një arkitekture sa më të thjeshtë, dhe me kosto sa më të ulët, shpesh duke cënuar rëndë vetë vlerat e një arkitekture të mirëfilltë.

Sidoqoftë, autoritetet treguan se kishin frikë nga liberalizmi tipik i arkitekteve, dhe sidomos tendenca për liri në krijimtari, gjë që mund të krijonte probleme ndaj ideologjisë së regjimit në fuqi. Për këtë arsye arkitektura si art apo shkencë për vitet të tëra u trajtua disi veçantë dhe me një kujdes të sofistikuar,



Rritja e sipërfaqes së ndërtimit gjatë periudhës 1990-2001.



Apartamente banimi në ndërtim, afër parkut të liqenit, Janar 2003

ndryshme të Shqipërisë, me përzjerje minikulturash e profesionesh, që ndryshonin mjaft nga pjesa e popullsisë së qyteteve.

Të ardhurit në periferi të kryeqytetit vijnë kryesisht nga rrethet: Tropojë, Skrapar, Dibër, Kukës, Mat, Mirditë, Pukë, etj.

Që nga viti 1990 popullsia e Bashkisë së Tiranës është dyfishuar ndërsa rajoni i Tiranës së Madhe është trefishuar. Më 1990 popullsia e Tiranës vlerësohej të ishte rreth 374 000 banorë, dhe mendohet të jetë rritur me 250 000 banorë dhe shtrirë në 1000 ha të tjerë. Çdo vit ndërtohen mesatarisht rreth 200 hektare tokë, kryesisht me ndërtime pa leje. Ritmi i shtimit të popullsisë së Tiranës është nga më të lartët në botë, me 5-7% në vit, nga e cila 2% vjen si pasojë e rritjes natyrore (raporti lindje vdekje) dhe 3-5% nga rritja mekanike (raporti ardhje dhe largime nga qyteti).

Më 1945, vetëm 20% e popullsisë jetonte në qytet. Gjatë 45 vjeteve, urbanizimi rritet me 15%, pra me 1990, 35% e popullsisë jetonte në qytet. Mbas vitit 1990, urbanizimi rritet çdo vit me 0,33% në vit, ose gjithësej 17% për 11 vjet.

Llogaritjet e përafërta tregojnë se në vitin 2010 rajoni i Tiranës së Madhe mendohet të strehojë rreth 1 milion banorë dhe ne se nuk hartohen politika në vitin 2020 ky numër mund të jete rreth 1.5 milion banorë.

### Industria e Ndërtimit

Industria e ndërtimit u bë një nga bizneset më të fuqishme dhe më të



OJQ e krijuar në vend. Edhe pse aktualisht kjo shoqatë është riorganizuar, ajo nuk ka mundur të bëhet ende një institucion me peshë në fushën e arkitekturës. Ndërkohë që legjislacioni në fuqi që lidhet me arkitekturën është ende ai i vjetri.

#### Rilindja e Arkitekturës

Gjatë dekadës së fundit në Tiranë u vu re një tendencë në rritje e krijimit të studiove private, ku arkitektë dhe specialistë të fushave të tjera të ndërtimit u riorganizuan në formën e byrove të vogla private të projektimit me një praktikë mjaft pragmatiste. Kjo lidhet me faktin se Tirana numëron gati 70% të arkitektëve të vendit, dhe se mentaliteti dhe mundësitë e biznesit në Tiranë janë më të mëdha se në qytetet e tjerë.

Prezantimi i sektorit privat edhe në arkitekturë përbën një pikë kthese ndërkohë që mjaft arkitektë u ekspozuan ndjeshëm ndaj arkitekturës ndërkombëtare për shkak të udhëtimeve të tyre jashtë vendit. Sidoqoftë hapat e parë të viteve 90-të ishin të vështirë dhe arkitektura e realizuar në shumicën e rasteve është mjaft modeste, me materiale dhe teknika ndërtimi të vjetëruara në koncept, shpesh edhe nën presionin e mbijetesës financiare.

Profesioni i arkitektit pati një lloj rirzgjimi çuditërisht gjatë vitit 1996, pasi mjaft njerëz të cilët investuan në firmat mashtruese piramidale filluan të bënin projekte investimesh të cilat kërkonin projekte dhe ide arkitektonike. Shpesh këto projekte ishin të mëdha dhe të ekzagjeruara, dhe megjithëse në

shumicën e rasteve nuk u realizuan kurrë, indirekt ndikuan në punësimi dhe ushtrimin e profesionistëve të arkitekturës.

Sidoqoftë zhgënjimi i investimeve piramidale dhe mungesa e stabilitetit politik dhe social gjatë krizës së vitit 1997, patën një efekt pozitiv për arkitektët dhe arkitekturën sidomos në Tiranë. Në mungesë të një sistemi bankar të konsoliduar në vend, mjaft biznesmenë dhe investitorë vendas (qofshin këta edhe individë) menduan të investojnë në sferën e pronave të patundshme dhe sidomos në ndërtimin e banesave për qëllime strehimi. Kjo i dha një shtytje të mirë arkitekturës në Tiranë, sidomos në qendrën e qytetit, ku vitet e fundit është vënë re një bum investimesh, sidomos në ndërtime shumëkateshe, por jo gjithmonë duke respektuar vlerat më të mira profesionale.

#### Stili arkitektonik

Natyrisht ky bum ndërtimesh është shoqëruar me progres si në format e ndërtimit, në stilin arkitekturor, si edhe në teknikat e përdorimit të materialeve të ndërtimit.

Sidoqoftë arkitektura shqiptare përfshi edhe atë në Tiranë, është ende larg krijimit të një identiteti apo të një stil tipik të saj. Kjo ndoshta sepse arkitektët që e dominojnë atë i përkasin ende gjeneratës së arkitektëve të shkollës së vjetër, llogjike e cila është krejt kundërt me atë të sistemit të tregut të lirë në të cilin jetojmë sot.

Me gjithë përpjekjet interesante në disa raste siç është rasti i Kullës Infosoft,

duke synuar që "të lëshohej litari" për aq sa nuk prishej pune! Kjo situatë vazhdoi për dekada të tëra, deri sa në Shqipëri filloi të fryje era e ndryshimeve.

#### Kriza e identitetit të Arkitekturës

Ndryshimet politike dhe ekonomike në fillim të viteve 90-të ishin të shpejta dhe dramatike, por nuk ndodhi e njëjta gjë në fusha si arkitektura, ku për vite të tëra ishte investuar për të përgatitur kadro steriotip që prodhonin një arkitekturë të ngurtë, standarte, dhe hera-herës primitive, po të përjashtojmë objektet me rëndësi publike.

Arkitektura postkomuniste në Shqipëri, përfshi atë në Tiranë hasi një krizë të thellë identiteti sidomos në vitet e para të ndryshimeve. Gjendja u përkeqësua më tej pasi në morinë e problemeve të vendit arkitektura nuk përbënte absolutisht një prioritet. Për më tepër privatizimi i tokës, copëzimi i saj, kthimi i pjeshëm i pronave dhe sidomos gjendja e vështirë ekonomike e vendit e bënte të pamundur ekzistencën e financimeve për ndërtimin e objekteve të reja serioze apo për të paguar vetë profesionin e arkitektit.

Në këtë mënyrë arkitektura shpesh përfundoi në duart e njerëzve anonime, të cilët duke synuar të zgjidhnin problemet e tyre me kosto sa më të ulët, injoruan profesionin e arkitektit dhe preferuan shpikjen e të ashtuquajturës "arkitekturë informale" duke investuar në mënyrë graduale pa iu referuar asnjë arkitekti, gjë që në një farë mënyre i nxorri jashtë loje arkitektët për një farë kohe.

Kjo është një nga periudhat më të vështira të arkitekturës shqiptare dhe sidomos për arkitekturën në Tiranë ku profesioni i arkitektit praktikisht kishte vlerë mjaft të ulët.

Në këto kushte mjaft arkitektë emigruan kurse shumë të tjerë për arsye mbijetese u detyruan të ndërrojnë profesion. Instituti Kombëtar i Arkitekturës (ose Instituti 1, siç njihej) falimento, dhe reformat e njëpasnjëshme praktikisht nuk arritën t'a ndihmonin riorganizimin e tij, por provokuan mbylljen përfundimtare të këtij institucioni.


E njëjta gjë ndodhi edhe me Byrotë Publike të Projektimit Arkitektonik. Për më të guximshmit privatizimi mbeti zgjidhja e vetme, kurse mjaft arkitektë lëvizën drejt zyrave të urbanistikës të cilat edhe pse u riorganizuan, mbetën publike, apo siç u përmend më sipër iu përshtatën ekonomisë së tregut në fusha të lidhura me arkitekturën si ndërtimi, prodhimi dhe shitja e materialeve të ndërtimit, etj.

Me pak fjalë vitet 90-të, kanë qenë vitet e krizës së identitetit të arkitekturës shqiptare, por në të njëjtën mënyrë ato shënojnë fillimin e një epoke të re për arkitekturën e Tiranës. Pikërisht këtu nisi edhe riorganizimi edhe reformimi i saj, edhe pse në mënyrë spontane, sepse vetë autoritetet u treguan të paafta të hartonin një strategji pragmatike për këtë qëllim.

Nga ana e tyre vete arkitektët u treguan të paaftë dhe egoistë për t'u organizuar në mbrojtje të interesave të tyre dhe pse Shoqata e tyre ishte e para



Ndërtime të reja pranë Bulevardit të Tiranës, Janar 2003.



Katedralja e "Shën Palit", ndërtuar në 2000 në krah të lumit të Lanës, në homazh të pelegrinazhit të parë të "Shën Palit" në Iliri në vitin 52 mbas Krishtit.

Sky Tower (ose siç njihet Kulla Vodafone), dy kullat "Binjake" pranë bulevardit Dëshmorët e Kombit, Kulla Drini (pas Sahatit), e një sërë objekte të tjera shumëkatëshe, vihet re ende një ngurtësim, dhe shpesh objekte të tilla kanë probleme serioze nga pikëpamja e vendosjes urbanistike, duke çenuar në ndonjë rast rëndë interesin publik dhe trashëgiminë kulturore.

Ende ndërtohet me sistemin tra kollonë të kombinuar me tullën, dhe fasadat janë mjaft të thjeshta, dritaret të vogla, dhe më tepër mund të flasim për një arkitekturë të stilit funksionalist.

Në të vërtetë ajo që është më interesante se sa vetë objektet në fjalë, është diskutimi në se duhet të ndërtojmë në lartësi apo të kufizohemi në 5-6 kate si më parë.

Më tej debati është shtrirë në vlerat e arkitekturës lokale të banesës tradicionale me qerpic e cila shpesh po zëvendësohet nga pallatet shumëkatëshe në ndërtim.

Llogjika e sistemit të ri ekonomik dhe mungesa e zonave të reja të qytetit me infrastrukturën e nevojshme, kanë nxitur arkitekturën vertikale, ndërkohë që mjaft objekteve të larta u mungojnë elemente të rëndësishme si shkallët e emergjencës, distancat e lejuara për diellëzim apo për raste fatkeqësish si termet, zjarri, etj. Për më tepër askush sot nuk mund të flasë me siguri në lidhje me qëndrueshmërinë sizmike të zhvillimeve të reja.

Sidoqoftë, pavarësisht nga problematika e komplikuar e trashëguar

apo nga ajo e krijuar, gjatë dekadës së fundit në Tiranë po kultivohet një arkitekturë e re e cila premtan se së shpejti ky qytet do të konsiderohet si një nga evenimentet arkitektonike europiane.


Kështu vitet e fundit janë ngritur edhe objekte me vlera në arkitekturë, ku duhet të veçojmë Kompleksin Katolik të Tiranës (Katedralja dhe Selia e Dioqezës Durrës-Tiranë), një arkitekturë thjeshtë me tendenca post-moderne. Produkte interesante të arkitekturës Tiranase vihen re edhe në një rrjet shkollash 8 dhe 12 vjeçare të rehabilituara, riorganizuar apo rindërtuara në kuadrin e Projektit Tirana 2000 të finacuar nga Projekti Soros dhe Qeveria Shqiptare, ku mund të veçojmë Shkollën e Kuqe, Shkollën Vasil Shanto, Emin Duraku, Ministrinë e Arsimit, etj.

Arkitekturë interesante përfaqësojnë edhe një sërë objekte më të vogla, si vila apo restorante, përfshi këtu edhe rikonstrukcionet e bëra, ku mund të veçojmë arkitekturën e "Real Park", "Vila Goldi", kinematë "Milenium" 1 dhe 2, etj., edhe pse për to është ngritur çështja e të drejtës së autorit.


Vend të veçantë në arkitekturën e kësaj dekade zënë edhe ndërhyrjet me karakter rinovimi, si në rastin e arkitekturës së kompleksit të ministrive, të Hotel Tiranës në qendër të qytetit, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Drejtësisë, Universitetit Politeknik, Parlamentit, etj.

Më tej interes paraqesin rehabilitimet e fasadave dhe arkitekturës të rrugëve





Ndërtesa e re e shkollës 8-vjeçare "Qazim Turdiu", ndërtuar në pjesën veriore të qytetit, financuar nga Fondacioni Soros.



Rikonstrukcioni i shkollës 8-vjeçare "Sabaudin Gabrani", financuar nga Fondacioni Soros.



Rikonstrukcioni i shkollës 8-vjeçare "Shkolla e Kuqe", financuar nga Fondacioni Soros.

kryesore të qytetit, të cilat me gjithë debatin që ka ngritur mbi ngjyrat dhe të drejtën e autorit, i kanë dhënë Tiranës një imazh të ri të një arkitekture moderniste gati surrealistike e cila dalëngadalë po bëhet simbol i ri i qytetit, duke unifikuar me sukses stilin informal me atë të arkitekturës formale.

Në përfundim arkitektura post komuniste në Tiranë mund të klasifikohet në dy grupime kryesore:


(i) *Arkitektura informale* - ku dallohen forma të arkitekturës spontane

si shtesa anësore ose kati të objekteve ekzistuese, ndërtime pa leje në pronë private ose në tokë të uzurpuar, të cilat në qendër të qytetit (Lana) kanë kryesisht qëllime biznesi, ndërsa në periferi (Bathore) kryesisht qëllime strehimi.


Për arsye të nivelit të ulët ekonomik, arkitektura e banesës tipike informale është ajo që njihet me emrin "model Elbasani". Kjo tipologji banese zhvillohet me llogjikën e arkitekturës me kosto të ulët dhe të vetëpunësimit. Arkitektura zhvillohet në një kat mbi një truall 80-



"Sky tower", një nga qendrat moderne të biznesit të ndërtuara në Tiranë.




Restoranti i ri "Juvenilja", ndërtuar në kodrat e Liqenit.




Kinema "Millenium 2", në krah të murit të shtëpisë-kështjellë të Toptanasve, e rikonstruktuar.



*Pamje nga ndërtesat qeveritare dhe ndërtesat publike të rikonstruara, të rinovuara ose siç thuhet zakonisht të "kthyer në identitet".*










Planimetri tip e banesës ilegale, ndërtuar në periferi të Tiranës dhe Bathore.

Një formë tjetër e arkitekturës së strehimit në Tiranë janë komplekset e banesave të ndërtuar kryesisht nga investitorë të huaj si në rastin e firmave Gintash dhe Caravan (Laparakë) Hawaii (Laparakë, Selitë, Don Bosko) YY International (prane aerodromit), dhe Hoxholli (investitor vendas) pranë Ekspozitës "Shqipëria Sot", etj. Këto komplekse janë më të kompletuara nga pikëpamja e shërbimeve tregëtare dhe sociale, por shpesh kualiteti i tyre lë shumë për të dëshiruar, sidomos në rastet kur ato janë të destinuara për familje me të ardhura të mesme dhe të ulta.

Arkitektura për qëllime biznesi përfshin një sërë investimesh në fushën e tregëtisë (bare resorante), rekreacionit dhe turizmit (*Kartodromi, Schateau Linza*), apo biznesit të mirëfilltë (*Hotel Rogner, Hoteli Sheraton, selia e Infosoft, selia e Wolsvagen, Kullat "Binjake", Banka Dardania, Banka Shqiptaro-Amerikane*, përfshi edhe objekte të karakterit të tillë si *televizioni Klan* apo *Katedralja Katolike*, etj.), si dhe një numër hotelesh të vegjël të shtrirë në të gjithë qytetin (*Diplomat, Mondial, Palma, Europa, Vjosa, Nirvana, President, etj.*). Kualiteti i arkitekturës në këto objekte është përmirësuar ndjeshëm dhe në mjaft raste ndihen elemente inovative bashkëkohore.

Më tej një zhvillim interesant ka marrë arkitektura industriale, kryesisht përgjatë koridorit të autostradës që lidh Tiranën me Durrësin dhe Aeroportin. Sidomos përgjatë segmentit Tiranë-Vorë gjenden një sërë objektesh me funksion industrial ose administrativ që kanë vlera interesante arkitektonike si sallonet e ekspozimit të makinave (Mercedes, Opel, Kia) të industrisë së lehtë dhe ushqimore (Olim) apo të materialeve të ndërtimit dhe të mobilerisë/interierëve.




Pamje nga fasadat e rinovuara të godinave të banimit në rrugën e Durrësit dhe rrugën e Elbasanit.

100 m<sup>2</sup>, dhe një kosto totale 10-15 mijë USD. Mbi këtë bazë objekti mund të zhvillohet më tej në dy apo tre kate apo me shtesa të tjera, në varësi të nivelit ekonomik të familjes investuese dhe të aftësive mbajtëse të objektit.



Ndërsa arkitektura e objekteve informale të biznesit varion nga 1 kat (kryesisht në formën e kioskave) deri në objekte solide 2-3 dhe disa raste 4 kate, në varësi të mundësive që lejon trualli, financat dhe kërkesat e biznesit. Në përgjithësi arkitektura informale përdor si material ndërtimi drurin, tullën, kollona dhe trarë betoni, kryesisht çati me tjegulla

të kuqe dhe në disa raste soletë betonarmeje. Dritaret dhe dyert janë kryesisht në dru ose duralumin. Shpesh shfrytëzohet edhe kati nën çati, kryesisht për funksion strehimi.

(ii) *Arkitektura formale* - ku përfshihen zhvillime të ligjshme për funksione strehimi, biznesi apo industriale. Arkitektura e strehimit shprehet kryesisht përmes objekteve të veçura shumëkateshe në formën e kullave 8-12 apo me më shumë kate siç është rasti i kullave të ndërtuara në qendër të qytetit sidomos në zonën e "Bllokut", kryesisht nga investitorë vendas.






*Apartamente të reja banimi, të projektuara dhe të zbatuara nga investitorë shqiptarë*






*Apartamente të reja banimi, të projektuara dhe të zbatuara nga investitorë shqiptarë.*







*Ndërtime të reja industriale.*




*Hotele të reja në Tiranë.*

Arkitektura & Zhvillimi  
Urban  
1991-2003



Pamje nga projektet e godinave që janë në ndërtim e sipër.

Arkitektura & Zhvillimi  
Urban  
1991-2003






Në fakt interesi kryesor i autoriteteve dhe institucioneve të specializuara është përqëndruar vitet e fundit pikërisht në hartimin e një plani të ri rregullues për qytetin e Tiranës.

Iniciativat më domethënëse të fokusuara në Rajonin e Tiranës së Madhe dhe përreth që janë marrë në konsideratë për hartimin e *Detjës së Projektimit të "Planit të ardhshëm Urbanistik të Tiranës"* janë:


1. Studimi i Planifikimit dhe Programimit Strategjik të Infrastrukturrës së Tiranës së Madhe ose shkurt "*Plani Strategjik për Tiranën e Madhe*", i ndërmarrë në kuadrin e "*Programit të Menaxhimit të Tokës Urbane*" në Ministrinë e Rregullimit të Territorit, që financohet nga një kredi e Bankës Botërore dhe asistohet teknikisht nga PADCO(U.S.A.)

Po kjo kompani konsulente, me eksperiencë ndërkombëtare në këtë fushë, ka realizuar më 1995 një studim paraprak për këtë qëllim në favor të së njëjtës ministri, financuar nga USAID. Ky studim i njohur si "*Plani Paraprak i Strukturave për Tiranën e Madhe*", merr në konsideratë dhe "*Studimin e Zonës Suburbane të Rajonit të Tiranës*" përgatitur nga ISPU.

2. "*Studimi Rajonal për Korridorin Tiranë-Durrës*", i ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare përmes ISPU, i cili është kompletuar më vonë me një plan të hartuar me asistencën e GTZ, organizatë Gjermane për Koperim, dhe që mbulon kryesisht territoret e Komunave dhe



Plani Strategjik i Tiranës së Madhe, realizuar nga M.R.R.T.T. dhe P.A.D.C.O.



Studim rajonal i Korridorit Tiranë-Durrës.

Bashkive në hapësirën rurale ndërmjet Durrësit dhe Tiranës pa u futur në këto qytete.

3. "*Studimi për Skemën e Transportit në Tiranë*", përgatitur nga Njësia e Menaxhimit të Projektit për Rikonstruksionin e Portit të Durrësit, financuar nga Banka Botërore në vitin 1993, studim i cili vlerëson gjendjen ekzistuese dhe propozon një skemë të rrjetit rrugor për qytetin e Tiranës. Kjo skemë është integruar dhe në Planin Strategjik të Tiranës së Madhe.

## 6. SKENAR I MUNDSHËM PËR TË ARDHMEN E TIRANËS

Tashmë dilema kryesore për të gjithë është: si do të zhvillohet Tirana në të ardhmen?

Duke iu referuar tendencave aktuale, zhvillimi i Tiranës po orientohet në dy drejtime kryesore:


- (i) densifikimi i qendrës së qytetit
- (ii) zgjerimi i periferisë së qytetit me krijimin i zonave të reja suburbane.

Në se autoritetet qendrore dhe lokale do t'i paraprijnë zhvillimit me plane, strategji dhe investime konkrete dyndja e popullsisë në Tiranë do të balancohet

tek shifra 50% e popullsisë së vendit, në të kundërt në kryeqytet do të instalohen në mënyrë kaotike të paktën 2/3 e popullsisë së vendit.

*Sigurimi i alternativave ligjore dhe integrimi i zhvillimeve të deritanishme* janë dy nga drejtimet kryesore të strategjisë së përbashkët të qeverisë qendrore dhe pushtetit lokal të Tiranës.

Kjo synon që duke zgjidhur problemet e mprehta të infrastrukturës, të lehtësohet zgjidhja e çështjeve sociale, si, varfëria, papunësia, strehimi, etj.




Panje panoramike e Tiranës, viti 2003.

### Disa të dhëna mbi Planin Strategjik të Zhvillimit Urban të Rajonit të Tiranës së Madhe, 2002


Plani bën një parashikim të rajonit të Tiranës së Madhe për 15 vjetët deri në vitin 2017. Plani nuk është një instrument planifikues rregullues, se sa një vizion për udhëheqjen dhe koordinim e zhvillimeve në nivel rajoni, vizion i cili do të përpunohet më tej prej çdo bashkie përmes planeve të detajuara rregulluese që do të hartohen nga njësitë e veçanta të pushtetit vendor.

Plani parashikon infrastrukturën kryesore sidomos atë rrugore. Ai parashikon zonimin funksional ose strukturat kryesore të përdorimit të tokës.


Më tej bëhet analiza financiare e zhvillimit dhe përcaktohen kostot dhe mënyrat e mbulimit. Kjo është shoqëruar me analizën e tregut të tokës, si dhe prezantohen forma bashkëkohore planifikimi, përfshi atë strategjik, të veprimit, dhe legalizimin.




Plani Strategjik i Tiranës së Madhe. Strategjia e përdorimit të tokës deri në 2017.



Plani Strategjik i Bashkisë së Kamzës.



Plani i Strukturave, financuar nga Banka Botërore dhe USAID.



Studimi i zonës Urbane nga NPI.

4. "Plani Strategjik për Zhvillimin Urban të Bashkisë Kamzë", manaxhuar nga CO-PLAN, Qendra për Zhvillimin e Habitatit, dhe asistohet teknikisht nga IHS Rotterdam Hollandë, një institucion me eksperiencë ndërkombëtare dhe aktiv në Shqipëri që nga 1997.

Ky plan detajon Planin Strategjik të Tiranës së Madhe për Bashkinë e Kamzës, e cila është një Bashki kufitare me Bashkinë e Tiranës, me të cilën ndan mjaft funksione sociale, urbane dhe ekonomike.

5. "Studimi mbi Zhvillimin e Qytetit të Tiranës", një projekt i Bashkisë Tiranë, përgatitur nga kompania Austriake e konsulcencës « Regional Consulting », me financimin e Qeverisë Austriake në vitin 1995.

6. "Rregullorja e Zonimit të qytetit të Tiranës", përgatitur nga Robert Y. Olsen, ekspert i Institutit Urban (U.S.A.) në kuadrin e "Projektit të Strehimit dhe Zhvillimit Urban", financuar nga USAID.

7. Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave, realizuar nga INSTAT.

8. Plani Urbanistik i Bashkisë së Tiranës me asistencën e Qeverisë Austriake (1995-1996).

9. Të dhëna të nevojshme për hartimin e Detyrës së Projektimit nga ISPU.



brenda lagjeve/zonave kryesore të qytetit.

**Kategoria e rrugëve të veçanta:**


1. Rrugët klasifikohen në 1 dhe 2 korsi (secila korsi ka 2 kalime) në varësi të trafikut dhe rëndësisë.

Nga kjo skemë krijohet një lidhje alternative më e shkurtër me aeroportin e Tiranës dhe koridorin e veriut, përmes zgjatimit të bulevardit të qytetit në veri drejt Paskuqanit, në lindje të Bashkisë Kamëz (përgjatë lumit të Tërkuzës) dhe

më duke u drejtuar drejt verilindjes i afrohet pjesës jugore të aeroportit ku takohet me autostradën e veriut.

2. Rrugët prioritare për transportin publik përmes linjave të autobuzave, si Porcelan - Rruga Bardhyl, Sauk - Partizani i Panjohur, Kafe Flora - Fabrika Coca-Cola, Kodër Kamëz - Yzberisht.

3. Rruga e Kavajës dhe një sërë rrugësh kryesore në pjesën perëndimore të qendrës bëhen rrugë me një drejtim lëvizjeje të detyruar për automjetet.



Plani i strukturave të Tiranës së Madhe. Sistemi i rrugëve kryesore.

Plani propozon edhe një sërë përmirësimesh ligjore. Rrjeti rrugor është një nga komponentet kryesore të këtij plani. Qendra zgjerohet dhe përfshin gjithë hapësirën brenda unazës së dytë (aktuale) të qytetit.

Ndërkohë prezantohet unaza e tretë dhe katërt, jashtë të cilës nuk lejohen ndërtime dhe konsiderohet si zonë e brezit të gjelbër. Ndërkohë zona e aeroportit dhe Vorës do të jenë zona të rëndësishme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe të biznesit.

Ky plan parashikon zhvillimin e disa kategorive rrugësh në funksion të lehtësimit të trafikut dhe transportit.

**Kategoria a parë janë unazorët:**

Këtu futen dy unazat kryesore, qendrat e të cilave ndryshe nga deri më tani janë të ndryshme (të zhvendosura).

1. Unaza (në hartë me vijë blu) - do të jetë në thelb kompletimi i unazës së tretë të qytetit, por që përfshin Brenda më shumë zona se sa ishte parashkuar nga plani i 1985. Në përfundim, segmenti i parë i saj është ndërtuar. Në veri ajo do të përfshijë edhe Paskuqanin deri në kufi me Bathoren (Bashkia Kamëz).

Në lindje ajo do të përfshijë zonat rrotull Kodrës së Priftit dhe Liqenit të Farkës ku ka mjaft zhvillime informale të viteve të fundit. Në jug ajo do të përfshijë Selitën, parkun dhe liqenin e Tiranës në kufi me Saukun, etj. Në një farë mënyre ky mund të jetë kufiri administrativ i ardhshëm i Bashkisë së Tiranës. Teritoret

e tjera mund të përfshihen në Bashki të tjera që mendohet të krijohen.

2. Orbitalia (në hartë me vijë të kuqe) do të jetë një unazë tjetër qendra e të cilës i shmanget sheshit Skënderbej. Në fakt kjo unazë e katërt, synon të mbulojë të gjitha zonat ekzistuese dhe ato të krijuara viteve të fundit duke filluar nga lindja e Tiranës me Lagjen e Kombinatit dhe rrethinat e saj deri në veri me zonat e zhvilluara rishtazi në Bashkinë e Kamzës.

Në këtë mënyrë bëhet lidhja me aksin rrugor perëndimor Tiranë-Durrës dhe me koridorin rrugor verior Tiranë-Shkodër, apo me atë juglindor Tiranë-Elbasan, duke shmangur hyrjen e trafikut të panevojshëm në qendër të qytetit siç ndodh aktualisht.

**Kategoria e dytë janë tangencialet:**

Akset tangenciale të reja më të rëndësishme që propozohen për t'u zhvilluar janë:

1. Segmenti që kalon nga veriu në Babrru, Allias, Rruga Bardhyl, Bërryli, Rruga Ali Demi, Farkë, deri në një takim në jug me rrugën për në Elbasan.

2. Në veri fillon me rrugën e Zall-Herrit, takohet me rrugën e Kamzës, dhe më pas degëzohet në drejtim të Bërxullit dhe të autostradës së Durrësit. Degëzimi i fundit kalon drejt Yzberishit dhe përfundon në Kombinat.

**Kategoria e tretë janë ato që quhen rrugë distrektuale dhe që janë akset kryesore që depërtojnë nga unazorët**

Përveç linjave të posaçme të transportit me autobuzë të cilat synojnë të reduktojnë trafikun privat, është planifikuar ndërtimi i dy linjave të transportit publik përmes tramvajit (trenit të shpejtë) që lidhin aeroportin me Kamzën deri në Bërxullë ku ndahet në dy drejtime kryesore:

1. Linja e tramvajit që vijon në Yzberish dhe përfundon në Kombinat.

2. Linja e tramvajit që vijon në linjën ekzistuese hekurudhore Durrës Tiranë nga Bërxulli tek stacioni i sotëm hekurudhor dhe përfundon gjatë bulevardit në Sheshin universitar Nënë Tereza.

Zonat kryesore ekonomike dhe të biznesit janë menduar në Bërxullë (administratë biznesi) dhe Kombinat, përgjatë autostradës së Durrësit, në zgjatimin verior të bulevardit (ndërtime shumëkatëshe) nga stacioni i sotëm hekurudhor deri në Paskuqan.

Këtu futen edhe zonat ekonomike të aeroportit (zona e ekspozicionit) dhe Vorës. Më tej janë parashikuar disa nje zhvillimi dhe investimi që shpërndahen në gjithë strukturën e qytetit.

Po kështu ndosh me qendrën. Përveç zonës tradicionale qendrore përbrenda unazës së dytë janë menduar edhe mjaft qendra të tjera të decentralizuara të cilat i shërbejnë zonave/lagjeve të veçanta.

Hapësirat kryesore të gjelbëra dhe parqet periferike do të jenë ato të pranë

liqenit të Tiranës në jug, Liqenit të Paskuqanit në veri, malit të Dajtit në lindje, dhe në kryqëzimin e autostradës së Durrësit me orbitalen në lindje.

Pjesa kryesore e qytetit brenda unazës së tretë (përjashtoj Paskuqanin dhe disa zona pranë malit të Dajtit që do ndërtohen me vila) mendohet të zhvillohen me dendësi të lartë.


Pjesa jugore e Bashkisë Kamëz, Yzberisht, Kombinat, Kombinat i Autotraktorëve, Kodra e Priftit, Allias, Paskuqan, etj, do të zhvillohen me densitet mesatar. Kurse pjesa kryesore e Bashkisë Kamëz, zgjatimi lindor i Kombinatit, dhe shtrirja lindore e qytetit drejt Dajtit mendohet të zhvillohen me densitet të ulët.

Impianti i depozitimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane do të ndërtohet në lindje të Kombinatit. Ndërsa ai i ujrave të zeza në lindje të Bërxullit. Projekte të veçanta janë parashikuar për pastrimin dhe sistemimin e lumejve të Lanës, Tiranës, dhe Tërkuzës.

### Bashkia e Tiranës

Administrata aktuale e Bashkisë Tiranë drejtuar nga Kryebashkiaku Edi Rama kanë dhënë prova se manaxhimi i këtij realiteti kompleks urban nuk është i pamundur, duke rizgjuar besimin dikur të vakët se "ky qytet mund të bëhet".

Strategjia e administratës aktuale bashkiake për të kultivuar një imazh të ri të Tiranës përmes një arkitekture agresive shumëkatëshe me forma moderne dhe



Itineraret e linjave të propozuara të tramvajeve.



materile të tilla si duralumini dhe xhami, pritjet që të ketë një impakt të ndjeshëm në pamjen dhe siluetin e qytetit, i cili aktualisht përbën një nga qytetet më interesante në Europë nga pikëpamja e dinamikës së zhvillimit.



Dhënia e një çmimi ndërkombëtar nga OKB-ja për Kryetarin e Bashkisë së Tiranës për shkak të kontributit të tij në përmirësimin e kushteve të jetesës në qytet, si dhe organizimi i konferencës ndërkombëtare të rradhës së ENHR-së, Rrjetit prestigjioz European të Studimeve mbi Strehimin dhe Zhvillimin Urban është një nga provat se Tirana tashmë ka filluar të tërheqë vëmendjen ndërkombëtare për rezultatet e saj në zhvillimin arkitektonik urban.

Kjo është një tjetër provë se si arkitektura dhe urbanistika mund të luajnë një rol kyç në ringritjen morale dhe ekonomike të një qyteti dhe më gjerë të një kombi. Kjo u përforcua më tej me organizimin e konkursit ndërkombëtar për qendrën e qytetit, edhe pse kjo iniciativë nuk arriti të kthehej në një proces gjithëpërfshirës, duke patur rezervat e komunitetit të arkitektëve dhe urbanistëve vendas.


Që nga viti 2000, janë ndërmarrë operacione të rëndësishme urbanistike që po ja ndërrojnë krejtësisht imazhin kryeqytetit shqiptar dhe kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik kryeqytetas, intitucioneve të huaja që operojnë në vendin tonë, si dhe të shtypit perëndimor.

Për t'u përmendur janë:

1 - Shembja e ndërtimeve pa leje në qendër të qytetit të Tiranës dhe sidomos




Pamje nga fazat e rindërtimit, që nga prishja e ndërtimeve pa leje e deri në rehabilitimin e plotë të dy kraheve të Lanës.




Tirana në qendër të akseve kombëtare dhe ndërkombëtare.

*Arkitektura & Zhvillimi  
Urban  
E Ardhmja*



*Rehabilitimi i fasadave në rrugët kryesore të Tiranës.*

*Arkitektura & Zhvillimi  
Urban  
E Ardhmja*



*Pamje nga Lana e rehabilituar, Mars 2003.*

në Parkun Rinia dhe hapësirën e Lumit Lana;

2 - Rehabilitimi dhe lysterja e fasadave të rrugëve kryesore të qytetit;

3 - Iniciimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje;

4-Zgjerimi dhe ndriçimi i rrugëve kryesore të qytetit, veçanërisht zgjerimi dhe reabilitimi i rrugëve paralele me Lanën; (e cila në fakt ka shtuar edhe trafikun)

5 - Rikthimi i gjelbërimit, ndërtimi i shumë lulishteve dhe gjelbërimi i skarpateve të Lanës;

6 - Rikonstrukcioni i kompleksit historiko-monumental të ministrive;



7 - Tendanca për të përfshirë banorët dhe komunitetet në procesin e përmirësimit të qytetit, (aplikohet për herë të parë) edhe pse kjo ka patur koston e vet për shkak të keqkuptimeve dhe vështirësisë të ndryshimit të mentaliteteve, etj. apo aplikimit të mangët të këtij koncepti.

Vlen për t'u përmendur prishja dhe pastrimi i ndërtimeve në Lanë nga komuniteti i Biznesit, duke i kursyer Bashkisë një fond prej 10 milion \$.


Është vërtet entuziasmes fakti se tashmë në Tiranë është hapur një debat i shëndetshëm publik, i cili edhe pse ka vështirësuar ose bllokuar realizimin e disa ideve, nga ana tjetër ka përmirësuar



Arkitektura & Zhvillimi  
Urban  
E Ardhmja



Harta e projektit të rehabilitimit të zonës së banimit në Breglumas, 1997.



Ndërtimi i rrugës në Breglumas, sipas projektit dhe me pjesëmarrjen e komunitetit.




Rehabilitimi i hapësirave publike në bllokun "1 Maji", ku kontributi i komunitetit përbën 20% të kostos së projektit (nga sipër-poshtë gjendja para dhe pas rehabilitimit)




Instalimi i infrastrukturës energjitike në Breglumas, ku 95% e komunitetit ka paguar kontributin financiar.




Parku Rinia.




Parku i Lojrave në rrugën e Elbasanit.




Parku pranë Parlamentit.



Parku pranë Gardës së Republikës.



Parku Rinia.



Parku përballë Presidencës.

Parqe në Tiranë.



ndjeshëm demokracinë dhe pjesmarrjen në vendim-marrje, si dhe ka shtuar shansin për qëndrueshmëri afatgjatë. Sidoqoftë bashkia ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim.

Aktualisht, synimi i Bashkisë së Tiranës është që të përgatisë një vizion zhvillimi i cili është fleksibël dhe i adoptueshëm ndaj ndryshimeve të shpejta në qytet, në vend që të përgatitet një plan rregullues i ngurtë i cili e do të donte të paktën 3-5 vjet për t'u hartuar, ndërsa qyteti evoluon me ritme dramatike.

Për këtë qëllim po punohet në 3-4 drejtimet më kryesore, që të përgatiten disa plan-veprime të shpejtë të cilët jo vetëm do t'i japin zgjidhje problemeve më emergjente të Tiranës, por në vetvete do të përbëjnë thelbin e planit të ardhshëm rregullues të qytetit.


Vizioni aktual i autoritetit bashkiak është hartimi e planeve fleksibël dhe të shpejtë të veprimit me të cilat ecet paralelisht duke planifikuar dhe zbatuar. Kjo sepse të paktën deri tani, në Tiranë zhvillimi ecën më shpejt se planifikimi, ndërsa zgjidhjet afat-mesme dhe afat-gjata që janë trajtuar mjaft mirë në Planin Strategjik të Tiranës së Madhe, mund të detajohen më pas.

### Planet e Veprimit





Disa nga planet e veprimit me të cilat po punon Bashkia e Tiranës dhe që po formojnë bazën e planit të ri rregullues të qytetit janë:

#### Plan Veprimi 1:

Identifikimi i zonës qendrore të qytetit e cila po vendoset në një regjim kontrolli



Pamje nga Tirana brenda Unazës së saj.



Trotuare të rinj dhe ndriçimi në Tiranë.





Pamje nga Tirana brenda Unazës së saj.

ose frenimi për ndërtime të reja. Kjo zonë përfshin zonën brenda unazës ekzistuese të qytetit, hapësirën urbane përgjatë bulevardit nga stacioni i trenit tek universiteti, si dhe parkun periferik të qytetit përreth liqenit artificial. Në këtë zonë do t'i kushtohet vëmendje e veçantë përmirësimit, rinovimit dhe mbrojtjes së objekteve me vlera historike apo arkitektonike, objekte të cilat janë përcaktuar një për një në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës.

Sidoqoftë, kësaj zone nuk mund t'i ndalohen absolutisht ndërtimet e reja, sidomos në rastet e trojeve me vlera gjeografike dhe potenciale të larta ekonomike për zhvillimin e qytetit. Por këto lloj sheshesh për zhvillim po të përcaktohen që tani në plan, duke identifikuar qartë kondicionet urbanistike si; sipërfaqja e truallit, koeficienti i shfrytëzimit, lartësia, volumet kryesore, materiali, afatet e ndërtimit, etj.



Ndërkohë, në qendër do të vendosen kritere për kufizimin e lartësisë së ndërtimit. Kjo do të shmangi mundësinë për abuzim si nga administrata edhe nga investitorët duke siguruar një

transparencë publike maksimale por edhe standarte më humane për qendrën. Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto sheshe ndërtimi, detajimi arkitektoniko-urbanistik i tyre do të bëhet me konkurse të hapura. Natyrisht, në zonën qendrore nuk mund të përjashtohet mundësia e adoptimeve apo ndryshimi i funksionit të ndërtesave sipas një procesi të monitoruar me kujdes. Koncepti që është përdorur në projektin "Kthim në Identitet" është një shembull konkret që mund të përdoret në zona të tjera të qendrës.

#### Plan Veprimi 2:

Meqënëse në zonën qendrore do të vendosen masa shtrenguese, për të evituar presionin e ndërtuesve dhe investitoreve me objekte intensive, është llogjike dhe e domosdoshme që të sigurohet një alternativë e ligjshme për këtë sektor jetik për ekonominë e qytetit, i cili për hir të së vërtetës konsiderohet jo si armik por si partner në zhvillimin e Tiranës.

Për këtë qëllim është propozuar zgjerimi qendres së qytetit duke iniciuar konkretisht vazhdimin e bulevardit përtej stacionit të sotëm hekurudhor në drejtim të kodrave të Paskuqanit dhe të Kamzës.



Pamje nga Tirana brenda Unazës së saj.

Ky është një aks i cili prej kohësh është menduar si një lidhje e shkurtër me aeroportin e Rinasit dhe që është rikonfirmuar si i tillë nga specialistët vendas edhe të huaj që po punojnë për planifikimin e zhvillimeve të Tiranës.

Për fat të mirë zona përgjatë linjës hekurudhore të stacionit është pothuaj e pandërtuar. Bashkia synon të përdorë një llogjikë të pastër biznesi në favor të interesit publik, duke mundësuar interesimin e biznesit privat për të investuar përmes lehtësirave fiskale për të ndërtuar atje objekte mikse shumëkatëshe për strehim dhe qëllime administrative dhe biznesi, përfshi këtu

edhe ndërtimin e infrastrukturës. Patjetër që këtu lind nevoja e krijimit të strukturave mikse midis bashkisë dhe biznesit privat që merren vetëm me zhvillimin e këtyre zonave nën monitorimin e shtetit, duke synuar që të lehtësojë procedurat burokratike dhe jofleksibile të administratës konservatore të shtetit.


### Plan Veprimi 3:

A - Hapja e akseve, degëve kryesore të rrjetit rrugor të qytetit sidomos unazat dhe radialet kryesore,


B - Përmirësimin e hapësirave urbane përreth sipërfaqeve ujore (liqeni) dhe të




Pamje panoramike e Bulevardit të rehabilituar të Lanës.




Plan pjesor rregullues në Korridorin e vertiut-  
Plani i veprimit 1.



Plan pjesor rregullues në Korridorin e vertiut-  
Plani i veprimit 2.



Pamje panoramike e rrugës së Kavajës.



Pamje panoramike e rrugës së Elbasanit.



duhet të jetë thjesht një vizatim i bukur, por mbi të gjitha duhet të jetë një dokument ligjor me akte dhe nene të qarta për detajimin e procedurave, guidave, normave e standarteve. Kjo provokon domosdoshmërisht edhe reformimin e plotë të legjislacionit të urbanistikës si një proces që duhet të eci paralelisht me zhvillimin e qytetit. Rregullorja e re urbanistikës e Tiranës mund të jetë një pikënisje e mirë për paketën e re Ligjore të re të Urbanistikës që ka nevojë vendi.

Në përfundim duhet nënvizuar se autoritet bashkiake të Tiranës kanë kuptuar se hartimi i një plani rregullues nuk duhet të absolutizohet, sepse ky plan nuk ka për të zgjidhur automatikisht problemet komplekse të Tiranës, përveçse do të rrisë transparencën dhe do të udhëheqë më mirë administratën bashkiake në procesin e hartimit të një vizioni të përbashkët për zhvillimin e qytetit, duke përmirësuar ndjeshëm llogjikën e zhvillimit, me shpresën se do të minimizohen dhe parandalohen deformime të ngjashme me ato që kemi pasur deri më sot.

Hartimi i këtij plani si proces dhe në partneritet me shumë institucione të specializuara pavarësisht nga diferencat që mund të ekzistojnë, ka gjasa të jetë efektiv dhe të mos kontestohet, për të krijuar bllokime dhe kaos urban si deri më sot. Le të shpresojmë në një ndryshim pozitiv në të ardhmen.

Aktorët që janë të interesuar dhe që mund të marrin pjesë në hartimin e Planit Rregullues të Tiranës dhe të gjithë rregulloreve bashkëngjitur janë :

- Bashkia e Tiranës
- Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
- Instituti i Studimeve dhe Projektive Urbanistike
- Instituti i Monumenteve të Kulturës
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik
- Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë
- Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë
- Co-Plan-Qendra për Zhvillimin e Habitatit
- Studio dhe institucione të specializuara të huaja.

### Boshtet kryesore të rritjes urbane

#### Metropoli


Zhvillimet e fundit urbane në vend e kanë bërë tashmë realitet rajonin metropolitan Durrës-Tiranë-Fushë-Krujë, ku dallohen dy pole :

-Poli i zonës Tiranë-Durrës, në të cilin janë përqëndruar kryesisht zhvillime industriale,

-Poli Tiranë -Kamzës, ku janë strehuar mijëra të ardhur

Ky rajon që përbën polin kryesor të zhvillimit në vend, përfshin 5 bashki kryesore: Tiranë, Durres, Kamzëz, Vorë dhe Fushë-Krujë, si dhe një numër komunash dhe fshatrash që ndërveprojnë ngushtësisht me njëra-tjetrën sidomos në aspektin social dhe ekonomik.

Në dhjetë vitet e fundit, popullsia urbane në këtë rajon trekëndësh, është



Pamje panoramike të Tiranës.

lumejve të Lanës dhe Tiranës, përfshi sistemimin, gjelbërimin dhe mobilimin urban.

C - Hapja dhe vazhdimi i unazës së re nga rruga e Durrësit përgjatë bregut të Lumit të Tiranës për të evituar trafikun e rëndë që aktualisht hyn në qendër të qytetit, duke e anashkaluar atë nga pjesa lindore e unazës ekzistuese .

D - Hapja e rrugës së re që lidh Bërrylin me Rrugën e Elbasanit në Sauk do të lehtësonte tani për tani trafikun e rënduar edhe ndotjen shqetësuese në qendër të qytetit deri në një fazë të mëvonëshme të ndërtimit të një unazë bypass-i drejt Elbasanit përmes luginës së Erzenit.

Kjo do të ndihmontë edhe përmirësimin e infrastrukturës në zonat depresive periferike, pavarësisht se kostot janë mjaft të kushtueshme, por sidoqoftë minimale dhe urgjente po të krahasohen me nevojat.

#### Plan Veprimi 4:

Planifikimi, përmirësimi i infrastrukturës dhe legalizimi me kushte i ndërtimeve pa leje në periferinë e qytetit, të paktën në disa zona pilot për të krijuar legjislacionin, eksperiencën dhe modelin

e duhur të punës që do të ndihmojnë më pas hartimin e politikave për gjithë qytetin.

Ky proces i vështirë si nga ana sociale ashtu edhe politike, do t'i shërbejë në fakt ndjeshëm integritet të popullsisë, reduktimit të problemeve sociale, sidomos kriminalitetit dhe papunësisë.


Më tej ai do të nxisë investime të mëtejshme përmirësimi në banesë dhe infrastrukturë nga vetë banorët, ndërkohë që do të sqarojë përfundimisht se cilat janë objektet në konflikt të papajtueshëm me ligjin dhe që bien ndesh me interesin publik (p.sh. hapja e unazës ) dhe për këtë duhen shembur përfundimisht, dhe cilat do të legalizohen me kushte duke paguar për dëmin e shkaktuar, pagesa të cilat në rastet e dhunimit të pronës do të shkojnë në favor të pronarit të ligshëm, qoftë publik apo privat.

Mbi të gjitha ky proces kërkon një pjekuri politike të administratës dhe të të zgjedhurve lokale në marrjen e vendimeve të rëndësishme ekonomike si shitja apo dhënia me qira e tokës.


#### Plan Veprimi 5:

Hartimi i rregulloreve përkatëse urbanistike për zbatimin e planit i cili nuk





Pamje nga debatet e hapura publike, organizuar në kuadrin e "Forumit Urban" nga Co-PLAN.



Skema e metropolit Tiranë-Durrës-Fushë-Krujë.

rritur rreth 45%. Gjatë të njëjtës periudhë, dendësia e popullsisë në rrethin e Tiranës është rritur rreth 40%, ndërsa në rrethin e Durrësit rreth 43%.

Me gjithë evolucionin e thellë të kësaj zone, qeverisja lokale ka mbetur në stadiet e mëparshme, si nga ana institucionale, ashtu edhe nga metoda e qeverisjes. E gjithë kjo shumicë njësisish administrative të metropolit, është nën ombrellën e dy qarqeve dhe dy prefekturave.

#### Nevoja për një autoritet të ri të planifikimit dhe menaxhimit urban

Copëtimi i qeverisjes në zonën e metropolit ka filluar të bjerë ndesh me zhvillimin harmonik të këtij rajoni. Lipset që të krijohen struktura të reja, të cilat do të sigurojnë një qeverisje më të mirë dhe një përdorim më të frutshëm të burimeve financiare dhe materiale.

Metropoli duket qartë se ka nevojë të ngutshme për një strukturë administrimi

të unifikuar, që të bashkërendojë dhe të organizojë më mirë problemet e zhvillimit hapsinor, të planifikimit dhe zhvillimit urban, si dhe të çështjeve mjedisore.

Kjo nuk është parashikuar në strategjinë e decentralizimit dhe në legjislacionin aktual të qeverisjes vendore e të urbanistikës. Deri më sot autoritetet lokale të njësive administrative të përfshira në këtë mega-njësi të re urbane, e shohin këtë konceptim si të jetë kundër prirjeve të decentralizimit të pushtetit, dhe nuk e vlerësojnë rëndësinë e një riorganizimi të tillë.

Në të vërtetë këtu nuk bëhet fjalë për centralizim, por për një përvojë tipike të metropoleve të vendeve më të zhvilluara.

Qëllimi është që të shmangen pasojat negative që shfaqen, kur zhvillimi shihet ngushtësisht në kufijtë e njësive baze lokale, dhe kur autoritetet qendrore e kanë të pamundur të bëjnë bashkërendimin në nivel rajonal apo metropolitan.

#### 6.2. Skenar i mundshëm zhvillimi për të ardhmen e largët .

Eksperiencia e deritanishme me Tiranën dhe përvoja botërore na bënë të mendojmë se një skenar i mundshëm zhvillimi në të ardhmen e largët do të ketë pak a shumë këtë mënyrë.

1. Urbanizimi - qendra e qytetit të Tiranës do të densifikohet çdo ditë e më shumë në sajë të konvertimit të shtëpive të ulta në ndërtime shumëkatëshe. Kjo nxitet edhe për shkak se në qendër të






Foto ajrore e Tiranës në 2000, dhuruar nga GEOCONSULT.

mbarimin e orarit të punës) të ditës një trafik të madh, bllokim dhe humbje kohe që mund të shkojnë nga 2-4 orë në ditë. Kjo gjë do ta shtyjë biznesin dhe shtresat me të ardhura të larta që të kërkojnë të rikthehen përsëri në qendër duke rehabilituar apartamentet në qendër. Kjo mendohet se do të rrisë kërkesën dhe çmimet e banesave në qendër dhe do të rezultojë përsëri në një çvendosje të famijeve me të ardhura të ulëta drejt periferisë ndërsa në qendër do të dominohet përsëri nga ato me të ardhura të larta. Në këtë moment mendohet që do ndodhi ai fenomen që njihet me emrin "xhentrifikim" (gentrification) që do të

thotë një rinovim dhe përmirësim total të qendrës përfshi edhe një ndryshim të strukturës sociale. Këtë skenar mund t'a jetojmë ndoshta nga mesi i këtij shekulli.

Pavarësisht nga skenaret e sipër përmendur, e ardhmja e Tiranës është një sfidë që varet edhe nga stabiliteti dhe siguria politike në vend e rajon, dhe mbi të gjitha, nga puna e qytetarëve të saj, nga roli i biznesit privat dhe nga lidhshipi i administratës publike që do të zgjidhet për t'a drejtuar atë.

Tirana i ka të gjitha shanset që të jetë një qytet kompetitiv në Ballkan dhe të

qytetit ndodhet infrastruktura më e mirë ndërkohë që ende nuk ka zona alternative zhvillimi të paisura me infrastrukturë. Kjo gjë do të stimulojë më shumë si investitorët ashtu edhe blerësit e apartamenteve/dyqaneve. Ky proces do të zgjase të paktën edhe për 15-20 vjetët me ritme gjithnjë e më të ulta.

2. Sub-urbanizimi - Nëse autoritet nuk do të ndërhyjnë në kohë, probleme të tilla si parkimi i vështirë, trafiku i madh, ndotja e ajrit, mungesa e hapësirave publike, dhe mbi të gjitha një degradim i banesave për shkak të mungesës së kulturës dhe ligjeve të mirëmbajtjes së pronës së grupit dhe komunitetit, do ta përkeqësojnë situatën e qendrës në atë pikë sa mjaft njerëz nuk do të preferojnë të banojnë në këtë zonë.

Familjet me të ardhura të larta do të lëvizin në periferitë e gjelbëra të qytetit, në kërkim të qetësisë dhe ajrit të pastër. Në mënyrë që të ulin kostot e infrastrukturës dhe të jenë më të sigurt, kjo shtresë e popullsisë do të vetë-organizohet në zona banimi vilash suburbane, të ngjashme me modelin e zhvillimit të qyteteve amerikane.

Shumë shpejt kjo formë jetese dhe komoditeti që krijon periferia do të kopjohet edhe nga shtresat e popullsisë me të ardhura më të ulta, duke nxitur një kërkesë në treg për banesa individuale periferike. Ndërkohë, për shkak të përkeqësimit të kushteve në qendër të qytetit, çmimet e banesave do të bien gjithnjë e më shumë. Kjo situatë do të stimulojë lëvizjen e shtresave të varfëra

nga periferia e qytetit në qendër të saj, ndërsa familjet në gjendje të mirë ekonomike gjithnjë e më shumë do të zhvendosen në periferi. Ky lloj zhvillimi do të nxisë përmirësimin e infrastrukturës në periferi por edhe një lloj ndarje klasore të popullsisë, ndërsa në qendër problemet sociale dhe kriminaliteti mund të bëhen të rrezikshme në se nuk do të ketë politika të qarta parandaluese.

Qendra ditën mund të jetë një ambient i zhurmshëm dhe dinamik për shkak të biznesit, por pas përfundimit të orarit të punës rrezikon të kthehet në një vend bosh dhe të frikshëm prej ku gjithkush dëshiron të largohet. Kjo mund të ndodhi për një periudhë 20-30 vjeçare duke filluar nga fundi i dekadës që sapo kemi hyrë.

3. Ri-urbanizimi - një nga pasojat kryesore të sub-urbanizimit do të jetë rritja e distancës punë shtëpi dhe rrjedhimisht e trafikut. (shtresat me të ardhura të larta banojnë në periferi por punojnë në qendër ku kanë dhe bizneset kryesore dhe zyrat e admisnitratës, ndërsa shtresat e ulta do jetojnë në qendër por duhet të punojnë në periferi ku do jenë ndërmarrjet dhe industritë kryesore të punës). Kjo gjendje do të përkeqësohet me rritjen e nivelit ekonomik, ku çdo njeri synon të ketë makinën e tij. Gjendja do përkeqësohet më tej nëse autoritetet nuk marrin masa dhe nuk nxisin transportin e mirë publik dhe të hapin akset kryesore të rrugëve të qytetit. Lëvizja të paktën 2 herë në ditë: nga puna në shtëpi - dhe anasjelltas; do të krijojë në orare të caktuara (mëngjes, drekë dhe pasdite me

## 7. KONKURSI PËR PLANIFIKIMIN E QENDRËS SË QYTETIT TË TIRANËS.

Konkursi për planin rregullues të qendrës së qytetit të Tiranës, u realizua gjatë vitit 2003. Ka patur shumë faktorë që ndikuan në marrjen e kësaj nisme mjaft interesante, që përbën edhe një nga momentet më kulmore për zhvillimin e qytetit pas ndryshimeve të fillim viteve 90-të, si dhe një investim i konsiderueshëm për përmirësimin e imazhit të kryeqytetit shqiptar dhe të gjithë vendit. Prishja e ndërtimeve pa leje në qendër të qytetit dhe mungesa e një plani të ri bashkëkohor për qytetin, nxorën më shumë në pah mangësitë në këtë drejtim. Puna e lavdërueshme e nisur nga Bashkia Tiranë për rregullimin e qytetit sidomos në qendër të tij, hasi edhe në kritika e reagime nga qarqet intelektuale dhe profesionale, të cilat në mjaft raste bazoheshin në argumenta konkrete. Ngritja e pikëpyetjeve tilla si: Çfarë fitojmë dhe humbim nga prishja e ndërtimeve pa leje? A duhet të ndërtojmë në lartësi apo me objekte 4-5 katëshe? A ka vlera të mirëfillta arkitektonike Tirana e vjetër? A duhet ta ruajmë Tiranën tradicionale apo ta shndërrojmë në një simbol të ri me ndërtime shumëkatëshe "moderne"? Në kushtet e Shqipërisë, a duhet të planifikojmë dhe pastaj të ndërtojmë, apo e kundërta? A mund të vazhdoje bashkia të japë leje ndërtimi pa përgatitur më parë një studim urbanistik për qytetin? Për çfarë lloj plani urbanistik ka nevojë Tirana? A mund të merren vendime të rëndësishme me interes publik, shpenzimi i fondeve publike apo qoftë edhe lyerja e fasadave e qytetit nga


një njeri i vetëm, qoftë ky edhe kryetari i votuar i bashkisë, apo duhet hapur një proces diskutimi publik për të terhequr opinionin e banorëve dhe profesionistëve? Çfare roli ka transparenca publike në zhvillimin e qytetit? Cili është roli i vetë banorëve, komuniteteve, rretheve akademike e profesionale, shoqërisë civile dhe biznesit privat.

Në këto rrethana dhe nisur nga fakti që së fundi ishin planifikuar edhe zgjedhjet e radhës për pushtetin vendor, Bashkia e Tiranës dhe kryebashkiaku Edi Rama ishin mjaft të motivuar për ta realizuar këtë konkurs, i cili do të dëshmonte sado pak për përpjekjet e kësaj administrate për të mbajtur premtimin e 3-viteve më parë për ta bërë qytetin me një plan të ri rregullues. Kjo do të ishte forca kryesore shtytëse për realizimin e këtij konkursi. Duke qenë se burimet financiare ishin të pakta dhe puna përgatitore për hartimin e bazës së të dhënave dhe detyrës së projektimit ishte voluminoze dhe komplekse, Bashkia vendosi që ta ndajë hartimin e planit rregullues të qytetit në dy faza: (i) hartimin e planit rregullues të qendrës së qytetit brenda vitit 2003; (ii) hartimin e planit rregullues të pjesës tjetër të qytetit në një fazë të dytë gjatë një mandati të dytë 3-vjeçar.

Për fazën e parë shprehu interes dhe gatishmëri që të asistonte procesin teknikisht dhe financiarisht Qeveria Gjermane, përmes Ambasadës së saj në

sigurojë mundësira për biznesin vendas dhe të huaj dhe të krijojë shërbimet më të mira për qytetarët dhe vizitorët e saj. Pozicioni i favorshëm gjeografik, klima, qenia pranë resurseve natyrore dhe humane mund ti japin zhvillimit një shtytje të madhe, nëse kjo do të

shfrytëzohet nga një administratë publike agresive, fleksibël dhe inteligjente e cila, ndërkohë do të ketë në duar gjithmonë e më shumë kompetenca dhe më shumë mundësi financiare për qytetarët e saj dhe duke forcuar besimin se Shqipëria do të integrohet me pjesën tjetër të Europës.



Pamje panoramike e Tiranës.



fitues u shpall varianti i propozuar nga studio franceze. Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër dhe ilustrimet për sejcilin variant.

*Në etapën e tretë* – studios franceze i është dhënë kohë që të përpunojë më tej projekt idenë duke shkuar deri në nivelin e një projekt zbatimi të planit rregullues.

Co-PLAN është përpjekur përsëri të nxisë nevojën e hapjes së një debati pozitiv midis studios fituese dhe rretheve profesionale në Shqipëri në mënyrë që varianti final të jetë sa më pak i kundërshtuar e sa më i qartë. Por kjo do të varet mbi të gjitha nga organizatorët e konkursit. Deri më sot kjo gjë fatkeqësisht nuk është realizuar.

*Një etapë e katërt* do të jetë puna e mëtejshme për vazhdimin e hartimit të planit rregullues të pjesës tjetër të qytetit, përsëri me konkurs ndërkombëtar.

Është e rëndësishme të theksohet se kjo eksperiencë pavarësisht nga mangësitë e saj (më kryesorja nuk ja arriti të përfshijë si duhet profesionistët vendas), arriti të sjellë një frymë të re që u reflektua më vonë me aktivitete të ngjashme e bashki të tjera të vendit. Ky organizim hapi një horizont më të gjerë për mendimin vendas mbi mënyrat dhe zgjidhjes së problematikës vendase. Konkursi shërbeu gjithashtu për të legjitimuar “de facto” edhe planin Strategjik të Tiranës së Madhe, i cili shërbeu si material referues për konkurentët edhe pse zyrtarisht ende nuk është ligjësuar nga Qeveria dhe Bashkia Tiranë, ndërkohë që është një dokument me vlera edhe pse jo perfekt. Mbi të gjitha

konkursi shënoi një pikë kthese në vëmendjen e autoriteteve ndaj planifikimit të territorit dhe ishte një investim mjaft pragmatik për imazhin e vendit dhe sidomos të kreytetit shqiptar. Mbetet që këto autoritete dhe organizatorët të dëshmojnë të njëjtin interes edhe për zbatimin e planit në fjalë, për të dëshmuar që në këtë proces janë angazhuar për interesa të zhvillimit të qytetit dhe jo thjesht për interesa të vogla elektorale.

#### *Cmimi i Parë – Studio franceze: Architecture Studio*

Studioja franceze është me shumë autoritet dhe ka realizuar mjaft projekte të rëndësishme, përfshi selinë e Parlamentit Europian. Varianti i prezantuar prej saj ishte më ekonomik, kriter që ndoshta i dha fitoren. Kjo edhe pse shkalla e ndërhyrjes është minimale dhe disi butaforike, duke ju shmangur praktikisht dhe padashur dhënies së përgjigjes së disa pikëpyetjeve kryesore të konkursit për qytetin. Sidoqoftë në disa zona, si Sheshi “Skenderbej” dhe Nënë Tereza, i lihet përparësi e plotë këmbësorëve, pasqyrave ujore e gjelberimit dhe eliminohet plotësisht qarkullimi i makinave. Punohet me bulevardin dhe lumin Lana duke futur elementë të mobilimit urban, trotuare për këmbësore dhe gjelbërim. Përgjatë gjithë bulevardit kryesor në të dyja anët e tij në një distancë rreth 50-100 metra propozohen dy akse paralele (një në çdo anë) me ndërtime shumëkatëshe të larta deri në 25-30 kate, për të krijuar një siluet me plastik dhe më agresiv që e shoqëron bulevardin kryesisht të gjelbëruar anash

Tiranë dhe GTZ (Kooperimi Teknik Gjerman), i cili ka një meritë të padiskutueshme në realizimin e këtij konkursi duke rritur besueshmërinë e këtij procesi në nivel ndërkombëtar. Për fazën e dytë ka shprehur interesimin e saj për të asistuar teknikisht dhe financiarisht Qeveria e Vendeve të Ulëta e cila mendohet t’ja delegojë zbatimin e punës konkrete Bankës Botërore në Tiranë. Një rol të padiskutueshëm ka luajtur edhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, i cili nga pozita neutrale punoi për spjegimin stafit të Bashkisë, ekspertëve të GTZ-së, jurisë dhe studiove ndërkombëtare të problematikës dhe rrugëdaljeve nga situata ekzistuese e zhvillimit urban në vend dhe sidomos në rajonin Tiranë. Ajo që është më e rëndësishme është fakti se Co-PLAN luajti rolin e ndërmjetësimit të komunikimit të procesit të konkursit dhe opinionit publik e profesional duke përdorur median elektronike në një proces transmetimi, debatimi dhe spjegimi të drejtëpërdrejtë të ideve të ofruara para përzgjedhjes finale nga Juria.

Fatkeqësisht kjo transparencë dhe frymë debati si më sipër nuk u sigurua gjatë fazës detajuese të projektit final, duke vënë në pikëpyetje punën e mirë të bërë deri më tani dhe zbatueshmërinë e planit zyrtar të aprovuar. Kjo është një mangësi e Bashkisë Tiranë.

Përcaktimi edhe i asaj çfarë kuptohet me *Qender* ka qenë një nga dilemat e organizimit të konkursit. Në përfundim u ra dakort se me *qendër* quhet pak a shumë gjithë hapsira brenda asaj që quhet unaza kryesore aktuale e qytetit.

Në zonën e cila do të përfshihej në konkurs u konsiderua e gjithë hapsira rreth 50-100 metra përgjatë gjithë gjatësisë së Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe “Zogu i Parë”, nga Sheshi “Nënë Tereza” e deri tek stacioni i trenit. Këtu përfshihen, hapsirat urbane brenda unazës së qendrës, midis rrugës së Elbasanit (Labinoti) dhe Rrugës “Dëshmoret e 4 Shkurrit”; apo hapsira urbane deri tek dhe përreth Sheshit “Avni Rustemi”, etj.

Konkursi u zhvillua në tre etapa.

*Etapa e parë* - filloi me shpalljen e konkursit në Konferencën Ndërkombëtare të ENHR-së, (Rrjeti Europian për Studimin e Strehimit dhe Zhvillimit Urban) organizuar nga Co-PLAN. Në këtë auditor ndërkombëtar Bashkia Tiranë ftoi studiot e arkitekturës dhe urbanistikës vendase dhe të huaja që të shprehnin interesimin e tyre për të marrë pjesë në konkurs. Të paktën 35 studio ndërkombëtare (vetëm një nga të cilat Shqiptare) disa nga të cilat mjaft prestigjioze shprehen interes. Nga një juri e ngritur me profesionistë të huaj dhe vendas u zgjodhën 3 studiot finaliste: Architecture Studio (France), Boles & Wilson (Gjermani-Australi), dhe Mecano (Hollande).

*Etapa e dytë* - Këtyre studiove ju dha një afat kohor që të përgatisnin grafikisht projekt idetë e tyre për qendrën e qytetit. Projektet u paraqitën para një jurie të dominuar nga ndërkombëtarët, ku merrnin pjesë edhe kryeministri shqiptar dhe kryebashkiaku i Tiranës, në një takim të hapur të transmetuar drejtëpërdrejtë edhe nga televizioni publik. Në përfundim

zonës së stacionit të trenit e riorganizojnë këte hapsirë si një alternativë për biznesin duke tentuar të vendoset një regjim më i kujdesshëm ndërtimi në qendër. Më tej, sheshi "Skënderbej" riorganizohet më mirë rreth ministrive dhe riorganizohet ose dendësohet qendra në ndërtime 3-5 kate, krahas atyre ekzistuese.

Qarkullimi në qendër dhe pjesë të bulevardit i kushtohet tërësisht këmbësorëve. Ndërkohë i jepet prioritet transportit publik. Parku Rinia dhe zona historike përreth Galerisë Kombëtare dhe Pallatit të Pionerëve gjelbërohet dhe

konsiderohet si zonë me vlera historike dhe rekreative. Kompleksi universitar tek Sheshi "Nënë Tereza" gjelbërohet dhe u lihet tërësisht këmbësorëve. Ajo kthehet në një zonë universitare të mirëfilltë. Në qendër ku sot ndodhet shatërvani propozohet një ndërtim modern në formën e një harku triumfi dhe pikëreferimi për transportin publik dhe këmbësorët. Disa zona me ndërtime admindsitrative-politike riorganizohen, mobilohen dhe ndërtohen, si rasti rreth kryeminsitrisë. Është i vetmi variant që shkoi përtej një zgjidhjeje thjesht grafike.

tij dhe në mes. Këto ndërtime propozohen ritmike, çdo 50-60 metra, por në realitet ideja interesante në dukje është praktikisht vështirë e zbatueshme, pasi shesh ndërtimet e propozuara janë të zëna. Fokusi i zgjidhjes së orfuar nga studioja franceze është pak a shumë tek theksimi i mëtejshëm i aksit *cardo-decumanus* (Bulevardi dhe lumi Lana) si akse politiko-administrative dhe biznes-tregëti, duke e konsideruar bulevardin të mbyllur tek stacioni i trenit me një zonë të gjelbëruar që e balancon me parkun Rinia, por kufizon zgjerimin e infrastrukturës vitale në veri të qytetit ku edhe po ndodh shtrirja kryesore e tij.

#### Çmimi i Dyte - Boles & Wilson (Gjermani-Australi)

Ky variant ishte mjaft interesant, veçanërisht për propozimet e tij në Sheshin "Skënderbej", hapsira e të cilit decentralizohet në hapsira më të vogla dhe më intime, të mirë-mobiluara. Sidoqoftë, varianti kishte edhe rrezikun e një lloj çarjeje të kësaj hapsire edhe pse propozohet për t'u shfrytëzuar më mirë se në këto kushte që është sot. Fokusi kryesor i skemës së propozuar nga studioja gjermano-australiane i kushtohet marrëdhënieve të arkitekturës dhe urbanistikës me skemën e qarkullimit dhe trafikut, sidomos në qendër të saj, ku unaza e qendrës ndahet në dy rrugë krejtësisht të veçuara e në sense të ndryshme duke i dhënë prioritet në sheshin kryesor këmbësorëve dhe transportit publik. Më tej ideja e propozuar shfrytëzon në mënyrë pragmatike trojet e lira për ndërtim në qendër dhe përgjatë bulevardit, duke

propozuar rritjen e dendësisë së ndërtimit përmes deklarimeve arkitektonike mjaft moderne dhe shpesh ekstravagante. Kjo është edhe arsyeja që ky variant u pëlqye veçanërisht nga qarqet e biznesit të ndërtimit. Skema e propozuar lejon vazhdimin e bulevardit kryesor përtej stacionit të trenit, duke e hapur zhvillimin e qytetit drej kodrave të Paskuqanit.

#### Çmimi i Tretë - Mecano (Hollandë).

Studioja holandeze, solli një skemë më të plotë, më të qartë dhe më gjithëpërfshirëse të qytetit dhe marrëdhënieve të tij me qendrën, duke qenë jo vetëm realiste për raportet e qarkullimit, të trafikut dhe marrëdhënieve qendër-periferi. Shqetësimi i kësaj studioje ishte kujt do ja japim qendrën e qytetit: qytetarit të thjeshtë apo grupeve të caktuara dhe biznesit? Një pyetje mjaft provokuese dhe intriguese që mbetet ende për t'u përgjigjur nga bashkia. Varianti i saj teknikisht ishte mjaft realist, por shkalla e ndërhyrjes sidomos në qendër ishte radikale dhe rrjedhimisht e kushtueshme. Edhe pse arriti t'i japë më drejtëpërdrejtë zgjidhje pikëpyetjeve të konkursit, fatura e lartë financiare me sa duket bëri që të kualifikohej si projekt ideja e tretë fituese edhe pse u pëlqye dhe u admirua nga një pjesë e mirë e publikut dhe profesionistëve vendas. Ideja e studios holandeze mbështetej në ndarjen e qendrës në zona tematike urbanistike, ku zgjidhjet përkatëse ofrohen nga funksioni përkatës. Propozohet zgjerimi i bulevardit në veri të qytetit, me një park alternativ në Paskuqan dhe lidhje e shpejtë me aeroportin Rinas. Ndërtime shumëkatëshe në Paskuqan dhe rreth







Foto nga Projekti Francez






Foto nga Projekti Gjerman








Foto nga Projekti Hollandez





Foto nga Projekti Francez



## PJESA E DYTË

Dëshmi të vlerave Arkeologjike në Tiranë

Tirana, Një vështrim i shkurtër historik

Aspekte nga Jeta Tradicionale e Tiranës

Jeta Kulturore në Tiranë

Tirana Qendër e Artit Figurativ

Turizmi në Tiranë dhe përreth saj

## DËSHMITË ARKEOLOGJIKE NË RRETHIN E TIRANËS

Territori që përfshin rrethi i Tiranës përbëhet kryesisht nga fusha e Tiranës dhe vargjet kodrinore e malore që e rrethojnë atë nga tre anët. Kushtet gjeoklimatike të favorshme për banim kanë bërë të mundur banimin e saj qysh në fillimet e shoqërisë njerëzore. Këtë e dëshmojnë gjetjet arkeologjike në Rrëzë të Dajtit dhe në Shpellën e Pullumbasit që i takojnë epokës së paleolitit (gurit të vjetër). Kjo trevë vazhdoi të banohej gjatë epokës së gurit të ri, epokës së metaleve dhe në vazhdimësi gjatë tërë epokës historike. Këtë e dëshmojnë kalatë, rrënojat e monumenteve të ndryshme dhe gjetjet arkeologjike, të cilat janë ruajtur deri në ditët tona. Më poshtë po i paraqesim sipas radhës kronologjike qendrat arkeologjike.


### Rrëza e Dajtit.

Ky emërtim ka hyrë në arkeologjinë shqiptare në fillim të shek.XX, kur gjeologu austriak B.Richthofen, zbuloi në afërsi të gurores së sotme të Dajtit disa vegla stërralli të cilat i takojnë epokës së paleolitit të lartë (30.000-10.000 vjet më parë). Gati pas një shekulli, gjetje të kësaj

epoke u zbuluan edhe në Shpellën e Pullumbasit. Mund të thuhet pa mëdyshje se rrethina e Tiranës është një nga trevat më të hershme të banuara në Shqipëri.

### Shpella e Pullumbasit

Shpella e Pullumbasit ose siç njihet nga vendasit Shpella e Zezë ndodhet rreth 2km. në verilindje të fshatit Pullumbas, pikërisht në krahun e majtë të lumit të Erzenit, aty ku lugina ngushtohet, së tepërmi, duke formuar grykën e Skoranës. Shpella është vendosur në faqen e thiktë që formon mali i Pullumbasit, në një



*Pamje e hyrjes së shpellës së Pullumbasit*



ndërtuar me gur të papunuar me lidhje të thatë. Në njërin anë të murit ka një hyrje në formë korridor. Brenda mureve ka shumë pak gjetje, fragmente enësh të epokës së hekurit shek.XI-VI p.e.s. kohë së cilës i takon edhe ngritja e mureve rrethuese.

Këto lloj vendbanimesh të fortifikuara shërbenin për mbrojtjen e gjithë banorëve të zonës, në rast sulmi nga fise të tjera.

**Kalaja e Persqopit** ose siç njihet ndryshe kalaja e Vilës, ngrihet mbi malin e Vilës, rreth 1km në lindje të kalasë së Petrelës. Nga kalaja ruhet një trakt muri i gjatë rreth 30m, i lartë 6m i bërë me blloqe kuadratik me përmasa të mëdha e mesatare, me lidhje të thatë. Në mesin e faqes ka një kontraforte që i ka dhënë qëndrueshmëri murit. Në anën lindore të kalasë është zbuluar një varr monumental, i vetmi në territorin e Shqipërisë së mesme. Ngritja e kësaj qendre të vogël qytetare i takon kohës së lulëzimit të përgjithshëm të jetës në Iliri, shek.III-II p.e.s.

Në malin e Vilës ruhen edhe gjurmët e fortifikimit të periudhës së vonë antike, shek.IV e.r. i cili kufizonte një sipërfaqe më të madhe se ajo e periudhës së parë.

### Kalaja e Petrelës.


Kalaja e antikitetit të vonë e mesjetës, ngritur mbi një kodër shkëmbore 400m të lartë, në juglindje të qytetit të Tiranës, në bregun e majtë të lumit Erzen me një pozicion dominues mbi gjithë zonën përreth. Ka shumë të ngjarë, pas braktisjes së Kalasë së Vilës, banorët e

kanë preferuar atë si më të përshtatëshme për banim.

Në gjendjen e sotme kështjellën e Petrelës e rrethon një mur i gjatë 100m., me dy kulla të rrumbullakta në anën më pak të mbrojtur të kodrës, me një portë të vogël midis tyre. Në pjesën e brendëshme ndodhen dy stera, gjurmët e dy ambienteve banimi si dhe një kullë drejtkëndëshe në pjesën qendrore. Përveç kështjellës së ndërtuar në pjesën më të lartë të kodrës një mur i harkuar rrethon pjesën më pak të mbrojtur të shpatit lindor të saj. Ky mur është pajisur edhe me një portë që ndodhet në skajin e murit.

Gjurmët më të hershme duket se i takojnë ndërtimit të sterave dhe një nymfeu (çesme) të shek.III p.e.sonë, kurse fortifikimi i parë i majës së kodrës duhet të jetë bërë në fillimet e mesjetës. Në shek.XI kalaja e Petrelës ose siç njihet nga burimet e shkruara Petrula, rifortifikohet dhe bëhet pikë mbrojtjeje në luftën midis normandëve dhe bizantinëve. Fortifikimi i Petrelës mori formën e një kështjellë të vërtetë feudale në kohën e sundimit të Topiasve. Në këtë kohë u ndërtua një kullë gjysmë rrethore.

Kësaj periudhe duket si i përket edhe muri i jashtëm rrethues. Për të hyrë në kështjellë duhej të ngjisje një palë shkallë guri që mbështeteshin nga jashtë murit dhe mbaronin me një shesh pushimi para portës. Korridori i hyrjes formonte dy kthesa këndrejt dhe mbulohej me qemerë. Pas çdo kthese vinin nga një palë shkallë me 4-5 këmbë që të ngjisnin në oborrin e kështjellës.



*Evolucioni i karstit në brendësi të thesarit natyral të shpellës së Pullumbasit*

lartësi rreth 300m mbi nivelin e detit. Shkëmbi formon një strehë të madhe e cila vjen gradualisht duke u zvogëluar dhe formon një hyrje me gjerësi 14m dhe lartësi 10-12m. Me këto përmasa shpella zgjatet në formën e një tuneli të gjatë 70-80m. Më tej shpella zgjerohet duke formuar një ambjent të bollshëm në formën e një dhome me një tavan shumë të lartë në formë kupole, të lartë 15-20m. Pas këtij ambjenti, gjithashtu shumë të përshtatshëm për banim shpella zhvillohet në formën e dy korridoreve të gjatë, njeri me drejtim lindje-perëndim i gjatë 140-150m dhe degëzimi tjetër në drejtimin verilindor, i gjatë 110-120m.

Në ambientin qendror e veçanërisht në korridorin e gjatë e nëpër degëzimet e shumta të tyre, gjatë miliona viteve të veprimtarisë karstike janë formuar stalaktite e stalamite që të befasojnë me shumëllojshmërinë e bukurinë e tyre, duke krijuar në ambjentet e brendëshme të shpellës një bukuri të rrallë.

Vlera dhe interesi që paraqet Shpella e Pullumbasit merr përparësi për faktin

se ka qenë e përdorur për banim qysh në fillimet e shoqërisë njerëzore, rreth 30.000 vjet më parë.

Për këtë dëshmon prania në Shpellën e Pullumbasit e materialit arkeologjik për epokat e paleolitit, neolitit, eneolitit, bronzit e hekurit. Ato janë të dhëna tërësisht të reja për këto epoka dhe nga një zonë krejtësisht e re e panjohur më parë, ndaj edhe vlera e tyre shumëfishohet.

Jetëgjatësia e banimit të Shpellës së Pullumbasit dhe vendndodhja e saj në një zonë qendrore e krejt të panjohur më parë, i japin asaj përparësi për tu bërë objekt i gërmimeve arkeologjike. Së bashku me interesin që paraqet si shpellë karstike ajo shumë mirë mund të kthehet në një pikë turistike, në një muze natyror i një vendbanimi prehistorik. Në këtë mënyrë Parkut të Madh Natyror të Dajtit do t'i shtohen vlerat e do të bëhet më i preferuar për tu vizituar nga të gjithë.

### Kalaja e Dorsit.


Kalaja e Dorsit është një qendër e fortifikuar protourbane (paraqytetare) e ngritur në një nga majat e kuotave më të larta në vargun e kodrave të shkëputura nga malet e Krrabës, rreth 20km. në jugperëndim të Tiranës.

Për ngritje e kalasë është zgjedhur një pllajë e pjerrët me sipërfaqe shkëmbore, më shumë e gjatë se e gjërë, dhe gati gjysma e saj është e rrethuar me mur, kurse pjesa tjetër e kodrës është e mbrojtur nga shkëmbi natyral.

Muri që rrethon kalanë është i gjatë rreth 300m dhe i gjërë 2,50-3,00m i

trashë 1,50-2,30m, që është mjaft i dëmtuar. Nga teknika e ndërtimit kalaja e Dajtit duhet të datohet në shek.VI të e.sonë.

**Kalaja e Tujanit** ndodhet pranë fshatit Tujan, mbi një kodër me shpate të pjerrta që mbyllin luginën e lumit të Tiranës, duke zotëruar rrugën që kalon për në Dibër. Muret e kalasë janë ndërtuar në përshtatje me terrenin, ato janë bërë me gurë mesatar të lidhura me llaç, dhe rrethojnë një sipërfaqe afërsisht 190m x 160m. Brenda mureve ruhen gjurmë banesash dhe një stere uji. Nga fragmentet e enëve të gjetura dhe teknika e ndërtimit të mureve, kalaja i takon shek.IV-VI të e.sonë.



*Mozaiku i kishës paleokristiane pranë kryqëzimit "21 dhjetori" në Tiranë, shekulli III i erës sonë*

### **Kisha e Tiranës.**

Gjatë ndërtimit të bllokut të banesave karshi Institutit të Kulturës Fizike, (sot janë zyrat e Atelies së Monumenteve të Tiranës) në vitet 70, u zbuluan rrënojat e një banese të shtruar me mozaik. Gërmimi i pjesës që kishte shpëtuar nga dëmtimi, nxori muret e një banese të shek.II-III të e.sonë, e cila në shek.IV të e.sonë ishte kthyer në godinë kulturi.

Ajo është një kishë një nefshe që përbëhet nga naosi, narteksi dhe absida. Naosi, 8m x 11,5m, e ka dyshtemenë të shtruar me mozaik me motive gjeometrike, ndërsa narteksi 12,9 x 4m, për aq sa mund të gjykohet nga fragmentet e ruajtura, është i shtruar me



*Pamje madhështore e kështjellës së Petrelës*

Një interes të veçantë për arkitekturën e kështjellës paraqet kulla gjysmë rrethore e skajit verilindor që përdorej vetëm për luftime. Në gjendjen e sotme kulla ka një lartësi 12.80m dhe formohet nga dy kate të ndarë me dyshteme druri. Kati i dytë mbulohet me një kësulë sferike prej tullash. Mbi tarracë ka patur edhe një kat të tretë me konstruktion druri. Kati i dytë ishte ambienti kryesor i luftimit, ai është i paisur me frëngji për grykat e topave të vegjël e të armëve. Në kohën e luftës kundër pushtuesve osman Petrela

shërbeu si parafortesë e Krujës dhe u përfshi në sistemin mbrojtës të Skënderbeut. Në shek.XIX e në gjysmën e parë të shek.XX Petrela përmendet për mullinjtë e blojes e zejet e ndryshme.

**Kalaja e Dajtit** gjendet në anën perëndimore të malit të Dajtit në një lartësi 1200m. mbi nivelin e detit, nga mund të vrojtohej një territor mjaft i gjërë në drejtim të perëndimit e jugperëndimit. Fortifikimi ka formën e një trekëndëshi që rrethohet nga një mür me gurë e llaç, i



6,40m. i lartë. Të kësaj kohe janë edhe kullat e qosheve, të cilat kanë qenë edhe 6-7m më të larta se muret rrethuese e të mbuluara me çati. Pas portës dy kanatëshe vazhdon një koridor i gjatë 4,5m., i mbuluar me qemer guri, që të çon në oborrin e kalasë.

Në periudha të ndryshme kalasë i janë bërë rindërtime e zgjerime të pjesëshme. Kështu mund të përmendim rindërtimin e mureve të dëmtuara, ndërtimin e xhamisë dhe së fundi ndërtimin e kullës së sahatit(fillim i shek.XIX).


#### Kalaja e Ndroqit.

Ngrihet pranë fshatit me të njëjtin emër mbi një kodër të lartë 387m. në krahun e majtë të luginës së Erzenit. Kodra mbaron me një majë të sheshtë rreth 300m gjatësi e 150m gjerësi, sipërfaqja e së cilës është e rrethuar me mure.


Dallohen dy teknika në punimin e mureve që i përkasin njera antikitetit të vonë dhe tjetra mesjetës, pa mundësuar dhënie të një date më të saktë. Gjithsesi ndërtimet e periudhave të ndryshme dëshmojnë për kohëzgjatjen e funksionimit të saj si dhe për rolin që kalaja ka luajtur në kontrollin e rrugës që vinte nga Durrësi.

#### Kalaja e Lalmit.


Në periudhën e antikitetit të vonë e mesjetës është ngritur dhe kalaja e Lalmit, mbi një kodër që ndodhet 2km. në perëndim të zonës së Kombinatit. Nga rrethimi i sipërfaqes së kodrës në formë vezake, me përmasa 100mx50m. kanë mbetur disa trakte muri të shkëputura.



*Kulla e rojës së kalasë së Prezës*



*Maja e kodrës ku ndodhen rrënojat e kalasë së Ndroqit*



*Pamje nga muret e kalasë së Prezës*



*Një nga kullat e kalasë së Prezës*

mozaik me motive gjeometrike, simbole të kultit dhe figura kafshësh.

Gjatë kthimit të godinës në kishë janë përdorur për ndërtim tulla me kryqe të datueshme që i takojnë kohës së perandorit Konstandin (gjysma e parë e shek.IV të e.sonë). Ambientet ndihmëse në anën veriore të ndërtesës janë përshtatur për funksione të tjera.


#### Kalaja e Prezës.

Kalaja është ndërtuar mbi pjesën më të lartë të kodrës që ka një pozicion dominues mbi fushën e Tiranës, duke kontrolluar njëkohësisht edhe rrugët me rëndësi ekonomike dhe ushtarake që lidhin Durrësin me Krujën, Lezhën si edhe rrugën që e lidh me Petrelën.

Në burimet e shkruara Kalaja e Prezës përmendet nga Marin Barleti në veprën e tij "Historia e Skënderbeut". Gjatë shek.XIX e XX ajo vizitohet nga disa studjues të huaj.

Kalaja ka planimetri katërkëndëshe me përmasa mesatare (80m. gjatësi me 50m gjerësi). Në të katër qoshet është e mbrojtur nga katër kulla rrethore. Një kullë tjetër katërkëndëshe është ngritur në faqen jugore për të mbrojtur më mirë hyrjen e kalasë. Pikërisht mbi hyrjen është ngritur një xhami, kurse në oborrin e kalasë është një sterc e madhe uji.


Mendimi mbizotërues është se kalaja u ngrit në shek.XV. Muret rrethuese që i takojnë kryesisht kësaj periudhe ruhen sot në lartësi të ndryshme. Lartësinë më të madhe e ka muri perëndimor që është



*Pamje e përgjithëshme e Mozaikut të kishës paleokristiane pranë kryqëzimit "21 dhjetori" në Tiranë, shekulli III i erës sonë*

Kalaja e Lalmit zotëron pamjen në drejtim të rrugëve që kalonin nga lugina e Erzenit në drejtim të Petrelës dhe nga fusha e Tiranës.

**Kalaja e Shën Gjergjit** gjendet në anën lindore të malit të Dajtit pranë fshatit homonim. Ajo është vendosur në një pllajë të vogël të krijuar në rrjedhien e sipërme të Erzenit, aty ku rruga natyrore për në Qafën e Priskës ngushtohet. Kalaja ka formë katërkëndëshe, me përmasa 100mx40m. Brenda mureve ka gjurmë banesash dhe gjetje arkeologjike që i takojnë shek.IV-VI të e.sonë. Kalaja e Shën Gjergjit mbronte e kontrollonte degëzimin rrugor që kalonte nga qafa e Priskës ose Tujanit



*Statuetë e lashtë e një kali, kushtuar mbrojtjes së udhëtarëve gjetur pranë Baldushkut në rrugën që të çon në Tiranë*

në Shën Gjergj, e cila të nxirrte në drejtim të Elbasanit, Matit e mëtej Dibrës.

**Baldushku.** Në juglindje të Tiranës, lugina e lumit të Zhullinës, degë e Erzenit,

formon një zonë të veçantë gjeografike e njohur me emrin e fshatit kryesor Baldushk. Udhëtarët që vinin nga Dyrrahu kalonin në Baldushk nëpër qafën e Kumonës, në Vrap për të dalë në Skampa(Elbasan) e më tej në lindje. Që kjo rrugë kishte shërbyer në kohën antike, e dëshmojnë gjetja në fshatin Koçaj(zona e Baldushkut), rrënojat e një banese antike të shek. të parë të e.sonë, dhe dy skulptura që paraqesin një kompozimnjerëz dhe kuaj. Poshtë tyre një mbishkrim në latinisht, që u kushtohet dioskurëve(kastorëve). Këto realizime skulpturore u kushtoheshin mbrojtësve të udhëtarëve.

**Vrap.** Fshati Vrap në jug të Tiranës, kufi me rrethin e Elbasanit, ka hyrë në historinë e arkeologjisë shqiptare me gjetjen e Thesarit të Vrapit, zbuluar rastësisht në vitin 1902. Thesari përmbante 9 enë të arta bizantine me peshë 3,044kg, 30 enë argjendi me peshë 1,043kg, disa pajisje rripi me zbukurime të ndryshme, shufra e sende gjysmë të punuara prej ari me peshë 2,371kg. Këtij thesari i përkasin edhe një kupë që u dërgua në Stamboll dhe një tjetër që u shit në Trieste. Më 1917, 39 objekte të këtij thesari përfunduan në fondet e Muzeut Metropolitan të Nju Jorkut ku gjenden edhe sot.

Thesari i Vrapit duhet të ketë qenë plaçkë lufte e kapur nga pushtuesit bullgarë rreth viteve 680. Pastaj është fshehur në fshatin Vrap në rrethana të panjohura.



# TIRANA


## VËSHTRIM I SHKURTËR HISTORIK

### 1. Lindja e një qyteti, legjenda dhe historia




Tirana është një qytet i ri, në krahasim me qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë, si Shkoder, Durrësi, Lezha, Berati, Vlora, etj., të cilat kanë një histori prej më tepër se 2 000 vjetësh. Tirana mori trajtat e qytetit vetëm në shek. XVII, ndërsa si fshat ka ekzistuar shumë kohë përpara.

Mbi themelimin e qytetit të Tiranës kanë qarkulluar legjenda të ndryshme, të botuara gjatë dy shekujve të fundit. Në qendër të këtyre legjendave qëndron Sulejman Pashë Bargjini, feudal ushtarak shqiptar në shërbim të Perandorisë Osmane, nga fshati Bargjin, sot i zhdukur, gërmadhat e të cilit shiheshin ende një shekull më parë, pranë lumit të Tiranës në verilindje të kryeqytetit. Sulejman Pashë Bargjini, vazhdon legjenda, pasi u bë i fuqishëm në sajë të karrierës ushtarake, vuri dorë në fillim të shek. XVII mbi fushën pjellore, ku shtrihet sot kryeqyteti i Shqipërisë. Në këtë fushë pjellore, në atë kohë ekzistonte edhe një fshat i vogël me rreth 15 shtëpi, me emrin Tiranë, pranë fshatit Bargjin. Në këtë fshat

Sulejman Pasha ndërtoi një xhami, një han, një furrë dhe një hamam duke formuar kështu, bërthamën e një qyteti.



Harta e Shqipërisë




të fitoreve ushtarake që ai kishte korrur në krye të ushtrive turke kundër Teheranit apo Tehranit, kryeqytetit të Iranit (A. Degrand). Ekziston më në fund një etimologji popullore lokale, e cila e shpjegon emrin Tiranë me fjalën shqipe tjerr anë, domethënë tjerr mendafsh (O. Myderrizi).

Por legjendat i përgjigjen të vërtetës vetëm përsa i përket katër objekteve të ndërtuara nga Sulejman Pashë Bargjini. Përkundrazi, mbiemri Bargjin i Sulejman Pashës tregon se ai nuk ishte nga fshati Mullet (siç trajtohet në një variant të legjendës), në juglindje të kryeqytetit, por nga fshati Bargjin, në verilindje të Tiranës. Po ashtu lidhja e emrit të Tiranës me Teheranin e Iranit ose me etimologjinë popullore tjerr anë nuk kanë asnjë bazë, mbasi emrin e sotëm të qytetit e ndeshim në burimet dokumentare historike gjatë dy shekulli e gjysëm më parë, përpara ngjarjeve që përshkruajnë legjendat.


Emrin e Tiranës e ndeshim, për të parën herë, në trajtën që përdoret sot (Tiranë), si vend i prejardhjes së dy emigrantëve shqiptarë të vendosur në Venedik, në vitin 1372, të regjistruar në aktet e noterit Vassallo, njëri me emrin Villino nga Tirana, tjetri me emrin Leo nga Tirana, me profesion marinar (marinarios), banues në famullinë e Shën Markut të qytetit të Lagunave (Arch. St. Ven. Rregjistri C. I. b. 221).

Gati gjysmë shekulli më vonë, ndeshi po në Venedik, në vitin 1418 një banor të shënuar nga regjistrat e noterit Bernardus me emrin Petrus nga Tirana, i

vendosur në famullinë e Shën Prokulit, pranë të cilit përmendet një grua, ndoshta e shoqja, me emrin Maria nga Shqipëria (Arch. St. Ven. Pri. I. C. 182, C. I. b. 24). Në shek. XV, e ndeshim përsëri në vitin 1478 si emër fushe që shtrihet njëmijë hapa larg Krujës, në veprën e historianit venedikas M. A. Sabellico. Në fillim të shek. XVI e gjejmë si emër të dyfishtë fushe në veprën e humanistit shqiptar Marin Barleti, botuar në vitet 1508-1510 në trajtat: Tirana e Madhe (Tyranna Maior) dhe Tirana e Vogël (Tyranna Minor), por në ndonjë rast edhe thjesht Tirana (Tyranna), pa u cilësuar as si



Monumenti Sulejman Pashë Bargjinollit, themeluesit të Tiranës



Hartë etnokulturore e rrethit të Tiranës

Ndërtimet, për të cilat flet legjenda, ekzistonin së bashku me varrin e Sulejman Pashë Bargjinit, në qendër të Tiranës deri në Luftën II Botërore. Madje në portalin e xhamisë të ndërtuar prej tij, ishte skalitur në gur viti hixhri 1023, i cili i takon vitit gregorian 1614. Xhamia, e quajtur dikur me emrin Xhamia e Vjetër, sot nuk ekziston.

Po ashtu dhe varri i Sulejman Pashë Bargjinit. Ato u shembën gjatë luftimeve

për çlirimin e kryeqytetit, nga forcat partizane kundër ushtrive hitleriane. Sot mbi truallin e tyre ngrihet monumenti i Partizanit.

Në legjendat mbi themelimin e Tiranës ndeshen tregime të ndryshme për origjinën e emrit të saj. Në njerën prej tyre thuhet se emri i qytetit ishte vazhdimi i emrit të fshatit më parë (J. G. von Hahn); sipas një varianti tjetër, Sulejman Pashë Bargjini ia vuri emrin Tiranë, në kujtim



## 2. Rritja e shpejte e qytetit

Edhe për historinë e Tiranës gjatë shekullit të parë të themelimit si qytet, burimet dokumentare janë tepër fragmentare. Por nga sinjalet e tërthorta që kemi, mund të thuhet se faktorët që përcaktuan ngritjen e saj si qytet, ndikuan edhe në rritjen e saj të shpejtë. Gjysmë shekulli më vonë, Tirana ishte kthyer, sipas terminologjisë turke, në një kasaba, qytet në kuptimin e mirëfilltë të fjalës dhe njëkohësisht në një shehër, qendër e një njësie administrative. Këtë na e thotë zyrtari turk, Evlia Çelebi, i cili e vizitoi Tiranën, gati gjysmë shekulli më vonë, në vitin 1662. Në veprën e tij të njohur "Libri i udhëtimeve" (Sejjahat-namesi), ai shkruan tekstualisht: "S'andejmi (nga Elbasani - K.F.) kaluam bjeshkët e Kërrabës me njëmijë vuajtje dhe mundime dhe arritëm pas 9 orë në kasabanë Tiranë. Është vojvodllëk në juridiksionin e sanxhakut të Ohrit. Është kaza prej 150 akçesh. Shehri ndodhet në një fushë të madhe. Ka xhamira, hane, hamame, ka çarshinë dhe sheshin e pazarit. Vreshtat dhe kopshtet janë të panumërta. Të gjitha strehët janë të mbuluara me tjegulla". Kuptohet pra, se pa mbushur akoma 50 vjet, qyteti kishte ecur shumë përpara. Dyqanet, hanet dhe hamamet, të cilat zyrtari turk i shpreh në shumes, flasin për rëndësinë që kishte marrë qyteti, frekuentimin e tij të shpeshtë nga banorët e huaj dhe jetën e kulturuar qytetare të banorëve, të cilët përveçse me hamame kishin dhe kopshtije të panumërta.

Veç kësaj përveç tregut fshatar javor, Tirana tani kishte edhe çarshinë, tregun e mirëfilltë qytetar.

Rritjen gjithnjë të shpejtë që pati Tirana gjatë dhjetëvjeçarëve të mëvonshëm, e tregon një pasqyrë e hartuar në fillim të shek. XVIII me popullsinë e qyteteve të Shqipërisë bregdetare. Sipas kësaj pasqyre, Tirana me Varoshin (Tirana col Borgo) kishte në vitin 1703, pra 90 vjet pas themelimit të saj, 500 shtëpi me 4 mijë frymë. Kjo do të thotë se pa mbushur akoma një shekull, Tirana e kishte arritur Krujën, e kishte tejkaluar Durrësin, i cili së bashku me fshatrat, kishte atë vit 400 shtëpi me 4 mijë frymë dhe e kishte lënë prapa Petrelën, e cila kishte mbetur në vend, me gjithsej 150 shtëpi dhe me rreth 440 frymë. Më tej akoma, në mesin shek. XVIII, Tirana me 6 mijë banorë zinte vendin e dytë, pas Elbasanit, midis qyteteve të Shqipërisë së Mesme. Dora-dorës, me shtimin e popullsisë së Tiranës dhe me rritjen e peshës së ekonomisë së saj u rrit edhe roli i saj në jetën politike të vendit, si rrjedhim edhe fondi i burimeve të saj dokumentare.

## 3. Ambiciet për sundimin e "Pashallëkut të Tiranës"

Në mesin e shek. XVIII, sundimin e Tiranës dhe të rrethit e kishin trashëguar, brez pas brezi, pasardhësit e themeluesit të qytetit, Sulejman Pashë Bargjinit. Por të ardhurat e begatshme që siguronte ekonomia tiranase tërhoqën lakminë e oborrit perandorak dhe të feudalëve fqinjë. Për hir të këtyre të ardhurave, në çerekun e dytë të shek. XVIII, sulltani e ktheu trevën e Tiranës nga zeamet, pra nga feud ushtarak që ishte më parë në maliqane, pra në feud ekonomik dhe si të tillë ia kishte dhënë për shfrytëzim nënës së tij, valide-sulltanës.

fushë, as si vendbanim. Si emër fushe (le pianure della Tiranna), e ndeshim te një autor anonim i vitit 1570. Më në fund, përmendet si emër i një fushe të famshme në relacionin e ambasadorit venedikas Lorenzo Bernardo, i cili në vitin 1591 udhëtoi përmes saj për në Stamboll duke e quajtur atë "fusha e madhe dhe e famshme e Skënderbeut, e quajtur Tiranë" (campagna grande famosa di Scanderbeg, detta Tiranna).

Burimet dokumentare historike për Sulejman Pashë Bargjinit janë të cekëta. Ai përmendet në fillim të shek. XVII si guvernator i Bagdatit, i emëruar nga veziri i madh me origjinë shqiptare Mere Hysen Pasha, me detyrë që të nënshtrohte kryengritësit irakenë, kurse pushtimi i Teheranit prej tij është një legjendë e trilluar. Më vonë sipas J. G. von Hahn-it, Sulejman Pashë Bargjini u emërua sanxhakbej i Ohrit. Si rrjedhim ai kishte nën juridiksionin e vet Krujën dhe Petrelën duke përfshirë dhe fshatin Bargjin që ndodhet midis tyre.

Megjithatë lindja e Tiranës si qytet nuk u diktua nga dëshira e Sulejman Pashës, por nga zhvillimi i ekonomisë së trevës, e cila pushtoi që në fund të shekullit XVI ndonëse me ritme të ngadalshme, viset e Shqipërisë së ulët bregdetare. Si pasojë e këtij zhvillimi ekonomik, lindi nevoja edhe në këtë trevë për një qendër zejtare dhe tregtare. Dy qendrat më të afërta administrative, Kruja dhe Petrela, ishin në këndet e trevës fushore, për më tepër, mbi maja kodrash të thepisura, larg rrugëve natyrore të komunikacionit. Ajo kishte nevojë për një qendër në zemrën e saj fushore.

Në caktimin e truallit ku duhej të themelohej qyteti, ndikoi rrethana se, që nga fundi i shek. XVI, përmes kësaj treve, trafiku i karvanëve kishte filluar të bëhej më i shpeshtë. Përmes fushës së Tiranës kalonin tri rrugë karvanësh që lidhnin përfundimisht me lindjen dhe veriperëndimin me jugun. Dy prej tyre niseshin nga Durrësi dhe Kavaja. E para, pasi kalonte në Shijak, ndiqte korridorin e Vorës, afërsisht në trasenë e rrugës së sotme të Durrësit. Tjetra përshkonte korridorin e Ndroqit, afërsisht në trasenë e rrugës së sotme të Kavajës. Të dyja këto rrugë vazhdonin më tej në dy degëzime, njëra përmes Bërrarit, Tujanit, Vendeshës, Murrizit për në Mat e Dibër, tjetra përmes Priskës dhe Shëngjergjit për në Martanesh dhe në Çermenikë. Rruga e tretë vinte nga veriu, nga Shkodra, Lezha dhe Fushë Kruja, e cila, pasi përshkonte fushën, vazhdonte nëpër malësinë e Kërrabës dhe zbriste në luginën e Shkumbinit, ku lidhej me rrugën historike Egnatia.

Paraqitja e tri rrugëve në hartë tregon se ato takoheshin si dhe sot, në qendrën e Tiranës, në pikën ku Sulejman Pashë Bargjini kreu ndërtimet e veta. Ndërtimi i hanit, furrës dhe i hamamit tregon se ai pa fillimet në atë pikë, të një tregu lokal, kurse xhamia sanksionoi fetarisht, sipas normave të Perandorisë islamike osmane, tutelën ndaj qytetit të ri.

Mund të thuhet, pra, se Tirana, si qytet, është pjellë e kryqëzimit të rrugëve të rëndësishme të komunikacionit, dhe e nevojës ekonomike për një qendër tregëtie.

e të cilave po zhvilloheshin tendencat autonomiste feudale shqiptare. Rivalët e tyre, përkundrazi, përfshirë edhe Toptanët, përfaqësonin forcat feudale shqiptare, të cilat e ndjenin veten ekonomikisht të dobëta për të sunduar pa përkrahjen e pushtetit qendror osman.

Pas kthimit të Ibrahim Bej Bargjinit në krye të Tiranës, marrëdhëniet e tij me Portën e Lartë u acaruan. Si rrjedhim sundimi që tani Bargjinolli ushtroi në kundërshtim me vullnetin e Stambollit, shënoi shndërrimin e trevës së Tiranës nga një njësi administrative perandorake në një zotërim feudal autonom ose, sipas shprehjes së kohës, në një "pashallëk" feudal autonom.

Vetëkuptohet se ardhja në pushtet e Ibrahim Bargjinollit i egërsoi edhe Toptanët e Krujës. Përpyjekjet e tyre për të shtënë në dorë sundimin e qytetit vazhduan, herë me suksese herë me dështime, por kurdoherë me dëme për qytetarët, për gati 70 vjet. Historia e këtyre përpjekjeve është e gjatë dhe e ndërlikuar.

Të egërsuar nga disfata që pësuan në Tiranë, Toptanët vendosën të shpaguheshin kundër qytetarëve. Për këtë qëllim, ata lëshuan kundër Tiranës bandat e tyre të armatosura. Herë pas here këto banda hynin në qytet, plaçkisnin pazarin, bastisnin shtëpitë, rrëmbenin njerëz, të cilët i lironin pasi merrnin nga familjet e tyre shpërblimet e kërkuara.

Zullumet e Toptanëve shkaktuan protesta të mëdha nga ana e popullsisë

së qytetit, por Porta e Lartë u bë e gjallë vetëm kur pa se Toptanët filluan t'i mbanin për vete të ardhurat që nxirrnin nga mukataja dhe nga taksat shtetërore. Më 1768, në pragun e luftës ruso-turke Porta lëshoi dekretin për internimin me gjithë familje jo vetëm të Bargjinollit, por edhe të dy krerëve krutanë, Tahir Agë Toptanit dhe Ismail Agë Toptanit. Të dy palët bënë sikur qenë penduar dhe kërkuan falje, por qetësia përsëri nuk u vendos. Madje, kur filloi lufta ruso-turke (1768), Ibrahim Bej Bargjini, nuk iu bind urdhërit të sulltanit për të shkuar në frontin e Danubit. Kështu, ai doli haptaz në rebelim. Këtë rrethanë Toptanët e shfrytëzuan dhe në vitin 1770 e rimorën për të dytën herë Tiranën. Por vitin e ardhshëm, me ndërhyrjen e Mehmet Pashë Bushatliut, Bargjinollit i erdhi falja. Me porosinë e Zejnepe sulltanës, Toptanët e lanë me të shpejtë Tiranën dhe u detyruan të pajtoheshin me Bargjinollin. Pajtimin, Bargjinolli e shfrytëzoi nga ana e vet, për të likuiduar me pabesi fizikisht armiqtë e tij.

Në një ditë të shtatorit të vitit 1771, dy krerët krutanë, Tahir Agë Toptani dhe Ismail Agë Toptani, ungj dhe nip, të shoqëruar nga 70 trima, erdhën për vizitë te Bargjinolli, për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre. Por gjatë bisedimeve që zhvilloheshin në konakun e Bargjinollit, dy krerët krutanë së bashku me trimat e tyre u sulmuan në befasi nga forcat tiranase. Në përfundim të komplotit, dy agallarët Toptanë së bashku me jo pak trima u vranë, kurse të tjerët u kapën robër. Kështu marrëdhëniet midis Krujës dhe Tiranës u acaruan përsëri.

Të ardhurat e maliqanes, valide-sulltana i vilte me anën e zabitëve apo funksionarëve ose i jepte në sipërmarrje (mukata). Por me degjenerimin që kishte pushtuar administratën perandorake, askush nuk ishte në gjëndje të pengonte abuzimet e funksionarëve dhe të sipërmarrësve të maliqanes.

Pakënaqësia e masave të popullsisë mori trajtën e kryengritjeve të armatosura kundër administratës perandorake dhe kundër feudalëve fqinjë, të cilët përpiqeshin ta shtinin në dorë sundimin e Tiranës, për të përvetësuar të ardhurat e maliqanes. Sulmet e armatosura që ndërmerrnin feudalët e shtrinë anarkinë, që kishte pushtuar mbarë Shqipërinë, edhe në rrethin e Tiranës.

Me sa dihet, shprehja e pakënaqësisë së popullsisë së kësaj treve kundrejt pushtetit perandorak, ishte pjesëmarrja e saj në kryengritjen që shpërtheu në Shqipërinë e Mesme, në vitet 50 të shek. XVIII. Kryengritja duhet të ketë qënë serioze sepse për shtypjen e saj erdhi në këto anë, në vitin 1757, vetë ministri i luftës së Perandorisë Osmane, Ismail Pasha së bashku me ushtritë e katër pashallarëve. Kryengritja u shtyp. Sundimtari i Tiranës, Sulejman Pashë Bargjini ose Bargjinolli, një pasardhës i themeluesit të qytetit, u arratis, por pakënaqësia e popullsisë nuk u shua. Natyrisht nuk u shua as procesi që kishte pushtuar në këtë kohë të gjitha krahinat e Shqipërisë, për të shpëtuar ekonominë lokale nga grabitjet fiskale të Stambollit, duke u distancuar nga pushteti perandorak.

Por ky proces politik, me përmbajtje partikulariste që po shpinte në formimin e pashallëkëve autonome, në trevën e Tiranës, u zhvillua në rrethana tepër të ndërlikuara, mbasi qyteti u ndodh në të njëjtën kohë nën sulmet e pinjollëve të familjes Toptani të Krujës.

Ai që e zhvilloi me vendosmëri politikën partikulariste në trevën e Tiranës, ishte Ibrahim Bej Bargjini, biri i Sulejman Pashë Bargjinit. Në fillim të viteve 60, Ibrahim Bej Bargjini kishte pozita të dobëta përballë Toptanëve, të cilët gjatë kryengritjes së viteve 50 kishin mbajtur anën e sulltanit dhe kishin pushtuar Tiranën. Por me përkrahjen e popullsisë qytetare dhe me aleancën që lidhi në vitin 1767 me dy sundimtarë të fuqishëm - Mehmet Pashë Bushatliun të Shkodrës dhe Ibrahim Pashë Alltunin të Kavajës, Ibrahim Pashë Bargjini, e shtiu po atë vit në dorë, brenda një nate Tiranën.

Si përgjigje Toptanët u lidhën me Çaushtollajt e Shkodrës, Begollajt e Pejës, Gjomarkajt e Mirditës dhe me një sërë bejlerësh lokalë që kishin nën sundimin e tyre Lezhën, Ishmin, Prezën, Petrelën, në mënyrë të veçantë, valiun e Rumelisë, autoritetin më të lartë të Portës së Lartë në Ballkanin Qendror.

Dy rreshtimet kundërshtare, përfaqësonin dy tendencat politike, të cilat dominuan në Shqipëri gjatë shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX. Rreshtimi i Bargjinollit dhe i Bushatliut përfaqësonte forcat feudale shqiptare kundërshtare të centralizmit perandorak osman, në gjirin



largohej me të mirë dhe të strehohej në Mat për t'u kursyer gjakderdhjen qytetarëve. Bargjinolli refuzoi.

Ndonëse Tirana nuk kishte as kala as pozitë natyrore mbrojtëse rezistoi. Sipas njoftimit që jepte ato ditë Alberghetti, konsulli venedikas në Durrës, nën urdhërat e Ibrahim Bej Bargjinit luftuan më se 6 mijë luftëtarë, nga më trimat, të gjithë, shton ai, "të vendosur më parë të vdisnin se sa të pranonin t'i nënshtroheshin Kurtit". Por më në fund, pas dy muaj e gjysëm rrethimi, kur mbaruan rezervat ushqimore, Bargjinolli me shokët e vet u larguan për në Shkodër, Ahmet Kurt Pasha hyri në Tiranë dhe Toptanët e morën për të tretën herë sundimin e qytetit, veçse për një periudhë të shkurtër. Pas gjashtë javësh, me marrëveshjen që Shkodra lidhi me Stambollin, Toptanët u larguan nga Tirana. Qyteti ra përsëri nën sundimin e Bargjinollit.

Këtë radhe qetësia vazhdoi pesë vjet. Më 1785 situata u keqësua, kur Bushatliu vendosi të sulmonte, në kundërshtim me porositë e sultanit, Malin e Zi. Në këtë situatë plot rreziqe për Tiranën, aleanca e Bargjinollit me Bushatliun u forcua më tepër. Më 20 mars 1785, Kara Mahmudi, të cilit disa muaj më parë i kishte vdekur e shoqja u martua me vajzën e dytë të Bargjinollit, i cili me këtë rast u bë vjehërr i tij për të dytën herë. Siç pritej, prishja e marrëdhënieve të Bushatliut me Stambollin, u dha zemër kundërshtarëve të tyre, Ahmet Kurt Pashës së Beratit dhe Mustafa Agë Toptanit të Krujës. Por Bushatliu energjik ua mori iniciativën e sulmit.

Në korrik, fill pasi përfundoi fushatën kundër Malit të Zi, ndërmori së bashku me Bargjinollin, fushatën kundër rivalit të rrezikshëm, Ahmet Kurt Pashës, ushtritë e të cilit u shpartalluan keq, në një ditë gushti, në afërsitë e Peqinit. Pas kërcënimeve që mori nga Stambolli, Bushatliu i ndërpreu veprimet kundër Beratit, por vitin e ardhshëm, më 1787, ai i rifilloi veprimet kundër Ahmet Kurt Pashës. Atëherë sulltani e shpalli Bushatliun "fermanli" dhe u dha urdhër të gjithë sundimtarëve të Shqipërisë të viheshin së bashku me forcat e tyre, nën urdhërat e valiut të Rumelisë kundër Shkodrës. Bargjinolli edhe këtë radhë refuzoi t'i bindej sulltanit. Më vonë, nga që dokumentacioni është i varfër, nuk kuptohet se si forcat qeveritare e shtinë në dorë Bargjinollin dhe e dërguan në Stamboll, ku u burgos. Në muajin nëntor të vitit 1787, forcat qeveritare të valiut të Rumelisë u shpartalluan nga Kara Mahmud Bushatliu. Biri i Ibrahim Bej Bargjinit, Kahreman Bargjinolli, dëboi me ndihmën e qytetarëve Mustafa Agë Toptanit dhe e shpalli veten sundimtar të Tiranës. Pikërisht ato ditë, në fillim të vitit 1788, kur Kahreman Bargjini erdhi në pushtet, në Stamboll, i ati i tij, Ibrahim Bej Bargjini, u ekzekutua në burg, si armik i Perandorisë Osmane dhe si "bashkëpunëtor i rebelit të madh të Shkodrës".

Me vrasjen e Ibrahim Bej Bargjinollit, mbyllet në një farë mënyre historia e "Pashallëkut të Tiranës", kurse historia e qytetit vazhdon të jetë e trazuar edhe për 30 e ca vjet të tjera, derisa Tirana u fut nën zgjedhën e Tanzimatit.

Pasi mbaroi lufta ruso-turke dhe u lidh paqja e Kuçuk Kainarxhikut, në qershor 1774, Porta e Lartë e drejtoi vëmendjen kundrejt Mehmet Pashë Bushatliut, i cili kishte mbajtur një qëndrim të pavarur. Meqënëse rivalët e vjetër të Bushatliut, Begollajt dhe Çaushollajt, tani ishin dobësuar, Porta nxiti kundër vezirit të Shkodrës, Ahmet Kurt Pashën, sundimtarin energjik të Beratit. Si shkak për grindjen midis tyre shërbeu çështja e mukatasë së Durrësit, koncesionin e së cilës sulltanësia ia hoqi Bushatliut dhe ia dha Kurt Pashës. Lufta midis tyre nuk vonoi. Në fillim u duk sikur epërsinë e pati Bushatliu, i cili i theu forcat e sundimtarit të Beratit në Kavajë, por në ndeshjen e përgjakshme që u zhvillua midis tyre në Peqin, Bushatliu së bashku me aleatët e vet, ndër të cilët ndodhej edhe Ibrahim Bej Bargjinolli, u thyen keq. Më 13 shtator 1775, ushtritë e Ahmet Kurt Pashës hynë në Tiranë, kurse Bargjinolli u largua me të shpejtë në Shkodër.

Bargjinolli qëndroi në Shkodër gati katër vjet, për aq kohë sa Tirana qëndroi nën sundimin e Ahmet Kurt Pashës. Në Shkodër, Bargjinolli u qëndroi besnik Bushatlinjve edhe pas vdekjes së Mehmet Pashë Bushatliut (1776). Madje pasardhësin e tij, Kara Mahmud Bushatliun, Bargjinolli e bëri dhëndër duke i dhënë vajzën e tij për grua. Me këtë lidhje, Bargjinolli e ndoqi Bushatliun edhe në veprimet luftarake që ndërmori në vitet e ardhshme.

Fushata që ndërmori Bushatliu në vitin 1779 kundër Ahmet Kurt Pashës i lehtësoi kthimin e Bargjinollit në Tiranë.

Në prill, Bargjinolli i shoqëruar nga trimat e tij dhe nga 200 kalorës që i dha Bushatliu së bashku me 500 këmbësorë lezhjanë, u nis nga Shkodra. Në afërsitë e Tiranës - raportonte konsulli venedikas në Durrës - i dolën për ta pritur tërë pleqtë së bashku me popullin (*tutti li vecchiardi il popolo unito*), të cilët, më 5 prill e shpunë Bargjinollin me madhështi në qytet. Konsulli venedikas shton se vegjelia e qytetit u vuri zjarrin sarajeve të bejlerëve rivalë.

Por sapo ushtritë e Bushatliut u larguan nga Shqipëria e Mesme, Toptanët rifilluan sulmet kundër Tiranës duke krijuar pasiguri në qytet dhe duke dëmtuar lëvizjen tregtare. Me kërcënimet që dërgoi Bushatliu, Toptanët pranuan të ndërprisnin zullumet dhe të pajtoheshin me Bargjinollin. Pajtimi vazhdoi vetëm katër muaj. Toptanët, sapo morën vesh se Stambolli po përgatitej të nënshtrohte Shkodrën, sulmuan me bandat e tyre përsëri Tiranën. Qyteti u mbrojt, por sulmi që tepër i furishëm dhe shpëtoi në sajë të ndihmave që erdhën nga Shkodra. Një muaj më vonë, në nëntor 1779, Porta e shkarkoi Kara Mahmud Bushatliun dhe aleatët e tij, midis të cilëve edhe Bargjinollin. As Bushatliu as aleatët e tij nuk e pranuan shkarkimin. Atëherë Porta nisi në fund të vitit 1779, një ekspeditë të madhe kundër Shkodrës dhe sundimtarëve të tjerë kryengritës. Barra për të nënshtroar Tiranën i takoi Ahmet Kurt Pashës së Beratit dhe Adem Agë Toptanit. Rezistenca kundër forcave proqeveritare, në Tiranë ka qënë e jashtëzakonshme. Ahmet Kurt Pasha kur iu afrua qytetit e ftoi Bargjinollin të



Mustafa Pasha i vazhdoi orvajtjet për të shtënë në dorë Tiranën dhe me vështirësi mundi të bëhej, më 1793, zot i saj, por e humbi përsëri shumë shpejt. Një vit më vonë, shfaqet në Tiranë Molla Beu, një kundërshtar i Toptanëve, i cili ndonëse ishte trashëgimtar nga vija femërore e themeluesit të Tiranës, lakmoi ta trashëgonte pushtetin e Ahmet Pashës. Më 1794, Molla Beu, ndër të tjera, hodhi themelet e xhamisë që ekziston edhe sot në qendër të qytetit dhe që mban emrin e birit të tij, Haxhi Etëhem Beu. Por më vonë ndërtimi i xhamisë u ndërpre pasi, me vrasjen e Kara Mahmud Bushatliut, në shtator të vitit 1796 gjatë ekspeditës së tij kundër Malit të Zi, rifilluan trazirat e shkaktuara nga konfliktet feudale. Aleanca e Bargjinollit me Shkodrën vazhdoi edhe me Ibrahim Pashë Bushatliun, pasardhësin e Kara Mahmud Pashës. Megjithatë Tirana nuk gjeti qetësi. Në fund të shek. XVIII, vendin e Mustafa Toptanit e zuri vëllai i tij, Kapllan Beu, më vonë Kapllan Pashë Toptani, po aq energjik sa i vëllai, por më dinak se ai. Kapllan Bej Toptani përpara se të sulmonte Tiranën, u përpoq ta izolonte Bargjinollin nga aleatët tradicionalë të tij, por nuk pati sukses. Kundërshtarët e Toptanëve mbetën gjithmonë Bushatlinjtë e Shkodrës. Por Ibrahim Pashë Bushatliu si shpërblim të mbrojtjes që i dha Bargjinollit, nga synimet e Toptanëve shtiu në dorë të ardhurat që nxirreshin nga taksat dhe nga mukataja e Tiranës. Tirana u ndodh kështu nën darën e një presioni të dyfishtë, të Bushatlinjve dhe të Toptanëve. Këtij presioni të dyfishtë, Ahmet Pasha nuk qe në gjendje t'i bënte ballë.

Duke patur më tepër frikë nga Toptanët, Ahmet Pashë Bargjinolli i lëshoi vazhdimisht pe vjehrrit të tij, Ibrahim Pashë Bushatliut. Por me lakmitë e tij për të përvetësuar tej mase të ardhurat e Tiranës, Bushatliu shkaktoi pakënaqësi te popullsia tiranase. Zëdhënësi i pakënaqësisë u bë Molla Beu, të cilin Ibrahim Bushatliu e ftoi në Shkodër dhe aty e likuidoi fizikisht. Pikërisht në kohën kur marrëdhëniet midis Bargjinollit dhe Bushatliut ishin acaruar në kulm, vdiq Ahmet Pashë Bargjinolli. Duke mos patur trashëgimtarë Bushatliu dërgoi si qeveritar të Tiranës një nga komandantët e vet. Parësia e Tiranës e refuzoi duke e dëbuar qeveritarin e Bushatliut. Marrëdhëniet midis Tiranës dhe Shkodrës u acaruan më keq. Frika e një ekspedite ndëshkimore nga Shkodra e detyroi parësinë e Tiranës të hynte në bisedime me kundërshtarët e saj të vjetër, Toptanët e Krujës. Marrëveshja u sanksionua me martesën e katër vajzave të Ahmet Pashë Bargjinollit me katër nga pesë djemtë e Kapllan Pashë Toptanit. Ibrahim Pashë Bushatliu i egërsuar, iu vërsul Tiranës, në janar të vitit 1810, me një ekspeditë ndëshkimore, të përbërë nga malësorë të Malësisë së Madhe, të quajtur lekë.

Tirana bëri një rezistencë të armatosur kundër kësaj ekspedite, e cila në traditën popullore mori emrin "Lufta e Lekëve". Por forcat tiranase u thyen keq në Laprakë, duke lënë 200 qytetarë të vrarë, kurse nga malësorët e Bushatliut mbetën rreth 120 të vrarë. Qyteti u plaçkit tri ditë me radhë. Megjithatë në pamundësi për t'i mbajtur nën zgjedhë qytetarët e egërsuar, Bushatliu i tërhoqi ushtritë e

Ibrahim Bej Bargjinolli ishte padyshim një sundimtar feudal, i formuar në ambjentin e rendit feudal osman. Megjithatë, ai duhet të veçohet nga lista e sundimtarëve të zakonshëm që ka nxjerrë Tirana në të kaluarën. Ai nuk ishte një sundimtar i bindur ndaj pushtetit qendror turk. Kjo notë e politikës së Ibrahim Bej Bargjinollit dominoi që në fillim dhe deri në fund të veprimtarisë së tij. Në veprimtarinë e tij politike, ai u mbështet jo në rendin feudal-ushtarak, tashmë të perënduar, por në forcat e reja shoqërore që lindën me zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Qendrimi i vazhdueshëm armiqësor që ai mbajti ndaj feudalëve të rrjeshtuar në anën e Portës së Lartë dhe aleancat që ai lidhi me sundimtarët kundërshtarë të pushtetit qendror osman, tregojnë se politika e Ibrahim Bej Bargjinit nuk qe aksidentale, por konsekuente. Në qoftë se do të depërtojmë në rrënjët e kësaj politike do të zbulojmë po atë proces që del në dritë në veprimtarinë e aleatëve të tij, Bushatlinjve, proces, i cili shpinte në dobësimin, gjithnjë e më tepër të pushtetit qendror osman në viset shqiptare dhe në forcimin gjithnjë e më shumë të pashallëkëve autonomë në këto vise.

Por në qoftë se problemi i një pashallëku të veçantë në krahinën e Tiranës mbetet akoma i hapur, në asnjë mënyrë nuk mund të mohohet fakti se në këtë trevë, ky proces gjatë sundimit të Ibrahim Bej Bargjinollit u bë tepër aktiv.

\* \* \*

Me vdekjen e Ibrahim Bej Bargjinollit, pushtetin e Tiranës e trashëgoi djali i tij i madh, Kahreman Bej Bargjinolli, i cili, siç treguan ngjarjet, trashëgoi nga i ati pushtetin dhe jo cilësitë e tij prej sundimtari energjik. Përveç pushtetit, ai trashëgoi nga i ati edhe aleancën me Kara Mahmud Bushatliun, të cilin e kishte kunat, por në të njejtën kohë dhe armiqësinë me Toptanët, të cilët menduan se tani pas vdekjes së Ibrahim Beut, do ta kishin më të lehtë pushtimin e Tiranës. Në vitin 1788, Mustafa Pashë Toptani, gjithnjë me përkrahjen e pushtetit qendror osman, e shtiu përsëri në dorë Tiranën, por Kahreman Beu me ndihmën e kunatit të tij, Kara Mahmud Bushatliu, u rivendos përsëri disa muaj më vonë në qytetin e vet.


Ndërkohë Tirana priste me ankth sulmin hakmarrës të Mustafa Pashë Toptanit, ky për habi të të gjithëve, kërkoi të pajtohej me Kahreman Beun. Pajtimi u bë në Tiranë, në shtëpinë e Kahreman Bej Bargjinollit. Me ftesë të Mustafa Pashë Toptanit, Bargjinolli i ktheu vizitën në Krujë. Më 13 gusht 1788, ndërsa Bargjinolli me suitën e tij ndodhej mysafir në sarajin e Mustafa Pashë Toptanit, në kalanë e Krujës, ky i sulmoi në pabesi, duke i vrarë të gjithë. Pas vrasjes së Kahreman Pashës, sundimtar u bë vëllai i tij, Ahmet Bej Bargjinolli (më vonë Ahmet Pasha), i cili nuk kishte djalë, por vetëm katër vajza. Si rrjedhim me Ahmet Pashën mbyllej trashëgimia me vijën mashkullore e themeluesit të Tiranës, Sulejman Pashë Bargjinit.



Ibrahim Bej Alltuni, të cilët me ndihmën që u dha Mustafa Pashë Bushatliu e sulmuan për pesë muaj me radhë Tiranën. *Më në fund, në maj të vitit 1820, Tirana e dëmtuar rëndë nga këto sulme ra në duart e Haxhi Etëhem Beut, i cili tani e përfundoi xhaminë që mban emrin e tij duke ngritur dhe kullën e sahatit pranë saj.*

Përsëri Tirana nuk shpëtoi dot nga këto sulme me ndryshim se tani ato i organizonin si dikur prapë Toptanët. Tirana u rezistoi këtyre sulmeve deri më 1831, kur qeveria turke ndërmori ekspeditën përfundimtare kundër Mustafa Pashë Bushatliut. Me rrethimin

e Shkodrës nga ushtritë turke, Haxhi Etëhem Beu mbeti pa përkrahjen e Mustafa Pashë Bushatliut. Këtë rrethanë e shfrytëzoi Abdurrahman Bej Toptani, i cili mbajti anën e sulltanit dhe me përkrahjen e qeverisë së Stambollit e shtiu përsëri në dorë Tiranën. Haxhi Etëhem Beu i bindur se tashmë me likuidimin e Ali Pashë Tepelenës dhe Mustafa Pashë Bushatliut, qeveria e Stambollit e kishte konsoliduar pushtetin e vet qendror në këto anë, nuk e kundërshtoi pushtimin e Tiranës nga Abdurrahman Bej Toptani, madje u pajtua me të. Në Tiranë u vendos administrata qeveritare. Me vendosjen e saj morën fund ngatërresat dhe luftërat feudale në këtë trevë.



*Sulejman Pashë Bargjinolli duke endërruar krijimin e Tiranës-pikturë në vaj nga Arben Basha*

veta dhe u kthye në Shkodër, ku pas disa ditësh (në shkurt të vitit 1810) vdiq nga një infeksion. Trazirat që shpërthyen në Shkodër pas vdekjes së Ibrahim Pashë Bushatliut i dhanë mundësi Kapllan Pashë Toptanit të shtinte në dorë, në aleancë me Ali Pashë Tepelenën, Tiranën, në vitin 1811 ose 1812. Kështu pas 60 vjet përpjekjesh e luftërash Toptanët e Krujës e realizuan aspiratën e tyre për t'u bërë përfundimisht (me një ndërprerje të shkurtër në vitet 20) zotër të Tiranës.

Megjithatë qetësia në Tiranë nuk u vendos. Pushtimi me dhunë i Tiranës nga

Toptanët shkaktoi reagimin e popullsisë së pakënaqur të qytetit, në krye të së cilës qëndronte gjithnjë Haxhi Etëhem Beu. Në të njejtën kohë lakmitë e Kapllan Pashës për ta shtrirë në dorë sundimin e vet përtej Krujës dhe Tiranës, shkaktoan shqetësime edhe te feudalët e krahinave fqinje. Si rrjedhim, kundër Toptanëve u krijua një koalicion i gjërë, në të cilin morën pjesë aleatët e Bushatlinjve të Shkodrës, duke përfshirë edhe dhëndrin e Kapllan Pashës, Ibrahim Bej Alltunin e Kavajës. Si kundërpeshë Kapllan Pasha vazhdoi t'i forconte lidhjet me Stambollin pa mohuar përkrahjen e Ali Pashë Tepelenës. Ai mundi ta arrestonte me pabesi sundimtarin e Kavajës. Por në këtë përplasje ai që humbi ishte vetë Kapllan Pasha. Bija e tij, e cila ishte e shoqja e Ibrahim Bej Alltunit, arriti ta helmonte të atin, në fillim të vitit 1819, në Krujë, duke shpëtuar kështu të shoqin.


Pas vdekjes së Kapllan Pashës, qeveritari i Tiranës u emërua biri i tij Abdurrahman Bej Toptani. Në vitet e para të qeverimit të tij, lufta e Toptanëve me rivalët e tyre u acarua në kulm. Abdurrahman Pasha ndërmori ekspedita për të asgjësuar kundërshtarët e vet të fuqishëm. Ai shtiu në dorë Kavajën dhe Durrësin, por rivalët e tij nuk i asgjësoi dot, pasi ata u arratisën duke u strehuar në Shkodër.

Por ndërkohë midis vëllezërve Toptanas plasi grindja për çështjen e të ardhurave nga koncesioni i mukatasë, e cila solli dobësimin e pushtetit të tyre. Këtë rrethanë e shfrytëzuan dy rivalët e tij kryesorë, Haxhi Etëhem Beu dhe



kryesisht nga pasardhësit e Kapllan Pashë Toptanit. Të pesë djemtë e tij u përpoqën, jo vetëm të legalizonin pronat shtetërore (mirie) të grabitura nga i ati i tyre, por edhe t'i shtonin ato me anë të përvetësimeve ose blerjeve të reja që nga Tirana deri në Breg Mat. Megjithatë jo të gjithë djemtë e tij u bënë njësoj pronarë të mëdhenj tokash. Disa prej tyre u pasuruan duke marrë edhe në veprime tregtare. Ai që u pasurua më tepër se të tjerët ishte djali i tij i dytë, Abdurrahman Beu, i cili e shfrytëzoi postin që kishte për një kohë të gjatë si qeveritar i Tiranës. Në këto rrethana filloi diferencimi në fushën e pasurisë midis vëllezërve Toptanas.

Por në të njejtën kohë klima që përmbante në thelbin e vet Tanzimati, për të parë drejt të ardhmes dhe jo drejt të kaluarës, e bëri për vete dhe vetë Abdurrahmanin. Ai e kuptoi se sundimi i tij nuk mund të ishte i sigurt nëse do të vazhdonte taktikën hakmarrëse të paraardhësve të tij. Ai u tregua më liberal. Sikurse u tha, ai pranoi të pajtohej me kundërshtarit kryesor të tij, Haxhi Etëhem Beun, madje atë e bëri dhëndër. Ndryshe nga veprimet arbitrare që ndërmori në fushën e pronësisë tokësore në fshat, ai u përpoq të vendoste njëfarë rendi në jetën dhe në ekonominë qytetare në Tiranë. Në këto rrethana qyteti filloi të rritet përsëri shpejt; bashkë me qytetin u rrit dhe ekonomia e tij. Zejtaria u zhvillua më tutje; tregtia u rrit me hov më të madh. Lajmet e kësaj kohe dëshmojnë për një numër të madh esnafësh në Tiranë. Ndër to vazhdonte lidhja e vjetër prej 7 esnafësh zejtarësh myslimanë, e quajtur Esnafi i Terzive dhe




Autoportret i Eduard Lear, piktorit të famshëm që vizitoi Tiranën në 1848

lidhja tjetër e fuqishme esnafësh, e quajtur Esnafi i Tabakëve. Ndërkohë në kodikun e kishës së Shën Prokopit thuhet se vetëm nga gjiri i komunitetit ortodoks nga 100 familje kishte 5 esnafë. Krahas tyre u rrit gjithashtu edhe borgjezia tregtare.

Në Tiranë kishte në atë kohë familje të mëdha tregtarësh që kishin ngritur agjensitë e tyre, jo vetëm në vise të tjera të Perandorisë Osmane, por edhe në shtete të huaja. Dy nga firmat tregtare më të mëdha të Tiranës ishin ajo e Haxhi Selman Beshirit dhe ajo e Ali Tabakut, të cilat kishin ngritur agjensi në vende të ndryshme si në Venedik, Selanik, Misir dhe kishin krijuar lidhje tregtare me shtete të tjera të Europës.

#### 4. Ekonomia në Tiranë në shekujt XVIII-XIX

Luftërat feudale që u zhvilluan në Tiranë, gjatë shek. XVIII dhe çerekut të parë të shek. XIX, shkaktuan dëme të mëdha materiale dhe njerëzore. Si pasojë e plaçkitjeve, djegieve, hakmarrjeve, numri i popullsisë, pas rritjes që pati në shek. XVIII, më vonë u pakësua. Udhëtari austriak J. Müller, i cili e vizitoi Tiranën në fillim të viteve 40 të shek. XIX, shkruan se nga 1 000 shtëpitë dhe 727 dyqanet që kishte patur qyteti, para vitit 1830 në kohën e vizitës së tij, pjesa më e madhe e tyre qenë të zbrazura. "Qyteti i përhapur, tani për tani, pa tregti, pa industri - shkruante J. Müller - paraqet një pamje të pikëllueshme". Edhe autori frëng Ami Boué, i cili kaloi nëpër Shqipëri



"Han në Tiranë" pikturë nga Eduard Lear e vitit 1848

në vitin 1839, flet për Tiranën duke thënë se kishte rreth 300 shtëpi, natyrisht një shumë e zvogëluar, fakt ky që e ka detyruar konsullin austriak Hahn, njohësin e mirë të Shqipërisë ta korrigjojë njoftimin e udhëtarit frëng.

Dy dhjetëvjeçarët e sundimit të Tiranës nga Abdurrahman Bej Toptani (vitet 30-40 të shek. XIX.) përkuan me periudhën e zbatimit të reformave centralizuese me karakter politik, administrativ, financiar, juridik dhe ushtarak, të njohura me emrin Tanzimat, që filloi të ndërmerre Perandoria Osmane gjatë atyre viteve. Megjithatë zbatimi i këtyre reformave në Shqipëri, rrjedhimisht në Tiranë u krye me vonë. Kjo periudhe tranzicioni kur sistemi i degraduar i pashallëkëve ende nuk ishte asgjësuar plotësisht dhe kur sistemi i qeverimit të ri burokratiko-administrativ i Tanzimatit ende nuk ishte konsoliduar, u karakterizua nga një mungesë e theksuar e rendit publik dhe pushtetit juridik, të cilët i dhanë fushë të lirë arbitraritetit dhe anarkisë. Nga ana tjetër sundimi i Tiranës nga Abdurrahman Bej Toptani përkoji me depërtimin më të hovshëm të ligjeve të tregut në ekonominë e trevës, e cila përfshiu edhe tokën bujqësore së bashku me prodhimet e saj. Si rrjedhim që në vitet 30 të shek. XIX me përfshirjen e tokës bujqësore në ekonominë e trevës filloi të ngrihej vazhdimisht edhe çmimi i saj. Të dy këta faktorë - mungesa e rendit ligjor dhe zhvillimi i ekonomisë së tregut - i dhanë shtytje të madhe prirjes për grumbullimin sa më shumë të pronës tokësore, jo vetëm me anën e blerjeve, shpesh herë fiktive, por sa më tepër me grabitje haptazi të tokave bujqësore.

Si në të gjitha trevat bujqësore shqiptare, ashtu edhe në trevën e Tiranës këtë prirje e shfrytëzuan qarqet pushtetore, të cilat këtu përfaqësoheshin




e mëparshme feudale, mbasi njohësi i mirë i Shqipërisë, Hahn, i cili e vizitoi qytetin, më 1850, nuk flet për gërmadha dhe ndërtesa të boshatisura. Ai shkruante se "qyteti i Tiranës dhe fusha e saj më bënë një përshtypje shumë të mirë. Banorët e këtushëm janë shumë punëtorë. Arat, kopshtet dhe pemishtet janë të punuara fare mirë dhe këto të fundit janë të rrethuara me gardhe; njerëzit janë të veshur pastër e mirë". Më 1863, 13 vjet më vonë, Hahn vizitoi përsëri Tiranën dhe "më la - shkruante ai - po atë përshtypje të mirë që më pat lënë, më 1850".

Edhe jeta shoqërore në Tiranë kishte ndryshim nga ajo e mjaft qyteteve të tjera të Shqipërisë. Me gjithë sundimin katër shekullor osman, zakonet dhe fanatizmi oriental turk akoma nuk kishin zënë shumë vend në Tiranë. Në mes të shek. XIX, albanologut Hahn i bëri përshtypje fakti i pranisë së gruas në tregun e qytetit. Në çdo vend të Shqipërisë, gratë e fshatrave shkonin në pazaret e qyteteve, thoshte Hahn-i, por në Tiranë "ajo që më tërhoqi vëmendjen dhe që nuk e kam parë në asnjë vend tjetër, është fakti se gratë myslimane (të qytetit - K.F.), të veshura me kostume qyteti, midis të cilave edhe ndonjë vajzë e re, rrinin në shkallët e xhamive ose gjatë mureve të tyre dhe shisnin plaçka e rroba të vjetra".

Megjithatë nga pikëpamja shoqërore dhe kulturore, Tirana ishte ende një qytet i prapambetur. Nuk kishte një rrjet arsimor modern, por vetëm disa medrese kuranike. Për të shkolluar fëmijët e tyre, familjet e pasura i dërgonin në shkollat e

qyteteve të mëdha të Perandorisë, si në Manastir, Selanik, Stamboll, të cilët ktheheshin në vendlindjen e tyre pasi kishin përfunduar shkollat e mesme. Në ndonjë rast, filluan të frekuentonin dhe shkollat e Perëndimit. Me sa dihet, nxënësi i parë që u shkollua në Perëndim ishte Seit-Sermedin Toptani, djali i tretë i Abdurrahman Bej Toptanit.

Në vitet 40 Seit-Sermedini (në dokumentacionin osman: Mehmet Seit-Sermedin), pasi u arsimua fillimisht në




*Pamje nga muret e shtëpisë-kala të Toptanëve.*

Stamboll, vazhdoi shkollën e mesme në Venedik, ku mori pjesë së bashku me Pashko Vasën në revolucionin çlirimtar kundër zgjedhës austriake. Më 1849, ai u kthye në Stamboll dhe u emërua (pasi fitoi konkursin) sekretar në Divanin Perandorak. Më 1854, shkoi në Paris si sekretar në ambasadën e Perandorisë Osmane, ku zgjeroi horizontin kulturor dhe shkencor. Një vit e gjysmë më vonë u kthye në Tiranë, pastaj shkoi përsëri në Stamboll si sekretar në Divanin Perandorak. Më 1858 i dërgoi qeverisë turke dy peticione. Me njërin kërkonte

Por lulëzimi i mëtejshëm ekonomik, i cili ndërkohë solli pasurimin e mjaft familjeve tregtare, pengohej megjithatë nga prapambetja e vendit, rendi i pasigurt publik, legjislacioni anakronik feudal dhe nga mungesa e rrugëve të komunikacionit.

Në këtë kohë, në Tiranë vihet re që vetë borgjezia e pasuruar mori iniciativë për të lehtësuar rrugët e komunikacionit. Kështu për shembull, esnafi i tabakëve ndërtoi urën në krye të rrugës së Shëngjergjit (sot rruga "Ali Demi"), e cila qëndron edhe sot e paprishur afër urës së re; esnafi i terzive, ndërtoi në krye të rrugës së Elbasanit, një urë mbi përroin e Lanës, e cila më tepër se 70 vjet më parë u prish për t'u zëvendësuar me një urë të re, gjithashtu e zëvendësuar nga ura që ekziston sot. Por ndërtimi më i rëndësishëm që ngritja e urës mbi lumin Erzen, në perëndim të Tiranës, rreth mesit të shek. XIX, nga firma e madhe tregtare "Beshiri", urë që lehtësonte transportin e mallrave midis Tiranës dhe skelës së



*Vendndodhja e Tiranës në hartën e Ballkanit Perëndimor të vitit 1848*

Durrësit. Ura u ndërtua me shpenzime të mëdha, madje dhe me sakrificat njerëzore, sepse familja Beshiri e përfundoi ndërtimin e saj, pasi la të vrrarë disa nga pinjollët e saj.

Qyteti pati dhe ndërtime të tjera në këtë kohë si xhamira dhe mesxhide. Disa nga xhamitë e mëparshme u zbukuruan me piktura artistike. Midis të tjerave me shpenzimet e Abdurrahman Bej Toptanit u restaurua, në vitin 1844 edhe "Xhamia e Vjetër", e ndërtuar më 1614 nga Sulejman Pashë Bargjini, si për të treguar se ai ishte pasardhësi i themeluesit të Tiranës. Xhamia, e cila sot nuk ekziston u zbukurua gjithashtu me piktura.

Më 1856, perandori i Austrisë, Franz Josefi, financoi ndërtimin e kishës katolike në Tiranë, kushtuar Virgjëreshës Mari. Më vonë, më 1874, komuniteti ortodoks i qytetit, me ndihmën e besnikëve të krishterë, ndërtoi kishën kushtuar ungjillëzimit të Virgjëreshës Mari, e cila u zbukurua me piktura artistike.

##### **5. Tirana si qender administrative, shoqërore dhe kulturore**

Me stabilizimin e gjendjes politike, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, Tirana njohu një zhvillim të shpejtë administrativ, shoqëror dhe kulturor. Ajo u shkëput nga sanxhaku i Ohrit dhe vilajeti i Manastirit duke u lidhur administrativisht, gjithnjë si kaza, me sanxhakun e Durrësit të vilajetit të Shkodrës.

Duket se Tirana tashmë i kishte shëruar plagët e shkaktuara nga luftërat

Tiranës në themelimin e vetë Lidhjes së Prizrenit, në qershor të vitit 1878. Banorët e Tiranës u solidarizuan në përgjithësi me programin e organizatës patriotike së Prizrenit. Pas shtypjes së Lidhjes (1881), si kudo dhe në Tiranë lëvizja u zhvillua kryesisht në fushën e kulturës shqiptare. Edhe këtu shkrimi shqip ndalohej nga administrata osmane. Megjithatë ai mësohej fshehtas.

Kështu Tirana mbeti si dhe më parë pa asnjë shkollë shqipe, vetëm me shkollat turke dhe me një shkollë greke, e cila ishte ngritur më 1872. Kjo gjendje vazhdoi edhe më vonë. Sipas Vjetarit turk të vitit 1897, Tirana kishte si kaza (rreth) 27 shkolla fillore, një shkollë qytetëse dhe një medrese, të gjitha në gjuhën turke.

Ndërkohë popullsia e Tiranës vazhdoi të rritej. Të dhënat që kemi për popullsinë e Tiranës janë të ndryshme, pasi nuk ka patur regjistrime të rregullta. Megjithatë asnjëra prej tyre nuk flet për më pak se 12 mijë banorë. Në vitin 1854, Hahn-i shkruante për Tiranën se kishte 2 mijë shtëpi; më 1857, Hecquard-i fliste për 20 mijë banorë; më 1873, Isambert-i gjithashtu për 20 mijë banorë; më 1880, Gopcevic-i thoshte se Tirana kishte 22 mijë banorë; më 1891, Sami Frashëri shkruante në "Kamusulalam" për 17 mijë banorë; më 1901, Degrand-i tregonte se Tirana kishte 25 mijë banorë, ndërsa Galanti, po atë vit për 12 mijë banorë; më 1905, Barbarich-i shënonte për Tiranën si një qytet me 17 mijë banorë; më 1907 Ippen-i fliste për 17 mijë banorë, kurse




*Said Toptani pikturuar me laps nga A. Buza*


sipas regjistrimit turk të vitit 1911, Tirana kishte 15 mijë banorë.

Të dhëna më të hollësishme për gjendjen e Tiranës i kemi në fund të shek. XIX. Vjetari turk për vilajetin e Shkodrës, për vitin 1897, duke bërë fjalë për qytetin e Tiranës, shënojnë se qyteti kishte 638 dyqane, 31 hane, 25 furra, 17 furra tjegullash, 1 fabrikë ullinjsh, 37 kafe e pijetore, 2 hamame, 1 farmaci. Brenda në qytetin e Tiranës kishte selinë e saj, një degë e Bankës Bujqësore osmane (Ziraat bankasi).

Në lëmin e industrisë, Tirana dallohej në prodhimin e mëndafshit, dhe në përpunimin e pëlhurave të hijshme mëndafshi. Një tjetër prodhim i rëndësishëm i qytetit qe vaji. Sipas statistikave turke, në rrethin e Tiranës



*Portikë të hyrjes së shtëpisë-kala të Toptanëve*



hapjen e një shkolle të mesme moderne në Tiranë, duke marrë vetë përsipër, shpenzimet e ndërtimit të saj, dhe me tjetrën, gjithashtu me shpenzimet e veta, ndërtimin e një linje telegrafike që do ta lidhte Tiranën me Shkodrën. Më vonë u internua në Kaukaz deri në fund të viteve 60. Pasi u kthye në Stamboll, ai mori pjesë në mbledhjet bashkë me Konstandin Kristoforidhin, Hoxha Tahsinin, Jani Vreton, Sami Frashërin, Ismail Qemalin, Pashko Vasën, etj., për caktimin e një alfabeti kombëtar të gjuhës shqipe dhe për përhapjen e letërsisë shqiptare.

Më 1877, Seit Toptani u bë anëtar i "Komitetit të Stambollit" (Komiteti për

Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare), i cili nën kryesinë e Abdyl Frashërit, organizoi disa muaj më vonë rezistencën kundër traktatit të Shën Stefanit dhe themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878). Më pas Seiti u internua përsëri në Kaukaz, ku vdiq në vitin 1897. Seiti lidhi miqësi të ngushtë me Abdyl Frashërin, me të cilin lidhi dhe krushqi.

Ndërsa Seit Toptani kontribuoi në historinë e Lidhjes së Prizrenit si anëtar i Komitetit të Stambollit, kushëriri i tij, Sami Bej Toptani (biri i Haxhi Mehmet Pashës, djali i parë i Kapllan Pashë Toptanit), mori pjesë si përfaqësues i



vdiq, më 1948, i mbeti mbiemri Mara-Drita. Reshit Luman Petrela u lidh me pasion pas çështjes kombëtare shqiptare dhe derisa vdiq ai i mbante përherë në gji librat dhe gazetat shqipe. Pionierë të tjerë, të cilët punuan pa u trembur për ta përhapur platformën e luftës kombëtare qenë Ali Kukaleshi, Xhafer Stërmasi, Mahmud Fortuzi, Hasan Bakiu dhe në mënyrë të veçantë Hafëz Ibrahim Dalliu, i cili u bë një nga figurat më popullore të lëvizjes patriotike në Tiranë.

Me përpjekjet e tyre dhe të qindra shokëve të tjerë, lëvizja kombëtare u përhap në Tiranë, në luftë kundër administratës osmane dhe kundër veglave të tyre lokalë. Në mënyrë të veçantë ata patën përballë tyre xhon-turqit, të cilët nën parrullën e luftës kundër absolutizmit të sulltan Hamitit dhe me premtimin e tyre për një perandori osmane demokratike u përpoqën të bënin për vete masat e popullsisë. Këta osmanistë fanatikë me flamurin e islamizmit ekstremist në dorë, të kryesuar nga ideologu i tyre sulltanist Haxhi Aliu dhe në Tiranë të udhëhequr nga myftiu integralist Musa Qazimi, të maskuar si demokratë, propaganduan idetë e kushtetutës dhe në kuadrin e saj luftën kundër bejlerëve, të cilët i identifikuan si bartësit e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe kështu me anën e mashtrimit mundën përkohësisht të bënin për vete një pjesë të borgjezisë së qytetit dhe mjaft fshatarë të rrethit të Tiranës.

Lufta midis patriotëve dhe xhon-turkistëve u acarua pas fitores së

revolucionit xhon-turk të korrikut të vitit 1908, i cili solli në pushtet partinë e tyre "Ittihad ve Terakki". Të nesërmen e shpalljes së kushtetutës, e cila formalisht u garantonte gjithë popujve të Perandorisë lirinë e kulturës kombëtare, patriotët e Tiranës vendosën që në tërë shkollat e qytetit (10 shkolla qytetëse) të futej menjëherë mësimi i gjuhës shqipe. Menjëherë u krijua klubi "Bashkimi" që do t'i shërbente çështjes kombëtare shqiptare. Por pas pak kohe "ittihatçijtë", siç quheshin në Tiranë xhon-turqit, anëtarët e partisë "Ittihad ve Terakki", bashkë me autoritetet qeveritare ndërmorën luftën e ashpër kundër lëvizjes kombëtare shqiptare. Ata mallkuan shkronjat shqipe, i dënuan patriotët shqiptarë si armiq dhe njerëz të shitur te bejlerët, përdorën më në fund edhe terrorin. Ky terror arriti kulmin gjatë ekspeditave të gjeneralit turk Shefqet Turgut Pashës, i cili në pranverën e vitit 1910, në krye të 80 bataljoneve e shkeli Shqipërinë me zjarr e me hekur. Bataljonet e Shefqet Turgutit shkelën edhe Tiranën, shpallën këtu shtet-rrethimin dhe shpërthyen në një terror që qyteti nuk e kishte parë deri atëhere asnjë herë. Ato shpallën shtet-rrethimin. Nën preteksin e mbledhjes së armëve, ato bastisën shtëpitë e patriotëve shqiptarë, sipas listave të përgatitura nga ittihatçijtë, arrestuan qindra vetë nga qyteti e nga fshatrat e Tiranës. Shumë prej këtyre patriotëve, të cilëve u gjetën letra, libra e gazeta shqip, pasi ua lidhën këmbët e duart, në prani të grave e fëmijëve të tyre si dhe përpara bashkëqytetarëve të tjerë, i rrahën rëndë në mes të rrugës, i fyen me fjalë të rënda, i kërcënuan me varje, i

kishte gati 140 mijë rrënjë ullinj të rregjistruar, produktet e të cilave përpunoheshin në 407 mullinj primitivë vaji dhe një fabrikë të re. Rrethi i Tiranës ishte një nga rrethet e pakta të Shqipërisë, ku importimet balancoheshin pak a shumë me eksportimet e jashtme.

#### 6. Tiranë gjatë peirudhes së Rilindjes dhe Pavaresise

Në dhjetëvjeçarën e fundit të shek. XIX, në Tiranë filluan të përhapen librat dhe gazetat shqip që botoheshin jashtë kufijve të Perandorisë Osmane. Në fillim të shek. XX, lëvizja mori përpjestime të gjëra. Në krye të lëvizjes tani qëndronin dy djemtë e Seit Toptanit - Murati dhe Refiku, të cilët iu kundërvunë

administratës osmane, madje edhe ndaj kushëririt të tyre, Esad Pashë Toptanit, pasardhësi të djalit të tretë të Kapllan Pashës, i cili i lidhur verbërisht pas sulltanit kryente grabitje dhe dhunime në radhët e popullsisë qytetare. Radhët e aktivistëve patriotë u shtuan me militantë të rinj që vinin nga shtresat e gjëra të popullsisë qytetare.

Më 1902, u hap këtu shkolla e parë shqipe, me mesues Filip Ashikun, të cilën e ndoqën nxënës të tre besimeve. Mustafa Mara ishte një nga militantët e shquar të luftës për çlirimin nacional; ai shpërndante me guxim gazetën shqipe "Drita" që botohej në Sofje nga Shahin Kolonja, dhe për këtë arsye atij, derisa



Një grup patriotësh dhe iluministësh Tiranës, nga e majta në të djathtë: Mustafa Drita (Mara), Beqir Luga, Isuf Elezi, Qamil Biçaku, Hafiz Ibrahim Dalliu, Emrulla Struga, Mahmut Fortuzi, (foto marrë nga libri Qyteti i Tiranës botuar nga A. Bakiu e 1998)

Por më 28 nëntor, kur në Vlorë, bashkë me delegatët e gjithë Shqipërisë edhe përfaqësuesit e Tiranës shpallën Pavarësinë Kombëtare, ushtritë serbe hynë në qytet duke vendosur këtu zgjedhën e okupacionit ushtarak të huaj.

### 7. Tirana ne periudhen 1912-1920

Me gjithë shpalljen e Pavarësisë Kombëtare dhe njohjen e saj nga shtetet e mëdha të Europës, si gjithë qytetet e Shqipërisë edhe Tirana nuk e gëzoi dot menjëherë lirinë dhe pavarësinë. Okupacioni ushtarak serb vazhdoi në Tiranë disa muaj, derisa u caktuan në parim kufijtë e Shqipërisë. Pas largimit të ushtrive serbe, Tirana dhe rrethi i saj nuk mundi të bashkohet me qeverinë shqiptare të Vlorës, të kryesuar nga Ismail Qemali, sepse Esad Pashë Toptani, një aleat i xhon-turqve, shpalli në Durrës një qeveri separatiste ndaj qeverisë së Vlorës, që u quajt qeveria e Shqipërisë së Mesme. Kjo qeveri përfshiu në juridiksionin e saj edhe qytetin e Durrësit.

Përveç tronditjes që pësuan patriotët shqiptarë nga shkëputja e Tiranës prej qeverisë kombëtare të Vlorës, Tirana, në vjeshtën e vitit 1913 u trondit dhe nga ngjarjet dramatike që shkaktuan muhaxhirët.

Muhaxhirët ishin refugjatët dibranë, të cilët për të shpëtuar nga terrori i egër i qeverisë së Beogradit që shpërtheu mbi ta, pas shtypjes së kryengritjes antiserbe në shtator të vitit 1913, braktisën shtëpitë e tyre, pa mundur të merrnin gjë me vete. Një pjesë e tyre kishte kërkuar strehim në Elbasan, Durrës dhe pjesa tjetër në Tiranë.



*Murat Toptani veshur me kostum popullor*

Në mars të vitit 1914, me ardhjen e princit Wied, si sovran i Shqipërisë dhe me caktimin e Durrësit si kryeqytet, si qeveria e Ismail Qemalit, ashtu dhe ajo e Esad Pashë Toptanit dhanë dorëheqjen. Por Esad Pasha nuk e humbi pushtetin. Ai zuri një pozitë me rëndësi në qeverinë e princit Wied (si ministër i Punëve të Brendshme dhe si ministër i Mbrojtjes Kombëtare). Esad Pashë Toptani, përveçse i stigmatizuar si "tradhtar" nga qarqet patriotike, për shkak të dorëzimit nga ana e tij të Shkodrës, për përfitime personale, forcave ushtarake malazeze,

brodhën të lidhur nëpër rrugët e Tiranës, i detyruan të fshinin rrugët dhe sheshet e qytetit. Pas disa ditësh, 22 qytetarë dhe 40 fshatarë u nisën në Elbasan për t'u gjykuar nga gjyqi i jashtëzakonshëm ushtarak i ngritur në atë qytet. Gjyqi u dha dënime të rënda të pandehurve, vetëm sepse kishin mbajtur libra në gjuhën shqipe. Ibrahim Dalliu, Mustafa Mara, Mahmud Fortuzi e të tjerë u dënuan me nga 10 vjet burg. Refik Fortuzi u dënua në mungesë me 15 vjet burg, sepse në shtëpinë e tij u gjet vepra e Sami Frashërit, "Shqipërija ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?".

Terrori vazhdoi edhe pas largimit të korp-armatës, të ashtuquajtur "paqëtuese" të Shefqet Turgut Pashës. Me gjithë terrorin lufta e qytetarëve të Tiranës për të drejtat kombëtare mori përpjestime më të gjëra. Kryengritjet e mëdha që shpërthyen në tërë Shqipërinë, në vitet 1911 dhe 1912, patën jehonën e tyre edhe në Tiranë.

Në verën e vitit 1912 u formuan nga qytetarët e Tiranës, dy çeta kryengritëse, të cilat vepruan, njëra në afërsitë e Krujës dhe tjetra në afërsitë e Durrësit. Ato ranë në përpjekje me ushtritë turke.

Ndërkohë, në tetor të vitit 1912, plasi Lufta e Parë Ballkanike; shtetet aleate ballkanike: Serbia, Greqia, Bullgaria dhe Mali i Zi, duke luftuar kundër ushtrive turke, filluan të hynin edhe në territorin e Shqipërisë. Ndërsa ushtritë malazeze u mbërthyen në dyert e Shkodrës, ushtritë serbe, duke kaluar nëpër Kosovë, hynë në viset verilindore të Shqipërisë dhe

zbritën në jug, në drejtim të Tiranës e të Durrësit. Në të njejtën kohë, ushtritë grreke nga jugu filluan marshimin nëpër Çamëri, rrethuan Janinën dhe marshuan drejt viseve jugore të Shqipërisë së sotme.

Në kohën kur rridhnin këto ngjarje, në nëntor të vitit 1912, një grup patriotësh të kryesuar nga Ismail Qemali, kishin lajmëruar tërë qytetet dhe krahinat e Shqipërisë, të zgjidhnin e të dërgonin sa më shpejt delegatët e tyre në qytetin e Vlorës, për të marrë pjesë në kongresin kombëtar që do të zgjidhte fatin e Shqipërisë dhe të shpallte Pavarësinë Kombëtare të atdheut. Por për qytetin e Tiranës koha nuk priste, sepse ushtritë serbe pushtuan, më 25 nëntor, Krujën dhe trokitën në dyert e saj.

Përballë presionit të madh të ushtrive serbe, më 26 nëntor të vitit 1912, tri ditë pasi Tirana kishte nisur delegatët e saj (Abdi Toptanin dhe Murat Toptanin) në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, populli i Tiranës, në një miting të organizuar nga patriotët tiranas, në sheshin përballë nënprefekturës (sot sheshi përpara ndërtesës së vjetër të Bibliotekës Kombëtare) vendosi shpalljen e Pavarësisë, si solidarizim paraprak me vendimin që do të merrte (të cilin në fakt e mori dy ditë më vonë) Kuvendi i Vlorës. Vendimin e saj, Tirana ua njoftoi me telegrame qyteteve të tjera të Shqipërisë, duke i ftuar dhe ato të ndiqnin shembullin e saj. Njëkohësisht u njoftua komanda e ushtrive serbe në Krujë për të mos e shkelur qytetin, ku nuk kishte asnjë ushtri turke dhe ku në vend të flamurit të Perandorisë Osmane valonte flamuri kombëtar shqiptar.




Princ Wied-i u largua nga Shqipëria më 3 shtator 1914. Por qetësia në Tiranë nuk u vendos. Pas largimit të Wied-it u kthye nga mërgimi Esad Pashë Toptani, në tetor. Me vendosjen e tij në Durrës shpërtheu lufta për pushtet midis xhon-turkistëve dhe esadistëve. Në frontin e xhon-turkistëve ishte rreshtuar dhe Haxhi Qamili, një fshatar nga fshati Sharrë i Tiranës, një fanatik islamik, i cili kishte fiksacionin se fatkeqësitë e fshatarëve do të vinin nga shkëputja e vendit nga Turqia islame dhe nga bejlerët që ishin larguar prej saj. Periudha njëvjeçare e këtyre trazirave (maj 1914 - qershor 1915), e cila tashmë ka marrë emrin viti "i mbrapshtë" i historisë së Shqipërisë, mori fund me shtypjen e lëvizjes xhon-turkiste nga ushtritë serbe dhe me rivendosjen në Tiranë të pushtetit të Esad Pashë Toptanit, i cili nuk vazhdoi gjatë. Gjashtë muaj më vonë, në janar të vitit 1916, Tirana, e sfillitur gjatë vitit "të mbrapshtë" dhe nga arbitraritetet e Esad Pashë Toptanit, u pushtua së bashku me gjithë Shqipërinë Veriore dhe Qendrore nga ushtritë austro-hungareze.

Pushtimi serb mori fund. Në Tiranë u vendos gjendja e okupacionit ushtarak austro-hungarez.

Me shtrirjen e okupacionit austro-hungarez edhe në Dibër, muhaxhirët dibranë u kthyen në shtëpitë e tyre. Në janar të vitit 1917, qeveria austro-hungareze e zbuti administratën ushtarake të okupacionit në bazë të premtimit se do ta njihnte në mbarim të luftës rimëkëmbjen e shtetit shqiptar. Ajo ngriti një administratë civile, të përbërë

nga nëpunësa shqiptarë. Organet më të larta të kësaj administrate u quajtën drejtorira, të cilat kishin funksione dikasteriale pa qënë dikastere ministrore, gjithnjë nën vëzhgimin e rrjetit ushtarak të korp-armatës austro-hungareze me selinë qendrore në Shkodër. Edhe pse nën vëzhgimin ushtarak austro-hungarez, administrata civile pati karakter shqiptar. Nëpunësit qënë shqiptarë. Drejtoria e arsimit hapi në mjaft vise shkolla shqipe. Nga këto masa, të cilat sadopak e zbutën regjimin e okupacionit, administrata austro-hungareze u distanca nga xhon-turkistët dhe esadistët. Ajo u mbështet te patriotët shqiptarë, ndonëse figurën e tyre më të spikatur, Murat Toptanin, e mbajti si "mysafir" në Vjenë.

Okupacioni austro-hungarez vazhdoi deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore, kur Austro-Hungaria humbi luftën. Madje që në muajin tetor të vitit 1918, ushtritë e saj u tërhoqën nga Shqipëria. Vendin e tyre në Tiranë e zunë menjëherë ushtritë italiane, të cilat qënë rreshtuar në anën e fuqive fitimtare.



*Mbërritja ceremoniale e Princ Wied në Shqipëri, foto nga Marubi*



*Esad Pasha, foto nga Marubi*

në mars të vitit 1913, akuzohej gjithashtu për lidhjet e fshehta që mbante me qeveritë serbe dhe greke. Madje me këto lidhje shpjegohej dhe formimi i qeverisë separatiste të Shqipërisë së Mesme, për t'u lënë mundësi Beogradit dhe Athinës të realizonin lakmitë e tyre në Shqipërinë veriore dhe jugore. Krijimi i qeverisë së princ Wied-it, e mbushur me bejlerë çifligarë, shkaktoi pakënaqësi në masat popullore të Shqipërisë së Mesme.


Këtë pakënaqësi mundën ta shfrytëzonin në fillim armiqtë e kombit shqiptar, siç qënë mbeturinat e partisë xhon-turke në Shqipëri dhe vetë Esad Pashë Toptani, i cili vazhdoi ta ruante aleancën me ta. Xhonturqit kërkonin të rikthenin sundimin osman në Shqipëri,

kurse Esad Pashë Toptani synonte ta merrte vetë pushtetin në dorë. Ata shfrytëzuan në njëfarë mase prapambetjen e shtresave të ulta të popullsisë dhe ndjenjat e saj fetare, duke e paraqitur princin e krishterë Wied si përfaqësuesin e forcave europiane antiislamike dhe si përkrahësin e bejlerëve çifligarë të urryer ndaj tyre. Ata mundën të organizonin (njëkohësisht me përkrahjen e fshehtë të Esad Pashës), në maj të vitit 1914, kryengritjen kundër sovranit të huaj dhe qeverisë së Durrësit. Me shpresën se do të shtypej kryengritja, forcat patriotike, të grumbulluara në Durrës, arritën ta detyronin Esad Pashë Toptanin të jepte dorëheqjen nga qeveria dhe të largohej nga vendi.

Kryengritja, drejtimin e së cilës tashmë e kishin xhon-turkistët, nuk u shtyp, përkundrazi e kombinuar me provokacionet ushtarake serbe dhe greke, pastaj me situatën e ndërlikuar që u krijua me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore (4 gusht 1914), u shtri në mbarë Shqipërinë e Mesme.

Ngjarjet dramatike të "kryengritjes antividiste", Tirana i përjetoi me dhimbje të madhe. Për shkak të kryengritjes gjendja ekonomike u këqesua tej mase, pasi u ndërpreu marrëdhëniet me skelën e Durrësit dhe me krahinat e tjera. Muhaxhirët, kur shpërtheu kryengritja, ende nuk ishin kthyer në vatrat e tyre. Në kohën kur patriotët merreshin me sistemimin e tyre, shpërtheu mbi ta terrori i egër i xhon-turkistëve. Si në të gjitha viset ku u shtri kryengritja edhe në Tiranë, patriotët shqiptarë u persekutuan, nga të cilët disa u burgosën dhe disa u arratisën.

Shqipërisë. Në marrjen e këtij vendimi luajtën rol një sërë faktorësh politikë, gjeografikë, shoqëror e urbanistikë. Së pari, në atë kohë Tirana ishte një nga qytetet e pakta në Shqipëri që nuk kishte ushtri të huaja; ushtritë italiane qenë larguar nga qyteti kohë më parë. Së dyti, Tirana ishte në qendër të Atdheut. Së treti, Tirana nëpërmjet portit të Durrësit ishte më afër kontakteve me botën e jashtme. Ajo ishte e lidhur me linja telegrafike, gati me tërë viset e Atdheut. Së katërti, Tirana ishte një qytet i madh që mund t'i plotësonte nevojat qeveritare për ndërtesat administrative dhe për banesat e nëpunësve. Së pesti, Tirana kishte qarqe patriotike të vendosura për të përballuar synimet e Esad Pashë Toptanit, i cili edhe pse ndodhej në mërgim po organizonte një aksion të armatosur për të shtënë në dorë qytetin dhe për të realizuar synimet e tij antikombëtare.



*Pamje nga ceremonia e fillimit të punimeve të Parlamentit më 1920 (foto marrë nga libri Qyteti i Tiranës botuar nga A.Bakiu e 1998)*

Rol luajti, më në fund, edhe ftesa e qytetarëve të Tiranës për të patur në gjirin e tyre qeverinë e Kongresit të Lushnjes. Në bazë të këtij vendimi qeveritar, më 11 shkurt 1920, qeveria shqiptare së bashku me Këshillin e Lartë dhe Këshillin Kombëtar (Senatin) hyri në Tiranë, të pritur me brohori nga populli i qytetit, tashmë kryeqytet i përkohshëm deri në janar të vitit 1925, kur u bë me kushtetutë, kryeqytet i përhershëm i Shqipërisë.

Largimi i ushtrive austro-hungareze, i la pas Tiranës një dëm të madh financiar. Ato e kishin mbushur qytetin me kartmonedhat e tyre (korona), të prekura nga një inflacion i thellë, si pasojë e të cilit fundi i luftës solli zhvlerësimin total të tyre. Veç kësaj situata e re, që u krijua me fitoren e Antantës, krijoi një shqetësim të jashtëzakonshëm politik rreth fatit të Atdheut. Shqetësimi buronte nga synimi i fuqive të Antantës për të vënë në jetë Traktatin e fshehtë të Londrës, të nënshkruar prej tyre, në prill të vitit 1915. Në bazë të këtij traktati, Serbia dhe Greqia do të aneksonin pjesën veriore dhe jugore të Shqipërisë. Italia do të aneksonte Vlorën së bashku me hinterlandin e saj dhe ishullin e Sazanit. Pjesët që do të mbeteshin, afërsisht Shqipëria e sotme Qendrore (përfshirë këtu dhe Tiranën), do të formonin një principatë shqiptare, e cila do të hynte nën protektoratin e Romës.

Përmbajtja e Traktatit shkaktoi një indinjatë të thellë si kudo në Shqipëri edhe në Tiranë. Për t'i bërë ballë rrezikut, patriotët shqiptarë vendosën të mbledhnin në Tiranë, më 11 janar 1919, një kongres kombëtar. Por Roma, e cila dyshonte në synimet antiitaliane të kësaj iniciative, u doli punëve përpara. Me ndihmën e disa personaliteteve shqiptarë të lidhur pas saj (Mehmet Konica, Myfit Libohova, Fejzi Alizoti, Mehdi Frashëri, Mustafa Kruja, Preng Bibdoda), të cilët preferonin më mirë një Shqipëri të tërë nën protektoratin e Italisë sesa të copëtuar sipas Traktatit të Londrës, organizoi me shpejtësi mbledhje, dy javë përpara, kongresi në Durrës. Nisma për Kongresin e Tiranës

dështoi. Megjithatë patriotët tiranas nuk iu kundërvunë qeverisë së Durrësit, përderisa ajo ishte kundër Esad Pashë Toptanit. Por nga ana ata tjetër as nuk u solidarizuan me të, përderisa ajo mbronte platformën e një Shqipërie nën protektoratin e Italisë. Por shpejt u pa se platforma politike e qeverisë së Durrësit ndeshi në kundërshtim jo vetëm në opinionin shqiptar, por edhe në forcat kryesore ndërkombëtare, në radhë të parë të Anglisë dhe Francës, të cilat nuk donin që nga "torta" shqiptare të përjashtoheshin Jugosllavia me Greqinë dhe të përfitonte vetëm Italia. Në këto rrethana, patriotëve shqiptarë u erdhi një sinjal pozitiv nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, W. Wilson, i cili deklaroi në Konferencën e Paqes në Paris se nuk do të njihte asnjë traktat që nuk e kishte nënshkruar SHBA, pra as Traktatin e Londrës. Patriotët shqiptarë të inkurajuar nga kjo deklaratë mbledhën me ngutësi një kongres të ri kombëtar në Lushnje. Më 28 janar 1920, kongresi e shpalli të rrëzuar qeverinë e Durrësit. Ai vendosi të mos e njihte Traktatin e Londrës. Shpalli gjithashtu se do të luftonte për të realizuar pavarësinë e plotë të Shqipërisë dhe të ruante integritetin e saj tokësor me kufijtë e caktuar në vitin 1913. Për të realizuar këtë program revolucionar, Kongresi i Lushnjes ngarkoi një qeveri të re, nën kryesinë e Sulejman Delvinës.

Kongresi i Lushnjes pati një rëndësi vendimtare për të ardhmen e Tiranës. Më 9 shkurt 1920, qeveria e Sulejman Delvinës mori vendim që selinë e saj ta vendoste në Tiranë dhe Tirana përkohësisht të ishte kryeqyteti i



vitin 1921. Lufta e ardhshme politike midis këtyre partive dhe përplasja në kryeqytet e problemeve të mprehta që shqetësonin mbarë vendin ndikuan në zhvillimin më të shpejtë të qytetarëve tiranas. Në kryeqytet u bë polarizimi në shkallë kombëtare i dy fronteve politike antagoniste të Shqipërisë - nga njëra anë i forcave konservatore bejlerë çifligare, nga ana tjetër i forcave demokratike liberale, me pjesëmarrjen e këtyre dy drejtimeve të personaliteteve më të spikatura të shoqërisë shqiptare. Shumica e banorëve të Tiranës anuan nga rreshtimi i demokratëve liberalë. Në këtë front u rreshtuan dhe patriotët tiranas që kishin luftuar kundër xhon-turkistëve dhe esaditëve. Për këtë arsye lufta politike për përmbysjen e sundimit të bejlerëve dhe për demokratizimin e vendit u ashpërsua në kulm.

Në Tiranë e pati selinë e vet edhe organizata demokrate-revolucionare "Bashkimi", e themeluar nga Avni Rustemi (më 1922), e cila pati përkrahjen e masave të gjëra të kryeqytetit. Organi i shoqatës së Avni Rustemit, me emrin gjithashtu "Bashkimi", pati si drejtor përgjegjës të riun intelektual tiranas, Masar Këlliçin. Nga radhët e banorëve të Tiranës lindën dhe organizata të tjera demokratike si "Xhoka", etj. Kjo luftë, siç dihet, u kurorëzua me triumfin e revolucionit demokratiko-liberal të qershorit, më 1924, të kryesuar nga Fan Noli.

Me përmbysjen e qeverisë demokratike të F. Nolit (dhjetor 1924), si për gjithë Shqipërinë, ashtu dhe për Tiranën, filloi

periudha e sundimit të Ahmet Zogut, i cili në fillim, në janar të 1925, u shpall kryetar i Republikës Presidenciale dhe më vonë, në tetor të 1925, mbret i Monarkisë Kushtetuese të Shqipërisë.

Në fillim të periudhës zogiste, Tirana ishte një qytet me tipare urbanistike mesjetare, ku dominonte zejtaria e thjeshtë tepër e copëzuar. Nuk kishte asnjë fabrikë moderne. Sipas regjistrimeve zyrtare të kryera, më 1927, Tirana kishte pak fabrika të vogla me fuqi motorike të ulët (5 fabrika mielli me 13 punëtorë). Në qytet dominonin zejtaritë e prodhimit (zejtari të punimit të metalit, të veshmbathjeve, të prodhimeve ushqimore e zejtari të ndryshme), pronë e mjeshtrave që e kryenin vetë prodhimin, disa nga të cilët kishin 1, 2 ose 3 çirakë (gjithsej 1321 njësi prodhimi dhe 1738 punëtorë). Po ashtu kishte 54 njësi tregtare me 140 shegertë (shitësa të artikujve ushqimorë, të pëlhurave, stofrave, etj). Veç këtyre kishte 24 hotele dhe hane. Në qytet kishte 85 vetura, kurse për shërbimet urbane dhe transportin e mallrave kishte 214 karroca e qerre. Më në fund kishte 65 njësi për të vogla që shërbenin si kafene.

Qyteti i Tiranës u pajis, dy vjet më vonë, me një central elektrik me kapacitet tepër të kufizuar, i cili erdhi duke u rritur.

Tirana filloi ta ndryshojë përmbajtjen ekonomike, jetën shoqërore dhe strukturën e saj urbanistike, gjatë viteve 30. Në të vërtetë, gjatë viteve 30 për shkak të përfshirjes së Shqipërisë në krizën ekonomike botërore të atyre viteve, zhvillimi i industrisë që shumë i

#### 8. Tirana ne periudhen 1920-1939

Me caktimin e Tiranës kryeqytet të Shqipërisë merr fund historia e Tiranës si qytet, histori të cilën deri atëhere e kishin ndërtuar vetëm banorët e saj. Me caktimin e saj si kryeqytet, me vendosjen e organeve të larta të shtetit, me popullimin e saj me banorë nga vise të tjera të Atdheut, historia e Tiranës dalngadalë filloi të shkrihej me historinë e shtetit shqiptar. Që tani e tutje çdo gjë ndryshoi në jetën politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të Tiranës. Tirana filloi të bëhej qyteti më përfaqësues i kombit shqiptar, ku krahinat e ndryshme të vendit, kush më pak e kush më shumë, i dhanë kryeqytetit kontributin e tyre në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe urbanistike. Megjithatë, të

paktën për dy dhjetëvjeçarë të ekzistencës së saj si kryeqytet, kontributi i banorëve të lashtë të qytetit, zuri një vend përsëri të rëndësishëm.

Nga pikëpamja administrative, Tirana kur u bë kryeqytet ishte ende nënprefekturë e prefekturës së Durrësit. Ajo u bë prefekturë me vete, më 1922.


Më 1923 Tirana kishte 12 453 banorë; më 1930 rreth 31 mijë banorë; më 1938 mbi 38 mijë banorë. Me caktimin si kryeqytet, Tirana filloi të dilte nga karakteri i mëparshëm i mbyllur. Po ashtu filloi të ndryshojë mentaliteti lokal i banorëve të saj. Një ndikim të veçantë ushtruan partitë politike të spektrit shqiptar që u formuan në Tiranë që në



*Një grup i famshëm deputetësh i Parlamentit të parë të Shqipërisë, mes tyre Ahmet Zogu dhe Fan Noli.*

shoqërore. Me dekret mbretëror (më 1937) gratë u ndaluan të mbanin ferexhe mbi fytyrë dhe burrat feste të zeza mbi kokë, të trashëguara nga sundimi osman, si shenjë e modernizimit të jetës shqiptare. Nga poshtë bartësit e lëvizjes përparimtare shoqërore u bënë intelektualët e rinj, të arsimuar në shkollat e mesme të vendit dhe në shkollat e larta jashtë Shqipërisë dhe të vendosur në kryeqytet. Në mënyrë të veçantë, pas vitit 1934, në Tiranë u duk një gjallërim, pa ndihmën e shtetit, i jetës kulturore dhe i veprimtarisë artistike. Filluan shfaqjet teatrale, u organizuan koncerte artistike, u zgjerua rrjeti i klubeve sportive, etj. Ky gjallërim u pasqyrua edhe në botime organesh kulturore shtypi, në mënyrë të veçantë në debatet politike, filozofike, sociologjike, artistike e kulturore që u botuan nga këto organe. Krahas organeve të mëparshme, të cilat dilnin në Shkodër ("Hylli i Dritës" dhe "Leka") dhe në Korçë ("Bota e Re"), tribuna të rëndësishme të këtij zhvillimi u bënë organet që u botuan në këto vite në Tiranë ("Illyria" dhe "Përpyekja Shqiptare").

Në të njejtën kohë, një zhvillim të madh pati dhe lëvizja shoqërore punëtore. Në radhët e kësaj lëvizjeje morën pjesë punëtore e intelektualë, të ardhur nga të gjithë viset e Shqipërisë, kurse nga gjiri i banorëve tiranas u shquan si organizatorë sindikalistë dhe si aktivistë demokratë në mënyrë të veçantë Hasan Reçi, Hamdi, Shijaku, Hamid Mëzezi. Pikërisht në kuadrin e lëvizjes punëtore dhe studentore u përhapën idetë komuniste. Në përhapjen



*Paradë festive me rastin e 25 vjetorit të Pavarësisë më 1937*

e tyre ndikuan lëvizjet ndërkombëtare antifashiste që u zhvilluan në emër të Frontit Popullor në Europën Perëndimore, kryesisht në Francë e në Spanjë. Ndonëse këto ide qenë të ndaluara nga legjislacioni i monarkisë dhe ndiqeshin nga organet e policisë, ato u përqaftuan nga disa qarqe, të cilat në emër të klasës punëtore organizuan celula komuniste, të lidhura disa me organizatën komuniste të Korçës, disa me atë të Shkodrës. Tirana ndoqi me interes procesin gjyqësor të zhvilluar në kryeqytet, në janar 1939, kundër 72 "komunistëve" të Shqipërisë, ndër të cilët kishte dhe intelektualë dhe punëtore tiranas.

Më në fund banorët e Tiranës qenë ndër të parët që u ngritën në këmbë, që në ditën e parë të muajit prill 1939, për të protestuar sapo u përhapën lajmet që Roma po përgatiste agresionin ushtarak fashist kundër Shqipërisë. Për ditë me radhë të rinjtë e kryeqytetit manifestuan nëpër rrugë duke kërkuar armë për të luftuar vullnetarisht në Durrës kundër

ngadalshëm. U ngritën vetëm disa fabrika të pakta që përpunonin si lëndë të parë prodhimet bujqësore të vendit: fabrika mielli, vaji, sapuni, duhani, druri (zdrukthëtari), fabrika tullash etj. Ritmet e zhvillimit të industrisë u dukën pas vitit 1934, pasi u kapërcye represioni në ekonominë botërore. Më 1938, Tirana kishte 2 termocentrale (njëra me kapital shqiptar, tjetra me kapital të huaj), 2 fabrika të mëdha dhe 3 fabrika të vogla mielli, 1 sharrë mekanike, 1 fabrikë moderne tullash, 6 shtypshkronja, 1 fabrikë akulli, 1 fabrikë sapuni dhe një varg punishtesh të vogla. Atë vit (1938), në Tiranë u ngrit radio-trasmetuesi i parë shqiptar me emisione të kufizuara.



*Mbreti Zog I*

Gjatë viteve 30, Tirana pësoi ndryshime të mëdha në fushën e urbanistikës. Përse u përket ndërtesave private të banimit, ato u zhvilluan në dy drejtime: njëri në hapësirën e Tiranës së vjetër, tjetri në hapësirën e pabanuar deri atëhere që shtrihej në anën jugperëndimore të kryeqytetit që u quajt Tirana e re. Kjo hapësirë (Tirana e re) deri atëhere pronë shtetërore, u nda në parcela, të cilat iu shitën me çmime të favorshme funksionarëve të shtetit shqiptar. Në këtë pjesë filluan të ndërtoheshin shumë shpejt vila moderne banimi me rrugë të drejta, sipas planit rregullues, detyrimisht të paktën me dy kate. Përkundrazi Tirana e vjetër mbeti ashtu siç ishte, me ndryshime të pakta urbanistike, vendi i punës dhe i banesës së qytetarëve. Kështu dalngadalë dallimi midis dy Tiranave filloi të bëhej gjithnjë e më tepër i theksuar.

Megjithatë gjatë viteve 30 u ndërtuan një mori godinash të reja private. Gjatë kësaj periudhe në Tiranë nuk u ndërtua asnjë vepër e mirëfilltë artistike, asnjë monument i historisë kombëtare, por vetëm një bust: ai i major Llesh Topallajit, adjutant i Zogut që u vra në Vjenë, më 1930, kur iu bë atentat mbretit. Veç kësaj, kryeqyteti i Shqipërisë nuk kishte as furnizime me ujë të pijshëm (ujësjellsa), as kanalizime për ujra të zeza, as rrugë të shtruara në asfalt (me përjashtim të Bulevardit të madh). Nëpër lagjet e qytetit mbisundonin shtëpitë e ndërtuara me qerpiç e jo me tulla.

Gjatë viteve 30, Tirana pati një zhvillim shumë të shpejtë të jetës




drejtimit të lëvizjes. Banorët e kryeqytetit e filluan luftën çlirimtare kundër okupacionit me shpërthime herë pas here të demonstratave antifashiste, të cilat paguheshin me arrestime dhe jo rrallë me dëshmorë të vrarë nga organet policore. Një hov të madh mori lëvizja pas nëntorit 1941, kur në Tiranë grupet e mëparshme marksiste u shkrinë në një parti të vetme - në Partinë Komuniste Shqiptare (PKSH), e cila në vend të programit të revolucionit socialist miratoi platformën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) për t'i kthyer Atdheut pavarësinë dhe për të vendosur këtu një demokraci popullore. Si rrjedhim me anën e këtij programi PKSH fitoi shumë shpejt rolin e organizatorit kryesor të rezistencës antifashiste brenda dhe jashtë Tiranës. Për të tërhequr forcat e ndryshme patriotike jo marksiste në frontin e rezistencës antifashiste, PKSH organizoi në Pezë, një fshat pranë kryeqytetit, një konferencë të posaçme. Konferenca e Pezës, si kuvendi i parë pluralist miratoi programin e përbashkët të forcave politike antifashiste shqiptare: bashkimin e popullit shqiptar pa dallim feje, krahine dhe ideje, luftën pa kompromis me armikun deri në çlirimin e Atdheut dhe vendosjen në Shqipëri pas çlirimit të vendit të një regjimi demokratik përparimtar.

Platforma e Konferencës së Pezës, megjithëse nuk u miratua nga një pjesë e demokratëve liberalë, e shumëfishoi hovin e luftës çlirimtare, e cila deri atëhere zhvillohej me anë të protestave, mitingjeve, njësiteve guerile në qytete dhe të çetave të armatosura në fshatra. Tani

e tutje filluan të organizoheshin formacione të mëdha ushtarake, siç ishin batalionet partizane, më 1942; më 1943, brigadat sulmuese partizane; më 1944, divizionet dhe korp-armatat e tyre, të cilat drejtoheshin nga një shtab i vetëm - nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, i themeluar në Labinot, më 10 korrik 1943. Në ngritjen e këtyre formacioneve, banorët e Tiranës kontribuan jo vetëm me militantë, por edhe me kuadro. Një jehonë të pashuar dhanë militantët antifashistë të Tiranës, të cilët dhanë jetën që në vitin 1942 duke luftuar heroikisht në kryeqytet, siç ishin Qemal Stafa (5 maj 1942), Misto Mame (6 gusht 1942), Vojo Kushi, Sadik Stavaleci, Xhorxhi Martini (10 tetor 1942), etj.

LANÇ-i vazhdoi të rritej e të zgjerohej akoma më tepër edhe gjatë okupacionit gjermano-hitlerian. Deklaratat e hitlerianëve se do ta njihnin pavarësinë e Shqipërisë, se pushtimi ushtarak do të ishte i përkohshëm, i diktuar nga nevojat e luftës kundër koalicionit anglo-sovjeto-



*Pamje e luftës për çlirimin e Tiranës, pikturë në vaj nga A. Buza*

agresorëve të huaj. Por ngjarjet rrodhën shumë shpejt. Më 6 prill 1939, "Mbret i shqiptarëve", Ahmet Zogu u largua së bashku me qeverinë nga Shqipëria. Të nesermen (më 7 prill 1939) filloi agresioni fashist me zbarkimin e ushtrisë italiane në brigjet e Shqipërisë. Por rezistenca shqiptare u thye shpejt përballë forcave superiore fashiste. Më 8 prill 1939, ato hynë në Tiranë. Filluan kështu për Tiranën dhe për Shqipërinë vitet e pushtimit fashist italian, të cilat në shtator të vitit 1943 u pasuan nga periudha e pushtimit gjermano-hitlerian.

#### **9. Tirana në periudhën prill 1939- nëntor 1944**

Me pushtimin nga Italia fashiste, Shqipëria e humbi pavarësinë e saj. Roma u mundua të tregonte se ky pushtim nuk do të cenonte pavarësinë, por do të sillte vetëm ndryshimin e regjimit. Për këtë qëllim Asambleja e organizuar në Tiranë prej qeveritarëve të Romës shpalli, më 12 prill 1939, se Shqipëria do të vazhdonte të ishte shtet me vete, por e bashkuar me Italinë nën kurorën e Viktor Emanuelit III, i cili do të quhej "mbret i Italisë dhe i



*Harku i Triumfit fashist në Tiranë*

Shqipërisë dhe perandor i Etiopisë". Por ky akt u prit si demagogji nga shumica e popullit shqiptar. Kështu me pushtimin italian të Shqipërisë, opinioni shqiptar u nda në dy fronte - në "bashkëpunëtorë" të fashizmit, ku u rreshtuan qarqe që pranuan t'i shërbenin pushtimit fashist dhe shtresat e gjëra të popullit, të cilat së bashku me intelektualët përparimtarë antifashistë iu kundërvunë okupacionit.

Qeveria e Romës hapi fronte pune duke nxitur investimin e kapitalit italian në fusha të ndryshme të ekonomisë, në mënyrë të veçantë ndër mori ndërtimin e një vargu objektsh publike, shumica e të cilëve u kryen në Tiranë. Kështu në Tiranë u ngritën një varg punishtesh e fabrikash industriale. Nga ana urbanistike Tirana filloi të zbukurohej dhe niveli i jetesës deri-diku filloi të përmirësohej, por këto ndërtime nuk e zbutën shijen e hidhur që shkaktoi pushtimi i huaj ushtarak dhe imponimi i ideologjisë fashiste. Kështu shumë shpejt filloi, ashtu si kudo edhe në Tiranë, organizimi i rezistencës antifashiste. Me fillimin e Luftës II Botërore, në shtator 1939, dhe pastaj me agresionin e Gjermanisë kundër Bashkimit Sovjetik, në qershor 1941, rezistenca antifashiste, e cila në fillim kishte mbetur e shkëputur nga lëvizjet antifashiste europiane, erdhi duke u rritur në përpjestime gjithnjë e më të mëdha dhe duke u integruar për herë e më tepër në koalicionin e madh antifashist anglo-sovjeto-amerikan.

Tirana qendroi në krye të rezistencës antifashiste si nga pjesëmarrja e forcave njerëzore ashtu dhe nga pikëpamja e

Sulejman Pashë Bargjinit, e cila gjatë atyre ditëve u rrënuar plotësisht. Luftimet të tilla u bënë në Sheshin "Skënderbej" dhe në ndërtesat qeveritare.

Më 5 nëntor, forcat partizane e thyen kundërsulmin që organizoi komanda hitleriane. Gjatë 19 ditëve që vazhduan luftimet për çlirimin e Tiranës, mbetën me qindra të vrarë nga ana e ushtrive gjermane dhe 127 të vrarë e 290 të plagosur nga ana e forcave partizane. Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, u çlirua më 17 nëntor njëherë e përgjithmonë. Qeveria e kryesuar nga Enver Hoxha, u vendos në Tiranën e lirë më 28 nëntor 1944.

#### 10. 1945-1990

Tirana doli nga lufta me një popullsi me 59,9 mijë banorë, gati të dyfishuar në krahasim me vitin 1938. Vitet e para të çlirimit përfaqësojnë për Tiranën periudhën e rindërtimit nga dëmet e shkaktuara gjatë luftës. Pas rindërtimit, Tirana njohu një zhvillim me ritme më të shpejta se ai që kishte përjetuar më parë. Që nga viti 1947, Tirana u mor me zgjidhjen e problemeve që lindën nga reformat e para me karakter socialist që ndërmoi Partia Komuniste Shqiptare, e cila pasi siguroi pushtetin politik hoqi dorë nga programi demokratik i Konferencës së Pezës dhe vendosi të ecte në rrugën e të ashtuquajturës diktaturë e proletariatit. Me zbatimin, pastaj me thellimin e këtyre reformave, Tirana njohu një zhvillim shumë të shpejtë ekonomik, shoqëror, kulturor dhe artistik. Si rrjedhim i këtyre reformave, popullsia e Tiranës u rrit me ritme shumë të shpejta.

Më 1955, ajo kishte 108,2 mijë banorë; më 1960, 136,3 mijë; më 1969, 152,7 mijë banorë; më 1979, 189 mijë; më 1989, 238,1 mijë banorë.

Transformimet e para të rëndësishme që pati Tirana në fushën ekonomike filluan në vitin 1947 u ngritën Kombinati i Përpunimit të Mishit dhe të Qumështit; Fabrika e Këpucëve, etj. Në vitin 1951 në Tiranë u ngrit industria e parë e mirëfilltë moderne - Kombinati i Tekstileve në Yzberish, në fillim me 5 mijë punëtorë e punonjës. Po atë vit u ngritën Kombinati i Drurit "Misto Mame", Hidrocentrali i Dajtit; dy vjet më vonë uzinat e prodhimeve metalike: Uzina "Dinamo", Uzina "Partizani". Më pas u ngritën Fabrika e Qelqit (1957); Fabrika e Porcelanit (1959); Kombinati i Tullave Silikate, Kombinati Ushqimor "Ali Kelmendi" (1960); Kombinati i Autotraktorëve (1966); Kombinati Poligrafik (1970); etj.

Në tridhjetëvjeçarët e mëvonshëm (deri në vitin 1990) u ngritën me qindra uzina e punishte të ndryshme industriale. Shkurt, me këtë zhvillim Tirana e humbi, që në vitet 60, karakterin e mëparshëm si një qytet ku dominonte plotësisht



*Pamje nga impianti pranë minierës së qymyrgurit në Valias*

amerikan dhe se në fund të saj do t'i tërhiqnin ushtritë e tyre nga Shqipëria, në fillim dhanë rezultat të pakët. Përpjekjet e tyre bënë për vete vetëm pak të vetëquajtur "nacionalistë", të cilët të shqetësuar nga fuqizimi i madh i frontit antifashist nacionalçlirimtar dhe i PKSH



*Pamje nga marshimi triumfal i brigadave partizane në Tiranë më 28 Nëntor 1944*


që qendronte në krye të tij, menduan se do t'i asgjësonin forcat e tyre partizane me ndihmën e ushtrive gjermane. Operacioni i madh ushtarak i komandës hitleriane kundër forcave partizane, i cili u zhvillua gjatë dimrit 1943-1944, dështoi. Dështimi i egërsoi hitlerianët, të cilët shpërthyen në një terror të egër edhe kundër banorëve të Tiranës. E paharruar ka mbetur ndër të tjera dita e 4 shkurtit 1944, kur forcat gjermane masakruan nëpër rrugët e kryeqytetit 84 vetë. Por as demagogjia, as terrori nuk dhanë rezultat te banorët e kryeqytetit. Përveç të tjerave, Tirana nisi delegatët e vet të zgjedhur për kongresin e jashtëzakonshëm, i cili u mbledh në qytetin e çliruar të Permetit, më 24 maj 1944 dhe shpalli formimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar nën kryesinë e Enver Hoxhës me atributet e një qeverie të përkohshme.

Një nga betejat më heroike të LANÇ-it e përfaqëson lufta për çlirimin e Tiranës. Më 29 tetor 1944, Tirana u rrethua nga tre divizione partizane, të komanduara nga Mehmet Shehu me detyrë për të realizuar çlirimin përfundimtar të saj. Sulmi filloi në mbrëmjen e po asaj dite. Në mbrëmjen e ditës së nesërme, pothuajse gjysma e kryeqytetit ra në duart e partizanëve. Luftimet vazhduan me ashpërsi edhe në ditët e ardhshme. Forcat partizane të ndihmuara nga populli i Tiranës e ngushtuan rrethimin e garnizonit gjerman në qendrën e kryeqytetit. Luftimet për çlirimin e Tiranës vazhduan rrugë me rrugë dhe shpesh herë shtëpi me shtëpi. Luftime të ashpra u bënë në qendrën historike të kryeqytetit, në afërsitë e xhamisë së




ndryshme të ekonomisë së vendit (industri, miniera, ndërtim, urbanistikë, transport, etj.). Më 1973 u ngrit Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e cila ka në varësi të saj një varg institutesh shkencore (Institutin e Gjuhësisë, e Historisë, e Arkeologjisë, e Kulturës Popullore, e Hidrometeorologjisë, e Fizikës Bërthamore, e Sizmiologjisë, e Gjeografisë, e Artit).

Krahas veprimtarisë shkencore u zhvillua me po ato ritme jeta kulturore dhe artistike. Që më 1945 u ngritën në Tiranë i pari Teatër Kombëtar Shqiptar dhe Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë. Më 1945, Tirana trashëgoi vetëm një bibliotekë me 12 mijë vëllime, kurse më 1990, ajo kishte 13 biblioteka, nga të cilat vetëm Biblioteka Kombëtare kishte gati dy milion libra. Fill pas çlirimit, Tirana u pajis me një pallat kulture (pallati "Ali Kelmendi"). Më 1960 u ngrit Pallati i Madh i Kulturës. Jeta letrare dhe artistike, ndonëse nën disiplinën ideologjike të shtetit, erdhi duke u gjallëruar. U rrit numri i botimeve letrare, i shfaqjeve teatrale, i koncerteve orkestrale, i festivaleve të këngës shqiptare. U kompozuan jo vetëm këngë të lehta, por edhe vepra simfonike dhe operistike. Në lagjet e Tiranës u ngritën një varg monumentesh e bustesh kushtuar personaliteteve të shquar të historisë së Shqipërisë, ndër to monumenti ekuestër i Heroit kombëtar shqiptar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i vendosur në sheshin qendror të kryeqytetit. Në të njëjtën kohë Tirana u bë qendra kryesore spitalore. Më 1989, ajo kishte 11 spitale, ku punonin me qindra mjekë, midis tyre



*Radha në dyqanin e vajgurit dhe një jetë e varfër*



*Bunkerë në dy radhë pranë Tiranës*

prodhimi i vogël zejtar dhe u kthye në një qytet industrial modern.

Tirana është nyje kryesore e transportit automobilistik dhe hekurudhor që lidhet me të gjitha qendrat e rretheve të Republikës. Vijat hekurudhore e lidhin me portet bregdetare, si Durrësin e Vlorën dhe me qendra të rëndësishme si Elbasanin, Pogradecin, Shkodrën, etj. Për udhëtimet ajrore përdoret aeroporti "Nënë Tereza" në Rinas.

Tirana njohu një zhvillim po aq të madh në fushën e arsimit dhe kulturës. Më 1947, u ngrit Instituti i Lartë Dyvjeçar Pedagogjik. Më 1951, hapën dyert katër institute të larta në shkallë universitare (Institutin e Lartë të Histori-Filologjisë, Institutin e Lartë Ekonomik, Institutin e Lartë të Mjekësisë, Institutin e Lartë Bujqësor). Më vonë me riorganizimin e arsimit u krijuan

një varg shkollash të larta në shkallë universiteti (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Kamzës, Instituti i Lartë i Arteve, Akademia e Lartë Ushtarake, Instituti i Lartë i Fiskulturës, etj.).

Një zhvillim po aq të vrullshëm pati në Tiranë dhe jeta shkencore. Për organizimin dhe drejtimin e saj shteti krijoi një mori institucionesh të profilizuara, të cilat u shtrinë në të gjitha sferat e jetës shkencore shoqërore dhe ekzakte. Hapi i parë u krye që në vitin 1947 me krijimin e Institutit të Shkencave, nën varësinë e të cilit lindën një varg institutesh shkencore dhe kërkimore. Më 1957, drejtimin e punës shkencore e mori Universiteti Shtetëror i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Kamzës.

Në fillim të viteve 70, pothuaj të gjithë dikasteret krijuan në Tiranë nën varësinë e tyre institute të posaçme për degët e



*Nisje e rinisë Tiranase në aksione për ndërtimin e hekurudhave, foto nga Jani Ristani*

madh, që u kryen në Tiranë, në korrik të vitit 1990 dhe që tashmë njihet me emrin "sulmi i ambasadave". Quket kështu ngaqë më 2 korrik, mbi 10 mijë qytetarë u dyndën nëpër ambasadat e fuqive perëndimore duke kërkuar strehim politik dhe leje kalimi për të dalë jashtë kufijve të Shqipërisë "së burgosur komuniste". PPSH dhe qeveria, të pazonja për të përballuar dallgën e banorëve të revoltuar të kryeqytetit, kapitulluan. Kapitullimi i hapi rrugë të lirë thellimit të lëvizjes demokratike. Disa muaj më vonë, në dhjetor 1990, studentët dhe profesorët e Universitetit të Tiranës, të përkrahur nga punëtorët e uzinave industriale e detyruan pushtetin komunist të lejonte pluralizmin partiak në Shqipëri. Si rrjedhim u shfaqën për të parën herë, pas shumë dekadash, formimi i partive politike opozitare, të cilat i dhanë fund monopolit partiak komunist dhe sanksionuan fillimin e regjimit demokratik në Shqipëri.


Kështu, pas fitores së pluralizmit partiak (12 dhjetor 1990), pastaj, pas



*Dy lideret kryesore partiake të Shqipërisë në një nga takimet e pakta konsensuale që rezultoi në një president konsensual, fund viti 2002*

shembjes së monumentit të Enver Hoxhës (20 shkurt 1991) dhe më tej pas zgjedhjeve të para pluraliste (31 mars 1991) në Shqipëri filloi e ashtuquajtura periudhë e tranzicionit e shndërrimit të regjimit të diktaturës komuniste me ekonomi socialiste të përqendruar në një regjim demokratik pluralist me ekonomi liberale të ligut. Kjo periudhë e tranzicionit është ende në zhvillim. Si rrjedhim, për këtë periudhë, historia e Tiranës është herët për t'u shkruar.

Prof. dr. Kristo FRASHËRI



*Dyndje të njerëzve në ambasadat e huaja, korrik 1990*

profesorë të shquar të specialiteteve të ndryshme të mjekësisë.

Në fushën urbanistike Tirana e ndryshoi pamjen e saj të mëparshme, sipas një plani të ri urbanistik të miratuar nga qeveria. Tirana u mbush me pallate banimi, zakonisht me 4-5 kate, të cilat zgjidhën deri-diku problemin e strehimit. Por nga ana tjetër duke qënë tepër të ngjashme midis tyre krijuan një monotoni nga pikëpamja estetike arkitektonike. Ndërkohë rrugët u kanalizuan dhe u shtruan. Qendra e kryeqytetit, e cila më parë gumëzhinte nga jeta zejtaro-tregtare, tani u shndërrua në një qendër



*Përleshje e policisë me studentët, dhjetor 1990*


zyrtare dhe kulturore. Njësitë tregtare dhe qendrat e prodhimit u spostuan nëpër lagje, kurse veprat e mëdha industriale në periferi të Tiranës. Përveç këtyre lagjet e kryeqytetit u mbushën me sheshe dhe lulishte. Ndër to vepra me e rëndësishme ishte parku i madh i Tiranës me liqenin artificial, në jug të kryeqytetit.

Me gjithë këtë zhvillim të hovshëm që pati si qytet, Tirana, duke qënë selia e aparatit qendror i shtetit, e ndjeu më shumë se qytetet e tjera, nga ana politike, peshën e regjimit 45-vjeçar komunist. Por presioni politik, ideologjik dhe policor i shtetit partiak nuk arriti dot të shtypte aspiratën demokratike të banorëve të Tiranës. Dëshmi janë arrestimet dhe burgimet e vazhdueshme të qytetarëve jo të paktë, të cilësuar si "armiq të popullit". Kjo frymë demokratike mbijetoi edhe në radhët e anëtarëve të PKSH, pas vitit 1948 e Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH). Një nga shprehjet më të bujshme të kësaj aspirate u shfaq haptazi në konferencën e organizatës së Partisë së Punës së rrethit të Tiranës, në prill 1956. Në këtë konferencë një shumicë delegatësh e kritikuan ashpër Komitetin Qendror të Partisë së Punës për devijim nga rruga e premtuar e demokratizimit të pushtetit. Masat e rrepta që u morën kundër komunistëve disidentë nuk e çrrënjosën aspiratën për demokraci të banorëve të kryeqytetit. Pakënaqësia sado që nuk doli haptazi u akumulua në pritje për të shpërthyer në momentin e parë të favorshëm. Momenti trokiti kur u shemb muri i Berlinit (në vitin 1989). Menjëherë filluan lëvizjet sizmike kundër diktaturës, të cilat u shndërruan në një tërmet të



## ASPEKTE NGA KULTURA TRADICIONALE TIRANASE



Deri në Luftën e Parë Botërore, në silueten e Tiranës ruheshin ende shumë tipare orientale. Megjithëse për pastërtinë e qyteteve administrata shtetërore e kohës



Qylym leshi nga fshatrat e Shëngjergjit, mbledhur dhe pikturuar nga Ikbale Bihiku

nuk kujdesej, në vitin 1840 konsulli frëng A. Boué konstatonte se: "në qytetet ku ka mjaft ujë ka edhe pastërti, të paktën aq sa ka në Francën Jugore e në Itali". Ndërsa për Tiranën e vitit 1857, një tjetër konsull frëng shkruante se "rrugët e saj të gjera kanë në çdo anë vija uji rrjedhës, që mbajnë freskinë dhe marrin me vehte plehurat" (H.Hecquard, Histoire et description de la Haute Albanie, f.255).

Edhe në fillim të viteve '20 të shekullit XX, Tirana kishte tregje të vogla të hapura në shumë pjesë të qytetit. Kishte shumë ndërtime të kultit mysliman (82 xhami, 19 teqe, tyrbe, namazgja], më shumë hane se hotele, kishte shumë shitësa ambulante nëpër rrugët e qytetit dhe gra që qarkullonin të mbuluara me çarçaf etj. Në fillim të viteve '30 Tirana po bënte ndryshime të mëdha. Megjithatë ishte "si mësalla me dy faqe". Kështu e karakterizon një letrar i kohës sepse "Ç" të kërkosh gjen brenda, të gjitha janë boll/ Herë je në Paris, herë je në Anadoll" (K.Cepa (Kapa). Por puls i jetës nuk rrihte me të njëjtin ritëm në të gjitha lagjet e qytetit.



Pipat e famshme Tiranase të prodhuara me mjeshtëri nga tre gjenerata të mjeshtrove të familjes Skënderi

Përveç banorëve të vjetër vendas, në Tiranë vinin vazhdimisht banorë të rinj nga fshatra të ndryshme të rrethit të saj dhe shumë të tjerë vinin nga qytete të tjera.

Dyndje popullsie të ardhur në Tiranë ka pasur veçanërisht si pasojë e pastrimeve etnike: (i) ardhja e dibranëve dhe kosovarëve pas pastrimeve etnike të shovinisteve serbë dhe (ii) ardhje e çamëve të dëbuar nga tokat e tyre prej qeverisë shoviniste Greke të kohës.

Si përfundim popullsia e qytetit në vitet 30 ishte mjaft e përzier.

Pjesa e qytetit që kishte më tepër gjallëri ishte Pazari i vjetër. Ditëve të enjte që ishte edhe dita e tregut, ai mbledhte shumë njerëz të ardhur nga viset për qark. Në një botim të kohës ai cilësohet si një pazar që ka një lëvizje të madhe sa nuk mund të krahasohet me asnjë qytet të Shqipërisë. (T.Selenica, 1927). Në këtë treg të rihiqnin vëmendjen disa prodhime tradicionale, sidomos në atë pjesë të tregut



Pamje nga Pazari i Vjetër

që quhej pazari i grave. Shumë gra qytetare e fshatare sillnin për të shitur aty prodhime të punuara nga duart e tyre. Këtu mund të përmenden, në rradhë të

parë pëlhurat e holla të pambukta e të mëndafshhta, shumë të kërkuara edhe sot si për qendrueshmërinë ashtu edhe për bukurinë e tyre. Të tjera gra shisnin përparje e bohçe të ndryshme të pambukta, mbulesa koke apo "kryqe", të pambukta në formë katrore, tentena apo ojna me gjilpërë për shamitë e kokës por edhe breza të leshtë, çorape shumëngjyrshe, si edhe shajak.. Në treg kishte shumë dyqane zejtarësh si argjendarë, qendistarë, rrobaqepës, këpuhtarë e opingarë, qeleshepunues etj.

Ndër mjeshtëritë tradicionale që i qendruan kohës më gjatë se të tjerat ishte punimi i qelesheve të bardha të burrave, që përdorshin në Tiranë e më gjerë në Shqipërinë e Mesme. Ato ishin më të larta se qeleshet e krahinave të tjera dhe shoqëronin veshjen e burrave me brekushe të leshta.

Një tjetër mjeshtëri tipike që ushtrohej në Tiranë ishte punimi me çark i pipave të gjata prej druri dhe i disa objekteve të tjera të vogla, me forma e ngjyra krejt të veçanta. Shumëkush nuk do ta përfytyronte dot një burrë të moshuar tiranas, të veshur me brekushtet e bardha dhe jakucen e zezë, me qeleshen e lartë, pa pipën e tij prej druri të gjatë deri 30-40 cm. më vonë larushia e këtyre objekteve prej druri, të punuara me çark u zgjerua mjaft duke përfshirë kuti e kupacë druri me përmasa të ndryshme, bishta pene, takëme shkrimi etj.

Ashtu si në shumë rrethe të tjera të vendit edhe në Tiranë, ka pasur fshatra të veçanta ku një pjesë e mirë e banorëve ushtronin një mjeshtëri të caktuar për të cilën njiheshin në gjithë krahinën. I tillë ka qenë fshati Farkë, 10-12 km në



Shëngjergjit, krahinë malore kjo që ndodhet në lindje të qytetit të Tiranës, në rrjedhën e sipërme të lumit Erzen. Kjo zonë kishte bjeshkë e kullota të mira dhe blegtori mjaft të zhvilluar, sidomos dhen e dhi e për pasojë edhe prodhim të mirë leshti. Me leshtin e bagëtive të tyre gratë fshatare të zonës prodhonin shajak për të përgatitur veshjet e tyre dimërore por edhe pajisje të ndryshme shtëpiake si mbulesa për fjetje, jastëkë, trasta etj.

Midis të gjitha punimeve prej leshti bien në sy qilimat e vegjël të Shëngjergjit, si një objekt me vlerë që nuk mungonte në pajën e asnjë vajze që martohej. Ata kanë një pamje shumë të veçantë e të gëzueshme, falë ngjyrave të tyre, karakteristike për gjithë zonën. Kështu në një fushë ngjyrë të kuqe të fortë, përshkohen së gjeri vija e motive të thjeshta ngjyrë të bardhë, të verdhë, e të zezë, me kombinime të shumëllojshme në renditjen e tyre. Përmasat e tyre janë afërsisht 2 m X 1,30 m. (shih fig.)

Një tjetër mjeshtëri tradicionale jo vetëm në fshatrat përfaqë Tiranës por edhe në ato të Krujës, ka qenë punimi i pëlhurave të pambukta e të mëndafshita, në avlemendin e thjeshtë shtëpiak.

Pëlhurat e pambukta të punuara në rrethin e Tiranës ishin padyshim nga më të bukurat që punoheshin në Shqipëri. Ato kishin përdorim të gjerë për pajisje nga më të ndryshmet. Kishin qëndrueshmëri shumëvjeçare dhe prodhoheshin relativisht lehtë për atë që e zotëronte mirë traditën ekzistuese. Për të zbukuruar një pëlhurë pambuku sëpari luhej me trashësinë e fijos duke kombinuar fijen e hollë të majës me fijen

pak më të trashë të qenarëve së gjati ose së gjeri pëlhurës dhe efektet ishin të mahnitshme, sidomos kur për qenarët përdoreshin edhe fije me ngjyra të lehta. Por ka patur edhe pëlhura ku vijat kombinoheshin me motive të thjeshta gjeometrike.

Mund të themi pa ndrojtje se këtu provohet qartë ajo veçori e artit popullor, që thotë se në këtë art nuk ka dy kopje të njëjta. Këto pëlhura të pambukta i kanë qëndruar gjatë konkurrencës së prodhimeve industriale, pikërisht në saje të këtyre cilësive. Objektet më të zakonshëm të punuar me këto pëlhura ishin këmishët e grave e të burrave, përparje, shami koke, bohçe brezi, pastaj kllëfë e faqe dyshekësh e jastekësh, peshqirë të përditshëm e peshqirë banje, bohçe të përmasave të ndryshme, piceta tryeze e piceta duarsh etj.

Ka një kalim gradual midis pëlhurave të pambukta e atyre të mëndafshita, që janë pikërisht pëlhurat e përzjera pra pjesërisht me fije pambuku e mëndafshi. Gjithë sa thamë për pëlhurat e pambukta është e vlefshme edhe për pëlhurat e mëndafshita por këtu transparenca është më e madhe, motivet zbukuruese më të pasura e të shumëllojshme dhe për shtresat më të pasura disa motive janë punuar edhe me fije të hollë ari. Pëlhurat më të bukura prej mëndafshi, përdoreshin nga shtresa e pasur për këmishë burrash e grash të veshjes së mirë ose për të dalë dhe për disa pajisje shtëpiake si çarçafë luksi, perde dhe namazshalle dhe ishin pjesë e rëndësishme e pajës së vajzave që martohehin.




juglindje të Tiranës, ku një lagje e tërë merreshin me punimin e enëve prej balte (për fat të keq po e humbasin krejt këtë traditë sepse sot kanë mbetur fare pak mjeshtra poçarë). Enët e Farkës, kryesisht tasa dhe vorba me një ose dy vegja, kishin një sipërfaqe me kokrriza të imta, kishin forma shumë harmonike, zbukurime diskrete vetëm te qafa e vorbave dhe ishin të pjekura mirë. Fshatarët e zonës përfaqë që i përdornin këto vorba ishin të bindur se groshët e ziera në këto enë, kishin shije shumë të mirë.

Jo larg Farkës ndodhej fshati i vogël *Daijas* ku punohej me mjeshtëri leshti i dhive për të prodhuar kryesisht shtroje


për ambientet e brendëshme të shtëpive të zejtarëve tiranas, por prodhoheshin edhe hejbe e trasta etj. Këto punime zbukuroheshin vetëm me vija së gjati në dy tri ngjyra të ndryshme, duke marrë një pamje mjaft të pëlqyer.

Më anë tjetër ato kërkoheshin edhe për një arsye praktike se ishin mjaft të qëndrueshme. Më në fund të kujtojmë se *Daijasi* është një nga të paktët fshatra në Shqipëri ku me endjen e këtyre punimeve krejtësisht me lesht dhije merreshin vetëm burrat dhe punonin vetëm në avlemendin vertikal.


Duke qëndruar tek tekstilet e leshta do të ndalemi pak tek qilimat e krahinës së




Dy trasta leshti dhe një qilym nga Shëngjergj, mbledhur nga IB




Kostum burri Tiranës



Xhaketë gruaje nga Shëngjergji





Xhaketë gruaje nga Selita e Malit



Një vështrim mbi veshjen e popullit në rrethin e Tiranës.

Në zonën e Shëngjergjit pothuaj deri në Luftën e parë Botërore burrat mbanin brekushe të trasha leshi, këmishë, jelek e mitan dhe sipër xhokën e trashë prej shajaku të zi që merrte një pamje interesante me atë jakën e madhe katrore prapa, të zbukuruar përçark me thekë të gjatë rreth 30 cm dhe me tufa të dendura në të dy anët përpara te gjoksi. Ky kostum kishte fare pak ngjyra gjallëruese: te brezi i gjatë i leshtë me vija dhe tek çorapet shumëngjyrshë.

Padyshim pjesa më e zbukuruar në këtë tip veshjesh për burra ishte jeleku, ose mëngorja prej shajaku të bardhë me gajtan të zi anëve dhe me disa zbukurime karakteristike tek mëngët nga bërryli e poshtë.. Në kokë burri mbante qeleshe të bardhë mjaft të lartë. Me kalimin e kohës ky kostum erdhi duke dalë ngadalë nga përdorimi, sidomos për moshat e reja. Me ndryshime të vogla ky kostum burrash është mbajtur në pjesën më të madhe të rrethit të Tiranës si edhe në qytet.



Dy mbulesa koke gruaje të veçanta: dy xhufkat duhet të qëndrojnë tek veshët

Megjithatë ka ende burra të moshuar që tregojnë me insistim se, si veshje festash të mëdha e sidomos si veshje për dhëndërrin është përdorur edhe kostumi me fustanelle. Në një ekspozitë për veshjet popullore të rrethit të Tiranës, të çelur në Pallatin e Kulturës në Tiranë, në shkurt të vitit 1983, ishte paraqitur një kostum i tillë me fustanellë, i sjellë nga fshati Skrep i Shëngjergjit.

Një element tjetër me interes i paraqitur në të njejtën ekspozitë ishte një mëngore burrash prej shajaku të bardhë e zbukuruar me gajtan të kuq e të gjelbër, që përdorej për dhëndërrin në fshatrat e zonës së Kërrabës.

Pothuaj të gjitha veshjet popullore të grave në rrethin e Tiranës i përkisnin tipit shumë të njohur në gjithë Shqipërinë, që ishte veshja me linjë të gjatë pëlhere shtëpiake, mbi të cilën vishej jeleku ose mëngorja, ngjishej brezi, vihej përparja dhe sëfundi vishej xhoka e leshtë. Ky tip veshjeje u ruajt më gjatë në zonën kodrinore malore dhe doli më herët nga përdorimi në fshatrat e zonës fushore, duke u zëvendësuar me dimitet prej



fotot)Një variant disi më i lehtësuar ishte ai që mbahej në fshatrat e zonës së Kërrabës.


Në veshjen e grave qytetare të Tiranës moda orientale e pati më lehtë të hyjë në përdorim, fillimisht në shtresat më të pasura e më vonë në shtresën e zejtarëve e të tregtarëve të vegjël. Por nga mesi i shek. XIX, ndjehen tashmë idetë e Rilindasve për zgjimin e ndjenjës kombëtare, për distancimin nga kultura e pushtuesit dhe ruajtjen e identitetit kulturor në shfaqje të ndryshme por edhe në veshje. Por jo çdo element i huaj mund të hiqej nga përdorimi me atë lehtësi që kishte hyrë. Shtresat më të emancipuara të shoqërisë qytetare e bënë të parat këtë

kapërcim dhe filluan të ndjekin modën perëndimore ose "alla frënga" në veshjen e tyre, si shihet në shumë fotografi të kohës. Po kështu mbas 1912 -ës e më tej, gjithë deputetët, antarë të qeverisë që u ndryshuan herë pas here dhe politikanët në përgjithësi visheshin "alla frenga". Në veshjen e grave ky kalim ka qenë më i ngadaltë.

Në ecurinë e këtij procesi bie në sy lehtë se moda e veshjeve të shresës së pasur kur lihej prej saj, kalonte në përdorim të shtresave të gjera, por natyrisht shumë më e thjeshtuar, ose si veshje martese, madje me kohe hynte në përdorim edhe në fshatrat për qark qytetit., shpesh me një transformim të ndjeshëm. Kështu nga kostumi i grave me çitjane akllazi, anteri



*Xhakëtë shumëngjyrëshe gruaje nga Shmria (Shën Mëri)*





*Kostum Gruaje nga fshati Klojkë*



basme ose sateni të zi, që hyri në fshat si një ndikim i, të modës orientale që vinte nga qyteti. Midis veshjeve që ruanin tipin e veshjeve vendase mund të përmendim, përveç kostumit të grave të Shëngjergjit, për të cilin u fol më lart, veshjen e grave të Shëmrisë (në Tamadhe) dhe veshjen e Selitës së Malit (në Bendë). Ato janë më të lehta se kostumi i Shëngjergjit por edhe më tërheqëse. Ndryshimi më i dukshëm është ai i mbulesës së kokës, sidomos në fshatrat e Bendës. Atje gruaja sëpari mbi flokët vendoste skuninë, në formë

trekëndshi dhe e mbuluar me qendisje të imta, duke e lidhur me dy gjalma skajet e të cilave mbaronin me disa tufëza shumëngjyrëshe që duhet të varehin përpara veshit, tek tëmthas. Përmbi skuni por nja dy gisht më lart vendosej mbulesa e kokës prej pëlhure të pambuktë avlemendi dhe e zbukuruar në të katër anët e saj, me përmasa 90 x 100 cm afërsisht, e cila varej lirshëm prapa mbi shpinë. Për raste të veçanta ato vishnin edhe xhokë e bardhë, memëngë nuk visheshin por varehin prapa. (shih



*Mbulesa koke gruaje*

## JETA KULTURORE NË TIRANË

Tirana ka pasur dhe ka një jetë kulturorë mjaft të pasur veçanërisht pas përzgjedhjes së saj si kryeqytet i vendit më 1920. Për të kuptuar më qartë këtë pasuri, aktivitetet kulturore janë ndarë sipas zhanreve artistike:

### Teatri në Tiranë

Teatri, bën pjesë në mënyrë të natyrshme në korpusin e trashëgimisë më të mirë kulturore e artistike të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë.

### Lindja

Ndonëse shfaqjet dhe grupet teatrore në Shqipëri datohen gjerazi në fundin e shekullit të XIX, që përkon me periudhën e Rilindjes Kombëtare, zhvillime të lëvizjes amatore në llojet e teatrit pikasen edhe në Tiranë. Gjithësesi nuk duhet harruar ajo pasuri e vyer e kulturës popullore tiranase që i përgjigjet korpusit të njohur me emrin "Teatri folklorik", ku përfshihen shumë lodra, ceremoniale, këngë, valle, rituale dasme, morti e mikpritjeje, veprime mimike, pantomima gazmore, karnavalet, teatri i hijeve, ai i

kukullave, veprimet me maskat etj. Nga kjo pikëpamje kemi të drejtë të themi se në Tiranë, sadoqë një qytet jo i hershëm shqiptar, fillat e teatrit rrënjëzohen, më së pari, tek format e tyre parake në kulturën popullore. Nga burimet historike është me interes të theksohet se lënda e hartuar për shfaqjet teatrore të kësaj kohe ka qënë e natyrave të ndryshme, qoftë kjo e organizuar në forma mirëfilli dramatike, qoftë në trajtën e skenarëve a libreteve ku thureshin brenda një teme shumë elementë teatrorë, qoftë edhe në trajta të tjera të përshtatshme për skenë.

Në vitet '30, Tirana bëhet një nga qarqet teatrore muzikore kryesore, me një lëvizje të gjerë amatore që mëton ecje, progres. Shoqëria teatrore "Tirana", e drejtuar nga Mihal Popi, ishte një grup i qëndrueshëm dhe i përkushtuar, që vuri në skenë disa pjesë si dhe përshtatje të Xhevat Serezit, drama të F. Postolit, komedi të Molierit, Kristo Floqit, pjesë nga Kerner, Shiler etj. Ndërkaq në Tiranë gjallonin shumë grupe amatore teatrore të shkollave të mesme.

Në Prill të vitit 1929 nga elita intelektuale e vendit hidhet ideja e krijimit



*Mbulesë fundi gruaje*

të gjatë mëndafshi të qendisur dhe xhybes prej cohe me shumë qendisje me fije ari, që ishte shumë i kushtueshëm, me kohë u la jashtë përdorimi sëpari anteria e

gjatë e më von edhe xhybeja dhe veshja mbeti me çitjane, ose dimite, këmishë pëlhure e mbi të një jelek ose mitan.

Mbas Luftës së parë botërore filloi të importohej një lloj vuali, pra pëlhurë transparente, disi e ngrirë ("nansuk"), që duket se pati shumë sukses për veshjet e balerinave të kohës. Tek ne, e sidomos në Shqipërinë e Mesme, ajo u përdor menjëherë për dimitet e nuseve, u pëlqye shumë dhe këto dimite u quajtën "dimite mermeri" dhe shoqëroheshin me njëlloj bohçeje, të lidhur për mesi, që quhej çerve dhe ishte e qendisur nëpër qoshet me tel e me inxhi., me një këmishë të hollë mëndafshi e një jelek. Ky kostum shihet ende në përdorim të shumë grupeve folklorike.

Në mbyllje duhet thënë se njerzit që shihen sot në rrugët e Tiranës janë të veshur si në qytetet e tjera të Ballkanit e të Europës dhe ata që ndjekin më fort rrymat dhe stilet e reja të modës janë moshat e reja.

*Prof. Andromaqi Gjergji*




Pjetër Gjoka etj. Duhet përmendur aktori i madh me origjinë shqiptare Aleksandër Moisiu, i cili shprehu simpatinë, njëkohësisht gadishmërinë, për të ndihmuar në ngritjen e një teatri nacional.

Me pushtimin e vendit nga Italia fashiste, arti dhe kultura kombëtare, përgjithësisht erdhën duke u tkurrur. Megjithatë, në disa qytete, veçanërisht në Tiranë, u organizuan mjaft aktivitete artistike me grupet e mbetura teatrore, sidomos shfaqje vokale e koncertale, spektakle me karakter argëtues etj. Disa grupe teatrore vunë në skenë vepra të autorëve vendas, duke nxitur ndjenjat atdhetare. Pati edhe vepra nga dramaturgjia e huaj, që i bënë jehonë qëndresës kundër pushtimit, siç ishte drama e Shilerit "Vilhelm Teli".

Sa më tepër zgjerohej dhe forcohej rezistenca dhe lufta për çlirimin e vendit, aq më shumë nisi të përvijohet synimi për një lëvizje të gjërë skenike artistike, me ide të reja, e cila i bënte jehonë gjendjes shpirtërore të popullit të revoltuar nga pushtimi, të ngritur tashmë në luftën çlirimtare. Gjini dhe lloje të tilla, si kënga, marshet partizane, skeçet, pjesët e shkurtra teatrore, vallet popullore epike dhe ato humoristike, u përhapën me shpejtësi të madhe dhe shumë prej tyre u bënë masive. Kjo lëvizje njihet me emrin teatri partizan (1941-1945). Nga pikpamja e ushtrimit të veprimtarisë artistike, ai u zhvillua 1) në mal midis njësisive të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, 2) në qytet dhe 3) në burg.

Midis krijimtarisë artisike, me karakter masiv, që realizohej në njësitet partizane dhe asaj që bëhej ilegalisht në qytetin e



Fasada e rehabilituar e ndërtesës së Teatrit Kombëtar në qendër të Tiranës

Tiranës, kishte ngjashmëri në trajtat e tyre demokratike, në frymën antifashiste që i përshkonte, si dhe në formën e thjeshtë të komunikimit.

Më 25 maj 1945 mbi bazën e këtij teatri u krijua për herë të parë në historinë e Shqipërisë *Teatri Profesionist i Shtetit*, nga i cili më 1947 doli Teatri Popullor, sot Teatri Kombëtar. Me qëllim që të aftësoheshin aktorët, që në nëntor të vitit 1944 u hap pranë Teatrit Qendror, Shkolla Dramatike dhe u shpall konkursi për aktorë profesionistë. Shkollën e ndoqën shumë nga aktorët e parë të teatrit shqiptar, që më vonë u bënë edhe artistët e shquar të tij, si Mihal Popi, Kadri



Postera të shfaqjeve teatrale të sezonit teatror të dimrit 2002-2003

të një teatri kombëtar shqiptar, por ajo mbeti e porealizuar. Në vitin 1930 në Tiranë organizohet për herë të parë një konkurs filodramatik, ku morrën pjesë shumë grupe teatrore të vendit. Dalëngadalë po bëhej e domosdoshme ngritja e teatrit nacional. Për këtë arsye Ministria e Arsimit hapi në vitin shkollor 1932-1933 të parën Shkollë Dramatike në Shqipëri, ku merrnin pjesë 16 djem dhe 12 vajza, që do të përgatiteshin si artistët e ardhshëm të teatrit. Pranë kësaj ministrie u krijua edhe "*Federata e djelmnisë shqiptare*", e cila interesohet dhe organizonte veprimtaritë teatrore në shkallë vendi.

Masivizimi i lëvizjes teatrore në vitet '20-'30 është dëshmi e dashurisë së

popullit shqiptar për artin; më gjerë për identitet kulturor, për emancipim, për përparim. Lëvrimi i një dramaturgjie shqiptare që nis të profillohet brenda një cilësie në rritje dhe kërkesave artistike që buronin prej vetë gjinisë letrare si të tillë, krijimi i një infrastrukture institucionale nëpërmjet ngritjes së shoqërive teatrore të ndryshme, organizimi i konkurseve, kualifikimi i artistëve të ardhshëm, këto së toku krijojnë kushtet për një përparim të ndjeshëm të veprimtarive teatrore në Tiranë, tashmë si një dukuri kulturore kombëtare e zëshme në proceset e zhvillimit dhe emancipimit shpirtëror të vendit. Nga shoqëritë teatrore të qytetit spikatin edhe mjaft aktorë të talentuar si Mihal Popi, Loro Kovaçi, Mihal Stefa,



Shfaqja teatrale "Arturo Ui" e B. Breht, vënë në skenë në 1971

artistëve, që përbënin trupën e Filarmonisë, vinin nga lëvizja amatore, të përzgjedhur nga më të talentuarit. Por në këto trupa u përfshinë edhe artistë që kishin studiuar në shkolla të larta artistike jashtë vendit, si M. Kraja, K. Antoniu, J. Truja, M. Ciko, L. Gjoka, K. Trako, M. Krantja etj. Nga viti në vit personeli u zgjerua me artistë të rinj të përgatitur kryesisht në vendet e Lindjes.

Më 1952 në Tiranë u krijua estrada e parë (*Estrada e Shtetit*), e cila u pasua më vonë me *Estradën e Ushtarit*.

Ndërkaq, nevoja për zhvillimin e mëtejshëm të baletit kombëtar bëri të domosdoshme çeljen e *shkollës së parë*

koreografike në Tiranë (1957), pranë Teatrit të Operas dhe Baletit. Po në këtë vit u ngrit dhe *Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore*, si një institucion qendror profesionist për interpretimin e krijimtarisë popullore si dhe përpunimin e saj. Zgjerimi i institucioneve të artit skenik, ai i teatrit dhe ai i estradës, bëri të domosdoshme që në vitin 1959 të çelet prane Teatrit Popullor e para shkollë e lartë e artit në Shqipëri, *Shkolla e Lartë për Aktorë "A. Moisiu"*.

#### Drejt konsolidimit

Në 10-15 vjetët e parë repertorin e trupave teatrore profesioniste e zotëronin



Komedia "Prefekti" e Besim Levones, vënë në skenë në vitet 50. Në rolin kryesor Mihal Popi

Roshi, Naim Frashëri, Besim Levonja, Drita Pelinku, Prokop Mima etj. Teatrin dhe shkollën e drejtonte regjisori i njohur Sokrat Mio. Gjatë dy vjetëve të Shkollës Dramatike dhe në vijim u tërhoqën në teatër aktorë të tjerë të talentuar nga lëvizja amatore e qyteteve, ndër ta Sandër Prosi, Pjetër Gjoka, Sulejman Pitarka, Violeta Manushi, Marie Logoreci, Loro Kovaci etj.

Në këtë vazhde, për t'i dhënë shtytje gjithpërfshirëse muzikore dhe asaj koreografike, më 1950, u ngrit në Tiranë *Filarmonia e Shtetit*, e cila përfshinte orkestrën e Radio Tiranës, korin e shtetit,

grupin e valleve (të baletit) dhe disa këngëtarë lirikë. Më parë grupe të ndryshme e zhvillonin veprimtarinë e tyre koncertale pranë Teatrit Popullor. Me ngritjen e Filarmonisë, u krijua bërthama profesioniste, e cila do të shërbente më vonë si bazë për *Teatrin e Operas* dhe të Baletit, që u themelua në vitin 1953. Filarmonia krijoi kushtet për kërkesa më të larta artistike duke ndërtuar një politikë të vijueshme repertori. Veç këngëve dhe valleve, ekzekutoi që në vitet e para edhe vepra të gjinive të mëdha simfonike e vokale shqiptare, veçanërisht të autorëve të shquar botërorë. Një pjesë e mirë e



vitin 1961 Teatri Popllor dha 137 shfaqje me 58 mijë shikues. Shifra të larta të numrit të shfaqjeve dhe shikuesve vërehen edhe në Teatrin e Operas dhe Baletit, sidomos në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Popullore, Ansamblin e Ushtrisë, Estradën e Shtetit, atë të Ushtarit etj. Bie në sy interesi i madh për vepra kombëtare. Për këtë arsye, si dhe për motive ideologjike, në trupat teatrore fiton dalëngadalë përparësi repertori me pjesë kombëtare. Teatri Popllor në vitin 1963 kishte në repertor nga autorët vendës pjesë si "Prefekti", "Toka jonë", "Familja e peshkatarit", "Shtëpia në bulevard" "Karnavalet e Korçës", "Doktor Aleks", "Halili dhe Hajria" etj. Kjo e fundit deri në vitin 1962 ishte dhënë 212 herë. Në repertorin e trupave të teatrit, vetëm gjatë këtij viti, kishte 13 pjesë të autorëve klasikë, si Shekspir, Goldon, Gogol, Molier, Shiler, Lorca etj., ndër to pjesët "Dhelpra dhe rushtë", "Moral i zonjës Dulcka", "Zonja e bujtinës", "Monsera", "Orët e Kremlinit" etj. Ndërsa Teatri i Operas dhe i Baletit nga veprat e autorëve shqiptarë kishte në repertor operetat "Mrika", "Pranvera", operën "Lulja e kujtimit", baletet "Halili dhe Hajria" dhe "Delina", veç disa pjesëve instrumentale. Në fushën e artit skenik u përgatit opera "Skënderbeu" e kompozitorit P. Jakova.

Dritarja e hapur mediatike e botës së lirë pati një ndikim të jashtëzakonshëm në shijen dhe vetëdijen artistike të publikut, çka bëri që edhe në artin shqiptar në fundin e viteve '60 dhe fillimin e viteve '70 të kërkohen mënyra të reja shprehëse, forma moderne, si dhe një kuptim më i avancuar ndaj aspekteve të

mprehta të formës së krijimtarisë. Në muzikë u realizuan disa vepra të gjinive të mëdha instrumentale simfonike, por si arritja më e madhe u çmua baleti "Cuca e maleve" (1970), me muzikë të N. Zoraqit dhe koreografi të A. Aliaj.

Mbresa të thella në publik la organizimi i Festivalit të 11 të Këngës në Radjo-Televizion, i cili u shfrytëzua më pas si një pretekst nga organet partiake për të shpërthyer një fushatë të egër kontrolli, me ideologjizimin e skajshëm të artit, që u ndjenë fort në vijim të viteve '70 e më tutje.

Në vitet 60-80 pjesa dërrmuese e repertorit të gjithë llojeve të teatrit në Tiranë u përballuan nga dramaturgjia dhe krijimtaria muzikore kombëtare. Në mesin e viteve '80 politika e repertorit moderohet diçka, vihet re një raport më i drejtë midis dramaturgjisë dhe (gjerazi) të krijimtarisë nacionale, nga njëra anë dhe veprave të repertorit botëror, duke ruajtur përparësinë e të pares mbi të dytën. Po në këto kohe u bë e mprehtë lufta për t'i dhënë Teatrit Kombëtar një status të ri cilësor, me kërkime formash të reja, kundër trysnisë së mediokritetit. E njëjta prirje vihet re edhe në TOB, në estradën e Tiranës etj.

#### Struktura e bashkësisë teatrore në Tiranë.

Tirana sot ka një rrjet teatrosht me repertori të llojeve të ndryshme, me godinat dhe trupat e tyre profesioniste, që kryejnë veprimtari sezonale, në salla a mjedise të larme. Struktura e bashkësisë teatrore në Tiranë aktualisht përbëhet nga: Teatri Kombëtar, Teatri i Operës dhe Baletit, Ansambli i Këngëve dhe Valleve



Shfaqja teatrale "Revisor" e N.V. Gogol, vënë në skenë në vitet 50

vepra të autorëve ruso-sovjetikë dhe ata klasikë. Njëherazi, përherë e më shumë bëheshin përpjekje për të sjellë në skenë vepra origjinale kombëtare. Si pasojë, në këtë periudhë u realizuan disa syresh, si



Shfaqja teatrale Hamleti" e W.Shakespeare vënë në skenë në 1961. Në rolin kryesor Naim Frashëri



Shfaqja teatrale "Dhelpra dhe Rushtë" nga Ezopi vënë në skenë në 1964. Në rolin kryesor Kadri Roshi

dramat "Halili e Hajria", "Toka jonë" (1954), "Familja e peshkatarit" (1955), ndonjë komedi etj. Teatri gjithnjë e më shumë synon drejt repertorit kombëtar, ku spikasin tema të rëndësishme, të trajtuara përgjithësisht me një gjuhë realiste, ndonëse ndjehet ndikimi i optikave skematike, herë herë edhe i shfaqjeve melodramatike. Ndërkaq në repertorin e teatrit shqiptar ishin njëmendësuar vepra të zëshme nga fondi i zgjedhur i dramaturgjisë botërore si "Hamleti", "Otello", "Mbreti Lir", "Shumë zhurmë për asgjë", "Revizori", "Xhaxha Vanja", "Kopraci", "Intrigë e dashuri" etj.

Në pjeset muzikore në këtë kohë u kompozua Simfonia numër 1 e Ç. Zadesë (1956), si vepra e parë e këtij zhanri, që realizonte edhe një nivel të lartë artistik. Po ashtu, në vitin 1958 u realizua dhe u interpretua opereta e parë shqiptare, "Mrika" e P. Jakovës

Pas vitit 1960, në kushtet e vetizolimit nga arti botëror, u rrit së tepërmi veprimtaria e trupave teatrore profesioniste, gjithashtu interesi i publikut për artin skenik. Kështu, për shembëll, në

shqiptar. Shfaqje të tilla si "Rikardi i III", "Në pritje të Godosë", "Fernando Krafi më ka shkruar këtë letër", "Magjia e madhe", "Armiku i popullit", "Kopshti me dallëndyshe", "Quo Vadis" etj. dëshmojnë rritje cilësore dhe risim të mjeteve shprehëse.

Teatri Kombëtar është teatri më i madh i dramës në Shqipëri. Deri në vitin 1990 ai kishte 55 aktorë, 4 regjisorë, 3 scenografë, si dhe personelin ndihmës. Aktualisht trupa e aktorëve ka zbritur deri në 30. Pas një krize të fortë identiteti dhe ristrukturimi, TK vijon të ruaj statusin e tij si teatri i një rëndësie të veçantë, me përmasë nacionale.

#### Estrada e Tiranës

Estrada e Tiranës është teatri me karakter satiriko-humoristik më i madh i varietesë në Shqipëri. Deri në vitin 1990 ai kishte 40 artistë: aktorë, këngëtarë, instrumentistë. Mesatarisht ka vënë në skenë 4-5 premiera në vit me rreth 250 shfaqje.

Repertori i saj ngihet mbi një sintezë miniaturash e nënlojesh skenike nga më të larmishmet të letërsisë, valles e muzikës, të veprimit aktorial, pikturës, deri tek projektionet, filmat, vidiokasetat etj. Teatri i estradës së Tiranës ruan gjithëpoq një karakter të dukshëm popullor të humorit, të tipave komikë. Dallon për sensin kritik, frymën bashkëkohore, problematikën e mprehtë të materialeve të paraqitura, duke ndihmuar në përsosjen morale të shoqërisë. Jo pa shkak Estrada është quajtur "medie lëvizëse", pasi është tejet komunikuese, atakon me humor e satirë

dobësitë, veset, të metat e shoqërisë, duke ndihmuar në përsosjen e saj morale.

#### Teatri i Operas dhe Baletit

U krijua në Nëntor 1953 mbi bazën e Filarmonisë (1950). Në periudhën e parë u vunë në skenë një varg veprash të literaturës periodike botërore si dhe disa balette. Këto ndikuan në aftësimin profesional të artistëve. Nga fundi i viteve 50 u inkurajua krijimtaria e kompozitorëve shqiptarë, si rrjedhojë u vunë në skenë edhe veprat e para kombëtare të gjinive të mëdha. Opera "Mrika" (1959) e Prenk Jakovës është opera e parë shqiptare. Ajo shquhet për lirizmin dhe ngjyrimin e saj kombëtar, me motive dhe tema që frymojnë prej muzikës popullore, duke çelur rrugën për vepra të tjera me struktura më komplekse siç ishte opera "Gjergj Kastriot Skënderbeu" 1968 e po këtij autori ku, tanimë, spikat ura monumentale, fryma heroike, koralet masive, zgjidhja e figurshme skenografike si dhe një interpretim më ekspresiv i këngëtarëve. Në vepra të mëvonshme si opera "Zgjimi" 1976 e Tonin Harapit, "Komisari" 1974 e Nikolla Zoraqit, "Goca e Kaçanikut" 1979 e Rauf Dhomit etj. pëson ndryshime dhe pasurohet nga pikëpamja strukturore mënyra e organizimit të lëndës muzikore letrare e koreografike, duke fituar një dinamikë të re dhe një gjuhë bashkëkohore. Vitet 70-80 shënojnë për këtë trupë hapa cilësorë për të krijuar repertorin e vet nacional. Vlen të përmendim baletet "Halili e Hajria" 1963, "Cuca e maleve" 1972, "Plagë e dhjetë e Gjergj Elez Alisë" 1963 etj. Pas viteve '90 në TOB spikat prirja për t'u ballafaquar



Drama "Toka Jonë" e Kolë Jakovës vënë në skenë në 1974


Popullore, Ansambli i Ushtrisë, Cirku, Estrada e Tiranës, Estrada e Ushtarit, Teatri i Kukullave Tiranë; të gjitha janë teatro që subvencionohen nga shteti. Krahas tyre në qytet gjallojnë edhe një sërë kompanish private teatrore, formacione të larme orkestrale, grupe vokale etj., që operojnë me projekte të mëvetësishme duke aplikuar (për burime financimi) në fondacione a institucione të ndryshme që veprojnë në Shqipëri. Për vlerësimin dhe nxitjen e krijimtarisë në teatër ne se dikur janë organizuar në mënyrë periodike festivalet e teatrove, Dekada e Majit, sot ka disa festivale të këngës, muzikës, teatrit etj.

#### Profile artistike

##### Teatri Kombëtar

Profili më i spikatur artistik mbetet "Teatri Kombëtar". Ai ka shërbyer dhe shërben si një shkollë e vërtetë për rritjen cilësore të teatrove të tjerë, si përvojë e aplikueshme, rezultative, që çon më tej arritjet e teatrit shqiptar në përgjithësi. Pas vitit 1990 TK provoi gjerazi shkollën dhe stilen të reja bashkëkohore në aktrim, regjisorë e scenografi; bëri pjesë të repertorit të tij autorë të ndaluar, "modernistë" si Jonesko, Beket, Mrozhek, sikundër u përpoq të japë pamje të reja historisë, dukurive sociale dhe njeriut





*Hyrja për në Sallën e Operas ku shfaqen operat, baletet dhe veprat koncertale*

kukullat me tela, teknikë e cila është përsosur më tej sot. Në vitet '60 shoqërimi muzikor nisi të bëhej më firzamonikë, jo më pllaka gramafoni si dikur. Më vonë u kalua në një teknikë radiofonike më të sofistikuar, deri në superpozim të këngës dhe fjalës.

#### Shkollat.

Në vitin 1959 u çel shkolla e lartë dramatike pranë "Teatrit Popullor", që mori emrin e aktorit të madh me origjinë

shqiptare Aleksandër Moisiu. Në vitin 1966 u bashkua me dy profilet e tjerë, muzikën dhe artet figurative dhe u krijua Instituti i Lartë i Arteve, sot Akademia e Arteve. Akademia e Arteve ka shërbyer e shërben si një fidanishte e artistëve të rinj; ka tre fakultete (arti skenik, muzika, artet figurative). Pedagogët e kësaj shkolle janë artistët më të zgjedhur të artit shqiptar. Vëmendja kryesore përqëndrohet në përvetësimin e mjeshtërisë, duke mëtuar si përvojën dhe stilin kombëtar, ashtu dhe përvojat dhe stilet e njohura të artit botëror. Ka një bazë të pasur metodike, programme shkencore kualifikimi, tekste të të gjitha lëndëve teorike e historike, leksione, punime shkencore e monografi, kushte pune të përshtatshme, një fond të pasur librash, kurse pasuniversitare, fonotekë e fototekë, arkiv etj.

#### Kritika dhe botimet.

Mendimi kritik në dhjetëvjetëshit e parë kishte karakter recensional me trajtime shpesh sociologjike. Sot kritika, karakterizohet nga toni polemist, prirja për shqyrtime më vehte të kompetenteve artistikë, si në teatër, muzikë, artet vizuale etj.

Janë botuar monografi për artistë të shquar, ndër ta për A. Moisiun, Zef Jubanin, Naim Frashërin, Mihal Popin, Kadri Roshin, Loro Kovaçin, Pirro Manin, Tefta Tashko Koçon, Vaçe Zelën etj.;

Janë shkruar tekstat e historive të arteve shqiptare (si ai për teatrin, artet figurative, muzikën), studime për traditat, për rrjedhat dhe prirjet aktuale të artit, për folklorin etj. Disa buletine periodike (dy mujore) si "Teatër", "Muzika" që nga

haptazi me veprat madhore botërore, bashkëpunimi me dirigjentë e muzikantë të njohur nga vendet e ndryshme, integrimi në tregun kulturor europian etj. Aktualisht TOB është teatri më i madh shqiptar. Deri në vitin 1990 ai kishte mbi 400 këngëtarë, instrumentistë, valltarë, punonjës të skenës etj. Sot numuri është më i reduktuar, disa artistë kanë emigruar në vendet e Europës.

#### Teatri i kukullave

Teatri i parë profesionist i kukullave filloi punën më 27 tetor 1950 në Tiranë. pjesa e parë që u shfaq në skenën e tij ishte "Fatbardha" pjesë nacionale. Në

fillimet e veta repertori u përballua me vepra të huaja, por me zhvillimin e letërsisë për fëmijë u bënë zotëruese pjesët nacionale. Në vitet 80, sidomos pas viteve '90, në shfaqjet e TKT u vërejt një rigjallërim i elementëve fantastikë e çudibërës duke shfrytëzuar më mirë subjektet e përrallave e legjendave popullore.

Deri nga mesi i viteve '50 dekoret ishin statike, më pas ato u bënë të lëvizshme, funksionale, rrjedhimisht më ekspresive. U përdorën elementë skulpturorë, çka theksoi plasticitetin e tyre. Nga kukulla me gishta, në vitin 1955 u kalua në



*Postera të shfaqjeve të vitit 2003 në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë.*

## Tirana si Qendër e Arteve Figurative


Murad Toptani (1866-1917), qytetar nga Tirana njihet si mjeshtri i parë i skulpturës moderne i periudhës së Rilindjes së Artit Figurativ Shqiptar. Ai krijoi vepra me tematikë patriotike ku shquhen dy buste të Skënderbeut (1899 dhe 1917).

Në fillim të viteve 30 të shekullit XX artistët dhe krijuesit më të mirë ishin mbledhur në Tiranë madje në një formë më të organizuar se sa më parë në Shkodër, Korçë ose gjetkë, duke formuar për herë të parë një ndërgjegje artistike kombëtare.

Ekspozita më e rëndësishme që dëshmon për këtë klimë Rilindase ishte "E para Ekspozitë Arti" e organizuar në Tiranë në 25 maj 1931 që ka hyrë në historinë e artit figurativ si e para ekspozitë kombëtare. Kjo ekspozitë kombëtare u moderua nga shoqëria "Miq të Artit", e cila është edhe e para shoqatë arti e krijuar po në Tiranë në të njëjtin vit. Po në këtë vit piktori A.Kushi hapi të parin "Kurs Pikturë" duke e bërë Tiranën përfundimisht qendër të mirëfilltë arti.



Bust i parë i Skënderbeut i realizuar nga Murad Toptani nga Tirana



Shfaqja teatrale "Kopshti i dallëndysheve" nga B.Cikliropulos, vënë në skenë më 1988

viti 1961 botonin drama, komedi, vepra muzikore, materiale teorike dhe metodike; në vitin 1980 u çel revista

tremujore "Skena dhe Ekrani", e cila botonte artikuj për probleme teorike dhe të praktikë krijuese në teatër, kinematografi, opera, estradë etj. Mendimi kritik lëvrohej gjerazi edhe në rubrikat e gazetës "Drita", të revistës "Nëntori", organe të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, si dhe në organe të tjera të shtypit.

Pas viteve '90, krahas faqes kulturore në gazetatat e shumta partiake apo të pavarura, mendimi kritik ka gjetur hapësirë edhe në organe të tilla shtypi si gazetatat "Drita", "Aks", "Ars", si dhe revistat "Studime për artin", "Pamorart" etj.

Prof. Dr. Josif PAPAGJONI





Tirana pikturuar nga Vangjush Mio në 1942

artistët më të mirë të vendit. Aktivitetet e tjera ishin kryesisht ekspozita vetiake.

### Krijimi i institucioneve të artit në Tiranë

Ngjarja e parë e madhe në artet figurative pas çlirimit të vendit është Ekspozita Kombëtare e hapur në prill 1945 në Tiranë.

Më 1946 u krijua edhe Shkolla e Mesme Artistike.


Mbas 1945, u bënë përpjekje të mëdha për krijimin e institucioneve të artit në përgjithësi dhe të artit figurativ në veçanti. Por Galeria e Artit u themelua

vetëm më 1954, ku u prezantuan veprat e mëdha të traditës dhe të kohës. 20 vjet më vonë, më 1976 u ndërtua një godinë e veçantë për Galerinë Kombëtare të Artit Figurativ që u pasurua me një numër të madh veprash.

Piktorët dhe skulptorët së bashku me artistët e skenës themeluan organizatën e tyre të quajtur "Lidhja e Artistëve" me synimin për të bashkuar forcat për krijimin e artit të ri të *realizmit socialist*.

### Formimi profesional i artistëve

Nxënësit që mbaronin Shkollën e Mesme Artistike në Tiranë zakonisht



Kapaku i Katalogut të parë të ekspozitës së parë kombëtare të hapur në Tiranë në Maj 1931

Një vit më vonë, në 1932, u hap në Tiranë e para "Shkollë Pikturë" e cila mbetet në trashëgiminë kulturore shqiptare si djepi i Akademisë së Arteve të Bukura të Shqipërisë. Në këtë shkollë erdhën për të mësuar nga të gjithë anët e vendit. Mësuesit e parë të kësaj shkolle ishin artistë si O. Paskali, A. Kushi, A. Buza, italiani M. Ridola dhe poeti i madh L. Poradeci (1896-1989).

Nxënësit e parë të kësaj "Shkolle Pikturë" që mësuan ndërmjet viteve 1940 dhe 1970 janë një plejade e njohur




Pazari i Tiranës, pikturuar më 1931 nga Mario Ridola, një nga mësuesit Italianë të Shkollës së Pikturës së Tiranës.

artistësh me famë kombëtare dhe ndërkombetare si B. Sejdini, K. Kodheli, N. Zaimi, F. Stamo, I. Kodra, Q. Grezda, Ll. Nikolla, F. Makoçi, H. Reçi, Z. Bumçi, S. Tuçi dhe shumë të tjerë që krijuan një fizionomi tepër origjinale të artit figurativ shqiptar.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm i periudhës së pavarësisë ishte gara ndërkombëtare për monumentin e Skënderbeut e zhvilluar në auditoret e Shkollës së Pikturës në Tiranë më 1937. Përveç artistëve vendas në këtë garë morën pjesë edhe artistë të njohur Evropianë. Çmimi i parë iu dha skulptorit të famshëm Kroat A. Agustiniç (1900-1979) dhe e drejta për zbatim iu dha skulptorit Italian R. Romaneli. Monumenti i Skënderbeut i krijuar nga Romaneli u vendos në "Piazza di Albania" në Romë dy vjet më vonë, në 1939.

Gjatë luftës së II Botërore (1939-1944) megjithëse kushtet për krijimtari u kufizuan së tepërmi, u organizuan disa ekspozita, më e rëndësishmja e të cilave ishte ajo e viti 1943, ku morën pjesë





Panje nga piktura moderne të ekspozuara në Expo-Onufri '99 në Galerinë Kombëtare të Artit Figurativ në Tiranë




Dimër në Tiranë, pikturuar nga A. Buza

vazhdonin kualifikimin e tyre në akademitë e arteve të Bashkimit Sovjetik apo në ato të vendeve të tjera të Lindjes. Më 1960, kur Shqipëria doli nga kampi i Lindjes, studentët Shqiptarë që studjonin në këto vende, u kthyen në atdhe. Po në këtë vit u hap Instituti i Lartë i Arteve sot i njohur si Akademia e Arteve. Ndërkohë u ngritën një sërë muzeumesh në rang kombëtar si Muzeumi Arkeologjik në Tiranë, Muzeumi Historik Kombëtar, etj. ku u ekspozuan dhe u vendosën në ruajtje shumë vepra me vlera të mëdha. Më 1986 u krijua Qendra e Studimeve të

Artit nën kujdestarinë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Për qëllime të promovimit dhe ruajtjes së trashëgimisë së pasur në fushën e artit figurativ është ngritur edhe Qendra e Riprodhimit të Veprave të Artit.

Ky rrjet institucional solli edhe krijimin e disa veprave monumentale në Tiranë si ai i Skënderbeut, me autorë O. Paskali, A. Mano, J. Paço i vendosur me mjeshtëri dhe elegancë në sheshin e qendrës së Tiranës me të njëjtin emër, si edhe monumenti "Nënë Shqipëri" i vendosur në varrezat e Dëshmorëve të Kombit.





O. Paskali, një nga mësuesit kryesorë të Shkollës së Pikturës së Tiranës.

Pothuajse për çdo vit, që prej vitit 1948, në Tiranë janë organizuar ekspozita të arteve figurative, më të rëndësishmet duke qenë ato të organizuara në përvjetore jubilarë të çlirimit, pavarësisë apo ngjarje të tjera jubilarë në nivel kombëtar. Me po të njëjtën frekuencë dhe përkatësi janë zhvilluar edhe aktivitete kombëtare. Konkursi i parë u shpall më 1948 për krijimin e një monumenti të Skënderbeut i fituar nga skulptori Janaq Paço (1914-1989) me "bocetën" e tij e cila 10 më vonë u derdh në bronx dhe u vendos në Krujë më 28 nëntor 1959, ku është edhe sot.

Një numër i madh veprash të rëndësishme dhe me vlera u krijuan në artet figurative duke përdorur një gamë të gjerë mjetesh dhe lëndësh dhe duke zhvilluar për herë të parë të gjitha zhanret dhe format e saj që nga grafika e thjeshtë, vaji, akuareli e deri tek tekstili, xhami,

skenografia, qeramika, etj duke krijuar vepra me forma nga më të ndryshmet deri tek muralet me mozaikë, një prej të cilave, me vulën e pamohueshme të kohës kur u krijua, është vendosur në fasadën e Muzeut Historik Kombëtar.

### Lufta për liri krijuese

Mes këtyre veprave, megjithëse të krijuara nën tryshninë e çensurës dhe autoçensurës së realizmit socialist, spikasin vepra që nuk kanë të bëjnë fare me këtë metodë të huazuar bolshevike, duke nxjerrë në pah vlerat e disa artistëve të mëdhenj shqiptarë të rritur në atmosferën moderne të Tiranës, e cila jo rrallë ka çuditur botën me talentin e qytetarëve të saj, pavarësisht nga koha kur kanë jetuar dhe regjimi në pushtet.

Në kushtet e një izolimi ndaj zhvillimeve në artin bashkëkohor për më se 40 vjet me radhë, artistët dhe krijuesit shqiptarë kanë bërë gjithnjë përpjekje për më shumë liri në krijimtarinë e tyre. Këto përpjekje për demokratizimin e artit figurativ u shfaqën në ekspozitën e vitit 1971 duke arritur pjekurinë e tyre dhe pikën kulmore në Ekspozitën "Pranverë 1972" hapur po në Tiranë. Sidoqoftë kjo ekspozitë u kritikua në mënyrë të ashpër dhe u çensurua duke ravijëzuar dhe nxjerrë në pah edhe artistët disidentë shqiptarë si E. Gjergo, E. Hila, A. Oseku, M. Velo, etj.

### Artet figurative në Tiranë pas vitit 1990

Tirana nuk është vetëm qyteti i bareve dhe mercedesit, siç mundohen ta paraqesin disa vendas apo të huaj, por edhe Qyteti i Galerive Private të Artit

Figurativ që kanë pushtuar gjithë rrugët më të rëndësishme dhe tregëtare të qytetit. Në këtë Galeri sheh punime në zhanre, stile, materiale dhe forma të ndryshme. Përveç përqafimit me shpejtësi marramendëse të tendencave të kohës prej artistëve të rinj të talentuar që ekspozojnë sa në Tiranë edhe në qytetet e tjera të Evropës, ka edhe artistë që krijojnë akoma në stilin e realizmit socialist

Me ardhjen e demokracisë mund të themi se Tirana është kthyer në një qendër të spikatur arti figurativ në rang Evropian. Kjo është arsyeja që Bienalet, këto festivale të artit modern, tashmë kanë gjetur vendin e përshtatshëm dhe

disa herë rresht bëhen në këtë qytet të artit.

Pavarësisht se jo shumë kohë më parë artistët shqiptarë ishin të izoluar mizorisht, ato po krijojnë me dinjitet bashkë me artistët e Evropës figurat dhe format e kohës ku jetojmë, duke e integruar plotësisht Shqipërinë në artin Evropian dhe duke ruajtur origjinalitetin kombëtar dhe personal.

Artistët shqiptarë aktualisht janë të organizuar në disa shoqata të ndryshme në varësi të zhanreve dhe vullnetit të tyre, pavarësisht se Lidhja e Artistëve (krijuar që më 1952) ekziston akoma me një platformë krejtësisht tjetër nga ajo e viteve të diktaturës.



"Albania fantastica" pikturuar nga Ibrahim Kodra një nga nxënësit më të suksesshëm të Shkollës së Pikturës së Tiranës.

Në 1993 u hap në Tiranë e para Galeri Arti private, "Te & Gi", me iniciativën e një grupi artistësh përparimtare. Nuk vonoi shumë dhe galeri të tjera private arti të madhësive dhe rëndësie të ndryshme mbinë si këpurdhat duke e kthyer Tiranën në një qendër të madhe arti. Ndërkohë Galeria Kombëtare e Artit Figurativ është mirë-integruar në aktivitete kombëtare dhe ndërkombetare

si Ekspozitat dhe konkurset me famë Onufri, Marubi dhe së fundi Bienalet në të cilat marrin pjesë rregullisht artistë nga shumë vende të tjera.

Tirana, për bukuritë natyrore që e rrethojnë, është gjithashtu edhe motivi më i preferuar i shumë piktorëve shqiptarë e të huaj që e kanë përjetësuar atë në disa qindra vepra arti.



**Prof.Dr. Ferid HUDHRI**  
Qendra e Studimit të Arteve  
Akademia e Shkencave, Tiranë.

## TURIZMI NË TIRANË DHE PËRRETH SAJ

Tirana është qytet i këndshëm për të jetuar dhe kaluar kohën e lirë apo pushimet.


Klima mesdhetare, me dimër të butë dhe verë në disa raste të nxehtë, afërsia

me detin Adriatik, kurora e kodrave përreth, vargmalet e larta dhe të bukura në lindje dhe të begatë me pyje, burime, lumenj dhe përrenj, janë premisa për një jetë cilësore në kryeqytetin e Shqipërisë.




Kapaku dhe frontespisi i Guidës së parë të Shqipërisë ("Guide de L'Albanie") realizuar dhe botuar nga Leon Rey me 1930, dorëzuar për këtë botim nga z. Zhani Canco, Architect.





Harta e parë turistike e Tiranës realizuar nga Jean Schweitzer botuar nga Leon Rey në "Guide de L'Albanie" më 1930, dorëzuar për këtë botim nga z. Zhani Canco, Arkitekt.



Harta e qendrës së Tiranës marrë nga "Çelësi" 2003


Tirana ka qenë dhe mbetet e famshme për pamjet e saj panoramike të shumëllojshme me pejsazhet e saj kodrinore dhe malore dhe me fushat e përshkuara nga lumenj dhe përrenj të zhurmsëm dhe të qetë.

Jeta turistike në Tiranë shihet si në zonat qendrore të saj ashtu edhe në pika të shumta përreth saj në periferi apo në fshatrat kufi me të.

Qendra e Tiranës ka qenë gjithnjë tërheqëse për atmosferën e mrekullueshme e cila ka qenë dhe mbetet

e pranishme prej themelimit të saj deri në ditët tona. Kjo veçanti e saj është theksuar edhe nga shumë udhëtarë dhe studjues të huaj si Eduard Lear, Edith Durham dhe Leon Rey. Ky i fundit hartoi dhe botoi edhe Guide of Albania më 1931. Harta e Tiranës dhe kapitulli mbi të e përshkruajnë mjedisin e qendrës së këtij qytetit që në atë kohë përfaqësohej me zonën e Pazarit.

Qendra e Tiranës ka ndryshuar si në krijimin e qendrave të reja krahas atyre të vjetrave ashtu edhe në përshtatje me




*Pamje nga bregu i liqenit dhe i pyllit në Parkun Kombëtar të Tiranës.*

c-Qindra bare dhe kafé me çmime që variojnë prej 25 deri 200 lekë kafeja (ekspresso Italiane e njëjtë si në Itali; disa shërbejnë edhe kafe Turke). Në zonën e Bllokut densiteti i bareve në disa vende arrin mbase rekord në mbarë botën: bare dhe kafene dhe restorante dhe pastičeri, dhe plotë me njerëz gjatë tërë ditës si lumë!

Të huajt që vijnë për herë të parë në Tiranë shpesh pyesin: punon njeri këtu?

Duket sikur të gjithë pijnë kafé për orë të tëra! Një përgjigje e zgjuar do të ishte: ato po diskutojnë për punën në kafe, po "negociojnë". Edhe në traditën Tiranase, kur do të fiksosh një takim pune thuhet "kur do e pimë kafenë": Dhe këshilla është që duhet filluar gjithnjë me një kafe, paçka se kjo "kafé" shpesh kthehet në qingj të pjekur në hell me verë apo një pica me birra, në se "kafeja" (takimi) lihet për orën e drekës. Shumë të huaj kanë rënë viktimë e kësaj "kafeye" Tiranase por siç edhe thuhet në gjithë botën "në Romë bëj si bëjnë Romakët". Kështu që në Tiranë pijnë kafenë si Tiranasi. Fakt është



*Pamje ajore e bar-restorant Juvenilia në hyrje të Parkut Kombëtar të Tiranës*

që të gjithë të huajt që punojnë gjatë në Tiranë, pasi habiten në ditët e para, e mësojnë shpejt zakonin e kafesë, madje më mirë se sa vendasit.

Një mundësi tjetër për të shijuar kafenë luksoze të Tiranës në çdo kohë është prezenca e dhjetra bareve dhe kafeneve në mjediset e Parkut të Madh të Liqenit në jug të qytetit, në fund të Bulevardit të Madh "Dëshmorët e Kombit" duke filluar tek ndërtesa madhështore e korpusit qëndror të Univeristetit të Tiranës dhe deri tek Kopshti Zoologjik në njërin anë e Pallati i Brigadave në anën tjetër. Në këtë Park mund të shkosh në këmbë për 10-15 minuta nga Blloku apo me makinë vetëm për 2-5 minuta. Perimetri i Parkut është i pasur në bare dhe restorante të thjeshta dhe luksoze për të gjithë llojet e klienteve duke ofruar mjedise të mrekullueshme mes një pylli me pisha, ekualipte, lisa, bredha, lule, etj ku mund të gesh freski në verë si edhe mund të rrish mjaft mirë edhe në diellin e janarit. Dhe me këtë mrekulli fare pranë punës e zyrës mund të ndërrosh mjedis fare lehtë

kohën, për të ardhur në ditët tona me disa zona qendrore (qendra) nga pikëpamja tregëtare, kulturore dhe njerëzore si më poshtë:

Tirana e Re, i ashtuquajtur "Bllok" i vilave të dikurshme të anëtarve të byrosë politike të qeverisë komuniste, dikur zonë e ndaluar për kalim nga populli dhe sot zona më e populluar me njerëz zyra, biznese, bare dhe restorante.

Zona ndërmjet rrugëve : Rruga e Durrësit, Rruga e Kavajës, Rruga Myslym Shyri dhe përreth.

Zona prej Sheshit Skënderbej në Pazari e Ri (Sheshi Avni Rustemi)

Bulevardi Zog I.

Këto zona paraqesin një kombinim shumëllojshëm e ku mund të dallojmë :

a-*Dyqane dhe boutique* moderne dhe ekonomike që prej produktve kineze, bizhuterive Turke dhe deri tek këpucët e dhe bizhuteritë e modës së fundit Italiane.

b-*"Tymin"*, klubin tradicional të "një qofte me birra" deri tek restorante elegante, luksoze dhe tepër të shtrenjta edhe në rang ndërkombëtar si Rozafa pranë sheshit të Sulejman Pashës, apo Piazza pranë Muzeut Kombëtar, Juvenilia pranë Stadiumit Qemal Stafa etj. Shumë bare dhe restorante kanë orkestra apo kënetarë profesionistë të muzikës jazz, pop, folk apo mikse.



*Pamje nga Parku Rinia para (pushtuar nga kioskat) dhe pas rehabilitimit*







Foto nga lart e bar-restorantit në majë të kështjellës së Petrelës hapur në 2003

Tirana ka pothuajse çdo ditë fluturime direkte për në Itali (Romë, Milano, Bari, Rimini, Ancona), Austri (Vienë), Hungari, (Budapest), Turqi (Stamboll), Greqi (Athinë), Slloveni (Lubljana), Kosova (Prishtina), Jugosllavi (Beograd), Bullgari (Sofie), FYR Maqedonia (Shkup) etj.

### TURIZMI PËRRETH TIRANËS

Turi turistik më tradicional në Tiranë është udhëtimi për në malin e Dajtit (lartësia max. 1612m) ku mund të shkohet më këmbë ose me automjet. Mali i Dajtit është një Park Kombëtar duke pasur kështu një status të veçantë turistik dhe mbrojtjeje të natyrës në një zonë prej 3.3 ha që shpejt mendohet të bëhet rreth 20 ha për fondin pyjor, faunën dhe florën e kësaj zone ku jetojnë shumë kafshë mes të cilëve edhe ariu i murrmë.

Në një lartësi 1000 m mbi nivelin e detit në malin e Dajtit hapet një fushë e gjerë në madhësinë e disa stadioneve futbollit duke krijuar lëndina dhe livadhe të mrekullueshme ku janë krijuar mjedise



Pamje të hyrjes dhe të brendësisë së shpellës së Pullumbasit .



Pamje të prodhimeve mjekësore në një fushë pranë Tiranës

vetem disa minuta larg më mirë se në çdo qytet apo metropol tjetër të Evropës.

Parku i Madh i Liqenit dhe zona e Bllokut pranë ofrojnë okazione të panumërta për amatorët e të ecurit dhe shëtitjeve për të shijuar sa natyrën ashtu edhe harenë e zhurmëshme të rrugës. Shumica e kalimtarëve në këto zona janë studente apo vajza dhe djem të shkollave të mesme plot jetë dhe gjallëri që i japin ngjyra tepër optimiste trotuarëve dhe lulishteve të shumta duke dhënë pejsazhe të një jete gazmore dhe tërheqëse.

Në zonat qendrore tregetare dhe kulturore, turisti dhe banori mund të përfitojë nga programi tepër kontemporan i dy kinemave tashmë të famshme të qytetit, Millenium I dhe Millennium II shfaqjet muzikore në Opera apo shfaqjet e Teatrit Kombëtar apo në skenën e Akademisë së Arteve. Ngjarje të mëdha muzikore apo spektakle të rëndësishme në nivel kombëtar apo ndërkombëtar si , Festivali vjetor i muzikës së lehtë, Miss Albania, show të grupeve të huaja pop dhe jazz, etj, Miss Europa, etj, organizohen edhe në Pallatin e Kongreseve apo në të ashtuquajturën "Piramida" ku është edhe Qendra e Kulturës Ndërkombëtare, (e pa imagjinuar nga diktatura disa vjet më parë: që mauzoleu i Enver Hoxhës të kthehej në qendër të kulturës ndërkombëtare, të cilën Enveri u përpoq ta mbante sa më larg nga Shqiptarët).

Interes të veçantë turistik dhe njohës paraqesin vizitat në Muzeun Historik Kombëtar, Galeria Arteve Figurative, Galeri private piktore (si Te&Gi etj) sepse dihet tashmë që piktorët e shqiptarë janë të famshëm në mbarë botën.

Tirana ka shumë biblioteka dhe një numër të pafund librashitësish sepse shqiptarët, edhe pse TV ushtron ekspansionin e vet, vazhdojnë të jenë një nga popujt që lexojnë libra më shumë në rang botëror. Në librashitësit e zonave të qendrës gjen edhe libra në shumë gjuhë të botës veçanërisht në English, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht Gjermanish, etj.

Një numër stacionesh Radio - TV kanë programe interesante ku dallohen *Radio Tirana*, *RTSH*, *Top Albania Radio*, *Top Channel*, *Klan*, *TVA*, etj.

Në Tiranë ka disa vite që janë prezent edhe shërbime private të çdo lloji si në çdo qytet Evropian dhe shpesh më të mira





Foto të malit të Dajtit në dimër dhe verë, nga Denis Mani

dhe me ekonomike si psh: *Internet cafës*, *taxi*, *shtëpi me qera*, etj. të cilat gjenden lehtë nga turistët në rrugët kryesore ku janë të dukshme një numër i madh agjencish apo qendra të tjera shërbimesh sa më sipër.



Kapakët e disa publikimeve të rëndësishme në vitet 1970-2003 për promovimin e vlerave kulturore dhe turistike të Tiranës

sportive për verë dhe ku bëhet ski në dimër. Kjo është Fusha e Dajtit që shërben edhe si pikë qëndrimi dhe argëtimi. Turi turistik më këmbë (ecje që zgjat nga 4-7 orë) ka krijuar në vite rrugë dhe shtigje këmbësorësh mjaft të bukura prej fshatit Linzë deri në Fushën e Dajtit. Turi i Malit të Dajtit është përmendur edhe në të parën "Guide of Albania" të Leon Rey të botuar në 1931. Lajm i mirë është që një investim Shqiptaro-Austriak po ndërton një teleferik që do të bëjë të mundur arrijtjen në Fushën e Dajtit në më pak se 15 minuta. Kjo do të shtojë numrin e vizitorëve të të gjithë moshave duke uruar të mos pakësojë numrin e atyre amatorëve të Turit të ecjes (këmbësorët) për të ruajtur këtë traditë Tiranase që mbase është më e shëndetshme se të tjerat.


Një tjetër tur tradicional dhe familjar është Turi i kalasë mesjetare të Petrelës

që ndodhet vetëm 12 km larg qendrës së Tranës. Një restorant luksoz dhe tradicional është ndertuar në kullat dhe bedenat e kalasë në kuadër të një restaurimi modern të kështjellës të ndërmarrë nga arkitektë të talentuar shqiptarë në bashkëpunim me Komunën Petrelë dhe nisma private të fshatit të Petrelës.

Pjesë e Turit të Kalasë së Petrelës mund të futet edhe sporti i qitjes dhe i gjuetisë që ofrohen nga një qendër sportive dhe agëtimi në fshatin Mullet të Komunës Petrelë. Këtu gjenden edhe shumë restorante tradicionale dhe luksoze, disa syresh edhe me pishina moderne dhe argetime të ndryshme për fëmijët dhe moshat e ndryshme.

Po në të njëjtën rrugë për në Elbasan, vetëm 2 km më tej kthesës që të çon në Kalanë e Petrelës, aty ku fillon Komuna Berzhitë, turisti mund të kthehet majtas për të vazhduar në Turin e Shpellës së Pëllumbasit që gjendet vetëm 6 km larg rrugës kombëtare për në Elbasan. Deri në fshatin Pëllumbas shkohet me automjet ndërsa 4 km e fundit bëhen më këmbë në një rrugë këmbësorësh, me pamje dhe pejsazhe të mrekullueshme kodrinore, që zgjat rreth një orë.

Turi i Shpellës së Pëllumbasit (përshkrimi i shpellës jepet me hollësi në kapitullin *Dëshmitë arkeologjike në rrethin e Tiranës* të Prof. Muzafer Korkuti ,faqe 129) ka filluar në mënyrë të organizuar vetëm disa kohë më parë si një bashkëpunim i projektit "Forumi i Projekteve të Zhvillimit me Pjesëmarrjen



Kapaku i një udhezuesi frazeologjik praktik për mesimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe për anglisht folësit, vendosur në pemën e stilizuar të gjuhëve indoevropiane marrë nga fjalori Webster 1975



Informacioni i kësaj Guide ndodhet edhe në internet në web site: [www.albanianculturalheritage.com](http://www.albanianculturalheritage.com), apo në [www.seda.org.al](http://www.seda.org.al) dhe [www.shqipëria.com](http://www.shqipëria.com)

Është shtuar numri i Turistëve të huaj që kanë interes të mësojnë shprehje praktike të gjuhës shqipe me synim që ta

përdorin atë gjatë qëndrimit në Shqipëri. Për këtë është përgatitur një metodë praktike me titull "NO PROBEM" e cila ka ngjallur mjaft interes në botimin e parë dhe është duke u përgatitur edhe botimi i dytë që do të dalë në qarkullim së shpejti. Përmbajtja e kësaj metode gjendet edhe në internet në adresën [www.seda.org.al](http://www.seda.org.al)

Genc MYFTIU

e Komunitetit" të OJFSEDA me Institutin e Arkeologjisë dhe Komunën e Bërzhitës si edhe me Projektin e Pyjeve Komunale të Bankës Botërore. Puna është në proces për ide dhe nisma të reja për këtë pikë të rëndësishme turistike që padyshim do të jetë shumë shpejt një nga qendrat më të rëndësishme turistike të metropolit të Tiranës.

Një tjetër kështjellë e bukur është ajo e Prezës e cila e meriton të ketë një turistik të veçantë si për vetë mjediset tradicionale dhe historike ashtu edhe për pamjet panoramike që dhuron: kur je aty aeroporti Rinasit duket si në pëllëmbë të dorës në njërin anë dhe bregu i detit në anën tjetër; mbi aeroport duken si në kartolinë qyteti historik i Krujës dhe vargmalet që prej Malit të Dajtit deri tek Tomorri... Disa restorante tradicionale i plotësojnë më së miri këtë kërkesat e turistit të çdo niveli, kulture apo kombësie. Pronari lokalit gjen rastin dhe të thotë se në këtë Kështjellë është martuar edhe Skëndërbeu dhe mbase ju jeni ulur pranë vendit ku ka qënë ulur nusja e Skëndërbeut.

Një tjetër tur, më shumë lokal dhe familiar se sa për turistët e huaj, por tepër i frekuentuar për Tiranësit dekadat e fundit, është një udhëtim i shkurtër në Pezë, fshat i njohur për konferencën e famshme antifashiste të shtatorit 1942 ku shqiptarët si rrallëherë vendosën të bashkohen kundër pushtuesve pa dallim feje krahine dhe ideje. Disa restorante komode ofrojnë gatime tradicionale dhe mish kafshësh e shpezësh të egra si mëllenjë, lepur, etj me çmime mjaft ekonomike.

Anës rrugës për në Pezë, Prezë dhe Petrela janë ndërtuar një seri fushash sportive mini futbollit, pishina, etj duke krijuar mundësi argëtimi për pushuesit dhe turistët veçanërisht gjatë fundjavës.

Mjedise të tjera sportive dhe zbavitje si për fluturime të lira, qitje me pjatela, (pranë Mulletit) ecje me kuaj gare, gara makine në pista dhe makina speciale (Kartodromi në Sauk) pishina dhe fusha sporti të panumërta, shtohen për çdo ditë dhe janë bërë shumë popullore në Tiranë e vitit 2003.

Përmirësimi i ndjeshëm i infrastrukturës rrugore dhe rritja e nivelit të transportit vetiak dhe privat ka bërë që plazhet e Durrësit dhe Kavajës të jenë shumë afër, aq sa mund të thuhet se janë pjesë e Tiranës, duke e pasuruar së tepërmi mundësitë dhe oportunitetet e banoreve, pushuesve dhe turistëve.

Informacion më të hollësishëm dhe pika kontakti për turet dhe zbavitjet e mësipërme jepen në disa guida turistike si Tirana Pocket Guide, The Practical Guide of Tirana, Çelësi Tiranës-key of Tirana), Tirana official Guide etj., . Ky informacion mund të gjendet edhe në disa web site si : [www.tiranaguide.com.al](http://www.tiranaguide.com.al) apo [www.shqipëria.com](http://www.shqipëria.com)

Turisti i huaj që ka më shumë interesa në fushën e kulturës dhe historisë Shqiptare në tërësi apo për fusha të veçanta të saj mund të shuajë kureshtjen apo të udhëzohet duke lexuar Guidën "Albania a patrimony of European Values" (Shqipëria Treve e Vlerave Evropiane) si edhe Guida të tjera.


- BERNARD R., - "Essai sur l'histoire de l'Albanie moderne", Paris, 1935.
- DEGRAND A., - "Souvenirs de la Haute Albanie", Paris, 1901
- Susan Hyman -"Edward Lear in the Levant , Travels in Albania, Greece, and turkey in Europe , 1848-1849"
- Pleurat Sulo , Francesk Ziri "Album of paintings of A. Buza printed in Kombinati Polgrafik Tirane
- Leon Rey, Guide D'Albanie, 1930, Paris
- Sami Frasheri,"Kamus-ul alam, I-VI," Istanbul, 1889-1898,"Vepra, 1,2,3,4," Pristina, 1978.,"Vepra, 1,2", Tirana, 1988.
- GARDES Gilbert, - "Le guide de l'Albanie", Lyon, 1995.
  
- Besnik Aliaj, Historic overview of Tirana and its planing. Urban environmental management of Cities, Copenhagen, Denmark 1995
- Besnik Aliaj, The Role of NGOs and CBOs for Housing for Low-Income People. the case of Tirana. IHS Rotterdam the Netherlands, 1996
- REGIONAL CONSULTING AUSTRIA , ZHVILLIMI I QYTETIT TE TIRANESPERMBLEDHJE E SHKURTER FAZA E PARE JANAR 1996
- Co-PLAN , City made by People, Volumi 1 (1998) dhe Volumi 2 (2000). Shtepia Botuese Mesonjtorja.
- B.ALIAJ, L.DEDA, D.SHUTINA, CO-PLAN, CO-PLAN PUBLICATIONSOCTOBER 1997SOCIAL-ECONOMIC UPDATING FOR BREGLUMASI PILOT SITE(LAPRAKA / TIRANA - ALBANIA)
- Besnik Aliaj, Pilot actions for community based planing in irregular settlements of Tirana, City and Culture Urban sustainability and Cultural Proceses, Stockholm, 1998, ,
- CO-PLAN, CO-PLAN PUBLICATIONS,14 SEPTEMBER 2000, REPORT OF THE WORKSHOP TIRANA 14.09.2000URBAN IMMOVABLE PROPERTY REGISTRATION (SPECIAL REFERENCE TO KAMZA)
- CO-PLAN,CO-PLAN PUBLICATIONS FINAL REPORT ON:SOCIAL ASSESSMENT, PHYSICAL SURVEY, PRE FEASIBILITY STUDY, PREPARATION OF CONCEPT PLAN & DRAFT OF COM. PARTICIPATION AGREEMENT FOR SELITA, M. GRAMENO, BATHORE 2, FRUTIKULTURA NEIGHBOURHOODS OF TIRANA, ALBANIA
- BESNIK ALIAJ & CHRIS BERRY, CO-PLAN & IFS, CO-PLAN PUBLICATIONS, MAJ 8 2002ASISTENCE PER PLANIN RREGULLUES TE BASHKISE TIRANERAPORT 1 (10-20-PRILL 2002)
- CHRIS BERRY,CO-PLAN PUBLICATIONS,MAY 9 2002, TIRANA PLANNING MISSION 10-20 APRIL 2002
- THE EUROPEAN SPATIAL DEVELOPMENT PERSPECTIVE (E.S.D.P.) (COMMENTS & RECOMMENDATIONS FROM THE EUROPEAN CONSULTATIVE FORIUM ON THE ENVIRONMENT & SUSTAINABLE DEVELOPMENT JANNUARY 1999)
- CO-PLAN PUBLICATIONS.FINAL REPORT, IMPROVING ACCESS AND CREATION OF BASIC SOCIAL INFRASTRUCTURE THROUGH EMERGENCY LABOR PROJECTS IN BATHORE AREA (MUNICIPALITY OF KAMZA - TIRANA DISTRICT) JULY 2001



- PADCO PUBLICATIONS MARCH 1995, FINAL DRAFT TIRANA LAND MANAGEMENT PROGRAM, TRUNK INFRASTRUCTURE NEEDS ASSESSMENT FOR GREATER TIRANA AND TERMS OF REFERENCE FOR TRUNK INFRASTRUCTURE PREPARED: LAND MANAGEMENT TASK FORCE & USAID&PADCO
- PLANI STRATEGJIK PER TIRANEN E MADHE STUDIMET BAZE ANALIZA FINANCIARE E SIGURUESVE TE PERZGJEDHUR TE SHERBIMEVE INFRASTRUKTURORREPROJEKTI I MANAXHIMIT TE TOKES URBANE & PADCO PROJEKTI I MANAXHIMIT TE TOKES URBANE & PADCO PADCO PUBLICATIONS JANAR 25 2002
- FLAMUR KUCI, CO-PLAN, CO-PLAN PUBLICATIONS GETTING STARTED A RENEWAL PROJECT IN INNER TIRANA PRELIMINARY INSTITUCIONAL ANALYSIS/ REPORT ON PROJEC"URBAN REHABILITATION & HOUSING IMPROVEMENTS FOR A QUARTER IN TIRANA" MAY 2000
- GTZ, STUDIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL TIRANE-DURRES, DREJT NJE ZHVILLIMI TE QENDRUESHEM TE RAJONIT TIRANE-DURRES. KONCEPT ZHVILLIMI (DRAFTI FINAL) SHKURT 2002
- CELES I TIRANES 2003, UDHERREFYESI PRAKTIK DHE HARTA E KRYEQYTETIT / THE PRACTICAL GUIDE AND MAP OF TIRANA, ADRESAR / GUIDE, 2003


## BIBLIOGRAFI

- Maket i Arkitektures Shqiptare, Group of authors, Academy of Science of Albania, published in 1974
- BAÇE Apollon, MEKSI Aleksandër, RIZA Emin, KARAIKKAJ Gjerak & THOMO Pirro, "Historia e arkitekturës shqiptare". Tirana, 1979
- Koço Miho, "Trajta te profilit urbanistik te Tiranes", published by 8 Nentori, Tirana 1987
- Giovanni Sergi, "Albania, ex-Yougoslavia, crescita urbane, identita culturale, sviluppo sostenibile", CLUA Edizione, Ancona, 1996
- Silvia Russo, "Tesi di Laura, Politecnico di Torino, Faculta di Arcitettura, "L'arcitettura coloniale Italiane-tipologie, edilizie, tecnica e costruzioni in Albania", 1998
- Besnik Aliaj "Planifikimi Urban", vol. 1, printed by Ombra 2003.
- Genc Myftiu & group of authors, "Albania e Patrimony of European Values", published by SEDA and FILD, 2000
- "Historia e Qytetit te Tiranes, Shqypnia e ilustrime". 1937
- Artan Lame, "Tirana ne kartolina deri ne vitin '44". Printed by TOENA and IGLI, 2000
- Luan Zelka, "Tirana objekt dhe subjekt i shtypit shqiptar". Botime Enciklopedike, 2000
- "Hafiz Ibrahim Dalliu, Patriotizmi ne Tirane", Imazh 1995
- G.A. Bakiu, A.Degrad, O.Myderizi, Z, Bakiu, "Qyteti i Tiranes", printed by "Erik", 1998
- Lazer Radi, "Shqiperia ne vitet 30t"
- Skender Jasa, "Tirana ne Shekuj", Monography, printed by Viktoria 1997
- Institute of History, Akademy of Science of Albania, group of authors "Historia e Popullit Shqiptar , Volumi I, II, printed by TOENA 2002
- BUDA Aleks, - "Shkrime historike, I, II," 1986, IV, 2000.
- "Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, II-III" 1962-1965.
- Z. Shkodra "Dokumente mbi Shqipërinë në shek. XVIII, I" (1696-1707), 1975.
- ROSATI Umberto, - "Condizioni agronomiche dell'Albania, Condizioni economico-agrarie dell'Albania in Relazione della Commissione per lo studio dell'Albania, II", Roma, 1915.
- SPENCER Edmund, - "Travels in European Turkey, through Bosnia, Servia, Bulgaria Macedonia, Thrace, Albania and Epirus" London, 2, 1853
- SHKOZA Haxhi, - "Financat e Shqipnis (1839-1934)", Tirana, 1935.
- HUDHRI Ferid, - "Albania and Albanians in world art", Athens, 1990
- HUDHRI Ferid, - "Murat Toptani. Artist dhe patriot", Tiranë, 1978.



Pamje e maketit të Qendrës së Tiranës, Projekti Fitues i Studios Franceze "Architecture Studio", ekspozuar në Galerinë Kombëtare të Arteve. Foto A. Babani





1954

K/201

Tri foto të Tiranës në kohë të ndryshme nga fotografi P.Kumi